

ILIR RRUGA



Modelet ndriçuese

*Haxherja  
dhe  
Sara*



MODELET NDRIÇUESE  
HAXHERJA DHE SARA

---



Shkup, 2015

**Autor:**  
Assis. Prof. Ilir RRUGA

**Recensent:**  
Hasan BAFTIJARI

**Lektor:**  
Namir LAPARDHAJA

**Korrektor:**  
Agim ABAZI

**Faqosja:**  
Furkan ISM

**Kopertina:**  
Jusuf SALIU

**Botues:**



**SHB "Furkan ISM"**

Brigada II Maqedonase lok. 22, 1000 Shkup

Tel./Fax. (02) 26 22 360

[http:// www.furkan.com.mk](http://www.furkan.com.mk)

E-mail: [furkan@furkan.com.mk](mailto:furkan@furkan.com.mk)

**Shtypi:**

Furkan Print - Shkup

Tel./Fax. (02) 26 22 360

Modelet ndriçuese

*Haxherja*  
*dhe*  
*Sara*

Assis. Prof. ILIR RRUGA



Furkan ISM  
2015

Të gjitha të drejtat e këtij libri janë të rezervuara. Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës, duke treguar referencën e plotë.

CIP - Каталогизација во публикација  
Народна и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

RRUGA, Ilir

Modelet ndriçuese : Haxherja dhe Sara / Ilir Rruga. - Shkup:  
Furkan ISM, 2015. - 272 стр. ; 21 см

Фусноти кон текстот. - Autori: стр. 266-267. -

Библиографија: стр.  
258-265

ISBN 978-608-216-111-2



9 786082 161112

а) Ислам

COBISS.MK-ID 98724618



*“Allahu e zgjodhi (pejgamber) Ademin, Nuhun, familjen Ibrahimit, familjen e Imranit mbi popujt e tjerë (të asaj kohe).” (Ali Imran: 33)*

*“Ju e keni shembullin më të mirë të Ibrahimit dhe të atave që ishin me të, kur i thanë popullit të vet: “Ne tërhiqemi prej jush dhe prej asaj që adhuroni, pos Allahut, nuk besojmë tuajën, prandaj ndërmjet nesh e jush është e hapët armiqësia e urrejtja derisa ta besoni vetëm Allahun Një!” (Nuk e kemi shembull) Me përjashtim të fjalës së Ibrahimit thënë babait të vet: “Unë do të kërkoj falje për ty, po unë nuk kam në dorë asgjë për ty të Allahut!” Zoti ynë, vetëm Ty të jemi mbështetur, vetëm nga Ti jemi të kthyer dhe vetëm te Ti është e ardhmja!” (El-Mumtehine: 4)*

*“Ne po të rrëfejmë saktë çështjen e tyre. Ata ishin disa djelmossa, kishin besuar Zotin e tyre, e Ne atyre edhe më ua shtuam bindjen.” (El-Kehf: 13)*

## PARAFJALË

Falënderimi i përket vetëm Allahut, Zotit të botëve, Krijuesit dhe Sunduesit të Gjithësisë. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij “Khatemu’l-Enbija” (profetin e fundit), Muhamedin [sal-lallahu alejhi ve sellem]. Paqja dhe mëshira e Allahut të Madhërishëm qofshin mbi babain e profetëve, Ibrahimin [alejhis-selam], dhe mbi familjen e tij.

Në çdo periudhë të historisë, popujt janë zhytur në batakun e injorancës dhe imoralitetit, madje, me vetëdije, janë larguar nga vlerat e larta jetësore. Allahu i Madhërishëm, nëpërmjet disa njerëzve të zgjedhur, i ka shpëtuar ata popuj dhe ua ka treguar rrugën e vazhdimit të jetës së ndershme, ose ndarjes ndershmërisht prej saj. Profetë e njerëz të besueshëm, dijetarë dhe njerëz të mirë. Ishin pikërisht këta, që Allahu i Madhërishëm zgjodhi si pishtarë pararojë, për të ndriçuar popujt nga netët që po errësoheshin.

Në historinë Islame, siç hasim burra të lartë dhe trima, hasim dhe gra me besim të fortë e virtyte, me simbole devotshmërie dhe ndershmërie. E veçanta e këtyre shembujve është se ato e kanë përvetësuar më së miri mesazhin e Islamit dhe e kanë krijuar imazhin e gruas muslimane ashtu siç duhet.

Njerëzia sot qëndron pranë një humnere, një batakut të madh. Kjo gjendje nuk është gjë tjetër veçse pasoja e largimit nga feja e drejtë e Islamit dhe mosmarrja shembull e njerëzve



të zgjedhur. Një jetë e shëndoshë dhe e devotshme mund të krijohet vetëm poshtë hijes së pemës së vlerave të çmuara njerëzore.

Mundësia e krijimit të një jete me virtytet e larta të Islamit do të lindë, nëse në jetën tonë do të mbizotërojë bashkimi i anës shpirtërore me atë materiale. Sigurisht, duke iu referuar grave shembullore/prijëseve muslimane, si mund të përmendim: Sara, Haxherja, Asije, Hane, Merjemja, Aisheja etj. (paqja e Allahut qoftë mbi to).

Këto gra shembullore dhe prijëse që përmendëm, janë dalluar për besimin dhe devotshmërinë ndaj Allahut të Madhërishëm. Për mbulesën, ruajtjen e nderit, vendosmërinë dhe durimin në rrugën e Allahut.

Shkaku kryesor i përgatitjes së këtij artikulli është një rikujtim për të tërhequr vërejtjen drejt shembujve me vlerë të lartë, ku këta ndriçues do të jenë shembuj të gjallë ndihmues, udhëzues, drejtues dhe tregues gjatë gjithë jetës sonë për një jetë sa më të shëndoshë përballë vështirësive, fatkeqësive dhe depresioneve.

Siç mund të nënkuptohet lehtë edhe nga titulli i librit *“Modelet ndriçuese në jetën tonë. HAXHERJA dhe SARA, sipas Biblës dhe Kur’anit Famëlartë”*, ky artikull është punuar duke e parë këtë histori nga Kur’ani Famëlartë, Suneti i Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] si dhe nga ngjarjet që përmban Bibla në lidhje me këtë temë. Në disa raste jam munduar të bëj krahasimin ose ndryshimin që qëndron mes Biblës dhe Kur’anit rreth familjes së Ibrahimit [alejhissalam].

Së fundi, dua të falënderoj Allahun e Madhërishëm, i Cili më mundësoi përgatitjen – përfundimin e këtij artikulli.



E lus Allahun e Madhërishëm t’ua shpërblejë me të mira në këtë botë dhe në botën tjetër të gjithë atyre që kanë dhënë ndihmë apo kurajë gjatë përgatitjes së këtij artikulli.

**Assis. Prof. Ilir RRUGA**  
**rrugailir@yahoo.com**

## HYRJE

Sot ndodhemi në një realitet ku të rinjtë ndikohen psikologjikisht ndaj imitimit. Ata ndiejnë simpati “të frikshme” dhe mundohen të përshtaten me jetën e aktorëve të tyre të preferuar, top modeleve, apo yjeve të muzikës. Fotografitë dhe portretet e të cilëve i mbajnë nëpër telefona, kompjuterë, kapakët e fletoreve dhe të librave. Nuk mungojnë as posterat e “idhujve”, që shpesh i sheh të varura nëpër muret e dhomave. Karakteret dhe personalitetet e të cilëve nuk përputhen me vlerat e larta të Islamit, madje mënyra e jetesës së tyre është larg pastërtisë shpirtërore.

Mirëpo, është një gjendje reale e dhimbshme që nuk përputhet me vlerat e larta të Islamit si dhe me pastërtinë shpirtërore, sepse disa yje që janë larg Islamit dhe vlerave njerëzore, në sy të një pjese të popullsisë, shihen sikur të jenë persona për të cilët mund të jepet edhe shpirti.

Yjet e muzikës, të filmave, të modës si dhe të sporteve, janë shpikur dhe bërë yje nëpërmjet medias si dhe duarve të fshehura në popull. Kështu që këta yje shndërrohen në idhuj dhe i afrohen popullit për t’i adhuruar e për t’i marrë shembull.

Do të tmerroheni posa të dalloni se vajzat tuaja marrin shembull në jetën e tyre top modelet, yjet e popit, heronjtë e filmave apo të telenovelave kur njëkohësisht ju mundoheni dhe u keni ofruar shembullin më të bukur të Hatixhes, Aishes, Fatimes, Zejnebes... etj. (Allahu qoftë i kënaqur me to).

Nëse do të pyesim vajzat se cilat janë ato gra ideale që marrin për shembull në jetën e tyre, do të vërejmë se përgjigja do të jetë: “Filan aktore, top modele, këngëtare apo ndonjë politikane e suksesshme.” E nëse do t’i pyesim se përse nuk është shembull për to Aisheja [radijallahu anha], gruaja ideale?! Atëherë do të shokohemi nga kjo përgjigje:

“Aisheja është grua që i përket një kohe e jetese tjetër. Ndërsa filan aktore është grua që gjendet në shekullin në të cilin jetojmë. Jeta e Aishes përbëhet vetëm prej transmetimeve dhe është e pamundur të jetuarit e jetesës së saj. Ndërsa filan aktore është një shembull i gjallë dhe jetesa e saj është e mundur.”

Për fat të keq thëniet dhe mendimet që janë krijuar ndaj gruas ideale muslimane bëjnë të mundur që të kuptohen sikur ato janë heroike të fshehta që jetojnë vetëm nëpër përralla. Pavarësisht se e rikujtojmë me dashuri dhe respekt Fatimen [radijallahu anha] dhe gratë e tjera të dalluara, nëpër mbledhje apo predikime, mendimet dhe thëniet që tregojnë se ato ishin gra që kanë jetuar në një kohë dhe gjeografi tjetër nga koha dhe gjeografia jonë, për fat të keq i shtojnë gratë që të mos i marrin për shembull gratë ideale muslimane të dalluara nga Allahu i Madhërishëm në ditët e sotme. Ato i shohin ngjarjet vetëm me pamjen e jashtme të thjeshtë, prototipi i grave ideale shembullore që duhen marrë në jetë janë aktoret që luajnë nëpër telenovela dashurie, politikanet e suksesshme, sportistet e njohura, manekinet, fotomodelet... etj.

Gratë ideale shembullore muslimane nuk mund të jenë gratë ideale të atyre personave që zotërojnë të tilla mendime. Mirëpo, Allahu i Madhërishëm na ka ndihmuar në udhëzim dhe akide duke na ofruar shembuj idealë gjatë përpjekjeve

tona në “Hak dhe Batil (Në thirrje për në të drejtë dhe ndalimin nga e shtrembra)”.

Modelet e jetesës e ruajnë cilësinë e tyre derisa të vazhdojë zhvillimi dhe jetesa me to. Ndërsa modelet që nuk ripërtërihen dhe që nuk jetojnë me to, atëherë atyre iu thuhet “Modele Muzeale.” Por, kurrsesi, nuk mund të thuhet “Modele Muzeale” as për Kura’nin, i cili, me anë të shpalljes hyjnore që përmban, formon modelin e jetesës së njeriut dhe as për Haxheren, e cila është shembull dhe model jetese me nënshtrimin e plotë dhe besimin e palëkundshëm përballë caktimit të Allahut të Madhërishëm si dhe personalitetin e pastër të saj. Nuk mund të themi “Model Muzeal” për Ismailin [alejhis-selam], sepse nuk është shembull dhe model muzeu dhe, gjithashtu, nuk mund të themi “Modele Muzeale” për familjen e Ibrahimit [alejhis-selam], e cila është një familje e zgjedhur nga Allahu i Madhërishëm. Sikurse po e shohim nuk mund t’u themi “Modele Muzeale” të kufizuara në kohë apo në vend, shembujve që na janë dhënë nga Allahu i Madhërishëm në Kur’an.

Baza kryesore vërtetuese e realitetit është të jetuarit dhe praktikuarit të modelit të jetës islame. Kjo duhet parë si alternativa kryesore dhe modeli i jetesës më të mirë dhe më të lartë nga modelet e tjera të të jetuarit.

Këta persona që na janë ofruar, janë ata që e kanë vërtetuar talentin, aftësinë dhe esencën e tyre të dendur nën urtësinë e Shpalljes dhe Profetësisë me përpjekjet e tyre përballë ndodhive që kanë hasur gjatë jetës.

Gjatë rrjedhës së historisë i shohim gratë muslimane në vijë të parë duke mbajtur flamurin e *shpëtimit* mbi supe. Ato gra ndriçuan rrugën e njerëzimit, kanë qenë si një llambë që

ndriçon anembanë, “*Dritë Udhëzimi*” në errësirën e herezisë, kanë qenë “*Anije Shpëtimi*” në batakun e katastrofave.

Kush ka ndjekur hapat e atyre grave është ndriçuar me nurin e tyre, në anijet e tyre kanë gjetur prehje dhe kanë përparuar. Ndërsa ai që ia kthen shpinën herët a vonë do të poshtërohet e do të nënçmohet.

Kur ecën pas “Të Parëve” të besimit, dashurohesh me to. Tek to gjen një dëlirësi, pastërri dhe devotshmëri. Mbi trup kanë rroba prej “turpi”, mbi shpatulla mbajnë mesazhin hyjnor, në zemrat e tyre gjendet dashuria ndaj Allahut të Madhërishëm dhe ato i sheh në skenë së bashku me burra që luftojnë për drejtësi.

Në përpjekjet për teuhid, “Njësimin e Zotit”, të Ibrahimit Halilullah (miku i Allahut), krah tij, gjithashtu, do të shohësh Sarën dhe Haxheren.

Me këtë punim dëshirojmë t’i përcjellim këto shembuj tek ju, të dashur lexues, që të kuptojmë në ditët e sotme nevojën e kësaj jetese të vërtetë islame.

Ka thënë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në lidhje me transmetimet e tregimeve të Biblës: “*Transmetoni ngjarjet mësimdhënëse nga Beni Israilët, nuk ka ndonjë problem transmetimi i tyre.*”<sup>1</sup> Nëse i jepet një muslimanit ndonjë tregim që gjendet në librat e shenjtë (nga Bibla që tashmë janë të ndryshuar dhe e kanë humbur origjinalitetin), kjo çështje pranohet, nëse nuk bie në kundërshtim me principet e përgjithshme të Islamit dhe nëse nuk bie në kundërshtim me Kur’anin dhe Sunetin e Resulullahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Por, sigurisht, ne e refuzojmë nëse kjo çështje bie në kundërshtim me principet e përgjithshme të Islamit, me

---

<sup>1</sup> Buhârî, Enbija, 52 (1444); Tirmidhi, Ilim, 13 (2669).

Kur'anin dhe Sunetin. Ne i përmbahemi këshillës së Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], ku thotë: *“As mos i vërtetoni dhe as mos i mohoni ehl-i kitabët. Por thoni se ne i besuam Allahut, Librit që na u zbrit neve (Kur'anit) dhe Ibrahimit...”*<sup>2</sup>

---

<sup>2</sup> Buhârî, I'tisam, 25.





## PJESA E PARË

PËRPJEKJET NË TEUHID,  
“PËR NJËSIMIN E ZOTIT”,  
TË IBRAHIMIT [alejhis-selam]



## LINDJA E IBRAHIMIT [alejhis-selam]

Profetët i kanë ftuar njerëzit dhe popujt në të cilët janë dërguar në adhurimin dhe njësimin e Zotit të Vetëm. Së pari, ata i kanë ftuar njerëzit në rrugën e drejtë me sjelljet dhe me jetesën shembullore të tyre. Për këtë arsye, profetët, të cilët janë njerëzit e zgjedhur të Allahut të Madhërishëm, së pari, zotërojnë një jetesë shembullore për besimtarët me sjelljet dhe përpjekjet e tyre përballë çdo gjendjeje gjatë gjithë jetës.

Allahu i Madhërishëm në Kur'an thotë: ***“Shembull i mrekullueshëm për ju është Ibrahim dhe ata që kanë qenë me të...”***(Mumtehine: 4)

Ibrahimi [alejhis-selam] ka lindur në fshatin Berze të Shamit (gjendet pranë malit Kajsan), në qytetin Babil,<sup>3</sup> në periferinë Sûs të Ahvazit, në vendin që quhet Kûsi<sup>4</sup> apo në qytetin Ur.<sup>5</sup> Ur-i ishte vendi i Kaldeasëve, në perëndim të lumit Frat në Babiloninë e Poshtme, sot njihet si Tel el-Mugajr dhe është 300 km në jug të Bagdadit. Ky gjendet në rrafshin jugor mes Dixhles dhe Fratit.<sup>6</sup> Historianët dhe studiuesit kanë thënë se Ibrahim [alejhis-selam] ka lindur në vitin 2100 para erës së re.<sup>7</sup>

---

<sup>3</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f.188.

<sup>4</sup> *El-Kâmil Fi't-Târih*, Ibnu'l-Ethir, v.1, f.87.

<sup>5</sup> *Târih Boyunca Tevhid Mücadelesi*, Mevdudi, 2/35; *Kur'an'da Peygamberler ve Peygamberimiz*, Abdulfettah Tabbara, f.120.; *T.D.V İslâm Ansiklopedisi*. 21/267; *Dhiata e Vjetër - Zanafilla* 11: 28.

<sup>6</sup> *T.D.V İslâm Ansiklopedisi*, v.21, f.267.

<sup>7</sup> *Târih Boyunca Tevhid Mücadelesi*, Mevdudi, v.2, f.35-36.

Emri i babait të Ibrahimit [alejhis-selam] në Bibël thuhet se e ka Terah,<sup>8</sup> ndërsa në Kur'an<sup>9</sup> dhe nëpër thëniet e profetit<sup>10</sup> Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] si dhe në historinë islame<sup>11</sup> është Azer.<sup>12</sup> Ibrahim [alejhis-selam] e ka prejardhjen nga Nuh [alejhis-selam] dhe këtë mund ta tregojmë në këtë mënyrë: Azer bin Nahor bin Sarug bin Argû bin Falig bin Gabir bin Shaleh bin Kajnan bin Arfahshaz bin Sam bin Nuh [alejhis-selam].<sup>13</sup>

Ndërsa emri i nënës së Ibrahimit [alejhis-selam] përmendet se ishte Usha, Nûna ose Ebjûna.<sup>14</sup>

## KUPTIMI DHE RËNDËSIA E EMRIT IBRAHIM

Emri Ibrahim është emër që vjen nga hebraishtja Abraham, që do të thotë “babai i publikut”. Por emri Abraham kur ka kaluar nga hebraishtja në fonetikën e gjuhës arabe ka marrë formën Ibrahim.

Maverdi dhe Ebu'l-Beka thonë se emri Ibrahim vjen nga gjuha siriane “Eb Rrahîm”, që ka kuptimin “babai i mëshirës”,<sup>15</sup> kurse studiuesit bashkëkohorë janë të mendimit se origjinali i emrit Ibrahim është Abraham nga hebraishtja.<sup>16</sup>

<sup>8</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla* 11: 10-26; 1 i Kronikave 1: 24-27.

<sup>9</sup> Sûre En'âm: 74.

<sup>10</sup> *Texhrid-i Sarih Terxhemesi*, v.9, f.108-109.

<sup>11</sup> *Yakub-Tarihi*, 1/17-20; Ibn Asakir-Tarihi, 2/136; *Tefsirli Peygamberler Tarihi*, Ubeydullah Bayram TEKİN, f.68..

<sup>12</sup> *Texhrid-i Sarih Terxhemesi*, v.9, f.108-109.

<sup>13</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed bin Xherir et-Taberi, v.2, f.141.

<sup>14</sup> Ibn Sa'd, *Tabakatu 'l-Kubra*, 1/46; *Peygamberler Târihi*, Prof. Dr. Ismâil YİĞİT, f.204.

<sup>15</sup> *Hak Dini Kur'an Dili*, Elmalılı Muhamed Hamdi YAZIR, v.1, f.405.

<sup>16</sup> *T.D.V. İslâm Ansiklopedisi*, 21/269; *Kur'an Ansiklopedisi*, Süleyman Ateş, 9/90; *Şamil İslam Ansiklopedisi*, İbrahim maddesi; *Hak Dini Kur'an*

Në disa pjesë të Biblës së sotme emri “Ibrahim” kalon në Avraham (Abraham). Sipas Biblës, emri Ibrahim më parë ishte “stërgjysh i madh” dhe më pas u kthye në Abraham (babai i kombeve). Pavarësisht këtyre mendimeve, origjina e emrit Ibrahim nuk është theksuar ekzaktësisht.<sup>17</sup>

Llagapi më i njohur dhe i famshëm i Ibrahimit [alejhis-selam] është “Ebu’l-Enbija – Babai i profetëve”. Ky emërtim i është dhënë atij për arsye se katërmbëdhjetë prej gjashtëmbëdhjetë profetëve që kanë ardhur dhe janë përmendur në Kur’an, kanë ardhur nga trangu i tij familjar.<sup>18</sup>

## **BËRJA SYNET E IBRAHIMIT [alejhis-selam] SIPAS BIBLËS**

Historia e bërjes synet të Ibrahimit [alejhis-selam] në Ungjillin e Barnabas tregohet në këtë mënyrë:

“Kur e mashtroi shejtani në Xhenet njeriun e parë, Ademin, dhe pasi e shijoi pemën/marrëdhënien intime (apo seksuale), të cilën ia pati ndaluar Zoti, lëkura e kundërshtoi shpirtin. Pas kësaj u betua duke thënë: “Beto hem në emër të Zotit që ty do të pres!” dhe e preu lëkurën pasi gjeti një gurë të mprehtë. Ai u qortua, kritikua, nga meleku Xhebrail.

Ademi u përgjigj: “Unë u betova në Zot që do e pres dhe kurrë nuk do të bëhem gënjeshtar!”

Më pas meleku i tregoi atij pjesën e tepërt të lëkurës në organin gjenital dhe ai e preu atë. Ja, pra, gjithkush është i

---

*Dili*, 1/405-407; *Kur’an-ı Kerim Meâl ve Tefsiri*, Ömer Nasuhi BİLMEN, 1/116-117.

<sup>17</sup> Ahmet Kalkan, *Kur’an Kavramları*: 2434.

<sup>18</sup> *Peygamberler Târihi*, Prof. Dr. İsmail YİĞİT, f.200.

detyruar të sjellë në vend prerjen e lëkurës, e cila është e tepërt, siç dha fjalën dhe e preu babai i tyre, Ademi. Kështu që Ademi këtë e bëri edhe tek bijtë e tij dhe një zbatim i tillë vazhdoi nga njëri brez në tjetrin. Por në kohën e Ibrahimit vetëm disa vetë ishin të bërë synet, sepse ishte e përhapur idhujtaria.

Pas kësaj Zoti i tregoi të vërtetën Ibrahimit dhe i tha: “Kurrë nuk kam për ta marrë në grupin e njerëzve të mi atë që nuk bëhet synet/pret lëkurën.”<sup>19</sup>

Në Zanafillën e Dhiatës së Vjetër të Biblës bërja synet tregohet në këtë mënyrë:

“Pastaj Perëndia i tha Abrahamit: “Nga ana jote ti do ta respektosh besëlidhjen time, ti dhe pasardhësit e tu, nga njëri brez në tjetrin. Kjo është besëlidhja ime që ju do të respektoni midis Meje edhe jush, si dhe pasardhësve të tu pas teje: çdo mashkull që ndodhet midis jush do të rrethprietet. Dhe do të rrethprienteni në mishin e prepucit tuaj; dhe kjo do të jetë një shenjë e besëlidhjes midis Meje dhe jush. Në moshën tetë ditësh çdo mashkull juaj do të rrethprietet dhe kjo nga njëri brez në tjetrin, qoftë ai i lindur në shtëpi apo i blerë me para nga çdo i huaj që nuk është pasardhës i yt. Do të rrethprietet si ai që ka lindur në shtëpinë tënde, ashtu edhe ai që është blerë me para. Besëlidhja Ime në mishin tuaj do të jetë një besëlidhje e përrjetshme. Dhe mashkulli i parrethprerë, që nuk është rrethprerë në mishin e prepucit të tij, do të hidhet jashtë popullit të tij, sepse ka shkelur besëlidhjen Time.”<sup>20</sup>

Diçka tjetër që na tërheq vëmendjen këtu është se Ibrahimimi [alejhisselam] është bërë synet në një moshë të

<sup>19</sup> *Ungjilli Barnabas*, 23. V. f.83

<sup>20</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla* 17: 9-14.

madhe bashkë edhe me burra të tjerë në kohën kur ka bërë synet djalin e tij, Ismailin [alejhis-selam].

“Atëherë Abrahami mori Ismaelin, djalin e tij, të gjithë ata që kishin lindur në shtëpinë e tij dhe të gjithë ata që kishte blerë me paratë e veta, gjithë meshkujt e shtëpisë së Abrahamit dhe, po atë ditë, kur Abrahami ishte nëntëdhjetë e nëntë vjeç u rrethpre në mishin e prepucit të tij.”<sup>21</sup>

Bërjen synet të Ibrahimit [alejhis-selam] e shohim, gjithashtu, edhe në një hadith të Resulullahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ku thuhet: *“Ibrahimi [alejhis-selam] në moshën tetëdhjetë vjeç e ka bërë vetveten synet në fshatin Kaddum.”*<sup>22</sup>

Nëse do t'i kthehemi përsëri vazhdimit të tregimit në Bibël do të shohim: “Dhe Ismaeli, biri i tij, ishte trembëdhjetë vjeç kur u rrethpre në mishin e prepucit të tij. Po atë ditë u rrethprenë Abrahami dhe Ismaeli, biri i tij. Dhe tërë një-rëzit e shtëpisë së tij, qoftë ata të lindur në shtëpi, qoftë ata të blerë me para nga të huajt, u rrethprenë bashkë me të.”<sup>23</sup>

Megjithëse bërja synet ka ardhur deri në kohën e Isait [alejhis-selam], këtë veprim e braktisën të krishterët që erdhën më pas. Ata bërjen synet e komentuan në kuptimin “Khitana – mbulesa e perdes së zemrës”.<sup>24</sup>

Të krishterët këtë veprim e kaluan plotësisht në komentim (tjetër për tjetër nga bërja synet), ndërsa hebrenjtë e

<sup>21</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 17:23-24.

<sup>22</sup> Buhâri, *Ehâdîthu 'l-Enbijâ*, 8; *Isti'zan*, 51 (1410); *Kutubi Sitte*, 7/2150.

<sup>23</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 17:25-27.

<sup>24</sup> Buhâri, *Texhridi Sarih Terxhumesi*, v.9, f.112; Şamil, *İslam Ansiklopedisi*, v.5, Sunet (kapitulli-pjesa).



vazhduan këtë veprim, por edhe këta duke e komentuar me të qenurit “populli i zgjedhur” nga Zoti.<sup>25</sup>

## STRUKTURA E SHOQËRISË NË KOHËN E IBRAHIMIT [alejhis-selam]

Populli Ur përbëhej prej amelu (prijësit shtetëror dhe prijësve fetarë), nushkenu (qytetarët normalë) dhe prej ardu (robërve).<sup>26</sup>

Pjesa amelu e popullit kishte veçori të veçanta në popull. Ata kishin të drejta më të larta se sa njerëzit e tjerë si në drejtësinë civile, po ashtu, edhe në drejtësinë gjyqësore (penale). Jeta dhe pasuria e tyre ishte e shenjtë. Sipas Talmud’it, edhe Azeri, babai i Ibrahimit [alejhis-selam], ishte prej klasës amelu.<sup>27</sup> Azeri ishte njëri nga njerëzit më me sy të mirë tek Nemrud’i dhe, gjithashtu, ishte një nga nëpunësit kryesorë të tij.<sup>28</sup>

Feja që ekzistonte në Ur ishte Sabîilik. Adhurimi fillonte duke adhuruar shpirtat dhe melekët e më pas vazhdonte me adhurimin dhe therjen e kurbaneve për idhujt, të cilët ishin bërë për hir të yjeve, hënës dhe diellit. Adhurimi i idhujve dhe i yjeve ishin simboli i shpirtave.<sup>29</sup>

Kjo ishte gjendja e familjes dhe e popullit kur lindi Ibrahimit [alejhis-selam].

<sup>25</sup> *İbrâhimi Okuyuş*, Ahmet Baydar, f.50.

<sup>26</sup> *İbrâhimi Okuyuş*, Ahmet Baydar, f.18.

<sup>27</sup> *Tefhim ’ul-Kur’ân*, Mevdudi, v.1, f.494.

<sup>28</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.141.

<sup>29</sup> *Sâre ve Hâxher*, Yıldız RAMAZANOĞLU, f.47.

Qyteti Ur ishte kryeqytet i dinastisë së Nemrudit në Irak. Rreth viteve 2100 para erës së re përbëhej prej një numër me më shumë sesa 250 mijë njerëzish.<sup>30</sup> Qyteti Ur në atë kohë ishte qytet që kishte marrë një famë të madhe me qendrën tregtare dhe kulturore. Vendi Ur ishte qendra e kultit të perëndisë së zjarrit, Nilgal. Shumica e popullsisë besonte se çdo gjë komandohej nga një krijesë shpirtërore. Prandaj, besimi në adhurimin e idhujve ishte tepër i përhapur në popull.<sup>31</sup> Në të njëjtën kohë qyteti ishte bërë qendra e shirkut, e ateizmit, epsheve, imoralitetit si dhe qendra e padrejtësive të popullit irakian.<sup>32</sup>

## PËRPJEKJET E IBRAHIMIT [alejhis-selam] NË TEUHID, “NË THIRRJEN E NJËSIMIT TË ZOTIT”

Emri i Ibrahimit [alejhis-selam] kalon në Dhiatën e Vjetër në pjesën Zanafilla me fjalën “Kadim”. “Abram” në arabisht ka kuptimin “Zotërues i dëshirës së Shenjtë”<sup>33</sup>, ndër- sa në literaturën islame e shohim me “Ebu’rr-Rrahim”, i cili ka kuptimin “Babai mëshirues”.<sup>34</sup>

Llagapi me të cilën më së shumti njihet Ibrahim [alejhis-selam] është “Ebu’l-Enbija” (Babai i Profetëve). Ky llagap i është dhënë për arsye se gjashtëmbëdhjetë profetë janë me

---

<sup>30</sup> *Peygamberler Târihi*, Prof. Dr. Ismâil YİĞİT, f.207; *İbrâhimi Okuyuş*, Ahmet Baydar, f.18.

<sup>31</sup> *İbrâhimi Okuyuş*, Ahmet Baydar, f.19.

<sup>32</sup> *Târih Boyunca Tevhid Mücadelesi*, Mevdudi, v.2, f.35-36.

<sup>33</sup> *Hac Risalesi*, Mustafa İSLÂMOĞLU, f.71; *T.D.V İslâm Ansiklopedisi* 21/267.

<sup>34</sup> *Hak Dini Kur’ân Dili*, Elmalılı Muhamed Hamdi YAZIR, v.1, f.405.

prejardhje prej tij ku katërmbëdhjetë prej të cilëve janë përmendur në Kur'an.<sup>35</sup>

***“Me të vërtetë, Ibrahim i ka qenë prijës shembullor (me të gjitha virtytet e mira), i përlur para Allahut, me besim monoteist dhe nuk ka qenë nga idhujtarët, (por ka qenë) mirënjohës ndaj dhuntive të Tij. Ai e zgjodhi atë dhe e udhëzoi në rrugë të drejtë. Ne i kemi dhënë atij të mira në këtë botë, ndërsa në botën tjetër, sigurisht që ai do të jetë nga të mirët.”*** (En-Nahl: 120-122); ***“Ne të frymëzuar ty (o Muhammed) me shpallje, ashtu siç frymëzuar me shpallje Nuhun dhe profetët pas tij; siç frymëzuar me shpallje edhe Ibrahimin, Ismailin, Is’hakun, Jakubin dhe bijtë e tij, Isain, Ejupin, Junusin, Harunin, Sulejmanin dhe Dautin, të cilit i dhamë Zeburin.”*** (En-Nisa: 163)

Ibrahimi [alejhis-selam] ishte i pari profet ulu’l-azm i dërguar pas Nuhut [alejhis-selam] për të përhapur mesazhin universal të Islamit.<sup>36</sup> Profetësia është një detyrë e lartë dhe e ndershme, të cilën Allahu i Madhërishëm ia ka dhënë robërve të zgjedhur të Tij. Ibrahim i [alejhis-selam], së pari, thirrjen në njësinë e Zotit të Vetëm e ka filluar në vendin e tij në qytetin Ur të Irakut.

Ibrahimi [alejhis-selam] mori përsipër një detyrë tepër të vështirë në thirrjen e Teuhidit të Zotit të Madhërishëm në një vend ku mbizotëronte dhuna, padrejtësia... etj. Ibrahim i [alejhis-selam] duroi në këtë shekull të errët derisa lindi drita, e drejta, njohja e vetvetes dhe dashuria në atë popull që ishte mësuar me dhunë dhe tortura.

<sup>35</sup> *Peygamberler Târihi*, Prof. Dr. Ismâil YİĞİT, f.200.

<sup>36</sup> *Târih Boyunca Tevhid Mücadelesi*, Mevdudi, v.2, f.35-37.

Ibrahimit [alejhis-selam] nuk u bë armik vetëm me dinastinë shtetërore dhe popullin, por ai u bë armik me të gjithë të afërmit dhe akoma më tepër edhe me familjen, u bë armik me babain e tij në thirrjen e tij në Teuhid – në njësinë e Zotit të vetëm. ***“Me të vërtetë, Ibrahim i ka qenë prijës shembullor (me të gjitha virtytet e mira), i përgjybur para Allahut, me besim monoteist dhe nuk ka qenë nga idhujtarët...”*** (En-Nahl: 120)

### IBRAHIMI [alejhis-selam] E FILLON THIRRJEN NGA BABAI I TIJ

Babai i Ibrahimit [alejhis-selam] ishte nga idhujtarët kryesorë në adhurimin e idhujve.<sup>37</sup> Akoma edhe më keq, ai ishte edhe marangoz, usta në krijimin e perëndive prej druri.<sup>38</sup> Ishte një gjendje e vështirë e të qenit idhujtar i babait të Ibrahimit [alejhis-selam], i cili thërriste njerëzit në njësimin e Zotit të Vetëm. Prandaj, gjithmonë e këshillonte babanë e tij kur ishin vetëm duke i treguar përfundimin e tmerrshëm që do të kenë idhujtarët.

Ibrahimi [alejhis-selam] për të sjellë në vendin e duhur detyrën e rëndë dhe të ndershme të profetësisë e filloi thirrjen nga më të afërmit e tij në njësimin e Zotit të Vetëm. Sikurse ishte i urdhëruar me urdhrin e Zotit: ***“Paralajmëroje farefisin tënd më të afërm.”*** (Esh-Shuara: 214)

---

<sup>37</sup> *El-Kâmil Fî-t-Târih, Ibnu 'l-Ethir, v.1, f.89.*

<sup>38</sup> *Târih-i Taberi, Muhamed bin Xherir et-Taberi, v.1, f.143.*

Ibrahimi [alejhis-selam] e pa më të përshtatshme ta fillojë thirrjen në njësimin e Zotit të Vetëm nga Azeri, babai i tij dhe:<sup>39</sup>

***“Trego për Ibrahimin, kur ai i tha të atit, Azerit: “A do t’i adhurosh idhujt si zotat e tu?! Unë vërtet po shoh se ti dhe populli yt jeni në humbje të madhe.”(El-En’am: 74)***

Ibrahimi [alejhis-selam] i tregonte babait të tij se është duke vepruar gabim, duke i thënë: ***“Ai i tha të atit: “O babai im, përse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh e as që mund të të sjellë ndonjë dobi?”(Merjem: 42)***

Ibrahimi [alejhis-selam] asnjëherë nuk e ka cilësuar me “inJORANCË” babanë e tij, mirëpo e ftoi atë në rrugën e drejtë, në njësimin e Zotit, me një gjuhë të butë me qëllim që mos të largohet nga Ibrahimi, duke menduar se ai po nënvlerëson besimin dhe mendimet e tij.

Më pas Ibrahimi [alejhis-selam] vazhdoi, duke thënë: ***“O babai im, mua më ka ardhur prej diturisë, çfarë s’të ka ardhur ty; andaj ndiqmë mua dhe unë do të të udhëzoj në rrugën e drejtë!***

***O babai im, mos adhuro djallin, sepse ai është gjithmonë i pabindur ndaj të Gjithëmëshirshmit.***

***O babai im, unë kam frikë se mos të vjen ndonjë dënim nga i Gjithëmëshirshmi e kështu të bëhesh i afërm i djallit!”(Merjem: 43-45)***

Azeri, babai i tij, ia ndërpreu fjalën e thirrjes së singertë në njësimin e Zotit të Vetëm pasi ai frikësohej nga humbja e postit të lartë që kishte në mesin e klasës amelu në popull dhe kështu iu përgjigj Ibrahimit me një gjuhë të ashpër, e cila tregonte qartë përfundimin e tij shpirtërisht, duke i thënë:

<sup>39</sup> *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/200; *Ibnu ’l-Ethir*, 1/90.

***“Ai u përgjigj: “O Ibrahim! Si guxon t’i hedhësh poshtë zotat e mi?! Nëse nuk heq dorë, unë do të të mbys me gurë; andaj, largohu prej meje për një kohë të gjatë!”*** (Merjem: 46)

Ibrahimi [alejhisselam], pavarësisht sjelljes armiqësore dhe mënyrës së ashpër të babait të tij, përsëri e ruajti gjakftohtësinë dhe dashurinë ndaj babait dhe u largua nga shtëpia e tij duke i thënë: ***“Ibrahimi tha: Shpëtimi qoftë mbi ty!<sup>40</sup> “Do t’i lutem Zotit tim që të të falë. Me të vërtetë, Ai është i mirë me mua.”*** (Merjem: 47) Dhe më pas i bëri lutje Zotit, siç i kishte premtuar babait të tij:

***“Nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve që të kërkojnë falje për idhujtarët, qofshin këta edhe të afërmit e tyre, pasi u është bërë e qartë se ata janë banorë të Xhehenemit.***

***Ndërsa lutja e Ibrahimit për faljen e babait të tij, ka qenë vetëm për shkak të një premtimi, që i kishte bërë. Por, kur iu bë e qartë se i ati ishte armik i Allahut, ai u nda prej tij. E megjithatë, Ibrahim i ishte njeri i dhembshur dhe i butë.”*** (Et-Teube: 113-114)

***“Po largohem nga ju dhe nga gjithçka që ju adhuroni në vend të Allahut. Do t’i lutem Zotin tim, sepse jam i sigurt se nuk do të jem fatkeq me lutjet që ia bëj Zotit tim.”*** (Merjem: 48)

Apostulli Petrus e pyeti Isain [alejhisselam] se sa ka qenë armiqësia e babait Azer me birin e tij, Ibrahimin, dhe si e sa duhet t’i bindet njeriu prindërve të tij si dhe në cilat raste duhet t’i bindet:

<sup>40</sup> Selamin (përsëhendetjen) e Ibrâhimit [alejhisselam] me babain e tij mund ta kuptojmë më mirë në këtë ajet të Kur’anit: ***“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!”*** (El-Furkan: 63).

- “Zotëria ynë! Si duhet ta dojë robi Zotin me dashurinë e vërtetë?”

Isai [alejhis-selam] tha: “Kush nuk e urren babanë, nënën, jetën e tij, fëmijët dhe gruan e tij për hir të dashurisë së Zotit, një njeri i tillë, nuk gjen vlerë për t’u dashur nga Zoti i tij.”

Petrus shtoi: “O Zot! Në Tevrat në librin e profetit Musa thuhet: “Tregoi babait respekt, për të jetuar shumë në botë. Mallkuar qoftë ai bir që nuk e respekton nënën dhe babanë e tij.” Për këtë arsye Zoti ka urdhëruar të mbytet nga populli me gurë përpara derës/hyrjes së qytetit një fëmijë i tillë mosrespektues. Kur është urdhëruar kështu, si mundet që ju na urdhëroni të urrejmë nënën dhe babanë?”

Isai [alejhis-selam] i tha: “Çdo fjalë e imja është e drejtë. Sepse nuk janë të miat (këto fjalë), janë fjalët e Zotit që më ka dërguar në popullin hebre, për këtë arsye po ju them juve që: “Çdo gjë që ju posedoni, janë të Zotit tuaj dhurues. Atëherë, kush është më e vlefshme dhurata apo dhuruesi i dhuruesit? Lëri ata armiq nëse të pengon nëna dhe babai bashkë me të tjerët përballë shërbimit të Zotit.”<sup>41</sup>

Besoj se do të jenë të mjaftueshëm ajetet e mëposhtëm për të treguar dhe qartësuar shkurtimisht bindjen dhe detyrimet ndaj prindërve:

***“Ne e kemi urdhëruar njeriun, që të sillet mirë me prindërit e vet dhe: “Nëse ata të nxisin ty që të më shoqërosh Mua (në adhurim) atë, për të cilin ti nuk di asgjë, atëherë mos i dëgjo ata.” Tek Unë do të ktheheni të gjithë e do t’ju lajmëroj për gjithçka që keni bërë.”*** (El-Ankebut: 8)

<sup>41</sup> Ungjilli Barnabas, Pjesa 25, f.88.



*“Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.” (Et-Teube: 24)*

Zoti i tha Ibrahimit: “Largohu nga shtëpia e babait dhe të afërmeve të tu, hajde dhe vendosu në vendin ku të kam premtuar.” Përse Zoti i tha kështu? A nuk i tha për arsye sepse babai i Ibrahimit bënte idhuj dhe ishte një nga idhujtarët e perëndive të rreme prej druri dhe guri? Për këtë arsye, kishte një armiqësi mes Ibrahimit dhe babait të tij sa që të largohej prej tij.”<sup>42</sup>

## IBRAHIMI REFUZON ADHURIMIN E TRUPAVE QIELLORE

Populli i Ibrahimit [alejhis-selam] ndërtonte tempuj të mëdhenj dhe pranonte edhe perëndi qiellore përveç perëndive, idhujve, tokësorë. Ata i adhuronin dhe i bënin lutje idhujve që i kishin bërë vetë prej druri ose guri. Gjithashtu, ky popull besonte se ngjarjet natyrore ndodhin si rezultat i këtyre perëndive.

Kështu që Ibrahimit [alejhis-selam] sipas detyrës/ misionit profetik që kishte marrë duhej t’i luftonte besimet idhujtare të tyre. Mirëpo, ai nuk kishte ndonjë dituri apo

<sup>42</sup> Ungjilli Barnabas, Pjesa 25, f.88.

metodë se si do ta vazhdonte këtë detyrë. Sigurisht që Krijuesi i gjithësisë nuk e la të vetmuar në këtë mision.

*“Në të vërtetë, Ne e udhëzuam Ibrahimin në rrugë të drejtë qysh më parë dhe e njihnim atë (se ishte i aftë për këtë gjë).”* (El-Enbija: 51)

*“Dhe kështu, Ne ia treguam Ibrahimit mbretërinë e qiejve dhe të Tokës, që ai të bëhej nga ata që besojnë vendosmërisht.*

*Kur ra nata, ai pa një yll dhe tha: “Ky është Zoti im!” Por, kur perëndoi ylli, ai tha: “Nuk i dua ata që perëndojnë.”*

*Kur pa Hënën duke lindur, tha: “Ky është Zoti im!” Por, pasi ajo perëndoi, ai tha: “Nëse Zoti im nuk më udhëzon në rrugën e mbarë, me siguri do të bëhem njëri nga të humburit.”*

*Kur vërejt Diellin duke lindur, ai thërriti: “Ky është Zoti im, ky është më i madhi!” Por, pasi dielli perëndoi, ai tha: “O populli im, unë jam larg nga idhujt që ju ia shoqëroni Allahut në adhurim!*

*Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!”* (El-En’am: 75-79)

Sikurse shihet përpjekjet në njësimin e Zotit të Ibrahimit [alejhis-selam] nuk ishin me hamendje, por me shpallje, dhe jo me ndjenja, por ishte një përpjekje me anë të logjikës.

## THIRRJA E IBRAHIMIT [alejhis-selam] DËGJOHET NGA NJË MASË E MADHE E POPULLIT

*“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë! Me të vërtetë, Zoti yt i di më së miri ata që janë shmangur nga rruga e Tij, e di më së miri ata, që janë në rrugë të drejtë.”* (En-Nahl: 125)

Ibrahimi [alejhis-selam], së pari, e filloi ftesën nga të afërmit e tij, mirëpo kur e pa se ata nuk ndaheshin nga injoranca e adhurimit të idhujve, atëherë u drejtua të thërrasë popullin, i cili ishte në të njëjtën gjendje.

Allahu i Madhërishëm në Kur’an thotë: *“Kujtoje Ibrahimin, kur i tha popullit të vet: “Adhuroni Allahun dhe frikësojuni Atij! Kjo është më e mirë për ju, nëse e dini.”* (El-Ankebut: 16)

Ata thanë: “O Ibrahim! A po i bashkon të gjithë zotat në një Zot? Çfarë do bëhet me zotat që janë në tokë dhe në qiell?”

Ibrahimi [alejhis-selam] tha: *“Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin. Qoftë i Lavdëruar Allahu, Zoti i Fronit dhe i Lartësuar mbi çka ia veshin Atij.”* (El-Enbija: 22); *“Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij s’ka asnjë zot tjetër, përndryshe çdo zot do të merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin. Qoftë i Lartësuar Ai nga shpifjet e tyre!”* (El-Mu’minûn: 91)

*“Kur i tha babait të vet dhe popullit të vet: “Çfarë adhuroni ju?” Ata u përgjigjën: “Adhurojmë idhujt e përherë u jemi përkushtuar atyre.”*

*Ai i pyeti: “A ju dëgjojnë ata kur ju luteni? A mund t’ju sjellin dobi apo dëm?”* (Esh-Shuara: 70-73)

Përpara se ata të përgjigjeshin Ibrahimimi [alejhis-selam] u tha: *“Vërtet, ata që ju i adhuroni në vend të Allahut, janë vetëm idhuj. Ju po shpifni gënjeshtër. Në të vërtetë, ata që ju i adhuroni në vend të Allahut, nuk kanë pushtet t’ju furnizojnë, andaj, vetëm tek Allahu kërkoni risk dhe adhuroni e falënderoni vetëm Atë. Tek Ai do të ktheheni.”* (El-Ankebut: 17)

*“U përgjigjën: “Jo, por i kemi gjetur të parët tanë që vepronin kështu.”* (Esh-Shuara: 74)

*“Kur atyre u thuhet: “Ndiqni atë që ka shpallur Allahu!” ata përgjigjen: “Jo! Ne do të ndjekim atë udhë në të cilën i kemi gjetur të parët tanë” - Vallë, edhe atëherë kur të parët e tyre nuk kuptonin gjë e nuk ishin të udhëzuar?!”* (El-Bekare: 170)

*(Ibrahimimi) tha: “Me të vërtetë, ju dhe baballarët tuaj keni qenë në humbje të qartë.”* (El-Enbija: 54)

*“Ata thanë: “A po na sjell të Vërtetën apo je nga ata që tallen?”*

*Ai tha: “Jo, por Zoti juaj është Zoti i qiejve dhe i Tokës. Është Ai që i ka krijuar ato, ndërsa unë jam njëri prej atyre që e dëshmojnë këtë.”* (El-Enbija: 55-56)

Me idhull nuk duhet të nënkuptohet vetëm ai që është i gdhendur nga guri apo i bërë prej bronzit. Atëherë, çfarë është idhulli? Çfarë duhet të nënkuptojmë me idhull? Idhujt janë ideologjitë që mundohen t’i vendosin në trutë e njerëzve dhe mos fshirjen e tyre. Gjithashtu, është edhe adhurimi, lutjet dhe shpresa për qëllime të ndryshme fitimprurëse etj. Por Kur’ani Famëlartë na tregon shumë qartë se:

*“Idhuj, që nuk mund t’u japin ndonjë ndihmë atyre e as veten nuk mund ta ndihmojnë?”*(El-A’raf: 192)

*“A kanë ata këmbë për të ecur ose duar për të kapur? A kanë sy për të parë ose veshë për të dëgjuar? Thuaj: “Thirrni zotat tuaj të rreme dhe kurdisni kurthe kundër meje, pa më lënë kohë!”*(El-A’raf: 195)

*“Ai tha: “A keni menduar mirë mbi çfarë keni adhuruar, si ju, ashtu edhe të parët tuaj të lashtë? Në të vërtetë, ata janë armiqtë e mi, përveç Zotit të botëve, i Cili më ka krijuar dhe më udhëzon (në rrugë të drejtë); i Cili më ushqen dhe më jep të pi; i Cili, kur sëmurem, më shëron; i Cili do të bëjë që të vdes e pastaj do të më ringjallë; dhe i Cili, shpresoj se do të m’i falë gabimet e mia në Ditën e Gjykimit!”* (Esh-Shuara: 76-82)

*“Dhe, kur populli i tij polemizoi me të, ai tha:*

*“Doni të polemizoni me mua për Allahun, ndërkohë që Ai më ka udhëzuar në rrugën e drejtë?! Unë nuk i kam frikë idhujt tuaj, sepse vetëm po të dojë Zoti im, ato mund të më lëndojnë. Zoti im, me dijeninë e Vet ka përfshirë çdo gjë. A nuk po mendoni?*

*E si të frikësohem nga zotat tuaj të rremë, ndërkohë që ju nuk keni frikë t’i shoqëroni Allahut idhuj, për të cilët Ai nuk ju ka zbritur kurrfarë argumenti?! Cili nga ne e meriton të jetë i sigurt? Më thoni, nëse e njihni të vërtetën!”* (El-En’am: 80-81)

*“Ai tha: “O populli im, unë jam larg nga idhujt që ju ia shoqëroni Allahut në adhurim! Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë, dhe nuk jam nga idhujtarët!”*(El-En’am: 78-79)

***“A kanë ata këmbë për të ecur ose duar për të kapur? A kanë sy për të parë ose veshë për të dëgjuar? Thuaj: “Thirrni zotat tuaj të rreme dhe kurdisni kurthe kundër meje, pa më lënë kohë!”*** (El-A’raf: 195)

Pavarësisht se Ibrahim [alejhis-selam] e ftoi popullin në njësimin e Zotit të Vetëm përsëri njerëzit ia kthyen shpinën shpalljes së Zotit dhe treguan një këmbëngulje në qëndrimin e besimit e gjyshërve të tyre.

## **IBRAHIMI [alejhis-selam] FTON NEMRUDIN NË NJËSIMIN E ZOTIT TË VËRTETË**

Ibrahimi [alejhis-selam] me urdhër të Zotit të Madhë-rishëm shkoi për të ftuar Nemrudin në njësimin e Zotit të Vetëm, i cili refuzonte ekzistencën e një Krijuesi, Zotit Superior të Vetëm. Nemrudi, përveçse refuzonte njësimin e Zotit të Vetëm, pohonte se ishte në vetvete një zot.<sup>43</sup>

Populli i Babilonisë adhuronte mbretërit bashkë me yjet dhe idhujt. Sipas tyre, mbretërit ishin njerëz të kompletuar me fuqi dhe cilësi mbinjerëzore si dhe të zgjedhur për të udhëhequr njerëzit, të cilët kishin zbritur nga qielli deri pas kohës së tufanit të Nuhut [alejhis-selam].<sup>44</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] e ftoi Nemrudin në njësimin e Zotit të Vërtetë. Nemrudi filloi të sulmojë Ibrahim [alejhis-selam] me një çmenduri të vërtetë kur filluan të bien rrezet e ndriçimit të dritës hyjnore/të shpalljes të predikuar

<sup>43</sup> *El-Bidâje ve ’n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f.211.

<sup>44</sup> *Ibrahim Ebu ’l-Enbijâ*, Mahmud Akad, f.279-281; *Kur’ân-ı Kerim ’de Hz. İbrahim*, Ömer Ahmed Ömer, f.44.

nga Ibrahimimi [alejhis-selam]. Kur pa se besimi që predikonte Ibrahimimi po përhapej në katër anët e njerëzve, atëherë preferoi të debatojë me Ibrahimimin [alejhis-selam] rreth Zotit të tij.

Kjo ngjarje në Kur'anin Famëllartë tregohet kështu: ***“A nuk ke dëgjuar ti (Muhamed) për atë që bëri fjalë me Ibrahimin për Zotin e tij, sepse Allahu i kishte dhënë pushtet?...”*** (El-Bekare: 258)

Shkaku i polemikës së tij ishte: mburrja dhe mendjemadhësia e tij u shfaq pasi Allahu i Madhërishëm i dhuroi atij një pushtet mbretërimi në këtë botë duke u mashtrua pas tij.

Mbreti e pyeti Ibrahimimin [alejhis-selam] rreth cilësive të Zotit në të Cilin e ftoi.

***“Ibrahimi i tha: “Zoti im është Ai që jep jetë dhe shkakton vdekje.” Ai u përgjigj: “Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje.”*** (El-Bekare: 258)

Ibrahimimi [alejhis-selam] pyeti: “Si, në ç’mënyrë?”<sup>45</sup>

Nemrudi urdhëroi menjëherë shërbyesit të sjellin dy të burgosur të dënuar me vdekje. Dhe më pas urdhëroi që njërin ta vrasin dhe tjetrin ta lënë të lirë. Kështu, me një pretendim dhe dëshmi qesharake u mundua të tregojë se edhe ai mund të ngjallë dhe të vdesë.<sup>46</sup>

Padyshim demagogjia në fjalë, pretendimi dhe dëshmia e Nemrudit, nuk ishte gjë tjetër vetëm se një shpifje dhe gënjeshtër përballë së vërtetës. Sepse të krijosh do të thotë të krijosh nga mosekzistenca. Kështu që Ibrahimimi [alejhis-selam] nuk hyri në dilemë me pretendimin e palogjikshëm

<sup>45</sup> Kur’ân’da Peygamberler ve Peygamberimiz, Abdulfettah Tabbara, f. 135.

<sup>46</sup> El-Bidâje ve’n-Nihâje, 1/211; Ibnu’l-Ethir, 1/91; Târih-i Taberi, 1/149.

dhe të rremë të mbretit dhe zgjodhi një rrugë tjetër më bindëse dhe më të dobishme. *“Ibrahimi pastaj i tha: “Allahu e sjell diellin nga lindja. Sille ti nga perëndimi!”* (El-Bekare: 258)

*“Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij s’ka asnjë zot tjetër, përndryshe çdo zot do të merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin. Qoftë i Lartësuar Ai nga shpifjet e tyre!”* (El-Mu’minûn: 91)

Nemrudi pretendonte se ishte zot. Mirëpo, për të qenë zot, krijues, së pari, ai duhet të krijojë nga mosekzistenca dhe të jetë absolut në ndryshimin si dhe përdorimin e krijesës si të dëshirojë. Nemrudit nuk i ngeli gjë tjetër vetëm se të habitet, pushoi dhe pas një përgjigjeje të tillë pa se sa i dobët ishte për t’u përgjigjur dëshirës dhe pyetjeje së Ibrahimit [alejhis-selam].

Sepse dielli ishte një nga perënditë që ai vetë dhe populli i tij e adhuronte.<sup>47</sup> Kështu që ishte një pretendim tepër i vështirë për t’u besuar pasi ai pretendonte se ishte zot, krijues, kur njëkohësisht ai adhuronte dhe i lutej perëndive, zotëve të tjerë.

Nemrudi u habit dhe pa paaftësinë e tij përballë një pyetjeje të tillë saqë nuk ishte në gjendje t’i përgjigjej me asnjë përgjigje. Nemrudi u shokua dhe kishte ngelur i paaftë kur Ibrahimi [alejhis-selam] i tha vetëm këto cilësi nga cilësitë e Zotit të vërtetë.

*“Atëherë, ai (mohuesi) mbeti me gojën hapur. Allahu nuk i udhëzon ata që janë keqbërës.”* (El-Bekare: 258)

<sup>47</sup> Hz. İbrahim ve Hz. Lût, Harun YAHYA, f.38-39.



Metoda e argumentimit të Ibrahimit [alejhis-selam] i shtynte njerëzit të pranonin të vërtetën me anë të agrumenteve dhe logjikës. Mirëpo, me gjithë mundimet dhe përpjekjet që bëri Ibrahimit [alejhis-selam], përsëri thirrja e tij nuk pati rezultat tek populli, të cilët kishin veshë, por nuk dëgjonin, dhe kishin sy, por nuk e shikonin të vërtetën.

### **IBRAHIMI [alejhis-selam] I THEU TË GJITHË IDHUJT**

Ishte një gjendje e palogjikshme dhe e papranueshme e popullit që bënte idhuj duke i gdhendur në forma të ndryshme dhe më pas i pranonin për zot. Kështu, ata adhuronin për zot të njëjtët idhujt që i kishin bërë me duart e tyre.

Natyrisht që Ibrahimit [alejhis-selam] i dhimbsej populli i tij, i cili adhuronte copat e gurit apo të drurit të idhujve. Me gjithë mundimet dhe përpjekjet që bëri për t'u treguar njerëzve se nuk gjendej asnjë dallim mes gurëve dhe drurëve të gdhendur nga duart e tyre dhe gurëve të tjerë, përsëri populli ishte këmbëngulës dhe kokëfortë në mospranimin e njësimin të Zotit të Vetëm dhe të Vërtetë.

Populli nuk dëshironte t'i besonte Ibrahimit [alejhis-selam], i cili u tregonte vazhdimisht se idhujt që ata adhuronin nuk kanë fuqi t'u sjellin as mirësi e as ndonjë fatkeqësi, ose nuk kanë fuqi të largojnë ndonjë dëm që mund t'i vijë popullit.

Populli nuk e dëgjonte ftesën në njësimin e Zotit të Vërtetë të Ibrahimit [alejhis-selam] si dhe ata mendonin se ai do të jetë personi i parë që do të dënohet nga dënimi i idhujve. Kjo ishte një luftë e ashpër mendimesh dhe besimi

mes popullit dhe Ibrahimit [alejhis-selam]. Tashmë, dy alternativa kishin mbetur: së pari, do të thyhen idhujt e popullit dhe populli do të besonte njësimin e vërtetë; së dyti, do të vazhdojë ekzistenca e idhujve në popull dhe në këtë mënyrë thirrja e Ibrahimit [alejhis-selam] do përfundonte pa sukses.

Kjo ishte një luftë në të cilën asnjë palë nuk pajtohej dhe i njihte vetëm njërës palë të drejtën e mbijetesës. Këtu shohim përsëri dy alternativa: e para është shkatërrimi, ngritja e shirkut dhe mbizotërimi i teuhidit, ndërsa e dyta është lufta e ekzistencës mes teuhidit dhe shirkut.

Mirëpo, natyra e luftës së teuhidit nuk lejon të jetojë injoranca dhe shirku bashkë me të. Kështu që misioni i Ibrahimit [alejhis-selam] si i të gjithë profetëve të tjerë islamë ishte: *“... për t’i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd.”* (Ibrahim: 1)

Sigurisht që duhej larguar shirku dhe injoranca pranë thirrjes në Zotin e vërtetë: *“Thuaj: “E vërteta erdhi, ndërsa e pavërteta u shkatërrua. Sigurisht, e pavërteta është e paracaktuar të zhduket!”* (El-Isra: 81)

Populli i Ibrahimit [alejhis-selam] kishte një festë pagane ku mblidheshin dhe e festonin të gjithë për çdo vit. Populli i tha Ibrahimit [alejhis-selam]: “Nëse do të vish edhe ti me ne në festë, do të shikosh se do të pëlqejë feja jonë edhe ty.”<sup>48</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] tha: *“Pastaj u hodhi një shikim yjeve e tha: “Unë jam i sëmurë.”* (Es-Saffat: 88) Ibrahimi [alejhis-selam] tha kështu me qëllim që të mos merrte pjesë me banorët e tjerë në festën pagane që zhvillohej jashtë qytetit.

<sup>48</sup> *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, Imam Kurtubi, v.11, f.503.

Babilonasit ishin tepër të dhënë pas parashikimeve dhe lëvizjeve të yjeve.<sup>49</sup> Kështu që edhe Ibrahimimi [alejhis-selam] duke parë yjet i bëri idhujtarët të mendojnë se yjet i kishin treguar Ibrahimit se do të sëmurej.

**“Ata u larguan prej tij, duke e lënë pas.”** (Es-Saffat: 90); **“(Beto hem) për Allahun, se do t’i flak idhujt tuaj, posa të largoheni ju!”** (El-Enbija: 57)

Pavarësisht se Ibrahimimi [alejhis-selam] i tha këto fjalë me zë të ulët, përsëri disa vetë e dëgjuan pëshpëritjen e tij.<sup>50</sup>

Ibrahimimi [alejhis-selam] hyri në vendin ku ndodheshin idhujt dhe pa se idhujt ishin radhitur në mënyrë të tillë ku pranë çdo idhulli të madh gjendej edhe një idhull i vogël. Banorët afruan gjellë përpara idhujve të mëdhenj kur shkuan për të festuar festën e tyre pagane dhe thanë:<sup>51</sup> “Zotat tanë do t’i kenë ngrënë gjellët derisa të kthehemi ne!” dhe më pas u larguan nga aty.<sup>52</sup>

Ibrahimimi [alejhis-selam] u tha idhujve kur pa gjellët që ishin vënë përpara tyre: “A nuk po hani?” Kur e pa që nuk erdhi asnjë përgjigje, tha: **“Ç’keni, përse nuk flisni? Iu afua atyre kalimthi, duke i goditur me dorën e djathtë.”** (Es-Saffat: 92-93); **“Dhe i bëri ata copa-copa, përveç idhullit të tyre më të madh, kështu që ata t’i drejtoheshin atij.”** (El-Enbija: 58)

Ibrahimimi [alejhis-selam] u largua nga vendi i idhujve dhe idhullit më të madh i la sëpatën në dorë me të cilën kishte thyer idhujt e tjerë.<sup>53</sup>

<sup>49</sup> *Kur’ân’da Peygamberler ve Peygamberimiz*, Abdulfettah Tabbara, f. 132.

<sup>50</sup> *Ahkâmi’l-Kur’ân*, Imam Kurtubi, v.11, f.503.

<sup>51</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.146.

<sup>52</sup> *El-Kâmil Fi’t-Târih*, *Ibnu’l-Ethir*, v.1, f.90.

<sup>53</sup> *Ibnu’l-Ethir*, 1/90; *Târih-i Taberi*, 1/147; *Ahkâmi’l-Kur’ân*, 11/504.

Thyerja e idhujve ishte një argument praktik për t'i treguar popullit të tij se idhujt nuk mund t'i bënin asnjë gjë edhe njeriut që i thyen ata. Sepse nganjëherë argumentet praktike janë më shumë ndikues tek njeriu se sa predikimet.<sup>54</sup>

Pasi mbaroi festa, njerëzit erdhën në vendin e idhujve për t'iu lutur, por çfarë të shihnin, të gjithë ishin të thyer përveç njërit dhe pas këtij pikëllimi thanë: ***“Disa thanë: “Kush i bëri kështu zotat tanë? Me të vërtetë, ai është keqbërës!”***

***Të tjerët u përgjigjën: “Dëgjuam një djalosh që i përgojonte, quhej Ibrahim.”***

***“Atëherë silleni atë para syve të botës, që ata të dëshmojnë” – thanë ata.”*** (El-Enbija: 59-61)

Ky ishte reagimi që priste Ibrahim [alejhis-selam] prej tyre. Sepse ai dëshironte që i gjithë populli të shikonte me sytë e tij se idhujt nuk kishin mundësi të mbronin as veten e tyre e as të sulmojnë personin që i thyen ata, kështu që edhe populli le të shikonte me sytë e tij se idhujt nuk ishin gjë tjetër vetëm se një mashtrim i klerikëve paganë.<sup>55</sup>

Pasi e sollën Ibrahim [alejhis-selam] përpara popullit, ***“Ata e pyetën: “Ti i bëre kështu zotat tanë, o Ibrahim?”***

<sup>54</sup> Njëri prej perandorëve japonez, bëri një skulpturë tepër të madhe të Budëf. Gati në mbarim të skulpturës ndodhi një tërmet dhe e rrëzoi këtë skulpturë nëpër tokë.

Kur e pa të rrëzuar dhe të coptuar këtë skulpturë perandori, hodhi një shigjetë në një mënyrë tallëse dhe nënçmuese duke thënë: “Harxhova shumë para dhe të ndërtova ty këtu. Por ti as vendin tënd nuk qe i zoti për të mbrojtur.” (*Kur’ân’da Peygamberler ve Peygamberimiz*, Abdulfet-tah Tabbara, f. 127).

<sup>55</sup> *Tefhimu ’l-Kur’ân*, Mevdudi, v.3, f.285.

***Ai tha: “Jo! Këtë e ka bërë ky i madhi i tyre.”*** (El-Enbija: 62-63)

“Sepse ai u shqetësua, xhelozua, nga adhurimi i idhujve të tjerë, u mërziu dhe i theu ata, ja shikojeni edhe sëpata është në duart e tij.”<sup>56</sup>

Mund të jetë mërziu kur pa se po adhurohen pa pasur dallim idhujt e vegjël nga idhujt e mëdhenj dhe për këtë i ka thyer idhujt e tjerë.<sup>57</sup>

“Gjithashtu, nuk është e drejtë të adhuroni idhujt e vegjël në vend të idhullit të madh!”<sup>58</sup> ***“Pyesni ata, nëse flasin!”*** (El-Enbija: 63)

Populli pagan u habit përballë pyetjeve që u bëri Ibrahim [alejhis-selam], kështu që nuk mundën të gjejnë ndonjë përgjigje të logjikshme dhe të përshtatshme për pyetjet. Ata po prisnin ndihmë nga idhujt duke heshtur me qëllim që ata t’i ndihmojnë nga gjendja e vështirë që kishin rënë.

Mirëpo, pasi kaloi një kohë e shkurtër panë gjendjen qesharake të tyre kur nuk dëgjuan asnjë përgjigje nga idhujt që adhuronin!<sup>59</sup>

***“Atëherë ata i thirrën mendjes dhe i thanë njëri-tjetrit: “Me të vërtetë, ju vetë jeni keqbërësit.”*** (El-Enbija: 64)

Kur populli e pa se nuk ishin në gjendje t’i përgjigjen pyetjeve të Ibrahimit [alejhis-selam], vërejtën se kishin bërë për zota, perëndi, qeniet materiale që nuk ishin në gjendje as të përgjigjen se cili i kishte thyer.

Filluan të flasin mes njëri-tjetrit duke thënë:

<sup>56</sup> *Târih-i Taberi*, 1/321; *Ahkâmi’l-Kur’ân*, 11/507.

<sup>57</sup> *El-Itkan Fî Ulûmi’l-Kur’ân*, Xhelaledin es-Sujuti, v.2, f.131.

<sup>58</sup> *Ibnu’l-Ethir*, 1/91; *Ahkâmi’l-Kur’ân*, 11/507.

<sup>59</sup> *Aziz Kur’ân*, Muhamed Hamidullah, f.474.

- A mos vallë Ibrahimimi ishte në të drejtë?

- A nuk e kemi kuptuar deri tani se çfarë ka thënë Ibrahimimi?

- Si do ta mbrojnë popullin këto qenie kur nuk janë në gjendje të mbrojnë as veten e tyre?

- Ne i bëmë padrejtësi atij (me mendimet dhe besimet tona). E fajësuam atë. Kur e dinim se prej idhujve nuk mund të vijë asnjë dëm e dobi dhe asnjë zemërim.”<sup>60</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] tha: “Përse i adhuroni ata kur e dini shumë mirë se ata nuk mund të thonë asnjë fjalë dhe se nuk mund t’i japin askujt as dobi dhe as dëm?”<sup>61</sup>

Populli ngeli mes besimit dhe injorancës i habitur pas pyetjeve të Ibrahimit [alejhis-selam], mirëpo shejtani i mash-troi dhe kështu ata përsëri mbetën jobesimtarë duke treguar kokëfortësi në mosbesimin e njësimin të Zotit të Vërtetë.

Shejtani i kishte lidhur pas tij dhe ia kishte zbukuruar rrugën e gabuar, të cilën e kishin ndjekur vazhdimisht. Kështu që ata u kthyen përsëri në paganizëm duke treguar kokëfortësi përballë ftesës së Ibrahimit [alejhis-selam] në njësimin e Zotit të Vërtetë dhe pasi u kthyen në besimin e tyre të vjetër iu drejtuan Ibrahimit [alejhis-selam] duke thënë: ***“Pastaj ulën kokat dhe i thanë: “Sigurisht që ti e di, se këta nuk flasin!”*** (El-Enbija: 65)

Ibrahimi [alejhis-selam] me veprën e tij dëshironte t’i tregojë popullit injorant të paditur gjendjen reale të idhujve që ata adhuronin. Kështu që së fundi ia arriti qëllimit të tij pasi populli e pranoi që idhujt nuk mund t’iu sjellin atyre kurrfarë dobie e as dëmi.

<sup>60</sup> *Ibnu’l-Ethir*, 1/91; *Ahkâmi’l-Kur’ân*, 11/511.

<sup>61</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.148.

Kështu që Ibrahimit [alejhis-selam] i lindi rasti t’i ftojë njerëzit në njësimin e Zotit të Vërtetë pasi pranuan pafuqishmërinë e idhujve.

***“Ai u tha: “Mos vallë, ju adhuroni në vend të Allahut gjëra që nuk mund t’ju sjellin kurrfarë dobie e as dëmi?!”***

***Mjerë ju dhe mjerë ata që ju i adhuroni në vend të Allahut! A nuk arsyetoni?!”*** (El-Enbija: 66-67)

Ibrahimi [alejhis-selam] dëshironte ta shpëtojë popullin e tij nga verbëria e injorancës së paganizmit dhe e këshillonte vazhdimisht atë për t’u zgjuar nga ky gjumë i injorancës së paganizmit si dhe ata të përdornin sa më shumë logjikën e shëndoshë.

Sepse paganët pranonin çdo gurë, dru, bronz dhe çdo gjë tjetër që gjendej në tokë dhe në qiell, përveç njësimit të Krijuesit të gjithësisë.

Në realitet një dëshirë e tillë gjithmonë nuk ka qenë një besim që ishte pranuar me pëlqimin e dëshirës së vetë popullit. Paganizmi zakonisht ishte një dëshirë dhe pëlqim që ka ndodhur nga dëshira dhe pëlqimi i klasës klerike dhe u është ofruar popullit të padijshëm.

Klerikët në realitet i bënë padrejtësi vetvetes duke i shoqëruar Allahut të Vërtetë objekte apo idhuj të gdhendur nga ata dhe ua ofronin popullit për përfitimet, të ardhurat e tyre të kësaj bote. Më pas fshiheshin pas idhujve dhe e kërcënonin popullin me anë të tyre.

## SPROVOHET IBRAHIMI [alejhis-selam] ME HEDHJEN NË ZJARR

Pavarësisht rrezet që hynë në mendjet e popullit nga drita e vërtetë nga reagimi i Ibrahimit [alejhis-selam], me plotë kuptim dhe trimëri, si dhe kundërshtimi përfshirës dhe zgjues nga injoranca që i bëri popullit, përsëri kokëfortësia në autoritet, mosbesim dhe frika që mbanin në zemër kundër Ibrahimit [alejhis-selam] nga dita në ditë po zgjerohej në të katër anët e popullit.

Ibrahimi [alejhis-selam] në realitet me thyerjen e idhujve dëshironte të luftonte me sunduesit e tyre. Sepse ata i kishin vënë një regjim popullit për përfitimet dhe lumturinë e një klase klerike apo udhëheqësve të popullit. Ose më saktë do të ishte shprehja e Marksit, i cili thotë: “Feja është opium për të shfrytëzuar popujt...” Edhe nëse ishte një fe apo besim i gabuar në popull, përsëri kjo ishte e mjaftueshme për përfitimet e klasës udhëheqëse... Kështu që thyerja e idhujve nga Ibrahimi [alejhis-selam] në realitet ishte thyerja e ideologjisë shtetërore. Për këtë arsye, bënin dhe (esnam) skulpturat, të cilat janë të dëmshme për njerëzit.

Udhëheqësit e popullit filluan të shqetësohen nga fjalimet e Ibrahimit [alejhis-selam] dhe vepra që bëri. Më pas filluan të flasin ndërmjet njëri-tjetrit duke thënë: “Nëse nuk do të marrim masa parandaluese ndaj tij, populli që është nën sundimin tonë do të vazhdojë të dëgjojë fjalët e Ibrahimit dhe do të adhurojë Zotin e tij, kështu që do e braktisin adhurimin tonë. Si pasojë do të shkatërrohet rregulli, do të na ikë jeta e rehatshme si dhe do të bëhemi edhe ne njerëz të



thjeshtë si të tjerët që do të dëgjojmë fjalët, urdhrat dhe do të adhurojmë Zotin e Ibrahimit.”

Nemrudi, i cili nuk ngeli aspak i kënaqur nga fjalimet e Ibrahimit, nuk dëshiroi ta lejojë thirrjen e tij në njësimin e Zotit të Vetëm. Ata e braktisën dialogun me Ibrahimin [alejhis-selam], sepse nuk gjenin dot ndonjë përgjigje shkencore apo të logjikshme ndaj pyetjeve të arsyeshme të tij, kështu që preferuan të përdorin dhunë ndaj tij, me qëllim që të mbulonin hilet gënjeshtare, mashtruese të tyre ndaj popullit.

Vendosën ta ndalojnë këtë gjuhë që thërret për drejtësi, për ta larguar nga aty këtë trup, i cili me të gjithë fuqinë e tij mundohet të thërrasë në njësimin e Zotit të Vetëm. Dhe **“Ata thirrën: “Digjeni atë dhe ndihmoni zotat tuaj, nëse doni të bëni ndonjë vepër!”** (El-Enbija: 68)<sup>62</sup>

Nëse nuk simbolizonin një idhujtari në popull këta idhuj, atëherë përse reagoi Nemrudi dhe klasa e tij sunduese në këtë mënyrë pasi Ibrahimit [alejhis-selam] i theu ata? Edhe në ditët e sotme në vendet e prapambetura (për arsye të regjimeve), shohim se ata që thyejnë skulpturat (monumentet) marrin dënimet më të rënda. Edhe nëse populli mund të ketë nevojë për një kafshatë bukë, përsëri ata që janë me një logjikë të tillë bëjnë harxhime pa masë në ndërtimin e skulpturave, monumenteve të forta me qëllim që të mos thyhen lehtë. Zakonisht këta i hapin tempujt në ditët e festave të popullit.<sup>63</sup>

Ibrahimit [alejhis-selam] nuk i theu idhujt me emociione të menjëhershme, me kokëfortësi apo me urrejtje, por ai i theu me një detyrim që ndiente përballë bindjes së thellë

<sup>62</sup> “O njerëz! Vriteni atë që na vrau zotat tonë!” *Ungjilli Barnabas*, f. 93.

<sup>63</sup> *Islâm Öncesi Meke Dönemi*, İhsan Süreyya Sırma, f.35.

që kishte në njësimin e Zotit të Vetëm. Sigurisht që ai i theu ata për të parandaluar adhurimin e gabuar të tyre dhe nuk i theu për të bërë ndonjë revolucion me qëllim që të marrë pozita të mëdha në popull.

Kurrsesi ai nuk u tremb kur dëgjoi shqetësimet dhe dënimin që do të merrte për arsye të thyerjes së idhujve. Sepse thyerja e idhujve ishte një detyrë e besimit nga ai. Kështu që ishte i gatshëm për të vuajtur dënimin dhe pasojat e kësaj vepre. Veprat në adhurimin e Zotit sado të zorshme dhe të rrezikshme që mund të jenë në atë vend, përsëri vepra duhet të veprohet pa u trembur nga rreziqet që mund të vijnë. Nuk mund të bëhet fjalë për një adhurues të sinqertë që mendon më shumë pasojat se sa obligimin e adhurimit. Për këtë duhet thënë: ***“Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.”*** (El-En’am: 162)

Ibrahimit [alejhis-selam] iu bënë armiq të gjithë njerëzit duke filluar nga babai, të afërmit, populli dhe, sigurisht, pallati mbretëror, vetëm e vetëm për arsye të thirrjes në njësimin e Zotit të Vetëm.

Nemrudi bashkë me idhujtarët e tjerë, së pari, u munduan ta devijojnë Ibrahimin [alejhis-selam] nga thirrja në teuhidit duke e kërcënuar. Por, kur nuk ia arritën qëllimit, atëherë e kërcënuan se do ta djegin në zjarr nëse nuk do të kthehet nga thirrja e Zotit të Vetëm. Kështu që Ibrahim [alejhis-selam] u sprovua me sprovën e hedhjes në zjarr nga Nemrudi për shkak të thirrjes në akiden e njësimin të Zotit të Vërtetë.<sup>64</sup>

<sup>64</sup> *Târih Boyunca Tevhid Mücadelesi*, Mevdudi, v.2, f.35-36.

Nemrudi urdhëroi të mblidhen nga të gjitha llojet e druve me qëllim që të digjte Ibrahimin [alejhis-selam].<sup>65</sup>

***“Ata thanë: “Përgatitni për të një furrë dhe hidheni në zjarrin flakërues!”*** (Es-Saffat: 97)

Mbledhja e druve zgjati një muaj. Flakët e zjarrit filluan të zgjaten drejt qiellit. Flaka e zjarrit shikohej nga një largësi tepër e madhe. Nxehtësia e zjarrit ishte aq e madhe sa që mund të digjte çdo gjë që kalonte afër tij.<sup>66</sup>

Nemrudi dhe idhujtarët e tjerë, tashmë, nuk dinin se si ta hedhin Ibrahimin [alejhis-selam] në zjarr nga flaka dhe nxehtësia e madhe e zjarrit. Por shejtani [alejhil-la’ne] (mallkimi qoftë mbi të) i sugjeroi hedhjen me gurëhedhës.<sup>67</sup> Një mendim i tillë ishte i pranueshëm për të gjithë ata që ishin prezent. Dhe kështu ***“Ata thanë: “Përgatitni për të një furrë dhe hidheni në zjarrin flakërues!”*** (Es-Saffat: 97) Bënë një gurëhedhës të madh dhe e lidhën Ibrahimin [alejhis-selam] nga duart dhe këmbët.

Atë ditë, përveç njerëzve dhe xhindëve, të gjithë melekët dhe krijesat e tjera që gjendeshin në tokë dhe në qiej u lutën duke thënë: “O Zoti ynë! Nuk ka asnjë njeri tjetër në tokë që të adhuron Ty përveç Ibrahimit [alejhis-selam]. Edhe ai është duke u hedhur në zjarr dhe do të digjet vetëm për hirin Tënd. Na lejo ta ndihmojmë Ibrahimin.”

Allahu i Madhërishëm u tha: “Ndihmoheni nëse kërkon ndihmë nga ju. Unë ju kam dhënë leje në këtë çështje. Mirëpo, Unë jam më i Dituri dhe e di gjendjen e tij më mirë

<sup>65</sup> *El-Kâmil Fi’t-Târih, Ibnu’l-Ethir, v.1, f.92.*

<sup>66</sup> *Ibnu’l-Ethir, 1/92; Târih-i Taberi, 1/151; El-Bidâje ve’n-Nihâje, 1/146; Ahkâmi’l-Kur’ân, 11/512.*

<sup>67</sup> *Târih-i Taberi, 1/151-152; Ahkâmi’l-Kur’ân, 11/512; Tiblyan Tefsiri, v.3, f. 174.*

se ai. Ai nuk ia hap duart e lutjes askujt tjetër përveç Meje. Unë jam Ndhimëtari më i mirë i tij.”<sup>68</sup>

Në këtë moment Ibrahim [alejhis-selam] i hapi duart e lutjes dhe iu drejtua Allahut të Madhërishëm, duke thënë: “Zoti im! Nuk ka zot tjetër përveç Teje. Ti je larg të metave. Ti je Krijuesi i gjithë botëve. Falënderimi të përket vetëm Ty. Ti je Sunduesi dhe Gjykuesi i Vetëm. Nuk ke shokë.”<sup>69</sup> **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”** (El-Fatiha: 5)

Ibrahimi [alejhis-selam] këmbëngulte në shpëtimin e tyre nga zjarri i Xhehenemit duke i ftuar në rrugën e drejtë, por populli idhujtar nuk e dëgjoji dhe e hodhi atë në zjarr për ta djegur.<sup>70</sup>

Ibrahimit [alejhis-selam] i erdhi Xhebraili [alejhis-selam] në momentin kur u hodh në zjarr dhe e pyeti: “O Ibrahim! A ke nevojë për ndonjë gjë?”

Ibrahimi [alejhis-selam] tha: “Nuk kam nevojë për ty.”

Xhebraili tha: “Atëherë nevojën tënde kërkoje prej Krijuesit tënd!”

Ibrahimi [alejhis-selam] tha: “Allahu e di gjendjen time dhe kjo më mjafton mua!”

Më pas Ibrahim [alejhis-selam] e ngriti kokën drejt qiellit dhe tha: “O Zoti im! Ti je i Vetmi në qiej dhe në tokë! Edhe unë jam vetëm në tokë. Në tokë nuk ka kush tjetër të adhurojë Ty përveç meje.”<sup>71</sup> Më pas tha: **“Neve na mjafton Allahu, Ai është Mbrojtës i Mrekullueshëm!”** (Ali Imran: 173)

<sup>68</sup> *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, Imam Kurtubi, v.11, f.512-513.

<sup>69</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/ 208; *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, 11/513.

<sup>70</sup> *Urfa Târihçesi*, Sabri Yazar, f. 53.

<sup>71</sup> *Nevairul'Usul*, Hakimu't-Tirmidhi, f.218; *Tarih-i Taberi*, 1/125; *Kutu'l-Kulub*, Ebu Talib Meki, 1/466; Arais, Thâlebi, f.77; *Tebisira*, Ebu'l-Ferexh

“Duro (ej Ibrahim)! Durimi yt është vetëm me anë të ndihmës së Allahut të Madhërishëm. Për këtë arsye mos u pikëllo, mos u shqetëso prej kurthit që kanë përgatitur! Sepse Allahu i Madhërishëm është me ata që bëjnë vepra të mira dhe mbrohen (nga punët e këqija).”<sup>72</sup>

***“Prandaj duro! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut. Dhe mos u pikëllo për ta e mos u ngushto për shkak të dredhive të tyre! Vërtet, Allahu është me ata që e kanë frikë dhe që janë punëmirë.”*** (En-Nahl: 127-128)

Në atë moment Allahu i Madhërishëm me fuqinë dhe me mëshirën e Tij urdhëroi dhe bëri një mrekulli. Kështu që ia prishi planet dhe kurthet që kishte planifikuar populli idhujtar përballë profetit të Allahut të Madhërishëm. ***“Allahu nuk do t’iu japë kurrë rast mohuesve që t’i shkatërrojnë besimtarët.”*** (En-Nisa: 141)

A nuk është Allahu i Madhërishëm Ai që e krijoi çdo gjë? A nuk janë grimcat më të vogla dhe malet më të mëdhenj nën urdhrat e Tij? Allahu i Madhërishëm e urdhëroi zjarrin: ***“...O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!”*** (El-Enbija: 69) Nëse Allahu i Madhërishëm nuk do e kishte urdhëruar të ftohtin “bëhu shpëtues”, atëherë Ibrahim i [alejhis-selam] do të vdiste nga i ftohti i madh sikurse do të vdiste nga nxehtësia e madhe e zjarrit.<sup>73</sup>

Zjarri u bë një vend i ftohtë dhe shpëtues për Ibrahimin [alejhis-selam] pasi Allahu i Madhërishëm e urdhëroi atë të

---

Ibn Xhevzi, 1/115; *El-Kâmil Fi't-Târih*, 1/99; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, Ebu'l-Fidâ, 1/146; *Ravdatu's-Safa Tercemesi*, Mir Havend, f.164; M. Asım Köksal, *Peygamberler Tarihi*, v.1, f.157.

<sup>72</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/208; Buhâri, Tefsir, 13; *Xhamiu's-Sagir*, 1/4.

<sup>73</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, 1/152.

bëhet i ftohtë dhe shpëtues për Ibrahimin [alejhis-selam].<sup>74</sup> Kështu që zjarri u kthye në një erë freskuese për Ibrahimin [alejhis-selam].

***“Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t’i thotë asaj “Bëhu!” - dhe ajo bëhet.”*** (Jasîn: 82)

Transmetohet se zjarri dogji vetëm litarët tek duart dhe këmbët e Ibrahimit [alejhis-selam].<sup>75</sup>

Tmerri dhe frika e zjarrit nuk e trembën zemrën e Ibrahimit [alejhis-selam]. Sepse në zemrën e tij ekzistonte vetëm dashuria e Allahut të Madhërishëm. Frika dhe tmerri ishin të vdekura për të. Pa dyshim ata që e duan Allahun e Madhërishëm kurrë nuk kanë frikë prej askujt tjetër përveç Tij. Frika nuk ka vend tek zemrat e besimtarëve të tillë.

Ibrahimi [alejhis-selam] tha: “Asnjëherë tjetër nuk kam parë dhunti të ngjashme me ato që pashë gjatë ditëve kur isha në zjarr.<sup>76</sup> Është e papërshtatshme qetësia dhe lumturia që pashë në ato ditë.”<sup>77</sup>

Transmetohet se Ibrahim [alejhis-selam] ishte njëzet e gjashtë<sup>78</sup> ose njëzet e shtatë vjeç<sup>79</sup> kur u hodh në zjarr.

Mbreti, të afërmit e tij si dhe magjistarët u ulën nëpër stola për të parë nga larg zjarrin që ishte përgatitur për dëgjien e Ibrahimit [alejhis-selam]. Pavarësisht se zjarri kishte një largësi të madhe prej tyre, përsëri nxehtësia e tij ishte tepër e madhe dhe e padurueshme për fytyrat e tyre. Edhe

<sup>74</sup> *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, 11/513; *Kisas-ı Enbijâ*, Ahmet Cevdet Paşa, 1/20.

<sup>75</sup> *Târih-i Taberi*, 1/152-153; *Ibnu 'l-Ethir*, 1/92; *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, 1/514.

<sup>76</sup> *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, Imam Kurtubi, v.11, f.514.

<sup>77</sup> *Tibyan Tefsiri*, Ayintabi Mehmed Efendi, v.3, f. 175.

<sup>78</sup> *Kisasu 'l-Enbijâ*, Thalebi, f.68 – *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, Imam Kurtubi, 11/514.

<sup>79</sup> *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, Imam Kurtubi, v.11, f.514.

shpirtrat e tyre u tmerruan nga frika dhe tmërri i temperaturës së nxehtë të zjarrit. Zjarri filloi të digjet për një kohë të gjatë saqë shumica e mohuesve filluan të mendojnë se nuk do të fikej kurrë. Ndërkohë, kur fytyra e Nemrudit dhe ithtarëve të tij ishin të skuqura nga nxehtësia e zjarrit, Ibrahimimi [alejhis-selam] doli nga prushi i zjarrit i gjallë dhe pa pasur asnjë plagë djegie në trup. Ndërsa fytyra e Ibrahimimit [alejhis-selam] ndriçonte porsin një dritë.<sup>80</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] qëndroi plotë shtatë ditë në zjarr.<sup>81</sup>

***“Ata deshën ta lëndonin, por Ne i bëmë të dështonin.”***

(El-Enbija: 70)

***“Allahu e shpëtoi atë nga zjarri. Vërtet, këtu ka shenja të qarta për njerëzit që besojnë.”***(El-Ankebut: 24)

Pavarësisht se idhujtarët e panë dhe e kuptuan se Ibrahimimin [alejhis-selam] e ruajti Zoti i tij nga zjarri dhe, tashmë, e kishin kuptuar se thirrja e tij në njësimin e Zotit të Vetëm ishte në të drejtë, përveç një grupi të vogël, të tjerët nuk e pranuan besimin e drejtë dhe të vetëm pavarësisht se e panë me sytë e tyre një mrekulli kaq të madhe.

***“Dhe ai tha: “Ju, në vend të Allahut, keni zgjedhur idhujt, për shkak të dashurisë midis jush në këtë jetë. Por, në Ditën e Kiametit do ta mohoni njëri-tjetrin dhe do ta mallkoni njëri-tjetrin. Streha juaj do të jetë zjarri dhe nuk do të ketë për ju kurrfarë ndihmësi.”***(El-Ankebut: 25)

<sup>80</sup> *Peygamberler Târihi*, A. Lütü KAZANCI, v.1, f.196.

<sup>81</sup> *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, Imam Kurtubi, v.11, f.514.





## **PJESA E DYTË**

### **HIXHRETI /EMIGRIMI I IBRAHIMIT DHE MARTESA ME SARAN**



## IBRAHIMI EMIGRON NË HARRAN BASHKË ME BESIMTARËT

Sara, vajza e xhaxhait të Ibrahimit, dhe Lûti, djali i Harranit, vëllai i Saras, besuan në pushtetin dhe fuqinë e Allahut të Madhërishëm si dhe në profetësinë e Ibrahimit halilullah (Miku i Allahut) kur panë se nuk e dogji zjarri më i madh dhe, gjithashtu, thirrjen me mëshirë dhe dhembshuri të Ibrahimit [alejhis-selam] në njësimin e Zotit të Vetëm, të Nemrudit dhe itharët e tij pavarësisht se ata u munduan ta djegin.<sup>82</sup>

***“Luti i besoi atij dhe tha: “Unë do të mërgoj te Zoti im; me të vërtetë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”*** (El-Ankebut: 26)

***“Shembull i mrekullueshëm për ju është Ibrahimit dhe ata që kanë qenë me të.”*** (El-Mumtehine: 4) Në këtë ajet theksohet se “ata që kanë qenë me të” ishin Sara, vajza e xhaxhait të Ibrahimit, dhe Lûti, djali i Harranit, vëllai i Saras.<sup>83</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] dhe besimtarët që u shpëtuan nga populli idhujtar nuk mundën të qëndrojnë më shumë në vendin e Nemrudit. Sepse populli idhujtar dhe mohues, siç nuk dëgjonin urdhrat dhe ndalesat e Krijuesit të botëve, po ashtu, nuk dëshironin jetesën e besimtarëve që përuleshin përpara urdhrave të Allahut të Madhërishëm. Tashmë në popull ekzistonin dy mendime dhe jetesa të ndryshme nga njëra-tjetra.

<sup>82</sup> *Târih-i Taberi*, 1/155; *Ibnu 'l-Ethir*, 1/100.

<sup>83</sup> *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, Imam Kurtubi, v.18, f.56.

Njëra prej tyre ishte rruga dhe jetesa e Nemrudit dhe popullit të tij, të cilët e kishin ndërtuar jetesën e tyre mbi errësirë, mashtrime si dhe ishin të mashtruar pas dëshirave të përkohshme të kësaj bote.

Ndërsa rruga tjetër ishte rruga e Ibrahimit [alejhis-selam] dhe e besimtarëve të tij, të cilët besonin dhe ndiqnin vetëm rrugën e shndritshme dhe të drejtë të Allahut të Madhërishëm, i Cili është Sunduesi i gjithësisë, Gjykues në këtë botë dhe në botën tjetër, i Gjithëdijshmi dhe i Plotfuqishmi. Allahu i Madhërishëm është Krijuesi i jetës dhe i vdekjes. Padyshim kthimi do të jetë tek Ai dhe do të japim llogari përpara Tij Ditën e Gjykimit.

Siç ishte i shqetësuar Nemrudi bashkë me ndjekësit e tij nga Ibrahim [alejhis-selam] dhe grupi i vogël i besimtarëve, po ashtu, edhe besimtarët ishin të shqetësuar përballë idhujtarëve, të cilët vazhdonin me këmbëngulje në injorancë si dhe në shirkun ndaj Allahut të Madhërishëm.

Kur erdhi koha e duhur Ibrahim [alejhis-selam] dhe besimtarët e tjerë u thanë popullit të tyre: ***“Ne shkëputemi nga ju dhe nga ato që ju i adhuroni në vend të Allahut; ne ju mohojmë dhe armiqësia e urrejtja midis nesh është e përherëshme, derisa të besoni tek Allahu Një dhe i Vetëm.”*** (El-Mumtehine: 4)

Më pas i ngritën duart dhe iu lutën Allahut të Madhërishëm: ***“O Zoti ynë, tek Ti mbështetemi, Ty të drejtohemi dhe tek Ti do të kthehemi.”***

***O Zoti ynë, mos na bëj sprovë për jobesimtarët dhe falna ne,***

***O Zot. Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti.”*** (El-Mumtehine: 5)

“O ju idhuj! Ne ju mohojmë dhe ju refuzojmë!

O ju idhujtarë! Armiqësia mes nesh do të vazhdojë derisa të besoni Allahun e Vetëm.”<sup>84</sup>

E shprehën vendosmërinë përballë idhujtarëve pa u trembur, duke u thënë: ***“Ne shkëputemi nga ju dhe nga ato që ju i adhuroni në vend të Allahut; ne ju mohojmë dhe armiqësia e urrejtja midis nesh është e përhershme, derisa të besoni tek Allahu Një dhe i Vetëm.”*** (El-Mumtehine: 4)

Mërgimi i profetit Ibrahim [alejhis-selam] në Zanafillën e Biblës tregohet në këtë mënyrë: *“Por Zoti i tha Abrahamit: “Largohu nga vendi yt, nga të afërmit e tu dhe nga shtëpia e babait tënd, dhe shko në vendin që do të të tregoj. Unë prej teje do të bëj një komb të madh, do të të bekoj dhe do ta bëj të madh emrin tënd, dhe ti do të jesh një bekim. Dhe Unë do të bekoj të gjithë ata që do të të bekojnë dhe do të mallkoj ata që do të të mallkojnë, te ti do të jenë të bekuara tërë familjet e tokës.”*<sup>85</sup>

Mbretëria e Nemrudit ishte e verbër dhe shurdhe përballë thirrjes në njësimin e Zotit të Vetëm. Zemrat e popullit ishin ngurtësuar aq shumë saqë nuk arrinin të kuptonin thirrjen e vërtetë. E mohuan profetin e Allahut të Madhërishëm, i cili ishte njëri prej tyre, gjithashtu u munduan ta digjnin me qëllim që ta zhduknin mesazhin hyjnor që solli ai.

Ibrahimi [alejhis-selam], i cili u shpëtua nga zjarri me urdhër të Allahut të Madhërishëm, tashmë, nuk kishte rrugë tjetër vetëm se të gjejë një vend tjetër për të banuar si dhe njerëz me zemra më të buta, të cilët do e pranonin predikimin e mesazhit hyjnor.

<sup>84</sup> *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, v.1, f.160.

<sup>85</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla* 12:1-3.

Emigrimi nuk ishte një dorëzim përballë idhujtarëve, sepse besimtari që është i shndritur me dritën e besimit nuk shmanget nga errësira, ngase errësira në vetvete shuhet përballë dritës së besimit. Emigrim do të thotë të zhvendosesh nga një vend ku janë shterur mundësitë e suksesit kur njëkohësisht është mundësia e gjallërimit në një vend tjetër.

Asnjëherë nuk ekziston vetëm një ambient, rrethinë apo vetëm një shtet i posaçëm për thirrësin e vërtetë. Padyshim për të nuk ekzistojnë kufij, sepse ai është një person që synon t'ua tërheq vëmendjen dhe t'i largojë njerëzit nga rruga e gabuar për në të drejtë.

Të gjithë profetët janë dërguar me mesazhin e thirrjes në njësimin e Zotit të Vetëm. Edhe hixhreti – emigrimi (shpërngulja) është një nga argumentet që tregon se nuk ekziston asnjë pengesë për atë person që është i dashuruar dhe i vendosur për përhapjen e besimit të vërtetë të Islamit si dhe nxjerrjen e njerëzve nga bataku i injorancës në lulishiten e lumturisë së vërtetë të kësaj bote dhe të botës tjetër.

Le të shohim disa ajete të Kur'anit Famëlartë në lidhje me Ibrahimin [alejhis-selam] dhe emigrimin – hixhretin:

***“Kush mërgon për çështjen e Allahut, ai gjen shumë vendbanime dhe begati në tokë. Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodh që t'i vijë vdekja, Allahu me siguri do ta shpërblejë. Se Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”*** (En-Nîsa: 100)

***“Ata që besojnë, mërgojnë dhe luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë e tyre dhe jetën e tyre, janë në shkallë më të lartë tek Allahu. Pikërisht këta janë të fituarit.”*** (Et-Teube: 20)

*“Ata që, pasi vuajtën të shtypur, u shpërngulën për hir të Allahut, Ne do t’i vendosim në vendbanime të mira në këtë botë. Natyrisht, shpërblimi që i pret në botën tjetër (Xheneti), është edhe më i madh. Ah! Sikur ta dinin ata! (Xheneti është për) ata që kanë duruar dhe janë mbështetur në Zotin e tyre.”* (En-Nahl: 41-42)

*“Ne e shpëtuam Atë dhe Lutin (dhe i çuam) në tokën, të cilën e kemi bekuar për njerëzit.”* (El-Enbija: 71)

## MARTESA E IBRAHIMIT [alejhis-selam] ME SARAN

Sara ishte vajzë e bukur. Kishte përparësi ndaj grave të tjera me bukurinë e saj.<sup>86</sup> Në atë kohë nuk kishte vajzë tjetër më të bukur se ajo.<sup>87</sup>

Sara ishte vajza e udhëheqësit/mbretit të Harranit.<sup>88</sup> Në atë kohë mbretit i thuhej edhe “Bujujel”.<sup>89</sup>

Nëna e Sarës ishte princeshë që quhej Havra binti Kusi. Kusi ishte një padishah/sulltan në Babiloni (Irak). Aty gjendej një përrua me emrin “Përroi Kusi”. Ishte emërtuar me këtë emër sepse gjermimi dhe rregullimi i tij ishte bërë nga Kusi.<sup>90</sup>

Kështu që Sara ishte vajzë e pasur si nga ana materiale, po ashtu, edhe nga ana shpirtërore. Njihej për bukurinë e madhe të saj. Transmeton Abdullah Ibn Mes’udi [radijallahu

<sup>86</sup> *El- Kamil Fi’ t-Târih, Ibnu’ l-Ethir, v.1, f.94.*

<sup>87</sup> *Târih-i Taberi, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.155.*

<sup>88</sup> *Ibnu’ l-Ethir, 1/94; Târih-i Taberi, 1/193.*

<sup>89</sup> *Târih-i Taberi, 1/156; El-Bidâje ve’ n-Nihâje, 1/214.*

<sup>90</sup> *Târih-i Taberi, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.193.*

anhu]: “Jusufit [alejhis-selam] iu dha një e treta e bukurisë së nënës së tij.”<sup>91</sup>

Sara ishte vajzë e zgjuar, e cila kishte besuar profetësinë e Ibrahimit [alejhis-selam].<sup>92</sup> Sigurisht që këto cilësi e bënë atë akoma më të dashur në sytë e Ibrahimit [alejhis-selam].

Ka thënë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në një hadith: “*Gruaja martohet për katër veti, e ato janë: pasuria, familja, bukuria dhe feja/besimi i saj. Ju gjeni dhe zgjidhni atë që është fetare dhe gjeni prehje/qetësi.*”<sup>93</sup>

Martesa e Ibrahimit [alejhis-selam] me Saran ishte urdhër nga Allahu i Madhërishtëm.<sup>94</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] i tregoi Sarës rreth urdhrit hyjnor.

Më pas Sara tha: “Mund të martohemi vetëm me kusht që të mos martohesh me ndonjë grua tjetër<sup>95</sup> dhe të mos ndahemi (divorcohemi).”<sup>96</sup>

Sipas transmetimeve, Sara atëherë ishte në moshën tridhjetë e shtatë vjeçare.<sup>97</sup>

Këtë në Bibël e shohim në këtë mënyrë:

<sup>91</sup> *Metâlib ul-Âlije*, Ibn Hâxher el-Askalânî, 4/3461.

<sup>92</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.155.

<sup>93</sup> Buhâri, *Nikah*, 15; Muslim, *Radâ’*, 53 (1466); Ebu Davud, *Nikah* 2 (2047); Nesâi, *Nikah*, 13 (6, 68); *Kutubi Sitte*, 15/5626.

<sup>94</sup> *Bedajiu’ dh-dhuhur*, Ibni Ijas, f.86; *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, 1/160.

<sup>95</sup> *Hadislerle Kur’ân’ı Kerim Tefsiri*, Ibni Kethir, v.10, f.5350.

<sup>96</sup> *Tabakat*, Ibn Sa’d, 1/46; *Târih-i Taberi*, 1/125.

<sup>97</sup> *Târih-i Taberi*, 1/160; *Tabakat*, Ibn Sa’d, 1/46.



“Emri i gruas së Abramit ishte Saraj.<sup>98</sup> Pastaj Perëndia i tha Abrahamit: “Për sa i përket Sarajt, gruas sate, mos e quaj më Saraj, por emri i saj do të jetë Sara.”<sup>99</sup>

Ndërsa kuptimi i emrit të saj “Sara” në hebraisht do të thotë “Princeshë”.<sup>100</sup>

Ka thënë Ibn Sa’di [rahimehullahu alejhi] në “Tabakat” se kjo martesë ka ndodhur përpara hixhretit/emigrimit.<sup>101</sup> Sepse Ibrahim i [alejhis-selam] gjatë hixhretit bëri një lutje të tillë: “Zot, çfarë do të më japësh, sepse unë jam pa fëmijë dhe trashëgimtar.”<sup>102</sup> ***“O Zoti im, dhuromë një fëmijë prej të mirëve!”*** (Es-Saffat: 100) Një lutje të tillë e bën vetëm një i martuar. Siç shihet kjo lutje është bërë në emigrim e sipër.<sup>103</sup>

Sara asnjëherë nuk ka qenë mosbindëse ndaj Ibrahimit [alejhis-selam] deri në atë kohë. Ishte grua e bindur, e mirë, e cila nuk e kundërshtonte burrin e saj.<sup>104</sup>

Sara e thërriste Ibrahimin “zotëria im” dhe ia dëgjonte fjalën gjithmonë.<sup>105</sup>

Ibrahimi ballafaqohej dhe takonte të gjitha klasat në mesin e popullit kur filloi “thirrjen për në besimin e Zotit të Vetëm dhe të Drejtë”, por edhe nëna jonë, Sara, predikonte të njëjtin besim në mesin e grave.<sup>106</sup>

<sup>98</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 11: 29.

<sup>99</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 17: 16.

<sup>100</sup> *Kitâb-ı Mukaddes*, Bot. K.M. , Şirketi 1997 Istanbul, f.14.

<sup>101</sup> *Es-Sîret 'un-Nebevije*, Ibn Sa’d, v.1, f.47.

<sup>102</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 15: 2-3.

<sup>103</sup> *Târih Boyunca Tevhid Mücâdelesî*, Mevdudi, v.2, f.37.

<sup>104</sup> *El- Kamil Fi't-Târih*, Ibnu'l-Ethir, v.1, f.94.

<sup>105</sup> *Ungjilli*; Petrus 3: 6.

<sup>106</sup> *İslâm Kaynaklarına Göre Hz. İbrahim ve Hanîflik*, Şaban KUZGUN, f.29.

Disa dijetarë kanë thënë se këto gra kanë marrë profetësi/frymëzim hyjnor: “Sara, Merjemja dhe nëna e Musait, paqja e Allahut të Madhërishëm qoftë mbi to.”<sup>107</sup>

Imam Eshariu ia njuh profecinë gjashtë grave, të cilat janë: Havaja, Asija, Sara (nëna e Musait [alejhis-selam]), Haxheri dhe Merjemja [alejhumes-selam]. Përse të mos ketë edhe gra profete përderisa gratë mund të jenë shhide, të përzgjedhura, të dalluara, besimtare të sinqerta? Është vërtetuar në Tevrat, Bibël dhe në Kur’anin Famëlartë, që këtyre gjashtë grave i ka shkuar meleku, i kanë dëgjuar fjalët e melekut dhe kanë folur me të.”<sup>108</sup>

Sipas shumicës së dijetarëve këto janë gra që kanë përfituar pëlqimin e Allahut të Madhërishëm dhe kanë arritur nivelin më të lartë të besimit.<sup>109</sup>

## DËRGIMI I PROFETIT LUT [alejhis-selam] TEK POPULLI SODOM

Në lidhje me Lutin dhe Ibrahimin [alejhimus-selam] në Bibël thuhet në këtë mënyrë:

*“Por Zoti i tha Abramit: “Largohu nga vendi yt, nga të afërmit e tu dhe nga shtëpia e babait tënd dhe shko në vendin që do të të tregoj.*

*Unë prej teje do të bëj një komb të madh, do të të bekoj dhe do ta bëj të madh emrin tënd, dhe ti do të jesh një bekim.*

<sup>107</sup> *El-Bidâje ve ’n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f.217.

<sup>108</sup> *Sahih-i Muslim Şerhi*, v.10, f.286.; *Tecrid-i Sarih Ter. ve Şerhi*, v.9, f.180; *Kelâm*, Prof. Dr. Şerafeddin GÖLCÜK – Prof. Dr. Süleyman TOPRAK, f.336; *T.D.V. İslâm Ansiklopedisi*, 29/240.

<sup>109</sup> *El-Bidâje ve ’n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f.216.

*Dhe Unë do të bekoj të gjithë ata që do të të bekojnë dhe do të mallkoj ata që do të të mallkojnë, te ti do të jenë të bekuara tërë familjet e tokës.*

*Atëherë Abrami u nis siç i kishte thënë Zoti dhe Loti/Lûti shkoi me të. Abrami ishte shtatëdhjetë e pesë vjeç kur u nis nga Harani.*

*Dhe Abrami/Ibrahimi mori me vete Sarajn, gruan e tij, dhe Lotin/Lûtin, birin e të vëllait, dhe të gjithë pasurinë që kishin grumbulluar dhe personat që kishin blerë në Haran, dhe u nisën për të vajtur në vendin e Kanaanëve. Kështu ata arritën në vendin e Kanaanit.<sup>110</sup>*

Allahu i Madhërisëm i dhuroi profetësi Lûtit [alejhis-selam]: *“Lutit i dhamë urtësi dhe dituri, dhe e shpëtuam prej vendbanimit ku bëheshin vepra të liga. Ata ishin vërtet njerëz të këqij e të mbrapshtë.”* (El-Enbija: 74); *“Po ashtu, udhëzuar edhe Ismailin, Eljesain, Junusin dhe Lutin - secilin prej tyre e ngritëm mbi të gjithë njerëzit.”* (El-En’am: 86); *“Lutin e pranuar në mëshirën Tonë. Me të vërtetë, ai është prej të mirëve.”* (El-Enbija: 75)

Lûti [alejhis-selam] u nda nga xhaxhai, Ibrahimi [alejhis-selam], dhe nusja e xhaxhait, Sara, dhe shkoi për të rindërtuar besimin dhe vlerat njerëzore tek populli Sodom pasi i erdhi shpallja hyjnore.<sup>111</sup>

Lûti [alejhis-selam] filloi të banojë në Sodom dhe më pas u martua me një grua prej Sodomit.<sup>112</sup>

Lûti [alejhis-selam] ishte profeti i Allahut të Madhërisëm me zemër dhe karakter të pastër, ndërsa populli Sodom

<sup>110</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla 12: 1-5.*

<sup>111</sup> *Ibnu 'l-Ethir, 1/96; Târih-i Taberi, 1/156.*

<sup>112</sup> *Târih-i Taberi, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.169.*

në të cilin ishte dërguar ishte një popull i shkatërruar si nga morali ashtu edhe nga besimi. Gjatë udhëtimit i plaçkisnin njerëzit duke u marrë pasuritë dhe më pas i vrisnin.<sup>113</sup>

Populli Sodom ishte një popull aq i shkatërruar sa që garonin mes njëri-tjetrit vetëm për punë të këqija, në padrejtësi, në imoralitet dhe në epsh ishin të dhënë pas burrave, këto paturpësi të tilla nuk i kishte bërë askush tjetër më parë.<sup>114</sup>

Ka thënë Muxhahid [rahimehullahu alejhi]: “Ata kryenin marrëdhënie seksuale burrë me burrë përpara popullit me qëllim që gjithkush t’i shikonte.”<sup>115</sup>

Megjithëse Lûti [alejhis-selam] e thirri popullin e tij në rrugën e drejtë, përsëri ata nuk ia vunë veshin kësaj thirrjeje të sinqertë. Akoma më shumë i vazhduan veprat e këqija.

***“Kujtoni fjalët e Lutit, i cili i tha popullit të vet: “Përse bëni paturpësi të tilla që askush nuk i ka bërë në botë?” (El-A’raf: 80); “Vallë, ju, nga e gjitha bota, iu qaseni meshkujve. E i lini mënjanë gratë tuaja, të cilat Zoti juaj i ka krijuar bashkëshorte për ju?! Njëmend, ju jeni popull që kaloni çdo kufi të së keqes.” (Esh-Shuara: 165-166)***

***“Vallë, a mos ju u qaseni me epsh meshkujve, në vend të femrave? Në të vërtetë, ju jeni popull i paditur.” (En-Neml: 55); “bëni marrëdhënie me meshkuj, u zini pusi atyre dhe në tubimet tuaja bëni punët më të ndyra”, populli i tij nuk kishte tjetër përgjigje, përveçse tha: “Na e sill dënimin e Allahut, nëse thua të vërtetën!” (El-Ankebût: 29)***

<sup>113</sup> Tefsir Ibn Kethir, 3/35 - Tefsirli Peygamberler Tarihi, Ubeydullah Bayram TEKİN, f.89.

<sup>114</sup> Târih-i Taberi, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.169.

<sup>115</sup> Tefsirli Peygamberler Tarihi, Ubeydullah Bayram TEKİN, f.89.

***“Kujto kur vëllai i tyre - Luti, u tha: “Vallë, a nuk i frikësoheni ju Allahut? Pa dyshim, unë jam i dërguar i besuar për ju, andaj, frikësojuni Allahut dhe bindmuni mua! Për këtë, unë nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërblimi, mua do të më shpërblejë vetëm Zoti i botëve.”***(Esh-Shuara: 161-164)

***“Populli i Lutit i quante gënjeshtarë të dërguarit.”***(Esh-Shuara: 160)

Pavarësisht se Lûti [alejhis-selam] e thirri popullin e tij në rrugën e drejtë plot dyzet vjet, përsëri atë nuk e besoi as gruaja e tij dhe askush tjetër përveç katër vajzave të tij.<sup>116</sup>

Përgjigjja e popullit ndaj ftesës së Lûtit [alejhis-selam] ishte e tillë: ***“Ata thanë: “Nëse nuk tërhiqesh nga këto, o Lut, me siguri do të jesh i dëbuar.”***(Esh-Shuara: 167) Por ata filluan duke u tallur përballë thirrjes së sinqertë dhe ***“Përgjigjja e popullit të tij ishte: “Dëbojini ata nga vendbanimi juaj! Ata janë njerëz që duan të mbahen të dëlirë.”***(El-A’raf: 82)

***“Ai tha: “Unë kam vërtet neveri për atë që bëni ju!”***(Esh-Shuara: 168)

Populli mohues kokëfortësinë e tij në injorancë e vazhdoi edhe më tej, duke thënë: ***“Na e sill dënimin e Allahut, nëse thua të vërtetën!”***(El-Ankebût: 29)

Lûti [alejhis-selam] përballë kësaj injorance kokëforte: ***“Ai tha: “O Zoti im, më ndihmo kundër popullit që bën mbrapshti!”***(El-Ankebût: 30)

Dhe lutjen e tij e vazhdoi, duke thënë: ***“O Zoti im, më shpëto mua dhe familjen time nga ajo që bëjnë ata!”***(Esh-Shuara: 169)

<sup>116</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.171.

## SARA NË PALLATIN MBRETËROR TË MBRETIT MIZOR

Ibrahimi [alejhis-selam] u nda nga Lûti [alejhis-selam] dhe shkoi në Egjipt bashkë me gruan e dashur, nënën tonë, Saran.<sup>117</sup>

“Ibrahimi [alejhis-selam] shkoi bashkë me Saran në vendin (Egjipt) ku mbretëronte mbreti mizor Amr Ibn Imrii'l-Kajs Ibn Nabiljun Ibn Seba'.”<sup>118</sup>

“Sara ishte më e bukura e njerëzve.”<sup>119</sup>

Kur hyri Ibrahimi [alejhis-selam] me Saran në Egjipt, rojet e mbretit panë bukurinë e Sarës dhe shkuan menjëherë tek mbreti për t'i treguar: “Ka ardhur/hyri një grua në mbretërinë tënde aq e bukur saqë nuk është e pëlqyeshme që ajo të jetë e dikujt tjetër.”

Mbreti mizor urdhëroi truprojat e tij që ta sjellin atë grua menjëherë përpara tij.<sup>120</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] i tha Sarës: “Ky mizor nëse e kupton që ti je gruaja ime, atëherë më mund mua. Prandaj nëse të pyet ty, thuaj se je motra ime. Sepse vërtetë ti je motra ime nga ana fetare. Dhe unë nuk njoh ndonjë motër tjetër muslimane në këtë botë (vend).”<sup>121</sup>

<sup>117</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.157.

<sup>118</sup> Buhâri, *Ehâdîthu'l-Enbijâ*, 8 (1412); Muslim, *Fedâil*, 154 (2371); *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/218.

<sup>119</sup> Buhâri, *Ehâdîthu'l-Enbijâ*, 8 (1412); Muslim, *Fedâil*, 154 (2371); *Ibnu'l-Ethir*, 1/94.

<sup>120</sup> Buhâri, *Ehâdîthu'l-Enbijâ*, 8 (1412); Muslim, *Fedâil*, 154 (2371); *Târih-i Taberi*, 1/157; *Ibnu'l-Ethir*, 1/94.

<sup>121</sup> Buhâri, *Ehâdîthu'l-Enbijâ*, 8 (1412); Muslim, *Fedâil*, 154 (2371); *Ibnu'l-Ethir*, 1/94; *Târih-i Taberi*, 1/157.

Ibrahimi [alejhis-selam] me thënien e tij: “El-Ard” (në tokë, vend) ka theksuar vetëm vendin e Egjiptit. Këtë mund ta shohim edhe në këtë ajet të Kur’anit: **“Me të vërtetë që Faraoni madhështoj në Tokë...”** (El-Kasas: 4) Fjala “El-Ard” (në tokë), e cila kalon në ajet, ka për qëllim vendin e Egjiptit.<sup>122</sup>

Ka thënë Ibn Kethiri [rahimehullahu alejhi] në lidhje me këtë çështje: “Ibrahimi [alejhis-selam] në fjalën e tij ka theksuar: “O Sara! Unë nuk di/njoh ndonjë çift burrë e grua që të jenë muslimanë sikur jemi ne.”, sepse Lûti [alejhis-selam], i cili ishte besimtar në atë kohë, akoma nuk ishte i martuar.”<sup>123</sup>

Sara pasi i kuptoi pasojat që mund të ndodhnin iu lut Allahut të Madhërishëm, duke thënë: “O Zoti im! Ti e di që unë jam besimtare që të kam besuar Ty dhe të dërguarin tënd. Gjithashtu, e kam ruajtur nderin tim. Prandaj më ruaj nga ky jobesimtar!”<sup>124</sup>

Edhe Ibrahimi [alejhis-selam] iu lut Allahut duke iu përulur në sexhde dhe tha: “O Zoti im! Armiqtë e Tu më hodhën në zjarr, ndërsa unë durova dhe nuk kërkova ndihmë nga askush tjetër. O Zoti im! Në të vërtetë nuk më ngeli durim përballë kësaj gjendjeje, ndaj më ndihmo mua!”<sup>125</sup>

Thotë Allahu i Madhërishëm në Kur’an: **“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit.”** (El-Bekare: 153)

<sup>122</sup> *Tefhimu 'l-Kur'ân*, Mevdudi, v.4, f.128.

<sup>123</sup> *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f.217.

<sup>124</sup> Buhâri, *Buyû'*, 100 (1043); Muslim, *Fedâil*, 154 (2371).

<sup>125</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.158.

Allahu i Madhërishëm ia zbuloi perden Ibrahimit [alejhis-selam] dhe Sarës dhe ata e panë se çfarë do t'i priste dhe me çfarë vështirësish do të ballafaqoheshin duke filluar nga takimi e deri tek ndarja nga mbreti mizor. Allahu i Madhërishëm u tregoi atyre se si mund të mbroheshin dhe cila ishte udha e shpëtimit nga mizoria e mbretit, me qëllim që të jenë të qetë si nga mendja ashtu edhe nga zemra.<sup>126</sup>Në momentin që hyri Sara pranë mbretit mizor, ai menjëherë tentoi të zgjasë dorën drejt saj, por dora menjëherë iu kap (i ngriu).

Mbreti, pasi e pa se çfarë i ndodhi, kërkoi nga Sara që t'i lutej Zotit që t'i kthehej dora përsëri si e kishte më parë duke e garantuar Saran që nuk do e prekë dhe lëndojë.

Sara i lut Allahut të Madhërishëm, duke thënë: “O Zoti im! Nëse do të vdesë ky burrë, atëherë njerëzit do të thonë se këtë e vrau kjo grua.”

Pas kësaj, mbretit iu lirua krahu, por ai përsëri tentoi ta përsëritë veprimin e tij, kështu që edhe këtë herë krahu i ngriu akoma më shumë se hera e parë. Mbreti përsëri kërkoi të njëjtën gjë nga Sara.

Sara i bëri përsëri të njëjtën lutje Allahut dhe krahu i mbretit u lirua, por mbreti mizor tentoi përsëri për herë të tretë dhe herën e tretë krahu i ngriu akoma edhe më shumë.

Më pas mbreti i tha Sarës: “Lutju Zotit tënd të më lirohet krahu. Allahu është dëshmitar që nuk do të lëndoj dhe nuk do të prek.”

Sara iu lut Allahut të Madhërishëm për herë të tretë dhe më pas mbretit iu lirua dora për herë të tretë.

---

<sup>126</sup> *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, Ibni Kethir, v.1, f. 218.



Mbreti thirri trupprojën, i cili më parë i solli Saran pranë tij, dhe i tha: “Ti nuk më paske sjellë njeri, por vetëm se një shejtan! Nxirreni menjëherë këtë nga vendi im dhe jepini Haxheren atyre si shpërblim.”<sup>127</sup>

Njerëzit përpara kohës së profetit Ibrahim [alejhis-selam] kur shikonin ndonjë gjendje të jashtëzakonshme mendonin se këtë gjë e bënin shejtanët ose xhindët. Për këtë arsye, edhe mbreti mizor i dha Haxheren Sarës si shpërblim duke menduar se ajo është një një xhinde. Dhe me qëllim mbrojtjeje nga të këqijat që mund të vinin prej saj urdhëroi të dalë nga vendi i tij, Egjipti.<sup>128</sup>

Thuhet se sunduesi i Egjiptit në atë kohë kishte katërqind robëresha dhe shërbëtore, që të gjitha ishin njëra më e bukur se tjetra. Mbreti i tha Sarës: “Të kam falur dy nga këto robëresha. Zgjidh dhe merr atë që të pëlqen.”

Pavarësisht se Sara nuk dëshironte të merrte asnjërën, përsëri sunduesi këmbënguli dhe tha që të paktën merr njëërën prej tyre.

Kështu që Sara zgjodhi njëërën prej tyre, e cila quhej Haxhere. Ajo ishte robëresha/skllavja më kryesore e katërqind robëreshave. Haxherja ndjeu një dashuri të madhe ndaj Sarës prej momentit të parë që e pa.

Mbreti u gëzua dhe i dha dhurata të tjera Sarës kur pranoi marrjen e Haxheres.<sup>129</sup>

Kur Sara iu afrua Ibrahimit [alejhis-selam], ai e pyeti: “Si je? Çfarë ndodhi?”

<sup>127</sup> Buhâri, *Ehâdîthu 'l-Enbijâ*, 8 (1412); Muslim, *Fedâil*, 154 (2371); *Ibnu 'l-Ethir*, 1/94; *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, 1/216; *Târih-i Taberi*, 1/158.

<sup>128</sup> *Sahih-i Muslim Sherhi*, Ahmed DAVUDOĞLU, v.10, f.172.

<sup>129</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.158-159.

Sara tha: “Allahu i Madhërishëm ia ngurtësoi – paralizoi krahun dhe më pas si shpërblim të lutjes sime më dha një robërëshë!”<sup>130</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] iku nga Egjipti në Tejmûn me Saran bashkë me egjiptianen Haxhere. Ata kishin me vete një shumë mallrash për të ngrënë. Tejmûni është Kudsi dhe rrethinat e tij.<sup>131</sup>

## ANALIZË E NJË TRANSMETIMI

Transmetohet se Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “*Profeti Ibrahim [alejhis-selam] ka gënjyer në tre raste gjatë gjithë jetës së tij: rasti i parë kur tha: “..Unë jam i sëmurë...”*, (Es-Saffat: 89) *siç është përmendur në Librin e Allahut të Madhërishëm. Rasti i dytë pasi i theu idhujt dhe më pas tha: “Këtë punë e ka bërë idhulli më i madh.”* (El-Enbija: 63) *Ndërsa rasti i tretë është kur tha: “Sara është motra dhe jo gruaja ime.”*<sup>132</sup>

Allahu i Madhërishëm i ka dalluar profetët me cilësi të tjera mbi njerëzit e tjerë. Profetët kanë disa cilësi më të larta sesa njerëzit e tjerë ngaqë janë mbartës të profetësisë.<sup>133</sup>

<sup>130</sup> Buhâri, *Ehâdîthu 'l-Enbijâ*, 8 (1412); Muslim, *Fedâil*, 154 (2371).

<sup>131</sup> *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f.217-218.

<sup>132</sup> Buhâri, *Enbijâ*, 8 (1412); Muslim, *Fedâil*, 154 (2371); Ebu Davud, *Talak*, 16; Tirmidhi, *Tefsir, Enbijâ* 3; *Ibnu 'l-Ethir*, 1/95; *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, 1/215; *Târih-i Taberi*, 1/157.

<sup>133</sup> Disa nga cilësitë më kryesore që duhet të kenë profetët janë: Sidk (besnik, i drejtë), Emanet (i besueshëm), Fetanet (i mençur dhe i zgjuar) dhe Ismet (jo mëkatar). Këto cilësi janë tepër të rëndësishme në Teblig (në thirrjen dhe përcjelljen e mesazhit që i ka shpallur Allahu i Madhërishëm për njerëzit). *Îbâdet Ilmihâli*, Âdem KARATAŞ, f.77-78).

Padyshim se një nga cilësitë kryesore të tyre është cilësia “Sidk” (besnik).

Sidk: Profetët janë njerëz besnikë, të drejtë, të besueshëm, të cilët nuk gënjejnë kurrë. Pa dyshim që ka ndodhur ajo gjë që ata thonë “ka ndodhur” dhe do të ndodhë ajo gjë që ata thonë “do të ndodhë”.<sup>134</sup> Një cilësi e tillë është një nga cilësitë kryesore të profetëve. Le të shohim një transmetim në lidhje me cilësinë e besnikërisë dhe besueshmërinë e profetëve:

Në realitet këtu nuk ka “gënjeshtër”, por është përdorur në mënyrë figurative. Pra, këtu ne shikojmë se ai ka përdorur fjalën “ta’ridh”.

Ta’ridh do të thotë: “Shprehje e diçkaje duke pasur për qëllim kuptimin e dytë të fjalës.” Ose më thjeshtë: “Përdorimi i fjalës në mënyrë figurative/alegorike, duke e përdorur në kuptimin e dytë të saj.”

Në fakt, shprehja në mënyrën “ta’ridh” është plotësisht e qartë, por ngaqë është fjalë alegorike përmban edhe kuptimin tjetër të fshehur që nganjëherë mund të jetë plotësisht ndryshe nga kuptimi i parë.<sup>135</sup>

Ka transmetuar Imran bin Husajn [radijallahu anhu]: “Shprehjet alegorike përmbajnë një gjerësi që e përjashtojnë gënjeshtren.”<sup>136</sup>

Në lidhje me tekstin e transmetimit ku thuhet se Ibrahim [alejhiss-salam] ka gënjyer, ne shohim se i është dhënë përparësi ajetit të Kur’anit në Suren Saffat ku në të thuhet:

<sup>134</sup> *İbâdet İlmiyhâli*, Âdem KARATAŞ, f.77.

<sup>135</sup> *El-Itkan Fi Ulûmi'l-Kur'ân*, Xhelaleddin es-Sujuti, v.2, f.130-131; *Kur'ân'a Göre Hz. Musa Firavun ve Yahudiler*, Dr. Necati KARA, f.65-66

<sup>136</sup> *Mustedrek*, Hakim, 2/25; *Edebu'l-Mufred*, Imam Buhâri, 885.

*“E tha: “Unë jam i sëmurë.”* (Es-Saffat: 89) Së pari, le t'i hedhim një sy këtij ajetit:

Thënia e Ibrahimit [alejhiss-selam] “Unë jam i sëmurë” tregon se Ibrahim i ishte i shqetësuar nga fjalët e tyre, sepse fjalët e tyre ishin me të vërtetë shqetësuese. Sigurisht që e shqetësonte festa e idhujtarisë së tyre, siç thotë Allahu i Madhërisëm në Kur'an: *“... Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe.”*<sup>137</sup> (Lukman: 13)

Populli besonte se Medjumët paganë parashikonin yjet, prandaj ai duke parë drejt yjeve i bëri ata të hulumtojnë se, vallë, a kanë yjet ndonjë njohuri mbi këtë çështje. Kjo nuk përmban tjetër vetëm se një kuptim të fshehtë (figurativ). Padyshim që këto fjalë janë larg gënjeshtërisë.<sup>138</sup>

Thotë Muhamed Ali es-Sabûnî: “Thënia e Ibrahimit [alejhiss-selam] që është i sëmurë, nuk është gjë tjetër vetëm se shprehje figurative. Kështu që ai tregon mërzinë dhe shqetësimin ndaj kufrit (mosbesimit) dhe inatit që mbanin ata në zemrat e tyre.”<sup>139</sup>

Ka thënë Ibn Kethiri [rahimehullahu alejhi]: “Ibrahimi [alejhiss-selam] e ka thënë këtë fjalë me qëllim që të qëndronte në qytet kur ata të shkonin në festën e tyre. Kështu që pasi ata të dilnin jashtë qytetit ai do të mbetej vetëm me idhujt dhe kështu do të kishte mundësi për thyerjen e tyre. Ai thoshte të vërtetën me thënien “jam i sëmurë”, sepse atë e shqetësonte jashtëzakonisht besimi i popullit në besimet e kota dhe mos dhënien e mundësisë për ndalimin e tyre nga

<sup>137</sup> *Hak Dini Kur'ân Dili*, Elmalılı Muhamed Hamdi YAZIR, v.4, f.442.

<sup>138</sup> *Safvetu 't-Tefâsir*, M. Ali SABUNÎ, v.5, f.256.

<sup>139</sup> *Peygamberlik ve Peygamberler*, M. Ali SABUNÎ, f.81.

besëtytnia si dhe sjelljen në vendin e duhur të urdhrit të Allahut të Madhërishëm.”<sup>140</sup>

Ndërsa Mevdudi këtë ajet e komenton në këtë mënyrë: “Nuk mund të thuhet se kjo fjalë është gënjeshtër përderisa nuk vërtetohet që ai ka qenë i shëndoshë (nuk ka qenë i sëmurë) kur e ka thënë këtë fjalë.”<sup>141</sup>

Ndërsa, për sa i përket gënjeshtres së dytë, e cila kalon në tekstin e ajetit të sures El-Enbija: **“Ata e pyetën: “Ti i bërë kështu zotat tanë, o Ibrahim?”**

**Ai tha: “Jo! Këtë e ka bërë ky i madhi i tyre. Pyesni ata, nëse flasin!”** (El-Enbija: 63)

Atëherë le të shohim shkurtimisht shpjegimin e këtij ajeti:

Së pari, thënia e tij që kalon në këtë ajet është një tallje me shirkun: “A unë i kam thyer? Apo këta idhuj që nuk lëvizin, nuk flasin dhe nuk mendojnë? Por, në realitet, nuk ka ndonjë dallim në të menduarit mes jush dhe atyre.”<sup>142</sup>

Komentimi i Shehristanit [rahimehullahu alejhi] në lidhje me këtë ajet është: “Ibrahimi kurrsesi nuk ka gënjer, por një shprehje e tillë është metodë mësimdhënëse për idhujtarët, duke ia hedhur këtë punë idhullit më të madh, i cili nuk mund ta vepronte një gjë të tillë.”<sup>143</sup>

Ka thënë Fahreddin er-Rrazî [rahimehullahu alejhi]: “Fjalja “Bel fealehû kebîruhum” (ky i madhi i tyre e ka bërë) është një fjali figurative. Mundet që Ibrahim i [alejhis-selam]

<sup>140</sup> Kur’ân’a Göre Hz. Musa Firavun ve Yahudiler, Dr. Necati KARA, f.65.

<sup>141</sup> Tefhimu’l-Kur’ân, Mevdudi, v.3, f.285.

<sup>142</sup> Fi-dhilâl’il-Kur’ân, Prof. Dr. Sejjid KUTUB, v.5, f.150.

<sup>143</sup> Kur’ân’a Göre Hz. Musa Firavun ve Yahudiler, Dr. Necati KARA, f.65-66.

me fjalën “i madhi i tyre” të ketë theksuar veten e tij, sepse ai ishte më i madhi i tyre.”<sup>144</sup>

Ndërsa Mevdudî ka komentuar në lidhje me fjalën “ky i madhi i tyre e ka bërë”, duke thënë: “Ky është një argument i qartë që ai nuk ka gënjyer. Sepse Ibrahim [alejhis-selam] me këtë u ka treguar atyre se idhujt nuk mund të bëjnë asnjë gjë për të ndihmuar, e as për të ruajtur dhe as për të shpëtuar, ashtu siç nuk mundën të ndihmonin, ruanin dhe shpëtonin vetet e tyre.

Nuk mund të thuhet se është gënjeshtër nëse bën ndonjë pyetje të palogjikshme me qëllimin për të treguar se mendimi dhe teoria e kundërshtarit (folësit) është e palogjikshme. Sepse folësi nuk ka për qëllim të gënjejë, por këtë gjë e di fare mirë edhe dëgjuesi.”<sup>145</sup>

Vallë, nëse do të ishte kjo një gënjeshtër, a nuk do të thoshin dëgjuesit: “O Ibrahim! Ti pretendon se je profet dhe thua gënjeshtër?! Edhe thua po thërras për në të vërtetën dhe, në të njëjtën, kohë gënjen? Kështu që ti nuk mund të jesh gjë tjetër vetëm se një gënjeshtar.” Kështu që nëse kjo do të ishte e vërtetë, atëherë sigurisht që ata nuk do ta humbnin një rast të tillë duke u tallur dhe e cilësuar atë si një gënjeshtar.<sup>146</sup> Por ata në një situatë të tillë nuk reagojnë në atë mënyrë. Vetëm se filluan duke menduar rreth përgjigjes: **“Atëherë ata i thirrën mendjes dhe i thanë njëri-tjetrit: “Me të vërtetë, ju vetë jeni keqbërësit.”** (El-Enbija: 64)

<sup>144</sup> İsmetu’l-Enbijâ, er-Razî, f.70 - *Fahreddin er-Razî ve Nübüvvet Anlayışı*, Mehmet KELEŞ, f.50.

<sup>145</sup> *Tefhimu’l-Kur’ân*, Mevdudi, v.3, f.285-286.

<sup>146</sup> *Kitab-ı Mukaddes ve Kur’ân-ı Kerim’de Hz. İbrahim*, Musa YILMAZ, f.45.

Ndërsa përsa i përket thënies së gënjeshtres së tretë të Ibrahimit [alejhis-selam], argumentet në lidhje me këtë i gjejmë në librat Buhari, Enbija, 8 / Muslim, Fedail, 154 dhe Ebu Davud, Talak, 16. Kjo ndodhi kalon, gjithashtu, edhe në Dhiatën e Vjetër të Biblës:

Le të shohim se si kalon ngjarja e Ibrahimit dhe Sarës në Dhiatën e Vjetër të Biblës:

*“Abrahami u zhvendos së këtejmi duke vajtur në Negev dhe banoi në Kadesh dhe në Shur mandej u vendos në Gerar. Tani Abrahami thoshte për Sarën, gruan e tij: “Është motra ime.” Kështu Abimeleku, mbreti i Gerarit, dërgoi njerëz për të marrë Sarën.*

*Por Perëndia iu shfaq Abimelekut në një ëndërr nate dhe i tha: “Ja, ti je duke vdekur, për shkak të gruas që ke marrë, sepse ajo është e martuar.”*

*Por Abimeleku nuk i ishte afruar asaj dhe tha: “Zot, a do ta shkatërroje një komb, edhe sikur ai të ishte i drejtë?”*

*Ai nuk më ka thënë: “Është motra ime!” Dhe ajo vetë ka thënë: “Është vëllai im!”? E bëra këtë gjë me ndershmërinë e zemrës sime dhe me duar të pafajshme.”*

*Dhe Perëndia i tha në ëndërr: “Po, unë e di që e ke bërë këtë gjë me ndershmërinë e zemrës sate, ndaj të ndalova të kryesh një mëkat kundër meje, ndaj nuk të lejova ta prekësh.*

*Tani ktheja gruan këtij njeriu, sepse ai është një profet; dhe do të lutet për ty dhe ti ke për të jetuar. Por, në rast se nuk ia kthen, dije që me siguri ke për të vdekur, ti dhe tërë njerëzit e tu.”*

*Kështu Abimeleku u zgjua herët në mëngjes, thirri gjithë shërbëtorët e tij dhe u tregoi këto gjëra. Dhe ata njerëz*

*i zuri një frikë e madhe. Pastaj Abimeleku thirri Abrahamin dhe i tha:*

*“Ç’na bëre? Dhe çfarë kam bërë unë kundër teje që më solle një mëkat kaq të madh si mua ashtu edhe mbretërisë sime?”*

*Ti më bëre gjëra që nuk duheshin bërë.”*

*Pastaj Abimeleku i tha Abrahamit: “Çfarë mendoje të bëje duke vepruar në këtë mënyrë?”*

*Abrahami u përgjigj: “E bëra sepse thoja me veten time: “Sigurisht, në këtë vend nuk kanë frikë nga Perëndia dhe do të më vrasin për shkak të gruas sime.”*

*Përveç kësaj ajo është në të vërtetë motra ime, bijë e babait tim, por jo bijë e nënës sime dhe pastaj u bë gruaja ime.*

*Dhe kur Perëndia më çoi të bredh larg shtëpisë së babait tim, unë i thashë: “Ky është favori që do të më bësh kudo që të shkojmë, do të thuash për mua: Është vëllai im.”*

*Atëherë Abimeleku mori dhentë, qetë, shërbyesit dhe shërbëtoret, dhe ia dha Abrahamit dhe i kthehu gruan e tij, Sarën.*

*Pastaj Abimeleku tha: “Ja, vendi im të qëndron përpara; qëndro aty ku të pëlqen.”*

*Dhe Sarës i tha: “Ja, unë i dhashë vëllait tënd një mijë copë argjendi; kjo do të shërbejë për të mbuluar fyerjen që të është bërë para të gjithë atyre që janë me ty; kështu je e përligjur para të gjithëve.”*

*Atëherë Abrahami iu lut Perëndisë dhe Perëndia shëroi Abimelekun, gruan e tij dhe shërbyeset e saj, dhe ato mundën të pjellin.*

*Sepse Zoti e kishte shterpëzuar plotësisht tërë shtëpinë*



*e Abimelekut, për shkak të Sarës, gruas së Abrahamit.*<sup>147</sup>

Të njëjtën gjë e shohim mes numrave 10 deri tek 19 të Kapitullit 12 në të cilin bëhet fjalë për fjalimin mes Ibrahimit [alejhis-selam] dhe mbretit Firaun të Egjiptit.

Mënyra e të treguarit në Bibël ka disa ndryshime me mënyrën që tregohet nëpër librat e haditheve. Mes tyre shihen dy dallime të mëdha.

Dallimi i parë: në hadithe Sara tregohet se është motra fetare (nga ana fetare) e Ibrahimit, ndërsa në Bibël tregohet se ajo ishte motra e tij e vërtetë (motër gjaku nga babai).

Dallimi i dytë: në Bibël mbreti është i pafajshëm nga mos dija dhe një person i ndersëm, ndërsa në Islam mbreti, pavarësisht se u njoftua, përsëri zgjati dorën drejt saj me qëllim dhe me vetëdije të plotë.

Ka thënë Ibn Haxher el-Askalanî [rahimehullahu alejhi]: “Sipas besimit të fesë së mbretit, bashkëjetesa me motër i jepte prioritet më parë vëllait të saj. Ibrahimit [alejhis-selam] duke përfutur prej një besimi të tillë, e mbrojti nderin e gruas së tij duke thënë: “Kjo është motra ime.”<sup>148</sup>

Ibn Kajjim el-Xhevziye [rahimehullahu alejhi] kësaj ndodhie i ka bërë një komentim të tillë: “Kjo ngjarje më shqetësonte gjithmonë. Dhe thosha: Përse Ibrahimit [alejhis-selam] përdori një fjalë me dy kuptime përballë një mbreti mizor? Çfarë pasojash mund të kishte nëse do të thoshte gruaja ime ose kushërira ime? Vallë, a nuk ishte më e lehtë të thoshte kjo është gruaja ime? Sepse në rast se do të thoshte kjo është kushërira ime, ishte një mundësi më e madhe për mbretin mizor që të thoshte më marto mua me këtë grua.

<sup>147</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 20: 1-18.

<sup>148</sup> *Fethu 'l- Bâri*, Ibni Hâxher, v.6, f.247.

Por, nëse do të thoshte kjo është gruaja ime, atëherë shprehet se mbreti do të heshte.

Kjo gjendje vazhdoi të më shqetësonte derisa mësova se ky mbret mizor ishte mexhus (adhurues zjarri). Sipas besimit mexhusi, kur u martonte një vajzë, burri i saj quhej edhe vëllai i saj dhe kështu ai kishte një prioritet ndaj të tjerëve për të thënë “kjo është motra ime”. Kështu që Ibrahim [alejhis-selam] duke ditur për këtë besim të mbretit mizor, e ka mbrojtur nderin e gruas së tij duke u përgjigjur në këtë mënyrë.”<sup>149</sup>

Por nëse do të thuhet se mexhusitë kanë ardhur pas profetit Ibrahim [alejhis-selam], atëherë një mendimi të tillë mund t’i japim përgjigjen e Muhamed Xherir et-Taberi [rahimehullahu alejhi], i cili ka thënë: “Kabili, biri i Ademit [alejhis-selam], ka qenë njeriu i parë që ka adhuruar zjarrin.”<sup>150</sup>

Ndërsa për sa i përket bashkëbisedimit mes Saras dhe mbretit mizor, Mevdudi [rahimehullahu alejhi] në lidhje me këtë ka thënë: “Kur Ibrahim [alejhis-selam] shkoi në Egjipt me gruan e tij, Sarën, sipas Biblës Ibrahim [alejhis-selam] ishte në moshën shtatëdhjetë e pesë vjeçare dhe gruaja e tij, Sara, në moshën gjashtëdhjetë e pesë vjeç. Dhe siç shihet nga mosha e shtyrë e saj, Sara nuk zotëronte një “bukuri dhe hijeshi”, një gjë e tillë nënkupton se nuk ishte e nevojshme ta shpëtonte Ibrahim [alejhis-selam] duke thënë se ajo ishte motra e tij.”<sup>151</sup>

<sup>149</sup> *Texhridi Sarih Terxhumesi* ve Şerhi, v.6, f.521.

<sup>150</sup> *Şeytanın Hileleri*, Ibnu'l-Xhevzi Ebu'l-Ferexh Abdurrahman bin Ali, f.89.

<sup>151</sup> *Tefhimu'l-Kur'ân*, Mevdudi, v.3, f. 286.

Ka thënë Kadi Îjadi në lidhje me këtë temë: “As nuk mund të paramendohet dhe imagjinohet që profetët të kenë gënjyer në lidhje me teblig (thirrje në Islam). Grada e profetësisë kurrsesi nuk e lejon gënjeshtren, qoftë ajo e vogël apo e madhe.”<sup>152</sup>

Është pyetur profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “A mund të ketë besimtari frikë?” Është përgjigjur duke thënë: “*Mundet!*”

Është pyetur se “A mund të jetë besimtari koprrac?” Është përgjigjur duke thënë: “*Mundet!*”

Është pyetur se “A mund të jetë besimtari gënjeshtar?” Është përgjigjur duke thënë: “*Jo, nuk mundet!*”<sup>153</sup>

Siç e shohim pak më sipër, Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] kurrsesi nuk ka lejuar që besimtari të jetë gënjeshtar. Kështu që është e pamundur të thuhet se profeti Ibrahim [alejhis-selam] që numërohet nga profetët Ulû'l-Azm (profetët e mëdhenj) ka gënjyer.

Këtë Fahrudin er-Rrazi e përmbledh bukur në një thënie të tij: “Thënia e gënjeshtreve nuk është punë e profetëve, por punë e atyre që i nxjerrin këto fjalë.”<sup>154</sup>

<sup>152</sup> *Sahih-i Muslim Şerhi*, Ahmed DAVUDOĞLU, v.10, f. 170.

<sup>153</sup> Muvatta, *Kelâm*, 7 (1803).

<sup>154</sup> Shihni: *Tabu Can Çekişiyor*, Din Bu, Turan DURSUN.



## **PJESA E TRETË**

### **MARTESA E IBRAHIMIT [alejhis-selam] ME HAXHEREN**



## KUSH ËSHTË HAXHERJA?

Emri Haxhere nuk përmendet në Kur'an, por vetëm në hadithe, mirëpo një emër të tillë e hasim edhe në Dhiatën e Vjetër.

Emri Haxher në hebraisht është Hagar,<sup>155</sup> në greqisht Agar dhe në sirianisht Axher.<sup>156</sup> Thuhet që origjina e emrit është Axher nga sirianishtja dhe më pas është bërë i njohur në arabisht duke marrë shkronjën “H” në fillim<sup>157</sup> ose Haxher është shqiptimi arabisht i emrit që në Dhiatën e Vjetër është Haxhar.<sup>158</sup>

Ndërsa tek librat e Buhariut kalon me emrin “Axher”.<sup>159</sup>

Kuptimi i emrit Haxher në arabisht është: ikje, largim, braktisje, shpërngulje, largim nga shirku dhe të qenurit i pashoq.<sup>160</sup>

Ndërsa në etiopianisht, e cila është edhe gjuha nënë e Haxheres, ka kuptimin “qytet, vend”.<sup>161</sup>

Haxherja ka lindur në vendin Umu'l-Arik ose Umu'l-Arap.<sup>162</sup> Umu'l-Arap është një vend në lindje të Egjiptit afër Farma dhe Ettine si dhe 3 km larg me Detin Mesdhe. Këtu

<sup>155</sup> *T.D.V. İslâm Ansiklopedisi*, v.14, f.431.

<sup>156</sup> *Kur'ân-ı Kerim'de Hz. İbrahim*, Ö. Ahmed Ömer, f.56.

<sup>157</sup> *Sireti Ibni Hisham*, v.1, f.40.

<sup>158</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla* 16:1.

<sup>159</sup> *Sahih-i Buhâri Tecrid-i Sarih Terc. ve Şerhi*, v.6, f.520.

<sup>160</sup> *El-Mevarid (Arapça-Türkçe Lügat)*, Mevlüt SARI “H” harfi; *T.D.V. İslâm Ansiklopedisi*, v.14, f.432.

<sup>161</sup> *Haxh*, Ali SHERIATI, f.46; *Hz. İbrahim'le Buluşmak*, Ali SHERIATI, f.149.

<sup>162</sup> *Tabakat*, Ibni Is'hak, 1/48; *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, 1/168.

ka pasur një kala në kohën e Faraonit. Sot këtij vendi i thuhet Tellu'l-Farma.<sup>163</sup>

Disa burime theksojnë se ajo ishte vajza e njërit prej sunduesve të Egjiptit,<sup>164</sup> ndërsa në disa burime të tjera thuhet se ajo ishte gruaja e njërit prej sunduesve dhe u mor robëreshë pasi i vranë burrin.<sup>165</sup>

Ka thënë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në një hadith: “*Silluni mirë dhe i bëni mirësi popullit të Egjiptit pasi t'i çlironi. Sepse ne kemi afrimetet, lidhje gjaku, farefisnore me ta.*”<sup>166</sup>

Amr bin Asi [radijallahu anhu] pasi e çliroi Egjiptin u tha egjiptianëve: “Neve na e premtoi Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] çlirimin e Egjiptit. Gjithashtu, na urdhëroi dhe na këshilloi që të sillemi mirë me ta, sepse ne kemi lidhje farefisnore me egjiptianët.”<sup>167</sup>

Egjiptianët pyetën se cila është ajo lidhje farefisnore që ka theksuar i Dërguari i Allahut të Madhërishëm? Amr bin Asi [radijallahu anhu] u përgjigj: “Nëna e Ismailit [alejhis-selam] (gjyshit tonë).”<sup>168</sup> Pas kësaj, ata thanë: “Të vërtetën thatë.” Më pas: “Nëna juaj ishte nga populli Menf dhe vajza e sunduesit tonë. Edhe sunduesi ishte nga populli Menf.

<sup>163</sup> *Ibnu 'l-Ethir*, 1/102; *Sireti Ibni Hisham*, 1/40; *T.D.V. İslâm Ansiklopedisi*, 14/432.

<sup>164</sup> *Târih-i Taberi*, 4/228; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, Ebu'l-Fidâ, 7/98; *Ibn Hadun-Tarih*, v.2, f.1, f.77; M.Asım Köksal, *Peygamberler Tarihi*, f.169; *T.D.V. İslâm Ansiklopedisi*, 14/432; *Sahih-i Buhâri Texhrid-i Sarih Terxhemesi*, 6/520.

<sup>165</sup> *Târih-i Taberi*, 1/245 *T.D.V. İslâm Ansiklopedisi*, 14/432; *Kur'ân-ı Kerim'de Hz. İbrahim*, Ö. Ahmed Ömer, f.56.

<sup>166</sup> *Muslim*, *Fedâilu's-Sahabe*, 226; *El-Kâmil Fi't-Târih*, 1/96; *Sireti Ibni Hisham*, 1/7; *Târih-i Taberi*, 1/127.

<sup>167</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, Ebu'l-Fidâ, v.7, f. 98.

<sup>168</sup> *Sireti Ibni Hisham*, 1/7; *Târih-i Taberi*, 1/127.



Populli Ajn-i Shems sulmoi popullin Menf, të cilët i mundën. Më pas i detyruan Menfët të emigrojnë (largohen) nga vendi i tyre.<sup>169</sup> Haxherja iku pas Ibrahimit [alejhis-selam] dhe kesh-tu ajo u martua me të dhe gruaja e Ibrahimit [alejhis-selam] është edhe nëna juaj.”<sup>170</sup>

Ndërsa në një transmetim të dobët thuhet se Haxherja ishte një robëreshë etiopiane.<sup>171</sup>

Por në një transmetim tjetër shohim se Haxherja ishte dhurata e mbretit të Egjiptit që iu dha Ibrahimit [alejhis-selam], e cila shkoi në Egjipt bashkë me nënën tonë, Sarën.<sup>172</sup>

Në lidhje me këtë si përfundim dhe shkurtimisht mund të themi se historia e saj në familjen e Ibrahimit [alejhis-selam] fillon duke qenë shërbëtorja e vajzës së Harranit, Sarës.

## MREKULLIA QË IU DHA FAMILJES SË IBRAHIMIT

Ibrahimi [alejhis-selam] dhe familja e tij kur u kthye nga Egjipti qëndroi një kohë në Tejmunde dhe më pas u vendosën me banim në vendin e quajtur Sebu.<sup>173</sup> Ky ishte një vend i pabanuar mes një pylli dushku, lisnajë. Ishte një vend i thatë pa ujë. Ibrahimi [alejhis-selam] aty hapi një pus. Me ndihmën dhe urdhrin e Allahut të Madhërishëm nga ai doli

<sup>169</sup> *Târih-i Taberi*, 1/228; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, Ebu'l-Fidâ, 1/98; Ibn Haldun, *Tarih*, v.2, f.1, f.77.

<sup>170</sup> *Târih-i Taberi*, 1/228; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/98.

<sup>171</sup> *Sistem İçinde Kadın*, Cihan AKTAŞ, f.204; *Ana Britanica*, v.10, f.39.

<sup>172</sup> Buhâri, *Enbijâ*, 8; Muslim, *Fedâil*, 154 (2371); Ebu Dâvud, *Talâk*, 16; Tirmidhi, *Tefsir*, *Enbijâ*, 3; *Ibnu'l-Ethir*, 1/95; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/215; *Târih-i Taberi*, 1/157.

<sup>173</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f. 159.

ujë i pijshëm. Pas kësaj Ibrahimimi [alejhisi-selam] dhe familja e tij vendosën të banojnë në atë vend.

Pas disa ditësh filluan të mbarojnë ushqimet dhe për fat të keq afër tyre nuk kishte banorë të tjerë. Në një gjendje të tillë edhe Ibrahimimi [alejhisi-selam] nuk dinte se çfarë të bënte.

Ibrahimimi [alejhisi-selam] mori një thes dhe vendosi të shkojë në një qytet që ishte larg tyre. Kur po shkonte drejt qytetit i erdhi për gjumë dhe tha me vete: “Sikur të shtrihem dhe të fle pak e më pas të vazhdoj rrugën për në qytet.” Dhe ashtu veproi duke e vënë thesin poshtë kokës për jastëk.

Pas njëfarë kohe u zgjua dhe pa se ishte bërë vonë. Kur e pa se kishte ardhur koha e akshamit vendosi të kthehet përsëri në shtëpi tek familja e tij.

U turpërua kur iu afrua shtëpisë së tij me duar bosh. E mbushi thesin me pak rërë dhe tha me vete: “Tani është natë e ku do të kuptojnë se çfarë ka në thes në këtë orë të vonë. Besoj se do të mendojnë se do të kem sjellë ndonjë gjë në thes. Dhe të nesërmen në mëngjes ngrihem më herët se to dhe shkoj e vij nga qyteti duke u sjellë ushqim.”

Ibrahimimi [alejhisi-selam] e mbushi thesin pak me rërë dhe pasi shkoi në shtëpi ra në gjumë me qëllim që të ngrihet herët të nesërmen për të shkuar në qytet.

Por Sara u zgjua përpara Ibrahimimit [alejhisi-selam] dhe i tha Haxheres: “Zgjohu, shiko njëherë se çfarë ka sjellë Ibrahimimi në thes.” Haxherja u zgjua dhe erdhi pranë thesit kur ishte ende errësirë. Futi dorën në thes dhe rëra që kishte futur Ibrahimimi [alejhisi-selam] më parë u bë miell. Në realitet ishte dhurata e Allahut të Madhërishëm, i Cili e shndërroi rërën në thes në miell.

Nënat tona, Sara dhe Haxherja, e morën menjëherë këtë miell dhe e gatuan bukë. Më pas Haxherja shkoi e zgjoi Ibrahimin [alejhis-selam] dhe i tha: “Hajde se kemi gatuar bukë. Hajde hani tani se është e ngrohtë.”

Ibrahimi [alejhis-selam] u zgjua dhe pa se vërtetë ato kishin gatuar bukë dhe po e prisnin atë me sofër përpara. Ibrahim [alejhis-selam] nuk e fshehu dot habinë e tij dhe pyeti:

“Ku e gjetët miellin?”

Ato thanë: “Mielli që solle ti në darkë.”

Menjëherë Ibrahim [alejhis-selam] e kuptoi se kjo ishte një dhuratë dhe urdhër i Allahut të Madhërishëm dhe më pas e falënderoi Allahun për këtë mrekulli, dhuratë.

Pasi u zbardh dita ata panë se kishte shumë kokrra gruri të pa bluara në thes. Më pas e ndanë grurin e pa bluar nga mielli dhe Ibrahim [alejhis-selam] e mori këtë grurë dhe e mbolli në arë për të siguruar ushqimin e tij, të familjes dhe për bagëtitë në të ardhmen.

E gjithë pasuria e tyre u begatua me mirësinë, begatinë e atij gruri, i cili në fillim nuk ishte gjë tjetër vetëm se rërë. Allahu i Madhërishëm i dhuroi shumë begati Ibrahimit [alejhis-selam] nga kjo dhuratë, begati dhe mrekulli e Tij.<sup>174</sup>

***“A mos i kanë zili njerëzit për çfarë u ka dhuruar Allahu nga të mirat e Veta? Ne u dhamë pasardhësve të Ibrahimit Librin e urtësinë, si dhe një pushtet të madh.”*** (En-Nisa: 54)

---

<sup>174</sup> *Târih-i Taberi*, 1/159; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/213; *Tibyan Tefsiri*, 1/183.

## MARTESA E IBRAHIMIT [alejhis-selam] ME HAXHEREN

Ibrahimi [alejhis-selam] ishte profet dhe po moshohej, por ai nuk kishte asnjë fëmijë, sigurisht që edhe ai dëshironte të kishte fëmijë si njerëzit e tjerë.

Ibrahimi [alejhis-selam], tashmë, e kishte kaluar moshën tetëdhjetëvjeçare dhe, pavarësisht se ishte i martuar me Sarën prej dyzet e tre vitesh, përsëri ajo nuk kishte lindur dot fëmijë. Edhe Sara dëshironte shumë të kishte fëmijë, por, tashmë, nuk kishte shumë shpresë rreth kësaj çështjeje.<sup>175</sup>

Kështu që Sara kishte një brengë në shpirtin e saj ngaqë nuk i kishte dhuruar fëmijë Ibrahimit [alejhis-selam]. Gjithashtu, kishte ardhur në një moshë në të cilën vetëm një mrekulli e Allahut të Madhërishëm do të bënte të mundur lindjen e një fëmije.

Sara mendonte vazhdimisht dhe shqetësohej kur mendonte se një profet si Ibrahimi [alejhis-selam] nuk do të linte pasardhës pas tij në këtë botë.

Pavarësisht kësaj, përsëri Ibrahimi [alejhis-selam] asnjëherë nuk mendonte që ta shqetësonte gruan e tij të dashur. Sepse gruaja e tij e dashur ishte ajo që i besoi dhe i qëndroi pranë ditën kur u hodh në zjarr si dhe në ditët më të vështira të jetës. Prandaj edhe Ibrahimi [alejhis-selam] e ka dashur gjithmonë me zemër dhe kishte një respekt tepër të veçantë për Sarën.

Ibrahimi [alejhis-selam] e donte shumë gruan e tij ngaqë ishte një grua fetare dhe tepër e bukur në çdo cilësi të

---

<sup>175</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/214; *Islâm Târihi*, Mahmud ŞAKÎR, 1/68.

saj. Nuk ishte parë grua aq e bukur sa ajo prej nënës tonë, Havasë, deri në atë ditë.<sup>176</sup>

Me gjithë këtë dashuri që kishte Ibrahimimi [alejhis-selam] ndaj gruas së tij të dashur, në një orë të natës në errë-sirën e saj ku nuk e shihte askush i ngrinte duart Rabbu'l-Alemin (Zotit të botëve), duke iu lutur: “O Zoti im! Unë nuk kam asnjë fëmijë. Çfarë të bëj/e dua unë pasardhësin tim?”<sup>177</sup>

**“O Zoti im, dhuromë një fëmijë prej të mirëve!”** (Es-Saffat: 100)

Ky ajet në të njëjtën kohë është argument që tregon se është e lejuar të kërkuarit e fëmijëve, pasardhësve. Pra, një lutje e tillë është sunet i të dërguarve dhe njerëzve të drejtë, të mirë.

Ka thënë Allahu i Madhërishëm në Kur’anin Famëlar-të: **“Vërtet, edhe para teje Ne kemi sjellë të dërguar, të cilëve u kemi dhënë gra dhe pasardhës. Asnjë i dërguar nuk ka sjellë me vete asnjë mrekulli, përveçse me lejen e Allahut. Çdo periudhë e kohës ka librin e vet** (ku është shënuar caku i saj).” (Er-Ra’d: 38)

**“Edhe ata që thonë: “O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!”** (El-Furkan: 74)

Ibrahimimi [alejhis-selam] iu lut Allahut të Madhërishëm me qëllim që t’i dhurojë trashëgimtarë, të cilët do ta vazhdo-nin detyrën e profetësisë, dijës dhe virtyteve të larta njerë-zore.

Ibrahimimi [alejhis-selam] iu lut Allahut të Madhërishëm që t’i dhurojë një trashëgimtar, i cili do të mbartte detyrën e

<sup>176</sup> *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, Ibni Kethir, v.1, f.218.

<sup>177</sup> *Tarih-i Yâkubî*, 1/25; *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, 1/168.

profetësisë, një prijës që do të orientonte njerëzit me flamurin e teuhidit (njësimit të Allahut të Madhërishëm). Kështu që do t'i shpëtonte njerëzit që kishin rënë në batakun e shirkut. Ibrahim [alejhis-selam] gjithmonë mendonte dhe mendohej për njerëzit e tjerë që edhe ata të kishin një jetë sa më të mirë, të pastër dhe të sinqertë në rrugën e vetme të Allahut të Madhërishëm.

***“Kur Allahu e provoi Ibrahimin me disa urdhërime, të cilat ai i plotësoi, Allahu i tha: “Unë do të të bëj ty imam (prijës) të njerëzve!”***

***“Po pasardhësit e mi?” - pyeti ai. Allahu tha:***

***“Premtimi Im nuk i përfshin të padrejtët.”*** (El-Bekare: 124)

Lutja e Ibrahimit [alejhis-selam] që i bëri Allahut të Madhërishëm në Dhiatën e Vjetër të Biblës tregohet në këtë mënyrë:

“Kjo është besëlidhja ime që ju do të respektoni midis meje dhe jush, si dhe pasardhësve të tu pas teje: çdo mashkull që ndodhet midis jush do të rrethprietet.”<sup>178</sup> Kur Abrami u bë nëntëdhjetë e nëntë vjeç, Zoti i doli përpara dhe i tha: “Unë jam Perëndia i Plotfuqishëm. Ec në praninë time dhe qëndro i ndershëm. Dhe unë do të caktoj besëlidhjen time midis meje dhe teje dhe do të të shumoj fort.”<sup>179</sup> “Pastaj e çoi jashtë dhe i tha: “Vështro me kujdes qiellin dhe numëro yjet, në rast se mund t'i numërosh...”, pastaj shtoi: “Kështu kanë për të qenë pasardhësit e tu.”<sup>180</sup>

<sup>178</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 17: 10.

<sup>179</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 17: 1-2.

<sup>180</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 15: 5.

“Dhe nuk do të quhesh më Abram, por emri yt do të jetë Abraham, sepse unë të bëj babanë e një shumice kom-besh. Do të të bëj shumë frytdhënës. Pastaj do të bëj prej teje kombe dhe prej teje kanë për të dalë mbretër. Dhe do të cak-toj besëlidhjen time midis meje dhe teje, si dhe me pasardhë-sit e tu, nga një brez në brezin tjetër; kjo do të jetë një besë-lidhje e përjetshme, me të cilën unë do të marr përsipër.”<sup>181</sup>

Me gjithë dëshirën e madhe që kishte Sara për t’i dhuruar fëmijë Ibrahimit [alejhis-selam] përsëri ajo nuk lindte dot.<sup>182</sup>

“Por Saraj ishte shterpë, nuk kishte fëmijë.”<sup>183</sup>

Sara tha: “O Ibrahim! Siç e shikon, tashmë, u moshuam. Tashmë ne nuk mund të bëjmë fëmijë. Sepse unë jam shterp-pë, nuk lind fëmijë.”<sup>184</sup> Nëse e shikon të arsyeshme martohu me Haxheren, sepse unë nuk munda të dhuroj fëmijë.<sup>185</sup> Ajo është grua e pashme, e bukur.<sup>186</sup> Mundet që Allahu i Madhë-rishëm të dhurojë një fëmijë me të dhe kështu do e heqim pastaj mallin e fëmijës.”<sup>187</sup>

Këtë propozim ia bëri vetë gruaja burrit të saj. Ajo ishte grua që i besoi Allahut të Madhërishëm dhe profetit të Tij. Sara qëndroi gjithmonë pranë Ibrahimit [alejhis-selam] në çdo vështirësi të tij dhe ajo e donte shumë atë. Për këtë arsye këtë propozim ajo ia bëri atij pa u ndrojtur nga vendimi i saj.

<sup>181</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla* 17: 5-7.

<sup>182</sup> *Târih-i Taberi*, 1/162; *Kısas-ı Enbiyâ*, Ahmet Cevdet Paşa, 1/20.

<sup>183</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla* 11: 30.

<sup>184</sup> *Kur’ân’da Peygamber Kıssaları*, Prof. Dr. Sejjid KUTUB, f.88.

<sup>185</sup> *Ibn-ul-Esir*, 1/96; *Târih-i Taberi*, 1/162.

<sup>186</sup> *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, v.1, f.168.

<sup>187</sup> *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f. 219.

Ibrahimi [alejhis-selam] pasi mendoi pak tha: “Jo, Sara! Ndiej shqetësim në vetvete për fundin e këtij vendimit. Nëse Haxherja lind fëmijë, ndoshta, atëherë do të bëhesh xheloze ndaj saj ngaqë nuk ke lindur fëmijë. Nëse do të dëshironte Allahu i Madhërishëm do të na dhuronte një fëmijë edhe ne.”

Sara tha: “Jo, jo, o Ibrahim! Unë do të gëzohem nëse do të dhurojë Allahu një fëmijë me Haxheren. Kështu që ne do të bëhemi akoma më të lumtur me fëmijën e saj.”<sup>188</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] pasi e pa vendosmërinë e Sarës tha: “Ti e di.”<sup>189</sup>

Sara e thirri menjëherë shërbëtoren e saj, Haxheren, dhe i tha: “Haxhere! Siç e ke parë, unë jam shterpë, nuk lind dot fëmijë. Ndoshta kjo shterpësi ndodhi si pasojë e udhëtimeve nga Babilonia në Harran, Sham, Egjipt dhe Palestinë. Me gjithë dëshirën e madhe që kisha, por përsëri nuk munda të lind asnjë fëmijë për këtë vend të bukur të Kenaanëve. U bëmë dhjetë vjet që po banojmë këtu dhe përsëri nuk ka ndonjë ndryshim. Dëshiroj që edhe ti të bëhesh gruaja e Ibrahimit [alejhis-selam] nga tani e tutje.”<sup>190</sup> Dhe kështu Sara ia dhuroi shërbëtoren e saj, Haxheren, Ibrahimit [alejhis-selam] për grua.”<sup>191</sup>

Gostitjet erdhën njëra pas tjetrës për Haxheren. Gostia e parë ishte largimi nga poshtërsia e shërbimit të mbretit mizor duke kaluar në shërbimin e një profeti të Zotit dhe

---

<sup>188</sup> *Kur’ân’da Peygamber Kıssaları*, Prof. Dr. Sejjid Kutub, f.88.

<sup>189</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.162.

<sup>190</sup> *Peygamberler Târihi*, M. Faruk GÜRTUNCA, f.197.

<sup>191</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1 f.162.



gostia e dytë ishte nderimi i saj duke u martuar me profetin e Zotit, Ibrahimin Halilullah (Miku i Allahut).

Kjo ngjarje në Dhiatën e Vjetër të Biblës tek Zanafilla tregohet në këtë mënyrë: “Por Saraj, gruaja e Abramit, nuk i kishte dhënë asnjë fëmijë. Ajo kishte një shërbyese egjiptase që quhej Agar. Kështu Saraj i tha Abramit: “Ja, Zoti më ka ndaluar të kem fëmijë; oh, futu te shërbyesja ime, ndofta mund të kem fëmijë prej saj.” Dhe Abrami dëgjoi zërin e Sarajt. Kështu, pra, Saraj, gruaja e Abramit, mbasi ky i fundit kishte banuar dhjetë vjet në vendin e Kanaanëve, mori shërbyesen e saj Agarin, egjiptasen, dhe ia dha për grua burrit të saj Abramit. Dhe ai u fut tek Agari, që mbeti me barrë. Por kur u bind se kishte mbetur me barrë, ajo e pa me përbuzje zonjën e saj.”<sup>192</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] u martua me Haxheren dhe më pas ai hyri tek dhoma e saj. Haxherja ngeli shtatzënë me Ibrahimin [alejhis-selam].<sup>193</sup> Ibrahimi [alejhis-selam] iu lut Allahut të Madhërishëm për t’i dhënë një fëmijë, një pasardhës prej të mirëve dhe Allahu i Madhërishëm iu përgjigj lutjes së tij:

***“Dhe Ne i dhamë lajmin e gëzuar për një djalë të mbarë!”*** (Es-Saffat: 102)

Ndërsa në Bibël është shprehur në mënyrë tjetër: “ai do të jetë ndërmjet njerëzve si një gomar i egër; dora e tij do të jetë kundër të gjithëve dhe dora e të gjithëve kundër tij; dhe do të banojë në prani të të gjithë vëllezërve të tij.”<sup>194</sup>

<sup>192</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla 16:1-4.*

<sup>193</sup> *El-Bidâje ve’n-Nihâje, Ibn Kethir, v.1, f. 219.*

<sup>194</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla 16: 12; Ibni Haldun, Târih, v.2, kf.1, f.36.*

“Dhe Haxherja lindi një djalë. Ibrahim [alejhis-selam] ia vuri emrin Ismail (Allahu është Dëgjues).<sup>195</sup> I vuri një emër të tillë, sepse Allahu i Madhërishëm e dëgjoi, iu përgjigj lutjes së tij për t’i dhënë një fëmijë.<sup>196</sup>

Emri Ismail është emër sirian, i cili ka kuptimin “I përrulur, i bindur ndaj Allahut”.<sup>197</sup>

Lindjen e Ismailit [alejhis-selam] në Bibël e shohim në këtë mënyrë: “Kështu Agari i lindi një djalë Abramit. Dhe Abrami i vuri djalit që Agari kishte lindur emrin Ismael. Abrami ishte tetëdhjetë e gjashtë vjeç, kur Agari lindi Ismailin për Abramin.”<sup>198</sup>

Ndërsa Ibn Kethiri [rahimehullahu alejhi] ka thënë: “Ibrahimi [alejhis-selam] ishte në moshën nëntëdhjetë e nëntë vjeç.”<sup>199</sup>

Të dyja gratë shkonin shumë mirë me njëra-tjetrën. Haxherja, pavarësisht se, tashmë, ishte gruaja e Ibrahimit [alejhis-selam], përsëri vazhdonte t’i shërbente Ibrahimit dhe Sarës si më parë. Kishte një personalitet aq të lartë si të ishte edukuar vetëm e vetëm për burrin e saj të dashur, profetin Ibrahim [alejhis-selam].

Mirëkuptimi, bashkëpunimi dhe respekti mes dy grave vazhdoi me muaj të tërë. Sigurisht që edhe Ibrahim [alejhis-selam] i donte dhe mundohej që t’i mbante të dyja në të njëjtën pozitë me qëllim që të mos nxiteshin ndjenjat e xhelozisë. Sepse me lindjen e fëmijës Sara, tashmë, mund të

<sup>195</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.162.

<sup>196</sup> *Ibrahim Ebu'l-Enbijâ*, Mahmud AKAD, f.31, 157 – *Kur’ân-ı Kerim’de Hz. İbrahim*, Ö. Ahmed Ömer, f.61.

<sup>197</sup> *T.D.V. İslâm Ansiklopedisi*, v.23, f.76.

<sup>198</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla* 16: 15-16.

<sup>199</sup> *Kur’ân Yolu*, v.3, f.291.

mendonte: “Mua, tashmë, më do më pak përballë Haxheres që i dha një fëmijë etj...”

Sigurisht që një profet i dashur i Allahut të Madhërishëm do të sillej në mënyrë të tillë dhe me drejtësi mes tyre.

## MOSMARRËVESHJET MES SARËS DHE HAXHERES

Ibrahimi [alejhis-selam] u gëzua shumë pasi Haxherja lindi Ismailin [alejhis-selam]. Pa dyshim që ky fëmijë ishte dhuntia e Allahut të Madhërishëm. Ismaili nga dita në ditë po rritej. Padyshim që ishte e paçmueshme lumturia e Haxheres. Por, në të njëjtën kohë, shihte se po shfaqeshin ndjenjat e xhelozisë tek Sara. Gjithashtu, ajo nuk i harronte sakrificat e Sarës, sidomos dëshira e saj që e martoi me profetin Ibrahim [alejhis-selam]. Për këtë arsye, Haxherja ishte e vendosur në dashuri dhe respektin që ndiente ndaj Sarës.

Ndërsa Sara, tashmë, ishte e ngushtuar në mendimet e saj në pranimin e gjithë këtyre ndodhive. E sidomos kur gruaja zeshkane, së cilës i dha me dëshirë burrin e saj të dashur, lindi.

Nga njëra anë, mendonte Haxheren, e cila më parë ishte robëreshë e mbretit mizor e që më pas iu dhurua asaj, dhe, nga ana tjetër, mendonte të qenurit e saj shterpë dhe dashuria për t'i dhënë një fëmijë burrit të saj e bëri që t'i ofronte atij shërbyesën, e cila me lindjen e fëmijës u bë nëna e nderit të trashëgimisë së familjes së Ibrahimit [alejhis-selam]. Këto mendime e shtynin Sarën që ta ndiejë veten keq dhe të mënjanuar. Sepse ajo nuk i dha asnjë fëmijë Ibrahimit

[alejhis-selam] gjatë gjithë atyre viteve. Ndërsa Haxherja ndiente dhimbje shpirtërore ngaqë Sara ishte e mënjanuar në skamjen e një fëmije kur Haxherja, tashmë, ishte nënë që do të mundësonte vazhdimin e trashëgimisë së Ibrahimit [alejhis-selam].

Ndjenjat e tilla nuk ishin aspak tregues të mira për Sarën. Më parë ajo ishte nderuar me të qenurit besimtarja e parë e Ibrahimit, me qëndresën pranë tij në ditët më të zorshme kur filloi thirrjen e tij në njësimin e Zotit, ajo bashkë me të kishin ngrënë në të njëjtën sofër. Edukatën dhe etjen e saj e kishte hequr duke pirë në lumin e profetësisë së Ibrahimit [alejhis-selam].

Siç e thamë edhe më parë, pavarësisht dëshirës së madhe të Sarës për t'u bërë nënë përsëri ajo ishte një grua shterpë. Dhe kur Haxherja i dha një pasardhës të bukur Ibrahimit [alejhis-selam], zgjoi ndjenjat e xhelozisë së Sarës.<sup>200</sup>

## XHELOZIA DHE GRUAJA

Xhelozia është një sëmundje psikologjike që shfaqet në veçanti tek zemrat e grave. Nëse përhapet dhe lëshon rrënjë në një trup, atëherë fillon t'ia verbojë syrin përballë çdo të mire dhe mirësie si dhe fillon shkatërrimin e ndjenjave njerëzore.<sup>201</sup>

Ka thënë I Dërguari i Allahut të Madhërishëm, Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], në lidhje me xhelozinë: *“Allahu e pëlqen një lloj xhelozie dhe urren llojin tjetër.*

<sup>200</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f. 162.

<sup>201</sup> *İman ve İnkâr Aynasında İki Kadın*, Muhamed Ali KUTUB, f.57.

*Xhelozia që pëlqen Allahu është ajo në të cilën bëhet fjalë për dyshime. Ndërsa xhelozia e urryer nga ana e Allahut të Madhërishtëm është ajo xhelozia që nuk vjen si shkak i dyshimeve ose që është pa shkaqe.*<sup>202</sup>

Ndjenjat e xhelozisë Aisheja [radijallahu anha] i tregon në këtë mënyrë: “Më erdhi shumë keq kur u martua profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] me Umu Selemen [radijallahu anha]. Sepse më patën treguar se ajo është shumë e bukur. Për këtë arsye isha tepër kurioze. Më në fund e pashë, por ç’të shihja! Ajo ishte edhe më e bukur se sa më kishin treguar. Ia tregova Hafsas [radijallahu anha] këto mendime.

Hafsa [radijallahu anha] tha: “Jo, vallahi! Këto janë shenja të xhelozisë tënde. Sepse Umu Seleme [radijallahu anha] nuk është aq e bukur sa ta kanë treguar ty. Më pas edhe ajo u bë kurioze dhe e pa (Umu Selemen [radijallahu anha]). Më pas u kthye dhe më tha:

- Edhe unë e pashë. Ajo është me bukuri normale dhe nuk është aq e bukur sa mendon ti dhe as sa të kanë thënë ty.”

Më pas e pashë edhe një herë Umu Selemen [radijallahu anha] dhe këtë herë pashë se ajo ishte e bukur sa më tha Hafsa [radijallahu anha]. Tashmë, unë kisha shpëtuar nga mendimet (xhelozia) dhe isha bërë dikush tjetër.”<sup>203</sup>

Xhelozia është një nga ndjenjat më natyrore dhe universale të njeriut. Xhelozia gjendet tek të gjithë njerëzit që duan dikë. Xhelozia mes burrit dhe gruas mund të quhet gjembi i trëndafilut kur nuk tejkalohen kufijtë.

<sup>202</sup> Ibn Mâxhe, *Nikah*, 56 (1996).

<sup>203</sup> *Tabakat*, Ibni Sa’d, 8/94; *Hayatu’s-Sahabe*, Muhamed Yusuf KANDEHLEV’I, 3/193.

Tregon Aisheja [radijallahu anha]: “Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] një natë doli dhe u largua. E xhelozova atë. Kur u kthye dhe pa ndryshimin tim, tha:

- “*Aishe, çfarë ke, a mos u xhelozove?*”

- “Si të mos xhelozojë dikush si unë përballë dikujt si ju?”

- “*Vallahi, ty të paska ardhur shejtani yt.*” – më tha.

- “O i Dërguari i Allahut, a kam unë shejtan?” - e pyeta.

- “*Po!*” – m’u përgjigj.

- “O i Dërguari i Allahut, edhe ju keni shejtan?” – e pyeta sërish.

- “*Po, kam, - ma ktheu, - por më ndihmoi Allahu dhe jam i shpëtuar nga sherri i tij.*”<sup>204</sup>

Nëse xhelozia fillon të kalojë në afshe, atëherë ajo e humbet të qenurit ndjenjë dashurie dhe dashurinë e saj.<sup>205</sup>

Islami e ka lënë të lirë gruan në ndjenjat shpirtërore ndaj burrit të saj. Por edhe burrit i ka njohur të drejtë martesore deri në katër gra. Megjithëqë i ka njohur një të drejtë burrit përsëri duke marrë parasysh të qenurit i drejtë për çdo gjë si dhe nga ana ekonomike etj. Pra, pavarësisht se Islami i lejon burrit të martohet me katër gra, përsëri këshillon që burri të martohet me një grua (do të jetë më e lehtë për të nga çdo aspekt).

Por asnjëherë nuk duhet harruar se “çdo grua muslimane duhet të besojë dhe pranojë që Islami i ka njohur të drejtën martesore burrit deri në katër gra. Ndoshta, gruaja mund të bëjë xhelozë dhe nuk dëshiron që burri i saj të martohet me grua të dytë etj., por këtë dëshirë dhe kundërshtim

<sup>204</sup> Muslim, *Munafikun*, 70 (2815); Nesâi, *Ishâretu 'n-Nisâ*, 4(7, 72).

<sup>205</sup> *Çocuk ve Ruh Sağlığı*, Prof. Dr. Atalay YÖRÜKOĞLU, f.152.

të saj duhet ta shpjegojë me një gjuhë të mirë dhe të pranueshme. Kurrsesi nuk duhet të harrojë që Allahu i Madhërishëm ia ka dhënë një të drejtë të tillë burrit dhe mohimi i kësaj të drejte të çon deri në mosbesim, deri në kufr.”<sup>206</sup>

Gruaja nganjëherë me sjelljet e saj i ndalon burrit edhe ato gjëra që Allahu i Madhërishëm ia ka lejuar. Njëra nga këto sjellje është xhelozia dhe kundërshtimi që i mohon të drejtën e martesës me grua të dytë. Disa gra martesën me grua të dytë e shikojnë në një këndvështrim sikur burri ka bërë zina apo ndonjë mëkat tjetër të madh. Të kundërshtosh lejen e Allahut të Madhërishëm do të thotë të kundërshtosh Atë. Por kemi edhe nga ato gra që e konceptojnë si dhunë martesën e dytë pa marrë parasysh lejen e Allahut të Madhërishëm.

Xhelozia paraqet gjendjen më njerëzore. Xhelozia ndodhet tek çdo burrë dhe grua. Dhe gjithmonë çdo gjë, çdo vendim, veprim apo ndonjë gjë tjetër rregullohet vetëm me mirëkuptim, dashuri, respekt... etj.

## **PLANI I ALLAHUT NË KRIJIMIN E FAMILJES SË IBRAHIMIT**

Sara nuk rezistoi më përballë dashurisë dhe vëmendjes që i kushtonte Ibrahimit [alejhis-selam] birit të tij, Ismailit [alejhis-selam], dhe Haxheres. Për këtë arsye vendosi të ndahet nga Haxherja.<sup>207</sup>

---

<sup>206</sup> *Islâm'a Göre Cinsel Hayat*, Ali Rıza DEMİRCAN, v.1, f.337.

<sup>207</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1 f.162.

Nxjerrja e Haxheres nga shtëpia në Dhiatën e Vjetër kapitulli Zanafilla të Biblës tregohet në këtë mënyrë: “Por Engjëlli i Zotit e gjeti pranë një burimi uji në shkretëtirë, pranë burimit në rrugën e Shurit, dhe i tha: “Agar, shërbyesja e Sarajt, nga vjen dhe ku po shkon?” Ajo iu përgjigj: “Po iki nga prania e zonjës sime Saraj.”

Atëherë Engjëlli i Zotit i tha: “Kthehu tek zonja jote dhe nënshtrouju autoritetit të saj.” Pastaj Engjëlli i Zotit shtoi: “Unë do t’i shumëztoj fort pasardhësit e tu aq sa të mos mund të llogariten për shkak të numrit të tyre të madh.”<sup>208</sup>

Shohim se gruas i është dhënë një vlerë e madhe jo vetëm në Kur’an, por edhe në Bibël. I shohim që kanë folur, marrë përgëzime dhe urdhra nga meleku, profetët burra, të njëjtën gjë e shikojmë edhe tek gratë që kanë folur, marrë përgëzime dhe urdhra nga meleku. Pra, sikur hasim me burra të zgjedhur, po ashtu, hasim edhe me gra të zgjedhura me cilësi të larta.<sup>209</sup>

Haxherja u kthye përsëri në shtëpi sipas urdhrimit të Zotit. Sara e pranoi Haxheren në shtëpi kur e pa se ajo u kthye përsëri.<sup>210</sup>

Por këtë herë Sara tha: “O Haxher! Ti po luan me ndjenjat e mia, por, vallahi, unë nuk e pranoj këtë dhe ose do të vras ose do të lë sakate.”

Sara më pas u pendua që u betua në këtë mënyrë jo të duhur dhe tha me vete: “Gabova, u betova në gabim. Nëse e vras do të jem gjakatare dhe mëkatare përpara Allahut të Madhërishëm. Por nëse e dëmtoj duke i prerë ndonjë gjë,

---

<sup>208</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 16:7-10.

<sup>209</sup> *Celâl ve Cemâl Aynasında Kadın*, Cevadi AMULİ, f.135.

<sup>210</sup> *Ibnu ’l-Ethir*, 1/97; *Târih-i Taberi*, 1/130.



atëherë edhe kjo është një dhunë ndaj Haxheres, sepse unë vetë e dëshirova këtë gjë dhe ajo është e pafajshme në këtë mes. Gjithashtu, u betova dhe nëse nuk i bëj ndonjë gjë, atëherë çfarë do bëj me betimin tim?!” Kështu që Sara u shqetësua tepër dhe nuk dinte se çfarë të bënte.<sup>211</sup>

Më pas u konsultua me Ibrahimin [alejhis-selam]. Ibrahimimi [alejhis-selam] tha: “O Sara, a dëshiron ta sjellësh në vend betimin tënd?”

Ajo tha: “Po, por si mundem?”

Ibrahimimi [alejhis-selam] tha: “Shpoi veshët dhe vëri diçka aty.”<sup>212</sup>

Dhe Sara ashtu veproi. I shpoi veshët dhe i vuri vathë. Por këtë herë Haxherja u bë akoma më e bukur.<sup>213</sup>

Kur e pa këtë gjë Sara tha: “Unë nuk bëra ndonjë gjë që ia shtoi bukurinë asaj!”<sup>214</sup>

<sup>211</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f. 163.

<sup>212</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/221; Thalebi, f.81; *Ibnu'l-Ethir*, 1/103.

<sup>213</sup> *M.E.B. Islâm Ansiklopedisi*, v.5, f.1110.

<sup>214</sup> *Ahbaru'n-Nisa*, Ibnu'l-Xhevzi, f.84.



**PJESA E KATËRT**  
**EMIGRIMI I HAXHERES**



## NDARJA QË ERDHI PAS URDHRIT HYJNOR

Sarën e kapën ankthet e mërziisë dhe tha me vete: “Unë po prisja që Allahu të më japë një fëmijë me Ibrahimin [alejhis-selam], ndërsa Ai nuk ma dha mua, por shërbëtores time.”<sup>215</sup>

Vallë, Ibrahim [alejhis-selam] nuk mund të qëndronte pa e ledhatuar, pa luajtur me Ismailin vetëm e vetëm për hatër të Sarës? Tashmë, Sara nuk ia toleronte vetes së vet vlerën e lartë që posedonte Ismaili bashkë me nënën e tij tek Ibrahim [alejhis-selam]. Gjithashtu, edhe praninë e tyre në shtëpinë e saj. Kështu që Sara, tashmë, kishte hyrë në një kaos të madh stresi përballë kësaj gjendjeje. Nuk ishte në gjendje të mendonte normalisht në këto rrethana.

Së fundi kërkoi me këmbëngulje nga burri i saj largimin në një vend të largët të Ismailit dhe nënës së tij, Haxheres.<sup>216</sup>

Sara tha: “Sigurisht që duhet ta largosh këtë shërbëtores me fëmijën e saj nga unë, sepse unë prej tani e më pas nuk mundem ta përballoj këtë vuajtje, dhimbje. Më parë e kam lënduar dhe kam frikë se do e lëndoj përsëri ose do të bëj ndonjë gjë të tillë që Allahu i Madhërishëm do t’ia bëjë obligim edhe brezave të ardhshëm. Për këtë arsye, largoje atë nga unë që të mos shohë ndonjë lëndim prej meje.”<sup>217</sup> Kështu që një orë e më parë largoje në një vend të largët prej meje.”<sup>218</sup>

<sup>215</sup> *Tefsir-i Kebir*, Fahrudin er-Râzi, v.14, f.27.

<sup>216</sup> *El-Bidâje ve’n-Nihâje* 1/220; *Târih-i Taberi*, 1/164; *Mukaddime*, 2/475.

<sup>217</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f. 164.

<sup>218</sup> *Târih-i Taberi*, 1/164; *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/220; *Ibnu’l-Ethir*, 1/97.

Sigurisht që Ibrahimimi [alejhis-selam] nuk do t'i thoshte Sarës menjëherë “në rregull, si të duash ti, unë i largoj menjëherë ata...” Por Ibrahimimi në një çështje kaq të rëndësishme ishte i detyruar të priste udhëzimin dhe urdhrin e Allahut të Madhërishëm.

Pavarësisht viteve që kaluan përsëri nuk mbizotëroi dot toleranca dhe vëllazëria mes grave në shtëpinë e Ibrahimimit [alejhis-selam]. Tashmë, edhe ndjenjat e mira që ekzistonin më parë kishin filluar të humbisnin dhe në vendin e tyre kishte filluar urrejtja dhe armiqësia.

Ibrahim [alejhis-selam] në lidhje me këtë çështje iu drejtua Allahut të Madhërishëm për zgjidhje dhe Allahu i Madhërishëm i tha: “O Ibrahim! Nxirre Ismailin dhe nënën e tij nga shtëpia, siç thotë Sara.”<sup>219</sup>

Ibrahimimi [alejhis-selam] tha: “O Krijuesi im! Ku t'i çoj ata?”

Allahu i Madhërishëm tha: “Ata çoi në Meke, në vendin që kam krijuar së pari në tokë, në vendin e sigurt.”<sup>220</sup>

Ka thënë Allahu i Madhërishëm në Kur'an: ***“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra...”*** (En-Nisa: 1)

Kjo ngjarje në Zanafillën e Dhiatën e Re të Biblës tregohet në këtë mënyrë: “Por Perëndia i tha Abrahamit: “Mos u hidhëro për shkak të djalit dhe të shërbyeses sate; dëgjo ato që të thotë Sara, sepse nga Isaku do të dalin pasardhës që do të mbajnë emrin tënd. Edhe nga djali i kësaj shërbyeses unë do të bëj një komb, sepse është një pasardhës yti.” Abrahami

<sup>219</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.164.

<sup>220</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.164.

u ngrit herët në mëngjes, mori bukë dhe një calik ujë dhe ia dha Agarit. Vuri gjithçka mbi shpatullat e saj dhe e nisi bashkë me fëmijën. Kështu ajo u nis dhe filloi të bredhë nëpër shkretëtirën e Beer-Shebas.”<sup>221</sup>

Jahuditë e vjetër Beer-Sheba i thoshin rajonit nga Palestina e deri në Hixhaz dhe, kur marrim parasysh një gjë të tillë, e vërejmë që kjo njohuri përputhet edhe me njohuritë e vërteta që janë në Kur’anin Famëlartë. Ndërsa sot shkretëtira Beer-Sheba ndodhet në pjesën jugore të Palestinës.<sup>222</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] ishte heroi i sprovave që e goditën gjatë gjithë jetës! Një nga sprovat ishte të qenurit pa fëmijë, më pas iu dhurua Ismaili. Por atij do t’i duhej të kalonte edhe sprovën tjetër, braktisjen e fëmijës bashkë me gruan e tij në një shkretëtirë të pabanuar me urdhër të Allahut të Madhërishëm.

Pavarësisht të gjitha këtyre sprovave të mëdha, ai përsëri nuk u ankua duke thënë: “Përse të gjitha këto, o Zot! Përse më ndan nga fëmija im, të cilin ma dhurove pas shumë vitesh?” Nuk u ankua, sepse ai i ishte mbështetur Allahut plotësisht dhe ishte vërtet heroi i sprovave të mëdha që në moshë të vogël.

Haxherja ishte tepër e pikëlluar në shpirt përballë të gjitha këtyre ndodhive, por problemi nuk qëndronte tek ajo. Nuk kishte bërë gjë tjetër vetëm se i kishte shërbyer Ibrahimit [alejhis-selam] dhe Sarës.

Më parë Haxherja as që e kishte menduar të martohej me Ibrahimin [alejhis-selam] dhe as të ishte konkurrenente përballë Sarës. Ajo mendonte vetëm adhurimin e Allahut të

<sup>221</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 21: 12-14.

<sup>222</sup> *Kur’ân Mesajî*, Muhamed ESED, f.35

Madhërishëm dhe shërbimin në familjen e Ibrahimit [alejhis-selam].

Nuk mund të ishte fajtore kur Sara ia propozoi vetë martesën me Ibrahimin [alejhis-selam] dhe pse Allahu i dhuroi një fëmijë me Ibrahimin [alejhis-selam].

## EMIGRIMI I HAXHERES

Pavarësisht se kishte shumë pyetje dhe gjëra të paqarta në kokë, përsëri Haxherja e mori fëmijën e saj të vogël në krah dhe filloi me Ibrahimin [alejhis-selam] udhën e shpërnguljes, emigrimit nga shtëpia pa kundërshtuar dhe pa diskutuar gjënë më të vogël me Sarën pasi dëgjoi se ky është një urdhër nga Zoti i Madhërishëm.<sup>223</sup>

Transmetohet nga Ibn Abbasi [radijallahu anhu]: “Veshja e grave me fund të gjatë është një adet i veshjes së nënës së Ismailit (Haxheres). Haxherja ka veshur fund të gjatë për t’u fshehur nga Sara (xheloze).”<sup>224</sup>

Haxherja u bë simbol nga gjendja në barbarizëm në civilizim, nga mosbesimi në besimin islam, nga skamja në pasuri. Shohim që edhe fjala hixhret (mërgim) origjinën e saj e ka prej emrit Haxher. Sepse veprimi i Haxheres është thelbi i hixhretit, mërgimit. Nuk duhet harruar se Haxherja, së pari, përmendet dhe dallohet nga gratë e tjera për hixhretin/ mërgimin e saj.

Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në një hadith hixhretin e Haxheres e ka theksuar si hixhret

---

<sup>223</sup> *Peygamberler Târihi*, Ahmed BEHCET, f.100.

<sup>224</sup> Buhâri, *Ehâdîthu'l-Enbijâ*, 9 (1414).



shembull, duke thënë: “*Emigrimi shembull është emigrimi i Haxheres.*”<sup>225</sup>

Haxherja, e cila më parë ishte një shërbëtore, e vetmuar dhe e varfër, u ndriçua me dritën hyjnore duke u bërë një pishtare në rrugën e Allahut të Madhërishëm në të cilën do të përmendet deri në Ditën e Fundit të kësaj bote.

Haxherja bashkë me fëmijën e saj, Ismailin [alejhis-selam], dolën nga shtëpia me Ibrahimin [alejhis-selam] për emigrim.<sup>226</sup>

Në realitet, ky ishte një urdhër nga Allahu i Madhërishëm. Nga njëra anë ishte një fillim drejt Qabes, që është vendi i vetëm në të cilin do të drejtohet e gjithë njerëzia (pas ardhjes së profetit Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] drejt saj duke përmendur emrin e Allahut).

Në çdo gjë që po realizohej nuk ishte dëshira e Ibrahimit [alejhis-selam], por dëshira dhe urdhri i Allahut të Madhërishëm. Pasi kaluan një pjesë të udhëtimit, Xhebraili [alejhis-selam] i erdhi Ibrahimit [alejhis-selam] dhe i tha: “O Ibrahim! Ku po shkon dhe ku po i çon të tjerët që ke pranë?”

Ibrahimi [alejhis-selam] tha: “E mora Haxheren dhe birin e saj e po shkoj në vendin ku Allahu i Madhërishëm më ka urdhëruar, por nuk e di se si do ta gjej?”

Më pas Xhebraili iu bë Ibrahimit [alejhis-selam] dhe familjes së tij udhërrëfyes për në Qabe.<sup>227</sup>

<sup>225</sup> *Haxh*, Ali SHERIATI, f.46; *Hz. Ibrahim 'le Buluşmak*, Ali SHERIATI, f.156.

<sup>226</sup> Buhâri, *Ehâdîthu 'l-Enbiâ*, 9 (1414); *Kutubi Sitte*, 14/4992; *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, 1/220; *Târih-i Taberi*, 1/164; *M.E.B. İslâm Ansiklopedisi*, 5/1110.

<sup>227</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.165.

Ibrahimi [alejhis-selam] ishte si një udhëtarë nga një vend në vendin tjetër dhe nga një sprovë në një sprovën tjetër... Por si udhëtarë në të cilin është bashkëngjitur dhimbja me bukurinë e mëshirës dhe dhimbja me mbështetjen e plotë në Krijuesin e gjithësisë.

Fytyra e Haxheres shkëlqente porsi një diell nga dashamirësia dhe bindja e plotë, ndërsa zemra e saj ishte e mbushur me besim dhe dashuri.

Ismaili, i cili ishte biri i babait Halilullah, Ibrahimit, dhe nënës ndriçuese Haxher, po shikonte rrugën në krah të nënës së tij.

Sa më shumë i afroreshin Qabes, aq më shumë i shtohet Ibrahimit malli dhe pikëllimi ndaj Ismailit dhe Haxheres. Sepse do e braktisë birin e tij, të cilin Allahu i Madhërishëm ia dhuroi pas shumë vitesh dhe nënën e tij të dashur, Haxheren. Allahu i Madhërishëm në shpallje e urdhëroi Ibrahimin [alejhis-selam] që ta lërë Haxheren me Ismailin [alejhis-selam] në vendin e bekuar në Qabe.<sup>228</sup>

O Ibrahim! Ti e di shumë mirë që nuk frikësohet nga asnjë gjë ai besimtar i cili e do dhe i mbështetet plotësisht Allahut të Madhërishëm. E dhuron gjënë më të shtrenjtë të tij në rrugë të Allahut pa pyetur dhe pa menduar aspak. Sepse nuk gjenden pyetje tek ata që duan me shpirt ngase në zemrat e tyre janë ngritur flamujt e bindjes së plotë.

Allahu i Madhërishëm i kishte treguar Ibrahimit [alejhis-selam] se ai do të përgatisë ndërtimin e Qabes me birin e

---

<sup>228</sup> *Ibnu'l-Ethir*, 1/103; *Târih-i Taberi*, 1/164.

tij, Ismailin, në vendin Bejti Atik/Kabe (Meke) si dhe, gjithashtu, do të nxirrte ujin (Zemzem) nga uji i të cilit do të pinë muslimanët që do të vijnë më pas deri në Ditën e Fundit.<sup>229</sup>

## MEKEJA, VENDI I URDHËRUAR

Çdo qytetërim lind nga një emigrim, si dhe nuk ka qytetërim pa pasur qytet/vendbanim.

Ibrahimi [alejhis-selam] kur shikonte ndonjë luginë me ujë gjatë rrugës nga Shami për në Meke e pyeste Xhebrailin [alejhis-selam]: “A këtu është urdhëruar?”

Xhebraili thoshte: “Jo!”<sup>230</sup>

Tashmë, erdhën në Meke, në vendin ku nuk gjendej as gjelbërim dhe as ujë.

Xhebraili [alejhis-selam] tha: “Ja, ky është vendi, o Ibrahim.”

Ibrahimi [alejhis-selam] tha: “Ky vend nuk është as vend bujqësor dhe as blegtor.”

Xhebraili [alejhis-selam] tha: “Po, ashtu është, por nga pasardhësit e birit tënd këtu do të vijë një profet, i cili do ta kryejë (plotësojë) mesazhin e thirrjes në besimin e teuhidit (njësimit) në Allah.”<sup>231</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] e pyeti Xhebrailin [alejhis-selam]: “A je urdhëruar t’i lësh këtu këta?”

Xhebraili tha: “Po!”<sup>232</sup>

<sup>229</sup> Ibn Kutejbe, *Kitab’ul-Mearif*, f. 16.

<sup>230</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.44; *Tabakat*, Ibni Sa’d, v.1, f.164.

<sup>231</sup> *El- Mizan*, 1/408; *Tabakatu’l Kubra*, Ibn Sa’d 1/164.

<sup>232</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.130.

Ibrahimi [alejhis-selam] iu lut Allahut të Madhërishëm për mbrojtjen dhe për furnizimin e mjaftueshëm të familjes së tij, të cilën po e braktiste në këtë vend të shkretë dhe jo të banuar.

Lutja e Ibrahimit [alejhis-selam] për familjen e tij në Kur'anin Famëlartë kalon në këtë mënyrë:

***“Kur Ibrahimi u lut: “Zoti im, bëje këtë vend qytet të sigurt dhe furnizoji me prodhime banorët e tij, ata që besojnë në Allahun dhe në jetën tjetër!” (El-Bekare: 126)***

Emri i Mekës në Kur'an një herë është përmendur me emrin Meke dhe një herë është përmendur me emrin Beke. Ky është ajeti në të cilin emri kalon në Mekë: ***“Është Ai që i ka penguar duart e tyre ndaj jush dhe duart tuaja ndaj tyre brenda në Mekë, pasi ju dha fitoren mbi ata. Allahu i sheh të gjitha çfarë bëni ju.” (El-Fet'h: 24)***

Dhe ky është ajeti në të cilin emri i Mekës kalon në Beke:

***“Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt.” (Ali Imran: 96)***

## PËRBËRJA GJEOGRAFIKE E MEKËS

Kur themi Mekë nënkuptojmë vendin në të cilin mbli-dhen njerëzit, përjashtohet mendjemadhësia si dhe falen mëkatet e njeriut. Gjithashtu, shohim nënshtrimin, shkatërrimin dhe fundin e mbretërve mizorë, të cilët janë munduar ta shkatërrojnë atë.<sup>233</sup>

<sup>233</sup> *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, v.1, f.182.

Përbërja gjeografike e Mekës: Meka, përveç tre hyrjeve, anët e tjera i ka të rrethuara me male. Njëra nga hyrjet është Tenim në anën veriore, hyrja tjetër është Udatu'l-Ibn në pjesën jugore dhe hyrja e tretë është Hudejbije (pesëdhjetë milje larg bregdetit të Detit të Kuq).<sup>234</sup>

Në pjesën jugore shtrihen edhe vargmalet Ebu Kubejs dhe Exhjad. Në pjesën veriore kemi malet Hind dhe Sebir. Në pjesën perëndimore kemi kodrat vullkanike krater.

Malet që rrethojnë Mekën, pavarësisht se kanë një pamje gëlqerore përsëri në përgjithësi përbëhen nga gurë me ngjyrë të zezë. Këto janë male të përbëra nga shumë pak dhe. Nuk bëhet fjalë për ndonjë mbulesë gjelbërimi në këto male.

Lartësia (Thevr 650 m dhe Hira 500 m) pavarësisht se nuk është shumë e lartë përsëri shkëmbinjtë përgjithësisht përbëhen prej gurëve të mprehtë.<sup>235</sup>

Meka në atë kohë ishte një shkurnajë që kishte dy pemë gjembore të quajtura “selem” dhe “semur”. Rreth Mekës banonte një fis i quajtur amelikanë.<sup>236</sup>

Lugina e Mekës ishte vendi në cilin Allahu i Madhëri-shëm urdhëroi braktisjen e Haxheres me fëmijën e saj të vogël nga Ibrahim [alejhis-selam]. Kjo luginë me një rërë të thatë e tepër të nxehtë në të cilën nuk gjendej gjë tjetër vetëm se pemë dhe bimë gjembore si dhe nuk gjendej asnjë pikë ujë për të pirë.

Njeriu sigurisht që nuk mendon të qëndrojë nën vapën përvëluese të një vendi të tillë shkretëtirë.

---

<sup>234</sup> Hz. Muhamed'in Hayati, Martin LINGS, f.10.

<sup>235</sup> Hac Risalesi, Mustafa İSLAMOĞLU, f.72.

<sup>236</sup> Ahbaru Meke, Ezraki, f.44

Përveç disa akacieve jeta në këtë vend dukej sikur kishte ndaluar, kishte marrë fund. Në të mbizotëronte heshtja, vetmia dhe dëgjohej vetëm zëri i erërave të forta.<sup>237</sup>

Përbërja gjeografike e Mekës në pamjen e parë na tregon se ky vend nuk është vend i përshtatshëm për vendbanim. Një mendim të tillë e mbështet edhe gjendja reale e Mekës në të cilën nuk ishte e mundur bujqësia sepse aty nuk gjendej asnjë përrua, liqen uji, si dhe nuk ishte e mundur blegtoria, sepse në të nuk kishte fare gjelbërim.<sup>238</sup>

## NË MEKË HIDHEN THEMELET E FESË MONOTEISTE

Ibrahimi [alejhis-selam] e la Haxheren me Ismailin [alejhis-selam] në vendin Bejtil-Haram (në Qabe).<sup>239</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] bëri udhëtime të ndryshme për të predikuar dhe hedhur themelet e besimit të teuhidit (njësimit të Zotit). Kur shkoi në Babilioni për t'i thirrur njerëzit në besimin e Zotit të Vërtetë, u përball me shumë vështirësi. U përball, gjithashtu, me shumë vështirësi përballë mbretit mizor kur shkoi në Egjipt për të predikuar fenë e drejtë të Allahut të Madhërishëm. Së fundi, me anë të Xhebrailit [alejhis-selam], iu tregua vendi i përshtatshëm në të cilin do të bënte predikimin e tij në njësimin e Allahut të Madhërishëm dhe ai vend ishte Meka. Meke, e cila është vendi ku do të ngrihet fjala e Allahut të Madhërishëm dhe do të bëhet qendra e thirrjes për në besimin Islam.

---

<sup>237</sup> *Rasûlullâh 'in Anesi ve Hanımları*, Bintu' Sh-Shati, f.65.

<sup>238</sup> *Şamil İslâm Ansiklopedisi*, v.5, f.160.

<sup>239</sup> *M.E.B. İslâm Ansiklopedisi* v.5 f.1110.

Nderi i këtij emigrimi të bukur ishte i Haxheres. Haxherja, e cila u bë simboli i mbështetjes në Allah me besimin e saj të lartë duke u përlulur përpara urdhrit të Allahut, duke u braktisur në këtë vend në të cilin nuk fluturonte as edhe një zog, nuk kalonte asnjë karvan dhe ishte një vend i shkretë dhe i thatë.<sup>240</sup>

Vendi ku u la Haxherja është vendi në pjesën e sipërme të Qabes dhe ujit Zemzem.<sup>241</sup>

Vendi i Qabes në atë kohë ishte një vend i ngritur si një kodrinë e vogël me dhe të kuq si të ishte i punuar. Reshjet e shirave rrëmbyes që kishin rënë herë pas here më parë i kishin gërryer anët (majtas-djathtas) të Qabes.<sup>242</sup>

Haxherja pranë saj kishte vetëm një pagurë uji dhe një trastë të vogël hurmash si dhe Ismailin [alejhis-selam], i cili akoma pinte vetëm qumësht.<sup>243</sup>

Më pas Ibrahim [alejhis-selam] pa i thënë gjë Haxheres mori rrugën për t'u kthyer nga kishte ardhur.

Kur Haxherja pa që Ibrahim [alejhis-selam] u largua pa i thënë gjë, i shkoi pas dhe në vendin Kedda i tha: “O Ibrahim! Ku po shkon? Në dorë të kujt po na lë neve në këtë shkretëtirë të vetmuar, në të cilën nuk banon asnjë njeri dhe nuk kam ku të strehohem?” Pavarësisht se Haxherja i foli disa herë radhazi Ibrahimit, përsëri ai nuk pa fare pas.<sup>244</sup>

<sup>240</sup> Buhâri, *Ehâdîthu'l-Enbiyâ*, 9 (1414); *Kutubi Sitte*, 14/4992; *Târih-i Taberi*, 1/130.

<sup>241</sup> *Kutubi Sitte Tercüme ve Şerhi*, Prof. Dr. İbrahim CANAN, v.14, f.222.

<sup>242</sup> *Texhrid-i Sarih Muhtasar Buhâri*, v.4, f.114; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, v.1, f.155; *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.54.

<sup>243</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f.221.

<sup>244</sup> *Kutubi Sitte*, 14/4992; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/220; *Târih-i Taberi*, 1/164.

Shkaku i mos shikimit pas të Ibrahimit [alejhis-selam] nuk ishte se ai ishte pa ndjenja dhe pa mëshirë ndaj familjes së tij, por, megjithëse ishte nga profetët e mëdhej (Ulul-Azm), përsëri edhe ai ishte njeri me ndjenja dhe mëshirë. Ndaj edhe ai, sigurisht, dëshironte ta shikonte familjen e tij të dashur për herë të fundit. Por qëllimi i tij ishte të çojë urdhrin e Allahut të Madhërishëm në vend pa asnjë mangësi. Ibrahim [alejhis-selam] në një anë mbarte urdhrin e Allahut të Madhërishëm dhe në anën tjetër mbarte përgjegjësinë që ishte babai i një fëmije, i cili akoma pinte qumësht tek nëna e tij dhe përgjegjësinë që ishte burri i një gruaje.

Këto ishin disa shkaqe prej të cilave ai nuk u kthye duke parë prapa se, nëse do të shikonte lutjet dhe gjendjen e gruas bashkë me fëmijën e tij, ndoshta, zemra, dashuria dhe mëshira e tij ndaj familjes do ta detyronin që të mos pajtohej me braktisjen e saj në një vend të shkretë dhe të vetmuar. Nëse do të bënte një gjë të tillë, atëherë kjo do të thoshte ardhje kundër urdhrin të Allahut të Madhërishëm. **“Vërtet, Ibrahim ishte i butë, i dhembshur e vazhdimisht i kthyer (tek Allahu).”**<sup>245</sup>

Pasi Haxherja e pa Ibrahimin [alejhis-selam] që nuk i ktheu përgjigje, për herë të fundit e pyeti: “A Allahu të urdhëroi ty të na braktisësh neve vetëm këtu?”<sup>246</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] pas kësaj pyetjeje u kthye kah Haxherja e pa me sytë e mbushur me lotë, me dashuri dhe dhembshuri dhe tha: “O Haxhere! Çfarë është kjo pyetje, nëse Allahu i Madhërishëm nuk do të më kishte urdhëruar mua kështu, vallë, a do t’ju braktisja unë ju? Vallë, a do e

---

<sup>245</sup> Sûre Hûd: 75.

<sup>246</sup> *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/221; *Kutubi Sitte*, v.14, H. No: 4992.



braktisja unë në këtë vend fëmijën tim me të cilin akoma nuk jam ngopur vetëm me të puthura?”<sup>247</sup> (Hûd: 75)

Në një vend tjetër shikojmë se Ibrahim i [alejhis-selam] pas kësaj pyetjeje mundi të përgjigjet duke thënë vetëm: “Po!”<sup>248</sup>

Në atë moment Allahu i Madhërishëm i ka shpallur në shpirtin e saj një frymëzim të tillë: “O Haxher! Ti je një fituese e madhe në përkushtim, dashuri dhe mbështetje të plotë në Allah. Ti je nën mbikëqyrjen Time! Unë jam Garantuesi i riskut tënd dhe i fëmijës tënde.”<sup>249</sup>

Pasi e mori një përgjigje të tillë nëna jonë, Haxherja, iu përgjigj Ibrahimit [alejhis-selam] me një përgjigje rehatuese duke pasur një besim dhe përrulje të plotë në Zotin e botëve dhe tha: “Përderisa erdhëm këtu me urdhër të Allahut të Madhërishëm, ne jemi dakord, mund të shkoni ku të doni.”<sup>250</sup> Sido që të jetë, neve na ruan Allahu i Madhërishëm. Ai na mjafton.”<sup>251</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] tha: “Në të vërtetë unë po ju lë ju këtu me pëlqimin e Allahut. Ai më ka udhëzuar në rrugën e drejtë.”<sup>252</sup> dhe më pas vazhdoi rrugën e tij.<sup>253</sup>

Ja, pra, këto ishin fjalët e Ibrahimit [alejhis-selam] gjatë gjithë këtij udhëtimit që bëri për ditë të tëra. Ndërsa përgjigjen që mori nga gruaja, vërtet ishte një përgjigje e mbushur

<sup>247</sup> *Târih-i Taberi*, 1/164; *Rahmete Yolculuk*, Mehmet ALAGAŞ, f. 58.

<sup>248</sup> Buhâri, *Ehâdîthu 'l-Enbijâ*, 9 (1414); *Kutubi Sitte*, 14/4992; *Târih-i Taberi*, 1/164.

<sup>249</sup> *Haxh*, Ali SHERIATI, f.71.

<sup>250</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f. 164.

<sup>251</sup> Buhâri, *Ehâdîthu 'l-Enbijâ*, 9 (1414); *Ibnu 'l-Ethir*, 1/97.

<sup>252</sup> *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f. 225.

<sup>253</sup> Buhâri, *Ehâdîthu 'l-Enbijâ*, 9 (1414); *Kutubi Sitte*, 14/4992.

me përulje dhe mbështetje të plotë ndaj Krijuesit të Madhërishëm si dhe një përgjigje që i përshtatet gruas së një profeti të Zotit. Për të kthyer një përgjigje kaq të madhe me një përulje dhe mbështetje kaq të përsosur në Allah, së pari, duhet të bëhesh një besimtar/e si Haxherja.

Dikur Ibrahim [alejhis-selam] e kishte dhënë një përgjigje të tillë me një përulje të plotë ndaj Allahut të Madhërishëm kur e hodhën në zjarr. Ndërsa tani një përgjigje me kaq përulje e dha ndriçuese Haxhere në kushte tepër të vështira.

Si përfundim, kur Sara e largoi Haxheren nga shtëpia si pasojë e xhelozisë së saj, Allahu i Madhërishëm e vendosi Haxheren në vendin e bekuar dhe në faqet e ndriçuara të historisë islame.

### **KTHIMI I IBRAHIMIT [alejhis-selam]**

Allahu i Madhërishëm e sprovoi Ibrahim [alejhis-selam] me sprovë siç mund të përmendim sprovën e fundit, e cila e ndau atë nga fëmija dhe gruaja e dashur, Haxherja. Pavarësisht se Ibrahim [alejhis-selam] ishte profet, por mos të harrojmë se edhe ai ishte njeri me ndjenja si njerëzit e tjerë.

Ndjenjat e tij ndaj të birit, Ismailit [alejhis-selam], nuk ishin ndryshe nga ndjenjat dhe dashuria e prindërve të tjerë ndaj fëmijëve të tyre. Megjithatë ai përsëri e la Haxheren të vetmuar me birin e saj në shkretëtirën përvëluese, sepse i tillë ishte urdhri i Allahut të Madhërishëm. Ai zgjodhi urdhrin e Allahut në vend të djalit në këtë sprovë.

Ibrahimi [alejhis-selam] u kthye drejt vendit ku ndodhet Kabeja sot dhe i hapi duart duke i lutur Allahut të Madhërishëm kur erdhi në vendin Thenijjetul Veda.<sup>254</sup>

***“O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi, në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndiejnë dashmirësi për ata dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë.”*** (Ibrahim: 37)

Sigurisht që Ibrahim [alejhis-selam] e dinte që Allahu i Madhërishëm do t’i ndihmonte dhe nuk do t’i linte të vdisnin në atë vend, sepse udhërrëfyeni i rrugës së tij për në atë vend të shenjtë ishte Xhebraili [alejhis-selam]. Për këtë arsye Ibrahim [alejhis-selam] e dinte se Allahu i Madhërishëm do t’i mbrojë ata nga çdo fatkeqësi dhe rrezik. Gjithashtu, besimi i tij ishte i plotë në furnizimin e tyre me ushqim nga ana e Allahut të Madhërishëm.

Krijuesi i gjithësisë, Allahu i Madhërishëm, e siguroi Ibrahimin [alejhis-selam] se është Ai që furnizon me bollëk dhe do t’i shumojë ata në të ardhmen, sepse Ibrahim [alejhis-selam] iu bind Allahut të Madhërishëm me një bindje të plotë dhe i la ata afër vendit të Qabes duke shpresuar vetëm në ndihmën e Tij.

Një gjë të tillë e shikojmë edhe tek Zanafilla e Dhiatës së Vjetër të Biblës, ku në të thuhet: “Edhe nga djali i kësaj shërbyeses unë do të bëj një komb, sepse është një pasardhës i yti.”<sup>255</sup> Ky ishte një lajm i mirë dhe përgëzues për Ibrahimin [alejhis-selam], i cili e la gruan e dashur dhe fëmijën e tij në

<sup>254</sup> Buhâri, *Ehâdîthu’l-Enbijâ*, 9 (1414); *Kutubi Sitte*, 14/4992; *Tibyan Tefsiri*, 2/394; *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/222; *Ibnu’l-Ethir*, 1/97.

<sup>255</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla* 21: 13.

një vend të pabanuar dhe të shkretë.

Tevekul (mbështetje) do të thotë t'i besosh, të lidhesh dhe t'i mbështetesh, të shpresosh me besim të plotë tek Allahut i Madhërishëm në çdo punë dhe situatë. Sepse një mbështetje e tillë në Allah do t'i mundësojë njeriut një fuqi tepër të madhe shpirtërore dhe materiale.

Allahu i Madhërishëm në Kur'anin Famëlartë në lidhje me tevekulin ka thënë: ***“Nëse besoni Allahun, mbështetuni tek Ai, nëse jeni muslimanë!”*** (Junus: 54) Pra, nëse jeni nga besimtarët, atëherë mbështetjuni Allahut të Madhërishëm dhe mundohuni të veproni urdhrat dhe ndalesat që ka caktuar Ai.

## HAXHERJA ËSHTË NJË MONUMENT I NËNSHTRIMIT DHE MBËSHTETJES NË ALLAH

Gruaja muslimane është shquar me figurën e saj fisnike në modelin e grave të botës. Gjithashtu, ajo është një simbol në të cilin shihet angazhimi, nënshtrimi i plotë i saj ndaj Allahut. Ajo është njeri. Ajo është krijuar nga Krijuesi i gjithësisë dhe i Vetëm. Ajo është nënshtruar ndaj urdhrave të Allahut të Madhërishëm me një sinqeritet të plotë dhe, gjithashtu, është një prijëse përpara popullit kundrejt zakoneve dhe veprave të gabuara të tyre.

Islami i ka dhënë një vlerë tepër të rëndësishme gruas. Një grua besimtare që nënshtrohet sinqerisht ndaj Allahut të Madhërishëm, e ka ngritur, nderuar dhe vlerësuar aq shumë saqë profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka

thënë: *“Xheneti është nën këmbët e nënës...”*<sup>256</sup> Në një hadith tjetër e gjejmë në këtë mënyrë: *“Nëna është mes dyerve të Xhenetit...”*<sup>257</sup>

Në luginën në të cilën u la Haxherja nuk gjendej asnjë njeri, asnjë kafshë, madje asnjë pemë. Askush nuk mund ta dëgjonte zërin dhe nuk mund të vinte në ndihmë në moment rreziku në këtë luginë të shkretë. Nëse njeriu do të bërtiste me zë të lartë në këtë vend, zërin e tij vetëm ai mund ta dëgjonte përsëri nga jehona e shkëmbinjve, gjë që nuk ka dobi tjetër përveçse të tregon dhe të shton akoma më shumë edhe një herë vetminë në këtë vend.

Lind pyetja: përse në një vend të pabanuar dhe pa strehim? Mund t’ju duket e habitshme braktisja e gruas me fëmijën e vogël në krah në një luginë të vetmuar, të shkretë, pa ujë dhe pa asnjë ushqim. Që të gjitha këto sprova ishin vetëm për të dalë në pah bindja dhe nënshtrimi i sinqertë ndaj Krijuesit të gjithësisë, Allahut të Madhërishëm.

Sigurisht që Haxherja bashkë me foshnjën e saj të vogël kishte nevojë për një mbrojtës dhe ndihmëtar në këtë luginë të vetmuar siç kemi nevojë të gjithë ne për frymëmarrjen e ajrit, pirjen e ujit dhe ngrënien ushqimit.

Njeriu gjithmonë ndien nevojë për një ndihmues, udhëzues dhe mbrojtës. Besimi dhe mbështetja e sinqertë në Allahun e Madhërishëm është një nga shkallët e para të besimit islam. Dhe ai që i posedon këto cilësi e ka më të lehtë tejkalimin e vështirësive dhe pengesave gjatë jetës. Sepse dashuria ndaj Allahut të Madhërishëm i tejkalon dhe kapërcen të gjitha vështirësitë, siç mund të përmendim rastin e

<sup>256</sup> Nesâî, *Xhihad*, 6.

<sup>257</sup> Ibn Hanbel, V, 198

Haxheres, e cila pavarësisht se ishte e vetmuar në një vend të pabanuar dhe shkretëtirë, përsëri dashuria e saj ndaj Allahut të Madhërishëm e mundi nevojën e madhe që ndiente ajo dhe fëmija i saj për një ndihmë, udhëzim, vendstrehim, për ujë dhe ushqim.

Haxherja u bë simboli i dorëzimit të plotë në Allahun e Madhërishëm me mbështetjen e saj të pashoq dhe, kur mori përgjigjen se ishte urdhër i Allahut të Madhërishëm për ta lënë në atë vend, nuk kërkoi nga burri i saj qoftë edhe një vend për strehim në këtë shkretëtirë të vetmuar. Në këtë gjendje ajo iu dorëzua Krijuesit të saj me bindje të plotë dhe nuk u frikësua pavarësisht se nuk kishte gjë tjetër pranë saj përveç disa hurmave dhe një sasive të paktë uji.

Vallë, çfarë do të hante dhe pinte në këtë vend të shkretë e të vetmuar? Por ajo preferoi bindjen dhe mbështetjen e sinqertë në Krijuesin e saj, pavarësisht gjendjes kaq të vështirë.

Ka thënë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: *“Nëse do t’i mbështeteni Allahut të Madhërishëm me një mbështetje të plotë, atëherë do të furnizoheni me risk nga Allahu sikur furnizohen zogjtë. (Zogjtë) dalin të uritur në mëngjes dhe kthehen të ngopur në darkë.”*<sup>258</sup>

Ka thënë Allahu i Madhërishëm në Kur’anin Famëlar-të: ***“Dhe do t’i japë risk prej nga nuk e pret. Allahu i mjafton kujt do që mbështetet tek Ai.”*** (Et-Talak: 3)

Mbështetja në kaderin (caktimin) e Allahut të Madhërishëm më parë tregon dashurinë ndaj Tij dhe është përgjigjja më e madhe ndaj vuajtjeve, vështirësive dhe fatkeqësive gjatë jetës. Durimi dhe mbështetja në Allahun e Madhërishëm i

<sup>258</sup> Tirmidhi, *Zuhd*, 33 (2344).

jep njeriut një fuqi aq të madhe saqë është në gjendje të përballojë çdo lloj vështirësie, vuajtjeje apo fatkeqësie gjatë jetës.

Nënshtrimi përballë vullnetit të Allahut të Madhëri-shëm do të thotë i pavarur nga nënshtrimi i njerëzve. Përulja dhe adhurimi i Allahut të Madhëri-shëm e refuzon përuljen e njeriut. Sepse përulja dhe adhurimi është vetëm mes njeriut dhe Allahut e jo mes njerëzve. Pranimi dhe përulja përpara caktimit të Allahut e bën njeriun të lirë. Kjo është liri që krijohet mes njeriut dhe caktimit të Allahut të Madhëri-shëm duke mënjanuar çdo nënshtrim tjetër. Ne si njerëz duhet të tregojmë vullnet dhe të bëjmë sa më shumë punë të mira.

Nënshtrimi është mënyra dhe zgjedhja e vetme përballë vështirësive të mëdha dhe pesimizmit gjatë jetës.

Nënshtrimi ndaj Allahut të Madhëri-shëm është logjika e shëndoshë, e cila e bën njeriun ta ndiejë veten si një trim hero përballë vështirësive dhe pengesave që ballafaqohet gjatë jetës ose një shehid, i cili është pajtuar me kaderin (caktimin) e Tij.<sup>259</sup>

## **HAXHERJA ËSHTË MONUMENTI I BESIMIT PËRBALLË INTRIGAVE (MASHTRIMEVE) TË SHEJTANIT**

Pasi Ibrahim i [alejhîs-selam] u zhduk nga pamja e syve, Haxherja u drejtua tek djali i saj, Ismaili [alejhîs-selam], për ta harruar vetminë e saj. Sepse dashuria dhe bukuria e djalit

---

<sup>259</sup> *Doğu ve Batı Arasında İslâm*, Ali İZZETBEGOVIÇ, f.399-400.

e bënin ta harronte vetminë. Ajo ishte e zënë duke parë fytyrën e tij të ëmbël, të dashur dhe të bukur.

Në ato çaste doli në skenë armiku më i madh i njerëzisë, shejtani i mallkuar, duke i hedhur vesvese nënës tonë, Haxheres, nga sprova e rëndë që po përjetonte.

Filloi duke i hedhur vesvese të tilla: “Oj Haxhere! Ibrahimimi të braktisi ty dhe djalin tënd këtu për arsye të Sarës, sepse Sara që nuk kishte fëmijë ishte xheloze ndaj teje dhe djalit tënd. Ibrahimimi të braktisi këtu të vetmuar vetëm me djalin e vogël, Ismailin, dhe shkoi pranë Sarës që është më e bukur se ti.”<sup>260</sup>

Por nëna jonë, Haxherja, iu mbështet Allahut të Madhërishëm nga vesveset e shejtanit dhe nuk ia vuri veshin vesveseve të tij. Sepse ajo e njihte shumë mirë se kush ishte Ibrahimimi [alejhis-selam] dhe nëna jonë, Sara. Për këtë arsye, ajo e kuptoi se mendimet e tilla nuk janë gjë tjetër vetëm se vesvese dhe hile të shejtanit.

Kjo nuk ishte xhelozia mes dy grave. Kjo nuk ishte gjë tjetër vetëm se një detyrë nga Allahu për Ibrahimimin [alejhis-selam], urtësia e së cilës ishte e fshehur.<sup>261</sup>

Gjithashtu, Sara, që është shembull drejtësie, i besonte dhe kishte besim të plotë tek Ibrahimimi, të cilin e pyeti më parë: “A Allahu të urdhëroi ty?” dhe prej tij mori përgjigjen “Po!”<sup>262</sup>

Haxherja nuk e ndjeu vetminë në momentet e para në këtë vend të thatë. Kështu që nuk i kuptoi vështirësitë e këtij vendi të thatë dhe të pabanueshëm.

<sup>260</sup> *Rahmete Yolculuk*, Mehmet ALAGAŞ, f.61.

<sup>261</sup> *Peygamberler Târihi*, Ahmed BEHCET, f.120.

<sup>262</sup> *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f. 221



Ajo filloi t'i kuptojë vështirësitë e këtij vendi kur po i mbaronte ushqimi dhe uji. Në atë kohë i ishte ndërprerë edhe qumështi.<sup>263</sup>

Ndërsa biri i saj, Ismaili [alejhis-selam], i cili nuk ishte në gjendje të kuptonte se çfarë po ndodhte, kërkoi ujë dhe qumësht nga nëna e tij. Gjendja e djalit ishte shqetësuese për Haxheren! Vallë, si mund të duronte zemra e nënës këtë gjendje të birit së saj?

Shqetësimet e Haxheres nuk ishin plasaritjet e buzës dhe etja e saj, por ajo e Ismailit.

Filloi të shikojë përreth. Filloi të shohë me qindra herë përreth dhe po priste një shenjë, një ndihmë nga Allahu i Madhërishëm.

Shejtani i mallkuar doli përsëri në skenë me vesveset e tij kur e pa gjendjen e vështirësuar të Haxheres, e cila nuk u dorëzua përballë saj. Kështu që dhe shejtani filloi të lëshojë vesveset helmuese të rrezikshme, duke i thënë:

“Oj Haxhere! Ja këto janë fjalët e Zotit tënd dhe të Ibrahimit! Vallë, a i kuptove sesa fjalë dhe premtime të rreme që janë? Tashmë, a e kuptove sesa e vetmuar dhe pa ndihmëtar jeni? Eja, largohu menjëherë me fëmijën tënd nga ky vend që të braktisi Ibrahimimi dhe shiko përreth se ndoshta mund të gjesh ndonjë burim uji dhe vend të banueshëm. O Haxhere! Nëse nuk të dhimbset vetja jote të paktën duhet të dhimbset biri yt. Eja, largohu menjëherë me fëmijën tënd përpara se të vdisni në këtë vend të thatë dhe të pabanueshëm!”

Haxherja, pavarësisht mungesës së ujit dhe pa rrugëzgjdhjes, iu mbështet Allahut të Madhërishëm me një

<sup>263</sup> *Doğuştan Günümüze Büyük İslâm Târîhi*, v.1, f.127.

sinqeritet shpirtëror të plotë pa i vënë veshin vesveseve të shejtanit. Prej buzëve të thata të saj rridhnin fjalët: “Ekziston Zoti – Krijuesi i botëve, vallahi bil-lahi (betohem), Ai ekziston dhe, vallahi bil-lahi (betohem), fjalët e Ibrahimit janë të drejta.”<sup>264</sup>

Pavarësisht të gjitha vështirësive përsëri Haxherja nuk mund të ikte me Ismailin nga vendi ku ishin. Sepse Ibrahim, profeti i Allahut dhe burri i saj, e la atë me fëmijën e vogël në vendin që e kishte urdhëruar Allahu i Madhërishëm!

## SPROVAT JANË PËR TË NGRITUR GJENDJEN SHPIRTËRORE TË NJERIUT

Ka thënë Allahu i Madhërishëm në Kur’anin Fisnik: *“Qoftë i Lartësuar Ai, në dorën e të Cilit është pushteti suprem dhe që është i Fuqishëm të bëjë çdo gjë! Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.”* (El-Mulk: 1-2)

*“Ne i kemi provuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu të dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë.”* (El-Ankebût: 3)

*“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit.”* (El-Bekare: 155)

Ka thënë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: *“Allahu e sprovon atë njeri që do...”*<sup>265</sup>

<sup>264</sup> Rahmete Yolculuk, Mehmet ALAGAŞ, f. 62-63.

<sup>265</sup> Fethu 'l-Kebir 1/68 - Rûhu 'l-Bejân, Ismâil Hakî BURSEVÎ, 5/176.

Sprova e lartëson akoma më shumë njeriun duke kaluar nga teoria në vepër. Kur sprovohet besimtari me goditjen e fatkeqësive, do të thotë se Allahu i Madhërishëm me anë të sprovave dëshiron që ai person të ngrihet në gradën më të lartë që meriton.

Ka thënë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në një hadith: *“Kur Allahu i jep një vend dikujt, ai nuk e arrin atë vend lehtë. Por Allahu e sprovon me dëmtim të pasurisë ose të fëmijëve. Dhe nëse ai duron përballë tyre, atëherë e arrin atë vend të caktuar.”*<sup>266</sup>

Allahu i Madhërishëm nuk e sprovon një besimtar për të matur gradën shpirtërore apo personalitetin e tij, mundet që ta sprovojë që t’i rritet grada e besimit dhe personalitetit të tij. Nuk e sprovon për të dalluar se cili është prej banorëve të Xhenetit dhe të Xhehenemit. Por e sprovon me qëllim që t’i lartësohet vendi i tij në Xhenet, nëse duron përballë sprovave, ose, nëse nuk duron, për të qëndruar në vendin që është.”<sup>267</sup>

***“...Allahu është i kënaqur me ata, por edhe ata do të jenë të kënaqur me Të. Ata janë pala e Allahut dhe, vërtet që pala e Allahut do të jetë fituese.”*** (El-Muxhadele: 22)

Ata nuk i ankohen Allahut sado që të jenë në vështirësi. Përsëri ankimet ia drejtojnë veteve të tyre. Kur i godet ndonjë mirësi atë e dinë nga Allahu i Madhërishëm dhe kur e godet ndonjë fatkeqësi atë e pranojnë se është rezultat i veprave të tyre.

Sprovat e besimtarëve të mirë dhe të rregullt janë të vështira dhe të vazhdueshme. Ose më saktë le të shprehemi

---

<sup>266</sup> *Tergib ve Terhib*, Hafiz Mundhiri, v.6, f.391.

<sup>267</sup> *Kur’ân’da İnsaniyet Mektebi*, Ayetullah Murtaza MUTAHHARÏ, f.38.

me shprehjen e Kur'anit *“dëshpërim pas dëshpërimi”*. Besimtarët e tillë që i kanë përkushtuar vetet e tyre në këtë rrugë, në fund të sprovave dalin me një besim akoma më të fortë sikur shpata, e cila është shuar me ujë nga dy tehet/anët e saj.

*“Kur ju morët malin dhe nuk i vinit vesh askujt, të Dërguarin e kishit prapa e ju thërriste, Allahu ju dënoi me dëshpërim pas dëshpërimit, që të mos pikëlloheni as për atë që ju doli duarsh, as për atë që ju goditi. Allahu di gjithçka që punoni ju.”* (Ali Imran: 153)

Tregon Sa'di [radijallahu anhu] se e ka pyetur Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “O i Dërguari i Allahut! Cilët janë ata që i kanë sprovat më të vështira?”

I Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] është përgjigjur duke thënë: *“Profetët, velitë* (personat e urtë me besim të lartë – dijetarët) *dhe ata që janë sikur dijetarët* (të cilët mundohen në rrugë të fesë). *Sprova e njeriut është sipas besimit të tij. Nëse është me besim të fortë edhe sprovën e ka të madhe, por nëse është me besim të dobët edhe sprova është e lehtë.”*<sup>268</sup>

Sprovat janë të mëdha dhe të rënda për personat që janë shembuj dhe që ecin në nivel të lartë, por ata nuk thyhen edhe nëse përkulen, nuk rrëzohen edhe nëse tunden, si dhe nuk flenë edhe nëse ngadalësohen. Edhe sikur të kenë hyrë kockat mes njëra-tjetrës përsëri do të shohësh se përgjigjja e tyre do të jetë gjithmonë e njëjtë dhe e tillë: *“Neve na mjafton Allahu, Ai është Mbrojtës i Mrekullueshëm!”* (Ali Imran: 173)

Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në një hadith ka thënë: *“Shembulli i besimtarit është si bima, e cila, edhe pse*

<sup>268</sup> *Tergib ve Terhib*, Hafiz Mundhiri, v.6, f.385

*vazhdon që ta rrëzojë era, përsëri drejtohet. Kështu është edhe besimtari, edhe pse sprovohet, ai përsëri është i durueshëm dhe i përballueshëm ndaj sprovave të ndryshme.*<sup>269</sup>

Besimtarit nuk i mungojnë asnjëherë fatkeqësitë dhe vështirësitë gjatë gjithë jetës së tij. Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: “*Vërtetë besimtari duhet të jetë në gjendje gatishmërie përpara Allahut, në vështirësi dhe në lehtësim.*”<sup>270</sup> E rëndësishme për besimtarin është që, edhe nëse nuk u reziston vështirësive, përsëri ai nuk duhet të rrëzohet, por edhe nëse rrëzohet nga vështirësitë, ai përsëri duhet të përpiqet për t’u drejtuar.

---

<sup>269</sup> Tirmidhi, *Zuhd*, 56 (2398).

<sup>270</sup> *Metâlib ul-Âlije*, 4/3250.



**PJESA E PESTË**  
**PËRPJEKJA DHE SHPËRBLIMI**





## LODHJA DHE TEVEKULI (MBËSHTETJA NË ALLAH)

*“Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu.”*

(Ali Imran: 159)

Kur thua Haxher menjëherë të vjen në mendje përlulja përpara shpalljes.

Kur thua Haxher menjëherë të vjen në mendje bindja e një gruaje ndaj burrit të saj, profetit Ibrahim [alejhisselam].

Kur thua Haxher menjëherë të vijnë në mendje mundimet dhe lodhja e tepërt për të ushqyer fëmijën e saj siç duhet.

Haxherja, pavarësisht përluljes që kishte treguar përpara urdhrit të Allahut të Madhërishëm, përsëri nuk u ul në vend duke ngritur duart dhe duke iu lutur Allahut të Madhërishëm për t'i zbritur ujë dhe bukë nga qielli, por ajo është një nga shembujt e bindjes së ligjeve natyrore që ka vënë Allahu i Madhërishëm për të mbijetuar.

Haxherja ndiente një dhembje të madhe në shpirt kur e shikonte birin e saj, Ismailin, që i ishin tharë buzët nga etja. Tashmë, ajo nuk duronte dhe nuk kishte më durim për ta parë djalin e saj të etur për ujë. Sigurisht që tashmë nuk mund të qëndronte ulur për të pritur ardhjen e ujit tek ajo.

Haxherja ishte e shqetësuar për gjendjen e saj dhe të fëmijës, por nuk i kishte prerë shpresat tek Allahu i Madhërishëm. Ajo kurrë nuk e ka humbur besimin e saj që kishte ndaj Allahut të Madhërishëm. Në të njëjtën kohë ajo nuk do të priste në të njëjtin vend për ushqim dhe ujë.

Haxherja filloi të qante kur e pa birin e saj dy vjeç, Ismailin, i cili po qëndronte i etur poshtë diellit përvëlues.<sup>271</sup>

Nënës i përvëlohej shpirti për birin e saj të vogël, kështu që u detyrua të dilte në kodrën Safa pranë Qabes me shpresë se mos shikonte ndonjë njeri për t'i kërkuar ujë.<sup>272</sup> Kur doli në Safa pa se nuk kishte asnjë njeri përreth. Zbriti nga kodra Safa dhe filloi të kërkonte ujë afër përroit të thatë. E kaloi luginën duke kërkuar dhe mbërriti në kodrën Merve. Por përsëri nuk pa asnjë njeri përreth.<sup>273</sup>

Haxherja nga njëra anë vraponte mes kodrave Safa dhe Merve dhe nga ana tjetër e luste Allahun e Madhërishëm: “O Allah! Më i Madhi Mëshirues i mëshiruesve. Kush do të na mëshirojë ne nëse nuk na mëshiron Ti!”<sup>274</sup>

Në atë moment i erdhën në mendje gjarpërinjtë dhe akrepat helmues dhe prej këtij mendimi shqetësues u kthye shpejt tek Ismaili. Por përsëri nuk duroi dot kur pa të qarat dhe etjen e madhe të fëmijës dhe për këtë u kthye përsëri në kodrat Safa dhe Merve për të kërkuar ujë.

Vraponte prej kodrës Safa në kodrën Merve këmbëzbathur.<sup>275</sup>

Kaderi i Haxheres dhe vrapimi i saj prej kodrës Safa në kodrën Merve, zuri një vend të rëndësishëm në faqet e historisë dhe ishte ndodhi mësimdhënëse si dhe u pranua nga kushtet e adhurimit dhe të fesë (gjatë Umres dhe Haxhit).

<sup>271</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.45; *Târih-i Taberi*, 1/165.

<sup>272</sup> *Tibyân Tefsiri*, 2/394; *Ibnu'l-Ethir*, 1/97; *Târih-i Taberi*, 1/164.

<sup>273</sup> Buhâri, *Ehâdîthu'l-Enbijâ*, 9 (1414); *Kutubi Sitte*, 14/4992; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/221; *Târih-i Taberi*, 1/164.

<sup>274</sup> *Mekeye Giden Yol*, Muhamed ESED, f.459.

<sup>275</sup> *Doğuştan Günümüze İslâm Târîhi*, 1/127; *Ibnu'l-Ethir*, 1/97; *Târih-i Taberi*, 1/165.

Në lidhje me këtë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Për këtë arsye njerëzit bëjnë Sa’j mes (kodrave) Safa dhe Merve.”*<sup>276</sup>

Ajo e dinte dhe ishte e sigurt që do t’i vinte ndihma e Allahut të Madhërishëm pas përuljes së plotë ndaj Tij, por përsëri ajo dëshironte që ndihmën ta fitonte me anë të mundimit të saj.

E la nën mbikëqyrjen e Allahut të Madhërishëm birin e saj të vogël mbi rërën e nxehtë për të kërkuar ujë. Vrapimi i saj këmbëzbathur mbi rërën e nxehtë mes kodrave Safa dhe Merve tregon përgjegjësinë dhe mëshirën e nënës ndaj fëmijës së saj.

Allahu i Madhërishëm në Kur’an thotë: *“... njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar.”* (En-Nexhm: 39)

Haxherja ishte një nënë e vetmuar, kërkuese, vuajtëse, nuk kishte ndihmues (përveç Allahut), pa strehim, pa shtëpi, në një shkretëtirë të pabanuar shumë larg popullit si dhe shumë pengesa dhe vështirësi të ngjashme me këto.

Haxherja, pavarësisht se ishte e vetme dhe e lodhur, përsëri vraponte nga një vend në tjetrin me këmbëngulje dhe me shpresë.

Shiko Haxheren dhe mëso lirinë. Liria e vërtetë ishte e Haxheres, e cila me anë të fuqisë, dashurisë dhe me kënaqësinë e lirinë që i dhuronte besimi, i tejkaloi pengesat e kësaj bote, pavarësisht se ishte në mesin e një shkretëtire pa ujë. Nuk është e “pamundur” arritja e lumturisë së vërtetë. Çdo pasuri e kësaj bote ishin të pafuqishme dhe pavlerë përpara besimit të Ibrahimit [alejhis-selam] dhe Haxheres.

---

<sup>276</sup> Buhâri, *Ehâdîthu’l-Enbiâ*, 9 (1414); *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/222.

Liria duhet të përdoret siç e ka përdorur Haxherja. Liria nuk është t'i përulesh rrjedhës së historisë/kohës, por të jesh kandidat për ta ndryshuar rrjedhën dhe shkrimin e historisë me shkronja (adhurim, bindje ndaj Allahut të Madhërishëm, vepra të mira) argjendi. Ndërsa, skllavëria e vërtetë është pajtimi dhe bindja e rrjedhës së kohës/historisë.

Ishte “dashuria” dhe “përuļja përpara urdhrit” që e shtyu të sillet në këtë mënyrë këtë grua, së cilës çdo qelizë i ishte e mbushur me besim. Por asgjë s'është e pamundur për dashurinë e vërtetë. Sepse besimi dhe dashuria ndaj Allahut të Madhërishëm është mundësia më e madhe për të arritur pikën më të lartë.<sup>277</sup>

## SHPËRBLIMI I HAXHERES ME UJIN ZEMZEM

Haxherja u shqetësua dhe mendoi se do të sprovohet me vdekjen e birit të saj kur shikonte etjen e madhe të tij dhe nxehtësinë përvëluese të Mekes.

Për këtë arsye mendoi: “Të paktën të largohem dhe mos ta shoh vdekjen e tij përpara syve të mi!”<sup>278</sup>

Është një gjendje tepër e vështirë dhe e padurueshme e nënës të shikojë djalin e vogël duke i dalë shpirti nga etja përpara syve të saj.

Haxherja u ngrit nga vendi dhe u ul pak më tej Ismailit, sepse nuk po duronte ta shihte gjendjen tepër të vështirësuar të tij.<sup>279</sup>

---

<sup>277</sup> *Hac Risalesi*, Mustafa İSLÂMOĞLU, f.91.

<sup>278</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.45.

<sup>279</sup> *Peygamberler Târîhi*, Muhamed Asım KÖKSAL, v.1, f.177-178.

Nuk dëgjohej zë tjetër vetëm se të qarat e Ismailit [alejhis-selam] dhe lutjet e Haxheres me sytë e përлотur. Haxherja më parë u mundua duke vrapuar ndërmjet kodrave Safa dhe Merve, duke shpresuar se mund të shikonte ndonjë njeri, por mundimet e saj mbetën pa rezultat. Pavarësisht gjendjes tepër të vështirësuar, përsëri Haxherja nuk i ndërpreu shpresat, sepse ajo e dinte shumë mirë që braktisja e saj aty nga Ibrahim [alejhis-selam] ishte me urdhër të Allahut të Madhërishëm dhe, për këtë arsye, ajo ishte e bindur se Allahu i Madhërishëm, Krijuesi i gjithësisë, do e ruajë atë dhe birin e saj nga çdo rrezik si dhe do e furnizojë me begati në fundin e kësaj sprove kaq të madhe, nëse do të jetë e durueshme.

Thotë Allahu i Madhërishëm në Kur'an: ***“...Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'i gjejë rrugëdalje*** (nga çdo vështirësi).” (Et-Talak: 2)

Tevekul do të thotë t'i mbështetesh dhe t'i besosh Allahut të Madhërishëm me sinqeritet të plotë, kështu që duhet t'i bësh tevekul Allahut në çdo punë. Në çdo punë duhet t'i besosh vetëm Atij. Ky besim i jep njeriut fuqi shpirtërore dhe fizike.

Sinqeriteti dhe tevekuli i Haxheres në Allahun e Madhërishëm është mësimdhënës për të gjithë ne me anë të së cilës mësojmë se fundi i durimit të sinqertë bashkë me tevekul të plotë është gëzim dhe lumturi e madhe. Gjithashtu, njeriu në jetë më parë duhet të mundohet dhe t'i përdorë të gjitha mundësitë me vendosmëri deri në fund dhe pastaj le të presë ndihmën e Allahut me një tevekul të plotë.

Thotë Allahu i Madhërishëm në Kur'anin Famëlartë: ***“...Do t'i jap risk prej nga nuk e pret. Allahu i mjafton kujt do që mbështetet tek Ai...”*** (Et-Talak: 3)

Haxherja shkoi katër herë prej kodrës Safa në kodrën Merve dhe tre herë prej kodrës Merve në kodrën Safa.<sup>280</sup>

Haxherja dëgjoi një zë kur zbriti nga kodra Safa dhe iu afrua kodrës Merve. Tha me vete: “Të pushoj njëherë dhe ta dëgjoj mirë.”

Përsëri e dëgjoi atë zë, i cili i përngjante zërit të njeriut.<sup>281</sup>

Pas kësaj tha: “O i zoti i zërit! U dëgjua zëri yt, nëse ke ndonjë ndihmë (mos e vono)!”<sup>282</sup> Më pas i hapi duart, duke iu lutur Allahut të Madhërishëm, dhe tha:

“O Zoti im, (me anë të krijesave të Tua që nuk shihen) më mundësove të dëgjoj zërin. Më ndihmo tani! Nëse nuk do na ndihmoni, atëherë unë dhe fëmija im do të vdesim.”<sup>283</sup>

Në atë moment iu shfaq një melek nga ana ku ndodhej Ismaili [alejhis-selam].<sup>284</sup>

Haxherja e pyeti atë: “Kush jeni ju?”

Meleku tha: “Unë jam Xhebraili. Po ju kush jeni dhe çfarë kërkon këtu?”

Haxherja iu përgjigj: “Unë jam gruaja e Ibrahimit [alejhis-selam] që më ka lënë këtu dhe ai atje është fëmija im.”

Xhebraili e pyeti: “Në dorë të kujt ju la profeti Ibrahim?”

Haxherja iu përgjigj: “Na la në dorë të Allahut të Madhërishëm.”

<sup>280</sup> *El-Kâmil Fi't-Târih, Ibnu'l-Ethir*, v.1, f.97.

<sup>281</sup> *Târih-i Taberi*, 1/130; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/222.

<sup>282</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f.222.

<sup>283</sup> *Târih-i Taberi*, 1/131; *Ibnu'l-Ethir*, 1/99.

<sup>284</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.46; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/222.

Xhebraili tha: “Ai ju paska lënë ju në dorën e Allahut, i Cili është më Bujari, Fisniku dhe Fuqiploti.”<sup>285</sup>

Haxherja iu lut Allahut të Madhërishëm: “E shikoni gjendjen tonë dhe e dëgjuat zërin tim. Më ndihmo mua. Në të kundërt, do të vdesim nga etja, unë dhe fëmija im (amaneti i profetit Ibrahim).”<sup>286</sup>

Më pas Xhebraili përpara dhe Haxherja pas tij shkuan afër vendit ku gjendej Ismaili që ishte mbi rërën e nxehtë.<sup>287</sup>

Kur Xhebraili [alejhis-selam] preku me majën e pendës apo me thembrën e këmbës në vendin ku gjendet sot uji i zemzemit, uji shpërtheu menjëherë.<sup>288</sup>

Uji i zemzemit shpërtheu si pasojë e besimit të pastër, mundimit dhe tevekulit të plotë që Haxherja kishte në Allahun, Krijuesin e gjithësisë, dhe kështu është dhuruar mëshirë dhe begati më parë për Haxheren dhe më pas për të gjithë njerëzit.

Haxherja kur e mori vesh se ishte urdhri i Allahut të Madhërishëm për t’u braktisur në Meke, fjala e saj ishte me plotë besim dhe tevekul në Allahun, Krijuesin e gjithësisë, dhe tha: “Na mjafton Allahu i Madhërishëm dhe na mbron.”

Ngjarja e Haxheres ishte një ngjarje “besimi – shpirtërore”. Ajo i besonte dhe i bënte tevekul Allahut të Madhërishëm aq shumë saqë nuk tregoi asnjë kundërshtim qoftë edhe të vogël, sepse e dinte se Allahu i Madhërishëm nuk do ta linte pa risk. Por për realizimin e kësaj mrekullie kaq të

<sup>285</sup> *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, v.1, f.178-179

<sup>286</sup> *El-Kâmil Fi’t-Târih, Ibnu’l-Ethir*, v.1, f.99.

<sup>287</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.46.

<sup>288</sup> *Ibnu’l-Ethir*, 1/99; *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/222.

madhe më parë ajo duhej të kalonte (që e kaloi) me sukses sprovën e madhe.

Kurrë nuk duhet të harrojmë se Allahu i Madhërishëm herët apo vonë në atë apo këtë mënyrë gjithmonë i ka ndihmuar dhe udhëzuar njerëzit që e kanë flijuar jetën e tyre në rrugën e Tij. Dhe ky realitet do të vazhdojë derisa të ekzistojë (deri në Ditën e Fundit të kësaj bote) Islami.<sup>289</sup> Allahu i Madhërishëm i ka ndihmuar muslimanët prej njeriut dhe profetit të parë, Ademit [alejhis-selam], dhe do t'i ndihmojë deri në Ditën e Fundit të kësaj bote.

**“...Allahu e furnizon kë të dojë, pa kufi”** (Ali Imran: 37)  
Këtë furnizim herë pas here e shohim në forma dhe mënyra të ndryshme sikur mund të përmendim disa prej tyre: dhënie profetësie, dije, urtësi, pasuri, durim, poste shtetërore, fuqi, trimëri etj. Por nganjëherë këto mund t'i shohim të dhëna të gjitha vetëm tek një njeri i zgjedhur.

Që të gjitha këto janë kredi të dhëna atyre që i janë përkushtuar rrugës së Allahut të Madhërishëm. Mund të përfitojnë furnizim pa kufi ata që më parë derdhin djersën e ballit, djersën e mendjes dhe të zemrës.

Allahu i Madhërishëm ia ka dhënë furnizimin Haxheres menjëherë pasi ajo e kaloi sprovën me sukses. Ky ishte një furnizim tepër i madh prej të cilit janë furnizuar dhe do të furnizohen edhe të tjerë deri në Ditën e Fundit.

Zemzemi iu dhurua si pasojë e djersës së ballit, djersës së mendjes dhe djersës së zemrës. Zemzemi simbolizon fillimin dhe Sa’j mbarimin. Sa’j është puna, ndërsa zemzemi është nderim dhe shpërblim. Sa’j është bota, ndërsa zemzemi

<sup>289</sup> *Adayış Risâlesi*, Mustafa İSLAMOĞLU, f.111-12.



ahireti. Sa’j është puna – vepra e sinqertë, ndërsa zemzemi është Xhenet.

Ky ishte një nderim dhe shpërblim i madh nga Allahu i Madhërishëm dhe kjo mrekulli mësimdhënëse do të vazhdojë deri në Ditën e Fundit.<sup>290</sup>

Haxherja menjëherë filloi të bëjë pellg uji dhe pasi e mbushi me ujë calikun tha: “zem... zem” – “Ndalo... ndalo”.<sup>291</sup>

Ka thënë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “*Allahu e mëshiroftë nënën e Ismailit. Sikur të mos e ndalonte Zemzemin* (nëse nuk do të bënte pellg duke e rrethuar me rërë), *atëherë do të bëhej përrua uji që ecën.*”<sup>292</sup>

Ndërsa në Bibël tek Dhiata e Vjetër kjo ngjarje kalon në këtë mënyrë: “*Dhe Abrahami e quajti këtë vend Jehovah Jireh. Prandaj edhe sot e kësaj dite thuhet: “Do të furnizohet mali i Zotit.”* Engjëlli i Zotit e thirri për të dytën herë Abrahamin nga qielli dhe tha:

*“Unë betohem për veten time, thotë Zoti, se ti e bërë këtë dhe nuk kurseve tët bir, të vetmin bir që ke, unë me siguri do të të bekoj fort dhe do të shumoj pasardhësit e tu si yjet e qiellit dhe si rëra që ndodhet në brigjet e detit dhe trashëgimtarët e tu do të zotërojnë portat e armiqve të tyre. Dhe tërë kombet e tokës do të bekoohen te pasardhësit e tu, sepse ti iu binde zërit tim.”* Pastaj Abrahami u kthye te shërbëtorët e tij, ata u ngritën dhe shkuan bashkë në Beer-Sheba. Dhe Abrahami zuri vend në Beer-Sheba. Mbas

<sup>290</sup> *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/222; *Kutubi Sitte*, 14/4992.

<sup>291</sup> *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/222; *Târih-i Taberi*, 1/165

<sup>292</sup> Buhâri, *Enbîjâ*, 9; *Musned - Ahmed bin Hanbel*, 1/347; *Ibnu’l-Ethir*, 1/98; *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/222; *Târih-i Taberi*, 1/165.

*këtyre gjërave i thanë Abrahamit këtë: “Ja, Milkah i ka lindur edhe ajo bij Nahorit, vëllait tend.”<sup>293</sup>*

## SHKRETËTIRA DHE ZEMZEMI

Meleku i tha Haxheres: “Mos kini frikë se do të zhdukeni, sepse këtu do të ndërtohet një Bejt (shtëpi) i Allahut të Madhërishëm.” Dhe ia tregoi vendin e saj.<sup>294</sup>

Vendi i saj ishte në një vend të ngritur, në një kodrinë të dukshme dhe me dhe të kuq.

Meleku i tha asaj: “Kjo është shtëpia e parë për njerëzit. Ajo është Bejtu’l-Atik (Shtëpia e Vjetër). Djeni se atë do e ndërtojë Ibrahim i [alejhis-selam] me djalin e tij, Ismailin [alejhis-selam], për të gjithë njerëzit dhe do të respektohet rregullisht deri në Kiamet.<sup>295</sup> Allahu i Madhërishëm nuk e humb punëtorin e kësaj pune.<sup>296</sup>

Zemzemi është burim jetese që rrjedh ndërmjet gurëve dhe, tashmë, është simboli i shpërblimit të pafund të besimit, besnikërisë dhe mundimit të Haxheres. Zemra e Haxheres, tashmë, ishte qetësuar dhe besimi ishte forcuar akoma edhe më shumë, sepse tevekuli dhe mundimi i saj nuk ngeli pa rezultat. Uji shpërtheu pa masë në mesin e shkretëtirës.

Shkretëtira dhe uji, shkretëtira simbolizonte “jetesën”, ndërsa uji “besimin”. Besimi e bëri që të ishte e vendosur me shpresë dhe me mundim. Jeta është sa një shkretëtitë e

<sup>293</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla 22: 14-20.*

<sup>294</sup> Buhâri, *Ehâdîthu’l-Enbijâ*, 9 (1414); *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/222.

<sup>295</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.46; *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/222.

<sup>296</sup> Buhâri, *Ehâdîthu’l-Enbijâ*, 9 (1414); *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/222.

pamëshirshme me parime të ashpra, ndërsa besimi është i rëndësishëm sa uji, shpresueshëm dhe nevojtar në këtë botë kalimtare të vështirë. E kush mund të ishte ujitja për një zemër të përvëlur në mesin e shkretëtirës përveç besimit të pastër dhe tevekulit në Allahun e Madhërishëm?

Haxherja i jepte ujë birit të saj dhe e falënderonte Allahun e Madhërishëm për begatinë e ujit (i cili ka veçorinë e largimit të etjes dhe të urisë) zemzem që është uji më i mirë në botë e që Allahu i Madhërishëm këtë begati ia mundësoi me anë të melekut Xhebrail.

Përmbajtja e ujit zemzem. Lënda tretëse e kripës është 1620 mgr në një milion, klorur 234 mgr në një milion, karbonat 363 mgr në një milion, squfur 190 mgr në një milion, nitrat dhe sulfat nuk përmban.<sup>297</sup>

Në lidhje me ujin e zemzemit profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Uji i zemzemit është uji më i mirë i ujërave të botës. Ka veçori ushqyese dhe është shërues për sëmundjen.”*<sup>298</sup>

Ndërsa në një hadith tjetër ka thënë: *“Uji i zemzemit bën mirë për atë gjë që pihet.”*<sup>299</sup> *Allahu i Madhërishëm të dhuron shërim nëse e pi atë ujë me qëllim që Allahu i Madhërishëm të dhurojë shërim. Allahu i Madhërishëm të ngop me të nëse e pi me qëllim që Allahu i Madhërishëm të të ngopë. Por, nëse e pi për të hequr etjen, atëherë ai ta heq atë., sepse ai është uji i begatshëm me të cilin Allahu i*

<sup>297</sup> *Alternatif Tıp*, Mustafa ÖZER, f. 308.

<sup>298</sup> *Et-Tergib ve't-Terhib*, Hafiz Mundhirî, v.2, f.209.

<sup>299</sup> Ibn Mâxhe, *Menâsik*, 78.

*Madhërishëm e furnizoi Ismailin [alejhis-selam] kur Xhebraili [alejhis-selam] e goditi tokën me këmbë.*<sup>300</sup>

Ebu Dherri [radijallahu anhu] tregon një kujtim të tij në lidhje me zemzemin: “Qëndrova në Meke rreth 30 ditë e 30 net. Nuk kisha asgjë për të pirë dhe për të ngrënë përveç ujit të zemzemit. Pavarësisht kësaj gjendjeje unë u shëndosha. M’u shëndosh barku dhe nuk ndjeva uri.”<sup>301</sup>

Tek uji i zemzemit gjendet bereqeti i Ibrahimit [alejhis-selam], mundimi i Haxheres dhe Sa’ji, lotët dhe britmat e Ismailit [alejhis-selam], si dhe lutja e profetit Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Kështu që nëna jonë, Haxherja, bashkë me birin e saj të vogël, Ismailin [alejhis-selam], në mesin e rërës dhe shkretëtirës përvëluese filluan të ushqehen me ujin e zemzemit që i dhuroi Allahu si pasojë e tevekulit dhe besimit të pastër.

Haxherja me jetesën e saj na ka treguar edhe ne nevojën, forcën dhe kuptimin e vërtetë të tevekulit në Allahun e Madhërishëm. Haxherja, pavarësisht shpresës, tevekulit dhe besimit të pastër që mbante në thellësinë e zemrës së saj përsëri ajo nuk priti në vendin ku e la Ibrahimimi [alejhis-selam] vetëm ndihmë nga Allahu i Madhërishëm, por nga një anë lutej dhe nga ana tjetër kërkonte për të gjetur ujë apo ndonjë ndihmë. Shembulli i tevekulit të Haxheres është shembulli që kërkon Allahu i Madhërishëm nga besimtarët.

<sup>300</sup> *Ahkâm ’il-Kur’ân*, Imam Kurtûbî, v.9, f.561.

<sup>301</sup> Muslim, *Fedâilu’s-Sahabe*, 132.

## PAVDEKSHMËRIA E HAXHERES GJATË RITEVE TË HAXHIT

Kur e vizitoi Ibrahim [alejhish-selam] Haxheren në Meke, dëgjoi hollësisht përpjekjet dhe mundimet e saj që bëri ndërmjet kodrave Safa dhe Merve si dhe Sa'jin për të gjetur ujë dhe ndihmë.

Ibrahimi [alejhish-selam] iu lut Allahut që mundimi i Haxheres, që bëri për të gjetur ujë në kodrat Safa dhe Merve, të përkujtohet prej haxhilerëve dhe kështu u bë vaxhib Sa'ji për ata që duan ta vizitojnë Qaben.<sup>302</sup>

Allahu i Madhërishëm në lidhje me këtë në Kur'an'in Famëlartë ka thënë: ***“Kodrinat Safa dhe Merva (në Mekë) janë pjesë e simboleve të Allahut, prandaj ai që viziton Qaben për haxh ose për umre, s’ka kurrfarë gjynahu nëse sillet mes tyre.”*** (El-Bekare: 158)

Ndërsa Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në lidhje me këtë ka thënë: ***“Njerëzit bëjnë sa’j (sillen) mes (kodrinave) Safa dhe Merve, sepse Haxherja ka shkuar dhe ka ardhur shtatë herë mes tyre.”***<sup>303</sup>

Të gjithë besimtarët që do e vizitojnë Kaben, qoftë për Haxh apo për Umre, do të shkojnë dhe do të vijnë shtatë herë mes kodrave Safa dhe Merve si Haxherja. Edhe haxhilerët do të vrapojnë në luginën që Haxherja vrapoi (në mes dy shtyllave jeshile). Besimtarët do të kërkojnë falje dhe mëshirë nga Allahu i Madhërishëm duke bërë sa’j në vendin në të cilin Haxherja kërkoi ujë duke vrapuar mes kodrave.

<sup>302</sup> Hz. Muhamed'in Hayati, Martin LINGS, f.12.

<sup>303</sup> Buhâri, v.4, f.114; Ahbaru Meke, Ezraki, 1/55; Delâilu'n-Nubuvve, Beyhâkî, 1/323; Ibnu'l-Ethir, 1/103; El-Bidâje ve'n-Nihâje, Ebü'l-Fida, 1/155; Ahkâmi'l-Kur'ân, 9/369.

Vrapimi i Haxheres për të gjetur ujë ishte sipas nevojës që ndiente ajo për të, edhe besimtarët që shkojnë për Haxh dhe Umre vrapojnë në të njëjtin vend me bindjen se sa nevojë ndiejnë për falje dhe mëshirë nga Allahu i Madhëri-shëm. Në fund të mundimeve Haxherja me Ismailin u përgëzuan me ujin e zemzemit, insha'Allah, po ashtu, do të përgëzohen me falje dhe mëshirë edhe besimtarët e Haxhit dhe të Umres në fundin e tyre. Allahu i Madhëri-shëm bëri që emri i Haxheres të përkujtohet deri në Ditën e Fundit të kësaj bote si pasojë e besimit të sigurtë dhe tevekulit të plotë. Gjithashtu, të gjithë besimtarët sa herë që pijnë ujin e zemzemit e përkujtojnë duke iu lutur Allahut të Madhëri-shëm për falje, mëshirë dhe ngritjen e vendit të tyre në Xhenet të Haxheres dhe Ismailit [alejhis-selam], të cilët u bënë shkak për ujin më të mirë në botë.

Haxherja ishte një grua që na mësoi nevojën e harmonisë mes mendjes dhe zemrës, mes idealeve me realitetin, mes mundimit me dorëzimin, mes lutjes me veprën, mes shpirtit me trupin si dhe harmoninë mes kësaj botës me botën e ardhshme. Kjo grua ishte një nënë, një prijëse, një lidere dhe një ndriçuese, por për dikënd tjetër që mundohet të shikojë të gjitha këto me syrin e helmuar dhe për ta nënçmuar, ajo ishte vetëm një shërbëto e ezmere nga Etiopia/Abisinia. Sigurisht që ne nuk kemi punë me mendime të tilla, sepse ajo për ne nuk është tjetër vetëm se simbol i nënshtrimit, përuljes, besimtare, e besueshme dhe me mundimin e saj shpresuese me tevekulin e plotë në Allahun e Madhëri-shëm.

## HAXHERJA PËRZGJIDHET PËR MËSIMIN/PËRGATITJEN E ISMAILIT

Ajo që ishte detyrë e Zekerijjas [alejhis-selam] ndaj Merjemes, ishte edhe e Haxheres ndaj Ismailit [alejhis-selam]. Detyra e tyre ishte kopshtar; për të mbjellë fidane dhe më pas për t'i përgatitur duke i ujitur me qëllim që të rriten sa më të shëndoshë dhe të japin fruta për brezat e ardhshëm.

Fëmija gjithmonë është si një lule në syrin e nënës së tij. Lulet janë delikate, të ndjeshme dhe kërkojnë një mirëmbajtje tepër të kujdesshme, sepse mund të vyshken dhe lëndohen, goftë edhe nga një pakujdesi.

Një lule kërkon ujë, kërkon dritën e diellit, pleh ushqyes, kërkon një vend të bukur, nuk duhet të harrojmë se çdo lule nuk bëhet në çdo vend, kërkon vend me klimë të përshtatshme, ku ajo do të jetojë. Lulet nuk bëhen në çdo lloj toke, ato kërkojnë tokë të përshtatshme për t'u mbjellë. Lulet kërkojnë kujdes të vazhdueshëm ditor dhe ato do të vyshken nëse nuk kujdeset dikush për to.”<sup>304</sup>

Së pari, duhet të ketë një bahçevan/lulishtar garant të rregullt që të marrë përsipër rritjen e shëndoshë, të kujdeset dhe ta ruajë nga çdo rrezik i brendshëm dhe i jashtëm.

Familja, rrënjët dhe fara e kësaj luleje ishin me prejar-dhje profetike, madje nga familja e profetëve më të përzgjedhur. Babai i tij ishte Halilullah, Ibrahim [alejhis-selam], prej profetëve të Allahut të Madhërishëm, Ulu'l-Azm, ndërsa nëna e tij ishte një mysafire e nderuar tek shtëpia e

---

<sup>304</sup> Adem Karatash, *Pishtarja e ndershmërisë Merjemja, sipas Biblës dhe Kur'anit Famëllartë*, Edit. Përth: Mr. Ilir RRUGA, yay. Progresi botime, Shkup – 2011, s, 44.

Allahut të Madhërishëm. Dheu i kësaj luleje ishte familja e Ibrahimit [alejhis-selam] e përzgjedhur nga Allahu i Madhërishëm; vendi “Bejtullah”, shtëpia e Allahut të Madhërishëm; dielli ishte dashuria e lindur bashkë me të, ndërsa pastërtia dhe adhurimi ishin plehu dhe uji i tij, kurse Haxherja ishte lulishtarja e mbikëqyrjes së kësaj luleje.

Haxherja po e përgatiste birin e saj të vogël duke i mësuar sahifet, besimin e pastër dhe moralin e lartë të Ibrahimit [alejhis-selam]. Allahu i Madhërishëm e zgjodhi këtë nënë të bekuar për t’u kujdesur, mbrojtur nga rreziqet, dhe për ta përgatitur për të ardhmen Ismailin [alejhis-selam].

Është e pashmangshme përgatitja e shëndoshë e filizave të rinj për një shoqëri, të ardhme të re dhe të shëndoshë. Një njeri i ri është ai që zotëron vetëdijen si dhe njeh e është i kujdesshëm përballë Krijuesit të tij, Allahut të Madhërishëm, dhe çdo gjallese tjetër.

## VENDOSJA E XHURHUMËVE PËRRETH UJIT ZEMZEM

Haxherja dhe biri i saj jetonin pranë ujit të zemzemit. Një ditë erdhi një grup shoqëror prej xhurhumëve të Jemenit.<sup>305</sup>

Xhurhum ishte emri i njërit prej stërgjyshërve të një fisit të madh në Jemen. Ishte djali i Kahtan Ibn Amir, ndërsa Katurani ishte i vëllai. Ishin me prejardhje nga bijtë e

---

<sup>305</sup> *Hadislerle Kur’ân-ı Kerim Tefsiri*, 2/554; *Kutubi Sitte*, 14/4992; *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/222; *Târih-i Taberi*, 1/165.



Nuhut.<sup>306</sup> Këta erdhën me karvan dhe u vendosën në pjesën e poshtme të Mekës me anë të rrugës Keda.<sup>307</sup>

Xhurhumët panë një zog duke fluturuar përreth dhe thanë: “Pa dyshim zogu qëndron afër ujit, por ne e dimë se në këtë luginë nuk ka pasur ujë!” Më pas dërguan dy vetë për të kontrolluar vendin.<sup>308</sup>

Kur mbërritën ata dy panë se pranë ujit qëndronte një nënë me birin e saj. Më pas u kthyen tek shokët e tyre dhe i treguan çfarë kishin parë. Më pas edhe ata erdhën tek lugina e Mekës.<sup>309</sup>

I dhanë selam Haxheres dhe birit të saj.

Edhe ajo ia ktheu selamin/përshendetjen.

Xhurhumët pyetën: “Grua e kujt jeni dhe çfarë bëni këtu në këtë vend të vetmuar? I kujt është ky djalë dhe ku doli ky ujë këtu, sepse ne e njohim këtë vend dhe më parë s’ka pasur ujë? Ne, pavarësisht se kemi kaluar me dhjetëra herë, përsëri nuk kemi parë ujë këtu. I kujt është ky ujë?”

Haxherja iu përgjigj: “Unë jam një rob i Allahut dhe ky djalë është biri im. Këtë ujë ma dhuroi mua Allahu Fuqiplotë. Kështu që uji është i imi.”<sup>310</sup>

Xhurhumët e panë nënën e Ismailit, e cila ishte e sinqertë dhe grua besimtare tepër e mirë.<sup>311</sup>

<sup>306</sup> *Texhrid-i Sarih Terxhemesi* ve Şerhi, v.9, f.123.

<sup>307</sup> *Hadislerle Kur’an-ı Kerim Tefsiri*, 2/554; *Kutubi Sitte*, 14/4992; *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/222; *Târih-i Taberi*, 1/165.

<sup>308</sup> Buhâri, *Ehâdîthu’l-Enbijâ*, 9 (1414); *Ibnu’l-Ethir*, 1/98; *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/222; *Târih-i Taberi*, 1/165; *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.47; *Tibyan Tefsiri*, 2/394.

<sup>309</sup> *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/222; *Târih-i Taberi*, 1/165; Buhâri, *Ehâdîthu’l-Enbijâ*, 9 (1414); *Kutubi Sitte*, 14/4992.

<sup>310</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f. 165.

<sup>311</sup> *Târih Boyunca Tevhid Mücadelesi*, Mevdudi, v.2, f. 44.

Xhurhumët kur panë mirësjelljen e Haxheres pyetën: “A na lejon që edhe ne të banojmë afër kësaj lugine. Kështu që edhe ju do të shpëtoni nga të qenit e vetmuar?”<sup>312</sup>

Resulullahu [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në një hadith ka thënë: “*Haxherja e donte urtësinë/mirësjelljen. Për këtë arsye i lejoi që edhe ata të banojnë përreth ujit.*”<sup>313</sup>

Haxherja tha: “E pranoj ofertën/propozimin tuaj.<sup>314</sup> Mund të merrni ujë vetëm me kusht që të mos kërkonin pronësinë e tij.”<sup>315</sup>

Ka thënë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “*Ajo (Haxherja) ndihej mirë të kishte bashkudhëtarë pranë saj.*”<sup>316</sup> Një ofertë e tillë ishte e arsyeshme për nënën e Ismailit përballë vetmisë.

Xhurhumët thanë: “Po, me kusht që ne nuk do kërkojmë të drejtë pronësie të zemzemit”<sup>317</sup> dhe me këtë kusht ata filluan të banonin në Meke.<sup>318</sup>

Ka thënë Hattabi [rahimehullahu alejhi]: “Dikush është pronari i pusit të ujit nëse e hap dhe nxjerr ujë, edhe nëse është në një vend shkretëtirë që nuk është pronë e askujt. Të tjerët nuk mund të bëhen ortakë të këtij ujit, por mund të përfitojnë me kënaqësinë dhe lirinë e atij që e ka gjetur ose e ka hapur atë. Por edhe pronari i ujit nuk mund

<sup>312</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/222; *Ibnu'l-Ethir*, 1/98; *Târih-i Taberi*, 1/165.

<sup>313</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.47.

<sup>314</sup> *Ibnu'l Esir*, 1/98; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/222; *Târih-i Taberi*, 1/165.

<sup>315</sup> *Buhâri*, *Ehâdîthu'l-Enbijâ*, 9 (1414); *Kutubi Sitte*, 14/4992; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/222.

<sup>316</sup> *Buhâri*, *Ehâdîthu'l-Enbijâ*, 9 (1414); *Kutubi Sitte*, 14/4992; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/222.

<sup>317</sup> *Buhâri*, *Ehâdîthu'l-Enbijâ*, 9 (1414).

<sup>318</sup> *Buhâri*, *Ehâdîthu'l-Enbijâ*, 9 (1414); *Kutubi Sitte*, 14/4992; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/222; *Mukaddime*, *Ibn Haldun*, 2/475.

t'i ndalojë njerëzit e tjerë të përfitojnë nga uji përveç sasisë që kanë nevojë për vete. Marrja e lejes nuk është kusht për shumicën tjetër të ujit që nuk ka nevojë pronari i tij.<sup>319</sup> Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në një hadith ka thënë: *“Muslimanët janë ortakë në tri gjëra: në ujë, në bar dhe në zjarr.”*<sup>320</sup>

Më pas xhurhumët i treguan edhe popullsisë tjetër, kështu që ata erdhën dhe u vendosën aty<sup>321</sup> dhe kështu me kalimin e kohës u shtuan.<sup>322</sup>

Një vit u thanë të gjitha pusët përveç një pusi që e posëdonte një hebre, të cilin e bleu Osmani [radijallahu anhu] me një çmim shumë të shtrenjtë dhe e bëri sadaka për muslimanët. Siç e shohim bëhet fjalë për një vit me një thatësi tepër të madhe, për këtë arsye Osmani [radijallahu anhu], pavarësisht çmimit tepër të shtrenjtë që ia shiti hebreu, përsëri e bleu këtë pus dhe më pas e hapi pasi dëgjoji këtë hadith: *“Kush e hap pusin e Rumes, atij i takon Xheneti.”*<sup>323</sup>

Uji është jetë në shkretëtirë. Nëse ka në një vend ujë, përreth tij ka jetesë. Aty ku ka jetesë ka edhe qytetërim.

E kanë pyetur Resulullahun [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “O i Dërguari i Allahut, cila është ajo lëmoshë që pëlqeni më shumë?”

I Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] është përgjigjur: *“Uji!”*<sup>324</sup>

<sup>319</sup> *Texhrid-i Sarih Terxhemesi* ve Şerhi, v.7, f. 232.

<sup>320</sup> *Kutubi Sitte*, Prof. Dr. İbrahim CANAN, v.3, f.47.

<sup>321</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/222; *Mukaddime*, Ibn Haldun, 2/475; Buhâri, *Ehâdîthu'l-Enbiyâ*, 9 (1414); *Kutubi Sitte*, 14/4992.

<sup>322</sup> Buhâri, *Ehâdîthu'l-Enbiyâ*, 9 (1414); *Kutubi Sitte*, 14/4992; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, v.1, f. 222.

<sup>323</sup> Buhâri, *Vasâjâ*, 33 (1201).

<sup>324</sup> Ebu Davud, *Zekat*, 41 (1679).

Nuk ka asnjë njeri tjetër që ta dijë rëndësinë dhe vlerën e ujit në shkretëtirë më mirë se sa bedevitë që merreshin me blegtori. Uji është gjëja më e çmuar për ata dhe blegtoritë e tyre për të mbijetuar në vendet e thata. Për këtë arsye, bedevitë i dinë të gjitha oazet e ujit nëpër shkretëtirat e Arabisë.

Këto ishin nga kushtet kryesore me të cilat filloi rregullimi i Mekës. Ky ishte një vend tepër i rëndësishëm për një vendpushimi të karvanëve, sepse ky vend është në mes veriut dhe jugut të Gadishullit Arabik. Ky vend preferohej për pushime të shkurtra apo të gjata nga karvanët dhe bedevitë. Kështu që uji i zemzemit ishte shkaku kryesor i vendbanimit dhe të ardhurave të banorëve të Mekës.

Qyteti i Mekës u zgjerua aq shumë sa që ndërtesat u afruan deri tek uji i zemzemit. Edhe fiset që banonin në periferi filluan të shpërngulen në Mekë për t'u njohur me familjen e lumtur që u bë shkak i këtij ujit të bekuar dhe për ujin e zemzemit.<sup>325</sup>

Ka thënë Resûlullahu [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: *“Allahu kur e do robin e Tij thërret Xhebrailin dhe i thotë: “Vërtet Unë e dua robin Tim, prandaj duaje edhe ti!”, atëherë e do atë Xhebraili; pastaj thërret në banorët e qiellit dhe thotë: “Vërtet Allahu e do filanin, prandaj duajeni atë!”. Atëherë e duan banorët e qiellit, pastaj ai bëhet i pranueshëm edhe në tokë. Ndërsa kur Allahu e urren robin e Tij e thërret Xhebrailin dhe i thotë: “Vërtet Unë e urrej filanin, prandaj urreje edhe ti!”, atëherë Xhebraili e urren; pastaj thërret ndër banorët e qiellit: “Vërtet Allahu e urren filanin, prandaj urrejeni*

---

<sup>325</sup> *Doğuştan Günümüze Büyük İslâm Târîhi*, v.1, f.128.

*atë!”, atëherë atë e urrejnë banorët e qiellit dhe si rrjedhojë e urrejnë njerëzit në tokë.”<sup>326</sup>*

Edhe Haxherja ishte njëra prej atyre besimtareve të rralla, e cila e fitoi dashurinë e banorëve të qiellit dhe të tokës me anë të besimit të pastër dhe të tevekulit të plotë në Allahun e Madhërishëm.

Në lidhje me këtë ka thënë Ebu’d-Derda [radijallahu anhu] në letrën që i ka shkruar Mesneme bin Muhalle: “Allahu i Madhërishëm e do robin e Tij kur ai përulet dhe punon për hir të Tij. Allahu i Madhërishëm e mundëson që ta duan edhe njerëzit e tjerë atë njeri që Allahu i Madhërishëm e do. Dhe i mundëson që ta urrejë populli atë person që Allahu i Madhërishëm nuk e do për arsye të kryengritjes/kundërshtimit të tij.”<sup>327</sup>

Qëllimi i vetëm i Haxheres ishte të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe të përulet përpara urdhrit të Tij.

Haxherja ka treguar gjithmonë një vëmendje dhe një vullnet të madh të vazhdueshëm përballë pengesave të nefsit dhe shejtanit, të cilët mundoheshin ta pengonin në përuljen dhe adhurimin e Allahut të Madhërishëm. Për këtë shkak, Allahu i Madhërishëm e ka ndihmuar dhe i ka mundësuar Haxheres gjithmonë triumfin përballë armiqve të saj në rrugën e drejtë. Allahu i Madhërishëm nuk e la pa ndihmë në mesin e shkretëtirës këtë besimtare të lartë. Gjithashtu, i mundësoi fitimin e respektit si dhe të dashurisë së njerëzve të tjerë.

<sup>326</sup> Buhâri, *Edeb*, 41; *Bed’ul-Hak*, 6.

<sup>327</sup> *Metâlib ul-Âlije*, Ibn Hâxher el-Askalâni, 4/3165.

Ka thënë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: *“Kjo gjendje e gëzoi nënën e Ismailit, sepse Ajo e pëlqente kallaballëkun.”*<sup>328</sup>

Sigurisht që xhurhumët silleshin tepër mirë me Haxheren sikur të ishte nëna ose motra e tyre me anë të ndjenjave që Allahu i Madhërishëm kishte futur në zemrat e tyre, kështu që Allahu i Madhërishëm e futi në mbrojtje Haxheren dhe Ismailin e vogël.

Ibrahimi [alejhis-selam] nuk i ndërpreu tërësisht lidhjet me Haxheren dhe Ismailin [alejhis-selam] pasi i la në shkretëtirën e Mekës. Në të kundërt, ai shkonte dhe i vizitonte herë pas here dhe kujdesej për shëndetin dhe nevojat e tjera që mund të kishin.<sup>329</sup>

Thotë Allahu i Madhërishëm në Kur’anin Famëlartë: *“Kujtoni kur Ne e bëmë Qabenë vendgrumbullimi dhe sigurie për njerëzit, duke thënë “Bëjeni vendin e Ibrahimit si vendfaljeje!” Ne i urdhëruam Ibrahimin dhe Ismailin: “Pastrojeni Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që e vizitojnë, që rrinë aty për adhurim dhe që falen duke u përkulur dhe përuhur.”* (El-Bekare: 125) Në këtë mënyrë filloi jetesa dhe vendbanimi në qytetin e Mekës. *“Kur Ibrahim i lut: “Zoti Im, bëje këtë vend qytet të sigurt dhe furnizoji me prodhime banorët e tij, ata që besojnë në Allahun dhe në jetën tjetër!” - Allahu tha: “Atë që nuk beson, për pak kohë do ta bëj që të kënaqet e pastaj do ta hedh në dënimin e zjarrit.” Eh, sa vendbanim i keq që është ai.”* (El-Bekare: 126)

<sup>328</sup> Hadislerle Kur’ân-ı Kerim Tefsiri, Ibni Kethir, v.2, f.554.

<sup>329</sup> Târih-i Taberi, Muhamed Xherir, et-Taberi, v.1, f.166.

## **PJESA E GJASHTË**

**ALLAHU KËRKON PREJ IBRAHIMIT [alejhis-selam] TË FLIJOJË/ BËJË KURBAN BIRIN E TIJ, ISMAILIN [alejhis-selam]**





## HISTORIA E ADHURIMIT TË KURBANIT

Kurban është fjalë arabe e formuar prej germave K-R-B. Fjala “kurban” ka kuptimin: “të afrohesh afër Allahut të Madhërishëm, shpenzimi i pasurisë në rrugë të Allahut të Madhërishëm, përulje dhe falënderim i Allahut të Madhërishëm.”

Ndërsa nga ana terminologjike kurbanit është: “therja e një kafshe me qëllim të pastër kurbanit në një kohë dhe sipas rregullave të caktuara për të fituar pëlqimin e Allahut të Madhërishëm.”<sup>330</sup>

Kur’ani Famëllartë na tregon se historia e therjes së kurbanit është aq e vjetër sa historia e njerëzimit: *“Lexoju (o Muhamed) saktësisht ngjarjen e dy bijve të Ademit, kur ata bënë nga një kurban, njërit iu pranua, kurse tjetrit jo. Njëri i tha tjetrit: “Ty gjithsesi do të të vras.” Tjetri tha: “Allahu pranon vetëm prej të devotshmit.”* (El-Maide: 27) Ndërsa tek Buhariu në lidhje me këtë temë thuhet: “Mbajeni hajrin dhe mbrohuni nga sherri i tij.”<sup>331</sup>

Habili dhe Kabili ishin dy bijtë e Ademit [alejhisselam]. Sipas transmetimit, thuhet se Ademi [alejhisselam] i martonte bijtë e tij me njëri-tjetrin (djali dhe vajza që do të martohej nuk i përkisnin të njëjtës kohë – nuk ishin binjakë). Ngaqë ishte koha e parë e njerëzimit dhe nuk kishte mundësi tjetër, ishte e detyruar një martesë e tillë për t’u shtuar njerëzia. Kur u rritën dhe erdhën në moshën e martesës, Kabili

<sup>330</sup> *İbâdet İlmihâli*, Âdem KARATAŞ, f.541.

<sup>331</sup> Buhâri, *Tefsir*, 15.

nuk dëshiroi martesën e binjakes së tij me Habilin, sepse ajo ishte më e bukur sesa binjakja e Habilit.<sup>332</sup>

Kur e pa këtë kundërshtim Ademi [alejhis-selam] urdhëroi e tha: “Therni të dy nga një kurban për hir të Allahut dhe më pas këtë vajzë do e martoj me atë që do t’i pranohet kurban i nga ana e Allahut të Madhërishëm.”<sup>333</sup>

Habili kishte një kope delesh dhe vetë ishte çobani i tyre. Habili zgjodhi delen<sup>334</sup> apo sipas një mendimit tjetër devenë<sup>335</sup> më të mirë dhe e bëri kurban për hir të Allahut të Madhërishëm.<sup>336</sup>

Ndërsa Kabili ishte bujk.<sup>337</sup> Kabili zgjodhi bimën më të keqe, të prishur dhe pa zemër dhe ia ofroi Allahut të Madhërishëm për kurban.<sup>338</sup> Ndërsa Allahu i Madhërishëm na urdhëron: **“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.”** (Ali Imran: 92)

Në atë kohë, kur bëhej një kurban zbriste një flakë nga qielli dhe nëse do e digjte kurbanin, atëherë ai kurban quhej i pranuar. Por, nëse nuk zbriste flakë dhe nuk e digjte kurbanin, atëherë do të thoshte se ai kurban nuk është pranuar nga ana e Allahut të Madhërishëm.<sup>339</sup>

<sup>332</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f.238.

<sup>333</sup> *Kur'ân'da Peygamberler ve Peygamberimiz*, Abdulfettah Tabbara, f. 61; *Furkan Tefsiri*, Hicazi, Mahmud Hicazi, 2/48.

<sup>334</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.88.

<sup>335</sup> *H. İbrahim'le Buluşmak*, Ali SHERIATI, f.72.

<sup>336</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.88.

<sup>337</sup> *Tefsir-i Kebir*, Fahrudin er-Razi, v.9, f. 2.

<sup>338</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.88.

<sup>339</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.153.

Allahu i Madhërishëm e pranoi kurbanin e Habilit duke dërguar një zjarr që e dogji dhe e gëlltiti atë.<sup>340</sup> Në këtë mënyrë doli në dritë e drejta e Habilit dhe përsëri fitoi të drejtën e martesës me binjaken e Kabilit.<sup>341</sup>

Kabili, megjithëse e pa që ishte në gabim kur nuk iu pranua kurhani, përsëri nuk hoqi dorë prej kokëfortësisë dhe inatit të tij, duke i thënë vëllait të tij: *“...Ty gjithësi do të të vras...”* (El-Maide: 27)

Ndërsa Habili u përgjigj, duke thënë: *“...Allahu pranon vetëm prej të devotshmit. Nëse ti ngre dorë të më vrasësh mua, unë nuk do ta ngre dorën që të të vras, sepse, në të vërtetë, unë i frikësohem Allahut, Zotit të gjithësisë. Unë parapëlqej të marrësh barrën e gjynahut tim dhe të gjynahut tënd e kështu të bëhesh ndër banorët e zjarrit. Ky është ndeshkimi i keqbërësve.”* (El-Maide: 27-29)

Pavarësisht fjalëve të buta dhe këshillave të Habilit, përsëri sytë e Kabilit nuk shikonin gjë tjetër vetëm se gjakun e vëllait të tij që e vrau duke e goditur me gurë në kokë.<sup>342</sup> Këtë e shohim edhe në ajetin e Kur’anit: *“Vetja e tij e nxiti në vrasjen e të vëllait dhe e vrau. Kështu, ai u bë nga të humburit.”* (El-Maide: 30)

Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Nëse vritet dikush padrejtësisht, padiskutim që i shkruhet gjak/mëkat edhe birit të parë të Ademit, sepse ai e thirri britmën e vdekjes për herë të parë.”*<sup>343</sup>

<sup>340</sup> *Tabakat*, Ibni Sa’d, v.1, f.36.

<sup>341</sup> *El-Kâmil Fi’t-Târih*, Ibnu’l-Ethir, v.1, f.35.

<sup>342</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.88.

<sup>343</sup> Buhâri, *Dijet*, 2; *I’tisam*, 15; *Xhenaidh*, 33; Muslim, *Kasame*, 27; Tirmidhi, *Ilim*, 14; Nesâi, *Tahrim*, 1.

Adhurimi i therjes së kurbanit për hir të Allahut të Madhërishëm ka filluar me dy djemtë e Ademit [alejhis-selam] dhe ka vazhduar dhe do të vazhdojë deri në Ditën e Fundit të kësaj bote.

Arkeologët tregojnë se në shumë faza të historisë janë therur kurbane për të fituar kënaqësinë e objekteve që janë quajtur perëndi. Arkeologët kthehen deri tek periudha neolitike (vitet 10.000 p.e.r.) në praktikimin e kurbanëve.

Është një realitet që mongolët bënë kurbane nga njerëzit për shpirtat e të parëve të tyre. Gjithashtu, një praktikim të tillë e shohim edhe në traditën egjiptiane dhe greke. Zakonisht actekët e Amerikës i zgjidhnin kurbanet prej ushtarëve dhe fëmijëve. Edhe në Afrikën Perëndimore ka ekzistuar ngrënia e fëmijëve pasi i bënë kurban. Fenikasit besonin se ishin në vend të prindërve të tyre fëmijët e bërë kurban që kalonin nëpër zjarr. Bërja kurban e njerëzve ekzistonte edhe tek popujt e Samit. Kur i vdisnin mbretërit asirianëve, bënë kurban prej ushtarëve dhe shërbëtorëve të pallatit mbretëror duke besuar se ata do e shoqëronin atë në udhëtimin e vdekjes. Therja kurban e fëmijëve për perënditë ishte një zakon i përhapur edhe tek popujt perëndimorë të Semit. Për këtë arsye ata besonin se fëmija i parë i përkiste Perëndisë.<sup>344</sup>

Shkaku i bërjes kurban të fëmijës së parë në Dhiatën e Vjetër të Biblës tregohet në këtë mënyrë: “Sepse nuk vinin në jetë dekretet e mia, por i hidhnin poshtë statutet e mia, përdhosnin të shtunat e mia dhe sytë e tyre ishin drejtuar te idhujt e etërve të tyre. Prandaj u dhashë statute jo të mira dhe dekrete me të cilat nuk mund të jetonin; dhe i molepsa

<sup>344</sup> *İbrâhimi Okuyuş*, Ahmet Baydar, f. 52.

me vetë dhuratat e tyre, meqenëse ata kalonin nëpër zjarr çdo të parëlindur të tyre, për t'i katandisur në shkretim të plotë me qëllim që të pranonin që unë jam Zoti.”<sup>345</sup>

“Kanë ndërtuar vende të larta të Tofetit, që është në luginën e birit të Hinomit, për të djegur në zjarr bijtë dhe bijat e tyre, gjë që nuk e kisha urdhëruar dhe që nuk më kishte shkuar kurrë në mendje.”<sup>346</sup>

“Kushdo që çel barkun është imi; është imja çdo pjellë e parë mashkull të të gjithë bagëtisë sate, qoftë e trashë ose e imët. Do të shpengosh me një qengj pjellën e parë mashkull të gomarit; po të jetë se nuk do ta shpengosh, do t'i thyesh qafën. Do të shpengosh edhe çdo të parëlindur të bijve të tu. Asnjeri nuk do të paraqitet para meje duar bosh.”<sup>347</sup>

## IBRAHIMI [alejhis-selam] ZOTOHET SE DO TA BËJË KURBAN NËSE DO T'I LINDË NJË DJALË

Ibrahimi [alejhis-selam] ishte i moshuar dhe i vetëm. Në të njëjtën kohë ishte në kulmin e profetësisë së tij. Por ai vuante nga skamja e një birit të tij, i cili do të ishte pasardhës dhe do e vazhdonte në të ardhmen detyrën e tij. Kështu që ai dëshironte të kishte një pasardhës. I kishte kaluar të tetëdhjetat dhe gruaja e tij, Sara, nuk i kishte lindur më parë.

---

<sup>345</sup> *Dhiata e Vjetër*; Hezekil 20: 24-26.

<sup>346</sup> *Dhiata e Vjetër*; Yeremya 7:31.

<sup>347</sup> *Dhiata e Vjetër*; Eksodi 34: 19-20.

Pavarësisht dëshirës që kishte, por kushtet e shtynin për ta pranuar këtë realitet.

Ibrahimi [alejhis-selam] iu drejtua Allahut të Madhërishëm, Fuqiplotit, duke iu lutur:

**“O Zoti im, dhuromë një fëmijë prej të mirëve!”** (Es-Saffat: 100)

Ibrahimi [alejhis-selam] është nga pasardhësit e Samit. Populli në të cilin ai jetonte ishin të atillë që bënë kurban edhe fëmijët e tyre për idhujt që i kishin bërë prej balte, druri apo hekuri. Ai nuk dinte se si të bënte një vetëflijmim – vetëflijimin për Allahun, Zotin e Vërtetë. Nëse është një vetëflijmim bërja kurban e fëmijës, atëherë ky flijim nuk duhet të jetë për idhujt e krijuar nga dora e njeriut, por për Krijuesin dhe Merituesin e Vërtetë. Por, vallë, a ishte i drejtë një flijim i tillë për Allahun e Madhërishëm? I Cili nuk ka nevojë për asgjë, është i Plotfuqishëm. Vallë, a priste Allahu i Madhërishëm ndonjë flijim të tillë nga njeriu i dashur i Tij?

Ibrahimi [alejhis-selam], nga njëra anë, nuk kishte hasur ende me ndonjë përgjigje të plotë të pyetjeve të tij, por, nga ana tjetër, iu zotua Allahut të Madhërishëm në lutje, duke thënë: “O Krijuesi im! Nëse do të më dhurosh një djalë, unë atë do e flijoj<sup>348/</sup> bëj kurban për hir të dashurisë Tënde.”<sup>349</sup>

<sup>348</sup> Një zotim për flijim kurban i një personi për shkaqe të ndryshme, është një detyrë që Allahu i Madhërishëm nuk e ka ngarkuar më parë, por personi ia bën detyrim vetes së vet. Edhe ky lloj flijimi është adhurim, por dallimi me flijimin (kurbanin) tjetër që jemi të obliguar është se: kohën, vendin dhe kurbanin që do të flijojë e përcakton vetë besimtari sipas dëshirës së tij.

Por askush nuk mund të zotohet për të flijuar birin e tij, sepse është e ndaluar flijimi i njeriut. Por zotimi për flijim mund të jetë brenda normave të një kurbanit. (*Ahkâmi 'l-Kur'ân*, Imam-i Kurtûbî, v.14, f.536-37).

<sup>349</sup> *Târih-i Taberi*, 1/178 ; *Ibnu 'l-Ethir*, 1/111; *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, 14/536.

Ibrahimi [alejhis-selam] ishte në dinjitetin e plotë se: ***“Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!”*** (El-Bekare: 156) Ai e dinte se: ***“...do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim.”*** (Er-Rahman: 27) Ai e dinte se: ***“...në dorën e të Cilit është pushteti suprem dhe që është i Fuqishëm të bëjë çdo gjë”*** (El-Mulk: 1) Ai e dinte se: ***“Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë dhe tek Allahu do të kthehen të gjitha çështjet”*** (Ali Imran: 109) Ai e dinte se: ***“Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është Xhehenemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend!”*** (Ali Imran: 107) Ai e dinte se: ***“Ta dini se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë dhe se vetëm tek Allahu është shpërblimi i madh”*** (El-Enfal: 28) Ai e dinte se Krijuesi i Madhërishëm ka lajmëruar, duke thënë: ***“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.”*** (Et-Tahrim: 6) Sigurisht që kjo ishte një mençuri e Ibrahimit [alejhis-selam], duke ruajtur veten dhe pasardhësin e tij, duke u zotuar me flijimin e tij.

Allahu i Madhërishëm e pranoi lutjen e sinqertë të Ibrahimit [alejhis-selam] dhe këtë e shohim edhe në ajetin e Kur’anit, në të cilin thuhet: ***“Dhe Ne i dhamë lajmin e gëzuar për një djalë të mbarë!”*** (Es-Saffat: 101)

Ibrahimi [alejhis-selam] ishte i shtyrë në moshë dhe sipas kushteve normale ai nuk mund të kishte fëmijë pas kësaj moshe. Pavarësisht moshës, ai përsëri iu lut me një lutje të sinqertë dhe kishte një besim të plotë në fuqinë e Allahut të Madhërishëm. Allahu i Madhërishëm i dhuroi Ibrahimit [alejhis-selam] një pasardhës që ishte tepër i vështirë sipas kushteve normale. Siç ishte një dhuratë e ndryshme, po ashtu, edhe

falënderimi duhet të ishte i madh. Por Ibrahimit [alejhis-selam] atë falënderim të madh e zotoi pa u trembur deri në fillim duke ia zotuar më të çmuarin e tij më të Çmuarit të Vërtetë. I zotuari ishte biri i Ibrahimit [alejhis-selam] për të cilin kishte pritur me një dëshirë të madhe gjatë gjithë jetës së tij. Padyshim vlera, rëndësia dhe vendi i birit në zemrën dhe jetën e Ibrahimit [alejhis-selam] ishte i veçantë, sepse ai kishte pritur një jetë të tërë për t'u përgëzuar me një pasardhës të mirë.

Përballë këtij përgëzimi kaq të madh duhej një falënderim, një falënderim i mirë me vlerë të madhe. Pa dyshim ky falënderim dhe kurban i përket vetëm derës më të lartë dhe të vërtetë, derës së Krijuesit të gjithësisë, i Cili në Kur'anin Famëlartë thotë:

***“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thua-ju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.”*** (El-Bekare: 126)  
 Këtë e pamë edhe tek Ibrahimit [alejhis-selam] që, pasi bëri një lutje të tillë të sinqertë, Allahu i Madhërishëm në Kur'an thotë: ***“Dhe Ne i dhamë lajmin e gëzuar për një djalë të mbarë!”*** (Es-Saffat: 101)

## Ç'ËSHTE ËNDRRA?

Ëndrra është përjetimi i shikimit të pamjeve, dëgjimit të tingujve, apo dëgjimeve të tjera në gjumë.

Ëndrrat kanë të bëjnë shpesh me dëshirat e mundshme e të pamundshme për t'u ndërtuar në jetë dhe shpesh janë përtej mundësisë së kontrollit nga ëndërruesi. Ëndrra mund



të shkaktojë përvoja dhe ndijime të ndryshme të fuqishme, si kënaqësi, pikëllim, frikë (makthe) etj.

Kemi disa lloj ëndrrash. Njëra prej tyre është të përjetuarit e disa ngjarjeve lidhur me ngjarjet e ditës.

Një lloj tjetër i tyre është paralajmërimi apo përgëzimi nga grupi i melekëve, të cilëve Allahu i Madhërishëm i ka treguar disa nga gjendjet e njerëzve dhe i ka emëruar në Levhi Mahfudh.

Ndërsa lloji tjetër është ngacmimi dhe shqetësimi i shejtanit të mallkuar, që i shqetëson dhe ngacmon gjatë ditës duke i hedhur mendime, mashtrime, kurthe etj.

Shejtani mundohet ta mashtrojë dhe ta bëjë prej të injoruarve njeriun në ëndërr me anë të hileve, vesveseve apo kurtheve të tij.<sup>350</sup>

Kur’ani Famëlartë përdor dy fjalë të veçanta, “Hulm” dhe “Ru’ja”, për të përshkruar ëndrrën. “Hulm” ose shumësi i kësaj fjale është “ahlam”, që do të thotë: të shikosh në ëndërr të mirën dhe të keqen në një gjendje të përzier me njëra-tjetrën. “Hulm” është përdorur tre herë në Kur’an në kuptimin ëndërr dhe ndjenja – parafytyrime të ngatërruara nga njëra-tjetra. Një hadith në lidhje me këtë thotë: *“Ru’ja është nga Allahu, ndërsa Hulmi prej shejtanit.”*<sup>351</sup>

Ka thënë Profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sellem] në lidhje me ëndrrën: *“Ëndrra është tre llojëshe: kemi ëndërr hak (të vërtetë), kemi ëndërr me të cilën njeriu merret me atë dhe kemi ëndërr që shejtani jep shqetësim me të.”*<sup>352</sup>

<sup>350</sup> *Şamil İslâm Ansiklopedisi*, v.1, f. 64.

<sup>351</sup> Tirmidhi, *Ru’ja*, 4 (2277).

<sup>352</sup> Tirmidhi, *Ru’ja*, 1 (2270).

Dijetarët islamë e kanë komentuar hadithin në këtë mënyrë:

E para: kjo është një ëndërr e vërtetë mësimdhënëse, paralajmëruese etj., e cila vjen direkt nga Allahu i Madhëri-shëm ose me anë të melekut.

E dyta: nuk është gjë tjetër vetëm se një imagjinatë e kujtimeve të grumbulluara nga e kaluara.

E treta: pamje dhe ngacmim që vjen prej shejtanit. Ndikime të jashtme që nuk janë gjë tjetër vetëm se ëndrra të ngatërruara dhe mashtruese.<sup>353</sup>

Në Kur'anin Famëlartë ne shikojmë thënien e komentuesve të kohës së Jusufit [alejhis-selam] në këtë mënyrë: ***“Ata thanë: “Këto janë ëndrra të ngatërruara e ne nuk dimë t’i shpjegojmë.”*** (Jusuf: 44)

Ndërsa “Ru’ja” është ndryshe nga “Hulmi”. “Ru’ja” është në lidhje me një realitet dhe, për këtë arsye, merr kuptimin e shikimit e një të vërtete përtej imagjinatës.<sup>354</sup> “Ru’ja” është përmendur shtatë herë në Kur’an. Pesë prej tyre janë përdorur për të theksuar ëndrrat (“Sadika”) e Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], të cilat kanë lidhje me vahjin-shpalljen. Në të nuk ka imagjinatë apo infrastrukturë psikologjike. “Ru’ja” në Kur’an gjithmonë është përdorur në sadika (e vërtetë, e drejtë) në të kundërtën e kuptimit të “Hulmit”.<sup>355</sup>

Ëndrra që pa Ibrahimimi [alejhis-selam] komentohet se ishte një nga ëndrrat “Ru’ja” (të vërteta - të sakta), sepse nuk ishte e mundur që shejtani t’i afrohej me vesvese dhe mashtrime, ngase ai mbrohej shumë mirë prej tyre.

<sup>353</sup> *Hak Dini Kur’ân Dili*, Elmalılı Muhamed Hamdi Yazır, v.5, f. 49.

<sup>354</sup> *Hak Dini Kur’ân Dili*, Elmalılı Muhamed Hamdi YAZIR, v.5, f.47.

<sup>355</sup> *İbrâhimi Okuyuş*, Ahmed BAYDAR, f.56-57

Në lidhje me këtë temë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sellem] ka thënë: *“Ru’ja është njëra nga dyzet e gjashtë xhuzet (pjesët) e profetësisë.”*<sup>356</sup> Dhe: *“Ëndrrat e profetëve janë shpallje.”*<sup>357</sup>

*“Ata (profetët) janë të veçuar nga ëndrrat e shejtanit. Ëndrrat e tyre ishin me urdhër Hyjnor. Patjetër që duheshin vepruar.”*<sup>358</sup>

Ka thënë Muhamed bin Ka’b [radijallahu anhu]: *“Profetëve i kanë ardhur shpallje edhe kur kanë qenë zgjuar edhe kur kanë qenë në gjumë. Sepse, pavarësisht se sytë e profetëve flenë, zemrat e tyre nuk flenë.”*<sup>359</sup>

## ËNDRRA E IBRAHIMIT [alejhis-selam]

Ismaili nuk ishte thjesht vetëm biri i Ibrahimit [alejhis-selam], por, në të njëjtën kohë, ishte edhe një dhuratë, shpërblim i madh i babait, i cili duroi dhe vuajti shumë vështirësi deri në atë kohë. Ishte qenia e dashur në ditët e fundit të jetës së tij që iu dha një babai të shtyrë në moshë, i cili e kishte kaluar jetën e tij me plotë vështirësi, sprova dhe me rreziqe.

Ibrahimi [alejhis-selam] e kishte harruar fjalën e dhënë Allahut të Madhërishëm për flijimin e djalit të tij. Një natë në ëndërr iu tha: *“O Ibrahim! Sille në vendin e duhur premtimin e dhënë Allahut dhe flijoje kurbanin.”*<sup>360</sup>

<sup>356</sup> Muslim, *Ru’ja*, 6; Tirmidhi, *Ru’ja*, 1 (2271); *Tarih-i Taberi*, 1/180.

<sup>357</sup> *Hadislerle Kur’ân-ı Kerim Tefsiri*, 12/6813; *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/226.

<sup>358</sup> *Kur’ân-ı Kerim’e Göre Peygamberler ve Tevhid Mücadelesi*, İsmâil L. ÇAKAN – N. Mehmed SOLMAZ, f.82.

<sup>359</sup> *Safvetu’t-Tefâsir*, Muhamed Ali es-SABUNI, v.5, f.258.

<sup>360</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f. 178.

Ibrahimi nuk e kuptoi këtë ëndërr. Mos, vallë, Allahu i Madhërishëm kërkonte, tashmë, bërjen kurban të Ismailit [alejhis-selam], birit të vogël, të cilin e donte shumë? Vallë, kjo ëndërr ishte nga ëndërrat “evham”? Vallë, nëse do të ishte një urdhër i tillë, a nuk mund t’i vinte Xhebrail Emimi me vahj (shpallje) kur ai të ishte i zgjuar? Për këto ngurrime kësaj dite i është thënë “Dita Tevriye (tefekur – meditim, mendim).”<sup>361</sup>

Kur e kujtoi Ibrahimi [alejhis-selam] birin e tij të vogël, Ismailin, menjëherë iu ndez zjarri i Nemrudit, por këtë herë në thellësinë e zemrës së tij. Por ky zjarr ishte ndryshe nga zjarri i Nemrudit, sepse ky në vend se të ftohej për Ibrahimin halilullah, vazhdonte të shtohet akoma edhe më shumë.

Krijuesi i gjithësisë më parë Ibrahimin e sprovoi me zjarrin e Nemrudit, ndërsa këtë herë e sprovoi me birin e tij, i cili ishte një nga dhuntitë më të mëdha të tij. Me këto sprova Allahu i Madhërishëm i ofroi të gjithë njerëzisë shembull në të cilin tregohet shumë qartë dhe pastër besimi dhe nevoja e tevekulit në Allah. Sigurisht edhe përfundimin e lumtur për atë që i kalon me sukses sprovat e këtilla.

Erdhi darka dhe Ibrahimi nuk gjeti ende një përgjigje të plotë. Por kur pa të njëjtën ëndërr edhe natën e dytë, atëherë e kuptoi se kjo ëndërr është një rikujtim nga ana e Allahut të Madhërishëm dhe, sado e vështirë që të ishte për Ibrahimin, përsëri ishte një flijim i premtuar më parë. Për këtë arsye edhe kësaj dite i thuhet “Dita Arafe (të kuptosh - të njohësh).”<sup>362</sup>

<sup>361</sup> *Tibyan Tefsiri*, 4/34; *Tefsir-i Kebir*, 18/625; *Nimeti Islâm*, “El Hac” Mehmed Zihni, f.541; *Ahkâmi'l-Kur'ân*, 14/523.

<sup>362</sup> *Tefsir-i Kebir*, 18/625; *Ahkâmi'l-Kur'ân*, 14/523; *Nimeti Islâm*, “El Hac” Mehmed Zihni, f.541/ *Peygamberler Târîhi*, Mehmed DİKMEN - Bünyamin ATEŞ, s232.

Ka thënë profeti Muhamed [sal-lallahu alejhi ve sellem]: *“Besimtari është si bima që ka lulëzuar; era e përkul/përthyen në atë anë që fryn. Dhe e përkulin/përthyejnë përsëri atë fatkeqësitë dhe vështirësitë.”*<sup>363</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam], kur e pa të njëjtën ëndërr edhe natën e tretë, atëherë iu hoq perdja e mjegullsisë që kishte në kokë dhe kështu pasi e pa ëndrrën tre net rresht vendosi bërjen kurban të birit të tij, Ismailit. Për këtë arsye edhe kjo ditë është quajtur “Dita Nahr (prerje në grykë-fyt)”.<sup>364</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] ishte prej profetëve Ulûl-Azm. Besimi në Allahun e Madhërishëm, zemra dhe tevekuli i tij ishin më të fortë sesa çeliku. Për këtë shkak ai triumfoi në këtë luftë. Nuk iu tremb syri për ta sjellë në vend fjalën e premtuar më parë. Për këtë arsye Ibrahimi u nis nga Palestina drejt Mekës.<sup>365</sup>

## SHFAQJA DHE VESVESET E SHEJTANIT

Ibrahimi [alejhis-selam] nuk i kishte prerë marrëdhëniet me djalin dhe gruan e tij të dashur. Herë pas here shkonte dhe i vizitonte në Meke. Qëndronte pak tek ta dhe interesohej për gjendjen e tyre.<sup>366</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam], i cili vite më parë nuk kishte pasur mundësi për të luajtur dhe ledhatuar djalin e tij, tashmë, po shkonte në Meke për ta bërë kurban me qëllim

<sup>363</sup> Buhâri, *Merdâ*, 1 (1947); Muslim, *Munafîn*, 58 (2809).

<sup>364</sup> *Tefsir-i Kebir*, 18/625; *Ahkâmi'l-Kur'ân*, 14/523.

<sup>365</sup> *Tefsir-i Kebir*, Fahrudin er-Razi, v.18, f.625.

<sup>366</sup> *Mukaddime*, Ibn Haldun, 2/475; *Tarih Boyunca Tevhid Mücâdelesî*, Mevdudi, 2/44; *T.D.V İslâm Ansiklopedisi*, 21/271.

sjelljen në vendin e duhur të premtimit të dhënë Allahut të Madhërishëm më parë.

Shejtani i mallkuar, kur e pa se Ibrahimimi [alejhis-selam] po shkonte për të sjellë në vendin e duhur premtimin e dhënë në vetvete, tha: “Betohem në Allah, nëse unë nuk do të mundem t’i fus një vesvese fitne mes Ibrahimit dhe familjes së tij në këtë rast, më pas asnjërit prej tyre nuk do të mundem t’i fus vesvese dhe fitne në zemra, kështu që nuk do të mundem t’i devijojë nga rruga e drejtë. Në këtë mënyrë, shejtani iu shfaq Ibrahimit [alejhis-selam] me fytyrën e një burrit<sup>367</sup> dhe e pyeti:

- “O Ibrahim, ku po shkoni kështu?”

Ibrahimimi [alejhis-selam] tha: “Kam një punë në këtë luginë.”

Burri pyeti: “Më duket se dëshiron të therësh Ismailin?”

Ibrahimimi pyeti: “A ke parë ndonjë baba, i cili e ther birin e tij?”

Burri iu përgjigj: “Po, babai je ti (që do e therësh)!”

Ibrahimimi [alejhis-selam] pyeti: “E përse do e ther unë birin tim?”

Burri tha: “Ti mendon dhe thua se therja e tij është urdhër i Allahut.”<sup>368</sup>

Ibrahimimi [alejhis-selam] tha: “Është më e mirë për mua përulja ime përpara urdhrit të Allahut të Madhërishëm nëse më ka urdhëruar për ta vepruar.”<sup>369</sup>

<sup>367</sup> *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, 14/528; *Târih-i Taberi*, 1/184

<sup>368</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.184

<sup>369</sup> *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, v.1, f.186.

Burri tha: “Vallahi, mua më duket sikur të ka ardhur shejtani në gjumë dhe të ka urdhëruar për të flijuar djalin tënd dhe ju tani mendoni të sillni në vend urdhrin e atij.”<sup>370</sup> Ky nuk ishte dikush tjetër përveç shejtanit të mallkuar që mundohet t’i nxjerrë njerëzit nga rruga e drejtë, por Ibrahimimi [alejhis-selam] e kuptoi se kush ishte ky burrë që iu shfaq.

Ibrahimimi [alejhis-selam] iu hidhërua dhe i bërtiti me zë të lartë shejtanit të mallkuar, që mundohej të hynte mes adhurimit të njeriut me Krijuesin e tij, duke i thënë: “Shporru nga këtu, o armiku i Allahut! Të betohem që unë do e çoj në vendin e duhur urdhrin e Krijuesit tim pa kurrfarë hezitimi.” Më pas u ngrit në këmbë dhe i gjuajti shejtanit me gurë.<sup>371</sup>

Sipas transmetimit që ka ardhur nga Ibn Abbasi [radijallahu anhu] kjo ngjarje tregohet kështu: “Ibrahimit shejtani iu bë bela tre herë kur u emërua për të bërë kurban djalin e tij.

Herën e parë i doli përpara në Xhemre Akabe. Iku pasi Ibrahimimi [alejhis-selam] i hodhi shtatë gurë. Më pas i doli përpara në Xhemre Vusta. Përsëri Ibrahimimi e largoi atë duke i hedhur shtatë gurë. Herën e fundit i doli në Xhemre (Xhemre Ûla). Ibrahimimi [alejhis-selam] e çoi urdhrin e Allahut të Madhërishëm në vend duke e larguar edhe nga këtu shejtanin pasi i hodhi shtatë gurë.”<sup>372</sup>

Ibrahimimi [alejhis-selam] tregoi se ishte i vendosur në rrugën e Allahut dhe nuk u mashtrua prej mashtrimeve që u mundua t’i bëjë shejtani i mallkuar.

---

<sup>370</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f. 184.

<sup>371</sup> *Târih-i Taberi*, 1/274; *Ibnu ’l-Ethir*, 1/105.

<sup>372</sup> *Musned*, 1/297, 306-307; *Ahkâm’il-Kur’ân*, 14/529; *Tefsir-i Kebir*, 18/633.

Nga Ibrahim [alejhis-selam] na ka ngelur gjuajtja me gurë shejtanit në Mina. Kështu që edhe ne, me anë të gjuajtjeve me gurë shejtanit, tregojmë se nuk kemi për t'iu bindur dhe nuk kemi për t'u mashtruar nga mashtrimet e tij. Gjuajtja me gurë shejtanit me një kuptim është paralajmëruese me domethënie të mirë, me të cilën tregohet se nuk do t'i binde mi asnjë mendimi apo veprë që vjen prej tij. Sepse një besimtar a mundet të braktisë rrugën e Allahut dhe të shkojë pas shejtanit, të cilin e ka larguar më parë me gurë?

Kush është shejtani?

Shejtani, kurrsesi, nuk është i vetmi armik.

Shejtani është një fuqi e cila qëndron përballë besimit të vërtetë.

Shejtani është një qendër negative, e cila i ka hapur luftë qendrës pozitive tek njeriu.

Shejtani është lakmia dhe epshi si dhe cilësitë e tjera të ngjashme që mundohen ta marrin njeriun nën kontroll dhe ta burgosin larg besimit dhe ndjenjave njerëzore. Me një fjalë, shejtan është çdo gjë që mundohet të hyjë dhe ta pengojë robin në rrugën e Krijuesit të Madhërishëm dhe ndërmjet tij.

Por, kurrsesi, nuk duhet të harrojmë se shejtani është i pafuqishëm. Fuqia dhe armët më të mëdha të tij janë dyshimet dhe vesveset. Gjërat në të cilët të fton shejtani janë iluzion dhe jo të vërteta. Shejtani të fton për një jetë stimuluese. Ata që bien në kurthet e tij fillojnë të preferojnë gënjeshtren përpara të vërtetës, të shtrembëtën nga e drejta, të keqen nga e mira dhe imagjinatën nga e vërteta, realja.<sup>373</sup>

Shejtani kishte një përvojë të madhe përballë Ibrahimit [alejhis-selam]. Për këtë arsye, ai e kuptoi se nuk do të

<sup>373</sup> *Hac Risalesi*, Mustafa İSLAMOĞLU, f. 58-60.



mundet ta mashtrojë, pasi ai e kuptoi që ishte shejtani. Sepse ai e dinte se përballë tij ishte Ibrahim, i cili më parë i theu idhujt pa iu trembur. Për këtë arsye, ai u largua nga aty për të gjetur (sipas atij) ndonjë tjetër më të dobët dhe pa përvojë.

Ibrahimi [alejhis-selam] erdhi në Meke pas një udhëtimi të lodhshëm dhe me shqetësimet e shejtanit. Ibrahim [alejhis-selam] kur erdhi në Meke e gjeti duke luajtur përreth çadrave birin e tij të vogël, Ismailin, i cili ende nuk e kishte mbushur moshën e pubertetit.<sup>374</sup>

Ismaili [alejhis-selam] e ftoi babain e tij në shtëpi. Por Ibrahim [alejhis-selam], duke i treguar thikën dhe litarin, i tha: “O biri im! Merre këtë thikë dhe litar, hajde pas meje dhe të largohemi pak nga këtu.”<sup>375</sup>

Babë e bir filluan të ecin bashkë dhe u larguan prej aty.

## HAXHERJA PËRBALLË NJË SPROVE TË MADHE

Haxherja në momentin që pa largimin e Ibrahimit [alejhis-selam] me birin e tij të vogël trembëdhjetë vjeç, iu afrua një burrë që nuk e njohte dhe e pyeti: “Oj Haxhere! Ku është burri yt, Ibrahim, dhe biri juaj, Ismaili?”

Haxherja tha: “Mendoj se ikën për të marrë dru në shkurnajë.”

Burri i tha: “Sa keq për ty, moj Haxhere! A nuk e di se ai ka ardhur për ta therur kurban Ismailin? Kam frikë se tani është duke e therur atë.”<sup>376</sup>

---

<sup>374</sup> *El-Kâmil Fi't-Târih, Ibnu'l-Ethir*, v.1, f.105.

<sup>375</sup> *Ibnu'l-Ethir* 1/105; *Târih-i Taberi*, 1/183.

<sup>376</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f. 184.

Haxherja tha: “Si ka mundësi? Ibrahim [alejhis-selam] është një baba shumë mëshirues, me një zemër tepër të butë dhe të dhembshme. Kurrë nuk e bën një gjë të tillë. Një baba nuk e ther dhe nuk mundet ta therë birin e tij...”

Burri tha: “Po habitem me ty, Haxhere! A nuk ju braktisi ai dikur në këtë shkretëtirë të vetmuar dhe më pas iku, kur, njëkohësisht, nuk kishit as çfarë të hanit, as çfarë të pinit dhe s’kishit asnjë njeri tjetër që t’ju ndihmonte?!”

Haxherja tha: “Atëherë ne na la këtu me urdhër të Allahut.”

Shejtani i mallkuar pasi buzëqeshi pak mendoi se ishte rasti më i mirë dhe i përshtatshëm i tij dhe tha:

“Oj Haxhere! Këtë herë me urdhrin e Allahut do të theri edhe birin tënd, pra do t’i presë kokën...”<sup>377</sup>

Pavarësisht këtyre fjalëve, Haxherja përsëri nuk u lëkund. Përkundazi, ajo veproi më një vetëbesim dhe nënshtrim të plotë në kaderin e Allahut të Madhërishëm, siç veproi vite më parë, duke thënë: “Duhet ta bëjë këtë nëse ka urdhëruar Allahu i Madhërishëm dhe neve nuk na takon gjë tjetër vetëm se përulje dhe dorëzim përpara urdhrin të Allahut.”<sup>378</sup>

Burri tha: “Oj Haxhere! Ti je një grua e pamëshirshme. A nuk ke pak mëshirë për djalin tënd? Si e dorëzon djalin tënd të bukur të hyjë poshtë thikës? E si ta mban zemra/ e si të pajtohet shpirti me këtë?”

Haxherja u përgjigj: “Ai që ma dhuroi atë është Allahu. Nëse dëshiron nga ne therjen e tij për dëshirën/pëlqimin e Tij, atëherë detyra jonë nuk është gjë tjetër vetëm se bindja

<sup>377</sup> *Ahkâm 'il-Kur'ân*, Imam Kurtûbî, v.14, f.528.

<sup>378</sup> *Ibnu 'l-Ethir*, 1/105; *Târih-i Taberi*, 1/184.

ndaj urdhrit dhe nëse është nevoja edhe ne bëhemi kurban pas tij në rrugën e Allahut.”

Burri tha: “Oj Haxhere, çfarë jeni duke thënë kështu! Nëse ke logjikë, vrapo e kape menjëherë. Ndaloje Ibrahimin nga therja e djalit, i cili është mashtruar nga ëndrra. Nuk mund të flijohet një djalë prej një ëndrre.”

Haxherja, pasi e pa me kujdes burrin, tha: “Ik, shporru nga këtu, ti duhet të jesh vetëm shejtani!”<sup>379</sup>

Më pas hapi duart dhe iu lut Allahut, duke thënë: “O Zoti im! Largoje shejtanin nga familja (jonë) Ibrahim.” Ndërsa shejtani u largua me trishtimin e të qenit i pasuksesshëm.

Kështu, Haxherja po kalonte sprovën e dytë të madhe në jetën e saj. Edhe këtë herë tregoi të njëjtin tevekul (mbështetje) dhe përulje ndaj Allahut të Madhërishëm si e kishte treguar vite më parë.<sup>380</sup>

Shejtani kishte planifikuar të vendosë Haxheren pengesë për ta ndaluar Ibrahimin në nënshtrimin e Allahut të Madhërishëm. Sipas planifikimit të tij, Haxherja posa ta dëgjonte këtë gjë, menjëherë do të shkonte dhe do të mendohej për ta ndaluar Ibrahimin [alejhis-selam] me të qara dhe lutje. Kështu që shejtani nuk do të mendohej dhe si rezultat do e pengonte Ibrahimin prej nënshtrimit ndaj urdhrit të Allahut të Madhërishëm.

Shejtani i mallkuar këtë herë ishte përplasur me një shkëmb tepër të fortë. Edhe këtë herë nuk mundi ta mashtronte këtë grua, e cila ishte një monument besimi dhe nënshtruese e plotë ndaj caktimit të Allahut të Madhërishëm. Kështu që edhe këtë herë asnjëra nga hilet, mashtrimet dhe

<sup>379</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f. 184.

<sup>380</sup> *Peygamberler Târihi*, A. Lütüfî KAZANCI, v.1, f.228.

vesveset e tij nuk mundën ta lëkundin dhe rrëzojnë besimin tepër të lartë të Haxheres.

## SHEJTANI DORËZOHET PËRBALLË BESIMIT TË ISMAILIT

Shejtani, pasi nuk mori përgjigjen që dëshironte nga Haxherja, këtë herë shkoi tek Ismaili i vogël me plane dhe kurthe dinake për ta shtyrë atë kundër Ibrahimit [alejhisselam] dhe e pyeti: “O djalosh! A e di se ku është duke të çuar babai?”<sup>381</sup>

Ismaili tha: “Mendoj se po më çon tek shkurnaja për të mbledhur dru.”

Shejtani, duke lëkundur kokën me kuptimin “po mashtrohesh”, tha: “Babai yt nuk mendon gjë tjetër vetëm se të theri ty. Të betohem se fjalët e mia janë të drejta.”<sup>382</sup>

Ismaili pyeti: “Përse të më therë babai mua? A ke parë ndonjëherë që një baba të therë birin e tij?”<sup>383</sup>

Shejtani tha: “Sepse atë kështu e ka urdhëruar Zoti.”

Në realitet shejtani e tha këtë fjalë që Ismaili t’i besojë, por u pendua një mijë herë pse e tha atë, sepse, pavarësisht moshës tepër të re, Ismaili i ktheu një përgjigje aq të madhe dhe të pjekur saqë e shokoi:

---

<sup>381</sup> *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, 14/528 *Târih-i Taberi*, 1/184.

<sup>382</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.184

<sup>383</sup> *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, 14/528; *Târih-i Taberi*, 1/184.

- “Atëherë duhet të veprojë çfarë t’i ketë urdhëruar Zoti.<sup>384</sup> Urdhri i Zotit gjithmonë është më i rëndësishëm sesa koka jonë.”<sup>385</sup>

Shejtani nuk u dorëzua menjëherë kur e dëgjoi këtë përgjigje. Këtë herë u mundua t’i tregojë se nuk mund të bëhet kurban një fëmijë vetëm e vetëm nga shikimi i një ëndrre. Shejtani u mundua t’i thyejë Ismailit besimin që kishte ndaj babait.

Ismaili [alejhis-selam] nuk duroi dot më shqetësimet e shejtanit dhe u ankua tek babai i tij. Ibrahimimi [alejhis-selam] iu drejtua Ismailit: “O bir, gjuaji me gurë.”

Ismaili veproi ashtu si e këshilloi i ati. Mori disa gurë dhe i gjuajti shejtanit. Shejtani u largua, por pas pak shejtani iu shfaq për herë të dytë dhe filloi përsëri me vesveset e tij. Ismaili përsëri i gjuajti me gurë. Shejtani u largua, por përsëri tregoi se nuk hoqi dorë dhe u kthye për herë të tretë. Por, kur e pa që u gurëzua edhe për herë të tretë, u largua i turpëruar dhe u dorëzua përballë besimit dhe karakterit të lartë të Ismailit [alejhis-selam].<sup>386</sup>

Pavarësisht përvojës që kishte shejtani prej Ademit [alejhis-selam] e deri në atë kohë, përsëri u detyrua ta pranojë humbjen dhe të dorëzohet përpara familjes së Ibrahimit [alejhis-selam], e cila ishte një familje me tevekul dhe nënshtrim të palëkundshëm ndaj Allahut të Madhërishëm, Krijuesit të gjithësisë. Tashmë, shejtanit nuk i kishte mbetur tjetër gjë, ndaj ai u mënjanua dhe filloi të shikonte me shpresë të

<sup>384</sup> *Târih-i Taberi*, 1/184; *Ahkâmi ’l-Kur’ân*, 14/528-29.

<sup>385</sup> *Ibnu ’l-Ethir*, 1/105; *Târih-i Taberi*, 1/184.

<sup>386</sup> *Peygamberler Târihi*, Ahmet Lütü KAZANCI, 1/228-229; *Yeni Rehber Ansk.* 10/169.

humbur se çfarë do të ndodhte. Filloi të mendojë se ndoshta Ibrahimimi mund të hiqte dorë në momentet e fundit, ndoshta Haxherja me dashurinë dhe mëshirën që kishte për birin e saj mund të shkonte tek Ibrahimimi dhe të kërkonte heqjen dorë nga zotimi, ose Ismaili të bënte kthesë në momentin e vështirë. Vetëm në një gjendje të tillë Iblisi mund të vishte mburojën dhe të zbriste në mejdanin e luftës kundër familjes së Ibrahimimit [alejhis-selam].

### **BESIMI DHE QËNDRUESHMËRIA E NËNSHTRIMIT TË ISMAILIT [alejhis-selam] NDAJ KRIJUESIT TË GJITHËSISË**

Ibrahimimi [alejhis-selam] dhe djali trembëdhjetë vjeç, Ismaili, erdhën në vendin Mina për t'u bërë kurban. Meka, tashmë, ishte zgjeruar dhe kishte një popullatë të madhe dhe, për këtë arsye, Ibrahimimi [alejhis-selam] e çoi Ismailin në vendin Mina me qëllim që të ishte larg njerëzve. Gjithashtu, në qendrën e Mekës ishte edhe Haxherja, nëna e Ismailit. Këto ishin disa shkaqe prej të cilave Ibrahimimi [alejhis-selam] zgjodhi vendin Mina, i cili është mbi tre kilometër larg qendrës së Mekës.<sup>387</sup>

Pavarësisht se zemra e Ibrahimimit [alejhis-selam] nga njëra anë po copëtohej, përsëri ai ishte i vendosur në sjelljen e premtimit të dhënë më parë, të cilin Allahu i Madhëri-shëm, tashmë, ia kërkonte ta zbatonte. Por sjellja në vendin e duhur të fjalës së dhënë sigurisht më parë kërkon marrjen

---

<sup>387</sup> *Târih Boyunca Tevhid Mücâdelesi*, Mevdudi, v.2, f.45.

e pëlqimit dhe dëshirën e Ismailit. Kjo gjendje tepër e vështirë në Kur'anin Famëlartë tregohet në këtë mënyrë:

**“Kur fëmija u rrit aq sa ta ndihmonte në punë,”** (Es-Saffat: 102) (Kur Ismaili erdhi në moshën në të cilën ai ishte në gjendje të kuptonte besimin dhe qëllimet e babait të tij)<sup>388</sup>  
**“Ibrahimi i tha: “O djali im, kam parë ëndërr se duhet të të flijoj...”** (Es-Saffat: 102)

Këtu duhet të nënvizojmë një gjë të rëndësishme në lidhje me ëndrrën që pa Ibrahim [alejhis-selam], sepse Ibrahim [alejhis-selam] në ëndërr nuk e pa djalin e tij të flijuar, por pa se ai duhej ta flijonte atë. Me shikimin e saj ai e kuptoi se kjo ishte një sprovë e Allahut të Madhërishëm që duhej vepruar.<sup>389</sup> Pavarësisht se nuk e pa të flijuar – therur djalin e tij në ëndërr, përsëri ai ishte i obliguar të vazhdonte drejt flijimit të tij. Për këtë arsye, Ibrahim [alejhis-selam] vendosi të flijojë djalin e tij të dashur dhe këtë gjendje ia tha edhe atij: **“Çfarë mendon ti?” – I biri i tha: “O ati im, vepron ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm!”** (Es-Saffat: 102)

Qëllimi i Ibrahimit [alejhis-selam] këtu me pyetjen rreth urdhrit që ishte urdhëruar nuk ishte gjë tjetër vetëm për të parë dhe mësuar se a ishte djali i tij prej besimtarëve “salih – i mirë, i devotshëm” apo jo? Siç e kemi parë edhe më parë, lutja e Ibrahimit [alejhis-selam] ishte për një djalë salih dhe Allahu i Madhërishëm e përgëzoi me pasardhës salih. Ibrahim [alejhis-selam] e kuptoi menjëherë se Ismaili [alejhis-selam] nuk ishte thjesht djali i tij nga ana e gjakut, por ai

<sup>388</sup> Kur'an Mesajı Meâl-Tefsir, Muhamed ESED, f.916.

<sup>389</sup> Tefhimu'l-Kur'an, Mevdudi, v.5, f.29.

ishte edhe pasardhës i tij nga ana e ahlakut (moralit), fesë dhe personalitetit të tij.<sup>390</sup>

Kur u pyet Ismaili [alejhis-selam] nuk tha: “Përse do të më flijosh mua kur unë asnjëherë nuk kam qenë i keq me ty...” Gjithashtu, ai nuk i tha babait të tij: “A nuk të mjaftoi braktisja që më bëre në shkretëtirë të vetmuar me nënën time? Dhe, tashmë, do edhe të më flijosh?” Thënie apo kundërshtime të tilla nuk ndodhën – nuk mund të ndodhnin. Sepse ai ishte një besimtar dhe e dinte shumë mirë se babai i tij nuk vepronte gjë tjetër pos urdhrave të Allahut të Madhërishëm. Ja, ky është një shembull në të cilin tregohet se besimtari tregon pëlqim dhe përukje pa asnjë kusht përpara kada dhe kaderit (përcaktimit) të Krijuesit të gjithësisë...<sup>391</sup>

Ismaili tha: “O ati im! Sikur të më kishe treguar për këtë gjë kur ishim në shtëpi, atëherë, të paktën, do të ndahesha me nënën.”<sup>392</sup> Megjithatë më pas pa kurrfarë frike iu përgjigj: **“...O ati im, vepro ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm!”** (Es-Saffat: 102) “Pa dyshim unë do të duroj, sepse besoj në shpërblimin e kësaj nga ana e Allahut të Madhërishëm.”<sup>393</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] ishte në ndjenja të ndryshme. Nga njëra anë, zemra e babait për birin e tij qante, por, nga ana tjetër, kur dëgjoji nënshtrimin dhe besimin e palëkundshëm të tij ndaj Krijuesit të gjithësisë, Ibrahim i [alejhis-selam] ndihej krenar me birin e tij kaq të mirë.

<sup>390</sup> *Tefhimu 'l-Kur'ân*, Mevdudi, v.5, f. 29.

<sup>391</sup> *Allah'a Davette Peygamberllerin Metodu*, M. Surur bin Naif Zejnelabidin I, f.325.

<sup>392</sup> *Târih-i Taberi*, 1/184; *Ahkâmi 'l Kur'ân*, 15/105.

<sup>393</sup> *Hadislerle Kur'ân-ı Kerim Tefsiri*, Ibni Kethir, v.12, f.6813



Tashmë, ishte afruar koha e sjelljes në vend të fjalës së dhënë!

Ismaili e pyeti babanë e tij: “A e ke njoftuar nënën time rreth kësaj?”

Ibrahimi tha: “Jo! Nuk e kam njoftuar!”

Ismaili tha: “Keni bërë mirë që nuk e keni njoftuar.”<sup>394</sup>

Ismaili kërkonte këto gjëra prej babait të tij, duke thënë: “Ati im i dashur! Më lidh me këtë litar kur të më flijosh, me qëllim që të mos pakësohet ndonjë sevap nëse bie ndonjë pikë gjaku mbi ty! Pa dyshim dhimbja e vdekjes është shumë e vështirë dhe e rëndë.”<sup>395</sup>

Nuk jam i sigurt a do të lëviz apo jo kur të më prekë thika fytin! Prehe shumë mirë thikën dhe fytin ma prit menjëherë që vdekja të jetë sa më e lehtë! Kështu që edhe unë të prehem në rehati!<sup>396</sup>

Kur të më therësh më shtri me fytyrë nga toka dhe balli të takojë në tokë. Mos më shtri në anë, sepse kam frikë kur të shohësh fytyrën time ndoshta nuk të bën zemra dhe do të kundërshtosh urdhrin e Allahut të Madhërishëm! Në këtë mënyrë, edhe unë nuk e shikoj thikën, sepse mund të trembem në atë moment.<sup>397</sup>

Mblidhi rrobat e tua mirë me qëllim që të mos spërkatën me gjak, sepse më pas i shikon nëna dhe i vjen keq.<sup>398</sup>

<sup>394</sup> Hakim-i Mustedrek, 2/556; *Ahkâmi'l Kur'ân*, 14/527.

<sup>395</sup> *Ibnu'l-Ethir*, 1/105; *Tefsir-i Kebir*, 18/633; *Ahkâmi'l Kur'ân*, 14/527.

<sup>396</sup> *Ahkâmi'l Kur'ân*, 14/527; *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, 1/188-189.

<sup>397</sup> *Tefsir-i Kebir*, Fahrudin er-Razi, v.18, f.633.

<sup>398</sup> *Ahkâmi'l Kur'ân*, 14/527; *Peygamberler Târihi*, A. Lütü KAZANCI, 1/232.

Nëse e shikon të arsyeshme këmishën time merre dhe jepja nënës! Ndoshta kjo mund të jetë një ngushëllim për të!<sup>399</sup> Gjithashtu, i thuaj selamin (përsëndetjen) time kur të shkosh tek ajo.”<sup>400</sup>

Është i pamundur përshkrimi me penë i këtyre fjalëve dhe kësaj sjelljeje kaq të madhe që tregoi Ismaili [alejhissalam] në rrugën e Allahut. Nga të dyja anët kemi sakrifica të mëdha. E para, e babait ndaj djalit dhe, e dyta, flijimi i vetvetes nga i biri.

Ky është peizazhi më i lartë i besimit në të gjithë kohërat. Besimi nuk përbëhet vetëm me disa fjalë që dalin nga goja. Besimi nuk është as ngushëllimi përballë trishtimeve. Në të kundërt, besimi është mbledhja në vepër të urdhrave dhe këshillave, përulja dhe pajtimi i plotë përballë dëshirës së Allahut të Madhërishëm dhe të sakrifikuarit në rrugën e Tij çdo gjë që është më me vlerë.

Sa e sa kemi nevojë për këtë mësim në këtë kohë, në të cilën më parë preferohet pasuria, përfitimi personal dhe vlerat e kësaj botë të përkohshme përpara urdhrave, ndalesave dhe pëlqimit të Allahut të Madhërishëm. Njeriu sa e sa zvogëlohet dhe nënvlerësohet kur largohet nga shkaku i krijimit të tij në këtë botë dhe nga rruga e si dhe kur është i pasionuar pas bukurive mashtruese të përkohshme të kësaj bote.

Vlerën e kurbanit mund ta vlerësojë vetëm dera për të cilën theret kurhani dhe nuk flijohet për t'i dhënë asaj vlerë, por për t'u vlerësuar dhe lartësuar akoma më shumë.

Ismaili tha: “Baba i dashur! Sille urdhrin e Allahut të Madhërishëm sa më shpejt, mos u harro, se mos bëhesh nga

---

<sup>399</sup> Tefsi-i Kebir, Fahrudin er-Razi, v.18, f. 633.

<sup>400</sup> *Ibnu 'l-Ethir*, 1/105; *Tibyan Tefsiri*, 4/34.

kundërshtarët. Si dhe mund të dëgjojë nëna dhe vjen më merr nga dora juaj. Shpejto përpara se ta dëgjojë ajo.”<sup>401</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] tha: “Biri im i dashur! Ti sa e sa bukur më ndihmove mua në urdhrin e Allahut të Madhërishëm.”<sup>402</sup>

## GJITHË NATYRA DHE KRIJESAT PO SHIKONIN TENTIMIN PËR FLIJIMIN E ISMAILIT [alejhis-selam]

Kodrinat Mina këtë herë ishin dëshmitare në një qetësi të madhe të ngjarjes së madhe të historisë së njerëzimit. Ibrahimi [alejhis-selam] po flijonte birin e tij të dashur për të cilin ishte lutur me vite të tëra. Ibrahimi [alejhis-selam] përveshi mëngët e duarve dhe ia lidhi fort duart Ismailit me qëllim që të ishte sa më e lehtë dhe më e shpejtë therja e tij. Më pas e shtriu atë në anën e djathtë. Ismaili [alejhis-selam] ia dorëzoi zemrën Allahut të Madhërishëm dhe po priste preren e thikës.<sup>403</sup>

Ibrahimi iu afrua atij ngadalë, kjo ishte një gjendje të për e vështirë dhe e padurueshme. Qëndroi një çast dhe filloi të shohë dorën e djathtë dhe thikën që ishte në dorën e majtë! Duart i dridheshin dhe thika sa nuk po i binte nga duart!

Ibrahimi [alejhis-selam] ende nuk po mundej ta therte Ismailin, por në brendësinë e shpirtit të tij, pavarësisht kohës kaq shumë të shkurtër, përsëri zemra dhe shpirti i tij ishin sikur të kishte therur me mijëra Ismail dhe Ibrahim! Nga sytë

<sup>401</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.185.

<sup>402</sup> *Ibnu 'l-Ethir*, 1/106; *Ahkâmi 'l-Kur'ân*, 15/105; *Tefsir-i Kebir*, 18/633.

<sup>403</sup> *Ibnu 'l-Ethir*, 1/106; *Târih-i Taberi*, 1/185.

e tij sikur rridhnin jo pika loti, por pika gjaku! I dridhej dora dhe një pikë loti i ra në fytyrën e Ismailit.

Ismaili i hapi sytë dhe, pasi pa fytyrën e babait të tij që nuk po mundej ta therë, i tha: “Ati im i dashur! Nëse nuk mundesh, atëherë ma mbulo fytyrën që të mos e shohësh atë.”<sup>404</sup>

Kjo ishte një gjendje e padurueshme! Por, në të njëjtën kohë, nuk kishte më kthim, sepse urdhri ishte prej Krijuesit të botëve dhe një nga cilësitë e besimtarit përballë urdhrave të Allahut të Madhërishëm është pëlqimi dhe nënshtrimi i plotë me fjalën: “... ***Ne dëgjojmë dhe bindemi...***” (El-Bekare: 285)

Tashmë, Ibrahim [alejhis-selam] nuk dëshironte të mendonte dhe të ndiente asgjë tjetër vetëm se të sillte në vendin e duhur urdhrin e Allahut të Madhërishëm, sepse për çdo sekondë që kalonte po i mundësonte shejtanit ofertën e një fushëbeteje të re.

Për këtë arsye, e mprehu shumë mirë thikën dhe mprehën e thikës e vuri poshtë fytyrën e Ismailit<sup>405</sup> dhe filloi të thoshte “Bismil-lahi, Allahu Ekber” (Me emrin e Allahut, Allahu është më i Madhi). Më pas i ra me thikë në fytyrë me sa fuqi kishte.<sup>406</sup>

Pavarësisht se Ibrahim [alejhis-selam] i ra me sa fuqi kishte, përsëri thika tepër e mprehtë nuk e preu Ismailin sikur të kishte hasur në një hekur tepër të fortë.<sup>407</sup>

Ibrahim [alejhis-selam] e mprehu thikën edhe dy apo tre herë.<sup>408</sup>

<sup>404</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.185.

<sup>405</sup> *Ibnu 'l-Ethir*, 1/106; *Ahkâmi'l Kur'ân*, 14/527..

<sup>406</sup> *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f.227.

<sup>407</sup> *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, 1/227; *Ibnu 'l-Ethir*, 1/105; *Ahkâmi'l Kur'ân*, 14/527.

<sup>408</sup> *Peygamberler Târihi*, Muhamed Asım KÖKSAL, v.1, f.189.

Në atë moment Ismaili pyeti: “Babai im! Çfarë po bën, përse po vonohesh duke e mprehur thikën disa herë?”

Ibrahimi [alejhis-selam] u përgjigj: “Nuk e kuptova se çfarë ndodhi! Pavarësisht se e mpreha shumë mirë dhe e vura me gjithë fuqinë që kisha përsëri ajo nuk preu. Po shikoj gjëra të habitshme!”

Ismaili tha: “Provoje edhe një herë me gjithë fuqinë se ndoshta këtë herë pret.”<sup>409</sup>

Pas kësaj, Ibrahimi [alejhis-selam] u mundua duke e shtyrë thikën para e mbrapa me gjithë fuqinë për herë të dytë dhe të tretë,<sup>410</sup> por përsëri thika nuk e preu fytyrën e Ismailit.<sup>411</sup> Këtu nënkuptohet se Allahu i Madhërishëm i kishte dhënë urdhër thikës: “Mos e prit...!”, kështu që edhe thika nuk e preu.

Ibrahimi [alejhis-selam] ishte i sigurt që i ra me thikë fytyrës me gjithë fuqinë që kishte. Nga njëra anë, u habit, por, nga ana tjetër, i erdhi në mendje menjëherë hedhja e tij në zjarr dhe mos djegien prej zjarrit.

Në momentin kur po i mendonte të gjitha këto, u dëgjua një zë dhe ky zë ishte: “Allahu Ekber, Allahu Ekber (Allahu është më i Madhi, Allahu është më i Madhi)”. Ibrahimi [alejhis-selam] e ngriti kokën dhe, ç’është shohë, po zbriste nga qielli Xhebrail Emini dhe anash tij kishte një dash të shëndoshë.<sup>412</sup> Menjëherë filloi falënderimin, duke thënë: “La ilahe il-lallahu vallahu ekber” (Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Allahu është më i Madhi).” Këtë gjë e pa edhe Ismaili, i cili menjëherë

<sup>409</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.185.

<sup>410</sup> *Kur’ân’da Peygamberler ve Peygamberimiz*, Abdulfettah Tabbara, f.143

<sup>411</sup> *Ibnu’l-Ethir*, 1/106; *Târih-i Taberi*, 1/185.

<sup>412</sup> *Târih-i Taberi*, 1/186; *Ahkâmi’l-Kur’ân*, Imam Kurtûbî, 14/523; *Ahkâmu’l-Kur’ân*, Ibnu’l-Arabi, 4/1608 - *Fikhi Aidan Kur’ân Kıssaları*, Dr. Abdullah ACAR, f.320.

filloi të falënderojë Allahun e Madhërishëm, duke thënë: “Allahu Ekber ue Lil-lahi’l-Hamd” (Allahu është më i Madhi dhe falënderimi i përket Allahut).<sup>413</sup>

Kështu u bë vaxhib thënia pas namazeve farz të “tek-birëve teshrik”, gjithsej njëzet e tre vakte/kohë namazi duke filluar pas namazit të mëngjesit të ditës së Arafatit dhe deri pas namazit të ikindisë të Ejjam Teshrik (ditët e teshrikut).

Transmetohet nga Abdullah ibn Mes’udi [radijallahu anhu]: “(Fillojnë) në (namazin) mëngjesin (tekbirët e teshrikut) e ditës së Arafatit, vazhdojnë (njëzet e tre vakte) deri në namazin e ikindisë së ditës së fundit (katërt) në Mina (bajramit).”<sup>414</sup>

Ibrahimi [alejhiss-salam], i cili po e përjetonte ëndrrën të njëjtë siç e kishte parë, tashmë, gjendej mes ndjenjave të ndryshme! Një herë shikonte thikën në dorën e tij e një herë shikonte Ismailin, djalin e dashur. Djali i dashur që i kishte sytë dhe duart e lidhura, elhamdulil-lah, jetonte. Por momenti kur thika preku fytin e Ismailit ishte çasti i paharruar që i qëndronte përpara syve. Pavarësisht mëshirës dhe dashurisë së madhe që ndiente për Ismailin, përsëri Ibrahimi e solli në vend premtimin dhe urdhrin e Allahut të Madhërishëm në zemrën e tij.

Tashmë, në zemrën e tij nuk qëndronte dashuria e Ismailit, por vetëm dashuria e Allahut të Madhërishëm, i Cili ia dhuroi përsëri Ismailin, kështu që e kyçi zemrën e tij përballë çdo dashurie tjetër përveç dashurisë së Allahut të Madhërishëm.

“Kush është besimtar më i mirë sesa ai që i dorëzohet sinqerisht Allahut, duke qenë bamirës dhe zbatues i fesë së

<sup>413</sup> *Reddu’l Muhtar Aleddurri’l-Muhtar*, Ibni Abidin, 3/368; *Târih-i Taberi*, 1/186; *Ahkâmi’l-Kur’ân*, 14/523.

<sup>414</sup> *Fethu’l-Bâri*, 2/462 - *Fikhu’s-Sune*, Sejjid SABIK, v.1, f.321.

pastër të Ibrahimit, të cilin *“Allahu e ka marrë për mik të ngushtë?!”* (En-Nisa: 125) Mik është ai në zemrën e të cilit nuk ka vend tjetër pos Allahut të Madhërishëm, dashuri dhe përuļje të plotë për çdo gjë që vjen nga Ai dhe që është i nderuar me përfitimin e pëlqimit dhe dashurisë së Krijuesit të gjithësisë.<sup>415</sup>

## SHPËRBLIMI I MONUMENTEVE TË NËNSHTRIMIT TË IBRAHIMIT DHE ISMAILIT

Ibrahimi [alejhis-selam] është nga profetët e rrallë që janë sprovuar me sprova të rënda. Pavarësisht sprovës tepër të rëndë, përsëri Ibrahim i [alejhis-selam] qëndroi në fjalën e dhënë dhe e tejkaloi me sukses sprovën.

Allahu i Madhërishëm në Kur’an thotë: *“Ne e thirrëm: “O Ibrahim, ti e përmbushe ëndrrën.” Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë punëmirët!”* (Es-Saffat: 104-105)

Siç e përmendëm edhe më herët, Ibrahimit [alejhis-selam] në ëndërr iu shfaq sikur ishte duke e flijuar dhe jo të flijuar, sepse ky ishte dhe qëllimi i sprovës, të cilën Ibrahim i [alejhis-selam] e kaloi me sukses me anë të besnikërisë.<sup>416</sup> *“Ne kështu i shpërblejmë punëmirët!”* (Es-Saffat: 105)

O Ibrahim! Ne i sprovujmë njerëzit me vështirësi dhe vuajtje dhe i lartësojmë duke u hequr dyshimet nëse kanë dyshime. O Ibrahim! Ti që more guxim in e flijimit, me anë të kësaj u bëre shkak shpëtimi për djalin dhe e ngrite gradën tënde tek Ne.<sup>417</sup>

<sup>415</sup> Kur’ân Yolu, v.2, f.117.

<sup>416</sup> Teshimu’l-Kur’ân, Mevdudi, v.5, f.29.

<sup>417</sup> Teshimu’l-Kur’ân, Mevdudi, v.5, f.29..

**“Kjo, me të vërtetë ka qenë një provë e qartë!”** (Es-Saffat: 106)

Këtu qëllimi nuk ishte marrja e shpirtit të djalit, por për të sprovuar se a gjendej dashuri tjetër më e madhe në zemrën dhe shpirtin e Ibrahimit pos dashurisë ndaj Krijuesit të gjithësisë.<sup>418</sup>

**“Kur Allahu e provoi Ibrahimin me disa urdhërime, të cilat ai i plotësoi...”** (El-Bekare: 124)

Sipas një transmetimi nga Ibn Abbasi [radijallahu anhu]: “Sprovat me të cilat ka sprovuar Allahu i Madhërishëm Ibrahimin [alejhis-selam] ishin: lufta me Nemrudin për hir të Allahut, durimi kur e hodhën në zjarr, braktisja e vendit të tij për të fituar pëlqimin e Allahut të Madhërishëm, nënshtrimi kur u urdhërua për të therur djalin e tij, Ismailin.”<sup>419</sup>

Kjo ishte prova më e madhe për Ibrahimin [alejhis-selam] se sa hedhja e tij në zjarr. Por edhe këtë herë ai e tregoi dashurinë dhe nënshtrimin e tij ndaj Allahut të Madhërishëm **“dhe i lamë atij** (Ibrahimit) **kujtim të mirë në brezat e mëvonshëm”**. (Es-Saffat: 108)

Shkaku i vazhdimit të sunetit të therjes së kurbanit që filloi me Ibrahimin e do të vazhdojë deri në Ditën e Kiametit është dëshira e Allahut të Madhërishëm për të mbajtur të freskët muslimanët gjatë gjithë historisë nënshtrimin e plotë të Ibrahimit [alejhis-selam] me anë të therjes së kurbanëve kafshë.<sup>420</sup>

<sup>418</sup> *Tefhimu'l-Kur'ân*, Mevdudi, v.5, f.29.

<sup>419</sup> *Safvetu't-Tefâsir*, Muhamed Ali SABUNI, v.1, f.173..

<sup>420</sup> *Tefhimu'l-Kur'ân*, Mevdudi, v.5, f.29.



Ka thënë i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sellem]: *“Therni kurban, ai është sunet nga babai juaj, Ibrahimimi [alejhis-selam].”*<sup>421</sup>

***“Dhe Ne e zëvendësuam atë (Ismailin) me një kurban të madh.”*** (Es-Saffat: 107)

Allahu i Madhërishëm e shpërbleu besimin dhe nënshtrimin e Ibrahimit [alejhis-selam] në këtë botë, duke i dhënë një kurban të madh. Ky ishte një shpërblim i dyfishtë për Ibrahimin. Nga njëra anë, do të gëzonte therjen e kurbanit dhe, nga ana tjetër, do të gëzonte përqafimin e djalit të tij të dashur. Dhe kështu ndodhi.

Nëse dikush në kohën tonë premton, duke thënë: “Edhe unë do të flijoj një kurban si Ibrahimimi [alejhis-selam]...”, atëherë mund të theri një kurban nga kafshët që ngrënia e mishit të tyre është e lejuar dhe që hyjnë në kategorinë për t’u bërë kurban. Por është plotësisht i ndaluar flijimi i njeriut për kurban.<sup>422</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] e shtriu kurbanin që solli Xhebraili [alejhis-selam] në Mina<sup>423</sup> në drejtim të Kabes që ndodhet sot dhe e theri duke thënë “Bismil-lahi Allahu ekber!” (Me emrin e Allahut, Allahu është më i Madhi). Tashmë, thika e preu menjëherë kurbanin në mënyrë perfekte dhe kjo prerje tregoi se mosprerja e Ismailit më parë ishte urdhër nga Krijuesi i gjithësisë.

Allahu i Madhërishëm në Kur’an thotë: ***“Për çdo popull, Ne kemi caktuar një ritual, që ata të përmendin emrin***

<sup>421</sup> Ibn Mâxhe, *Edâhî*, 3 (3127)..

<sup>422</sup> Ibnu’l-Arabî, *Ahkamu’l-Kur’ân*, 4/1608; Cassas, *Ahkamu’l-Kur’ân*, 5/351; Kurtûbî, *Ahkami’l-Kur’ân*, 15/111 - *Fıkhi Açıdan Kur’ân Kısaları*, Abdullah ACAR, f.219.

<sup>423</sup> Ibnu’l-Ethir, *El-Kâmil Fi’t-Tarih*, v.1, f.105

*e Allahut gjatë flijimit të kafshëve, që Ai ua ka dhuruar për ushqim. Zoti juaj është një Zot i Vetëm, prandaj vetëm Atij përuljuni. Dhe jepu lajme të mira atyre që janë të përulur.”* (El-Haxh: 34); *“Mos hani asnjë mish që nuk është therur me emrin e Allahut...”* (El-En’am: 121)

Resulullahu [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] ka thënë: *“Allahu e mallkoftë atë që ther kurban për tjetërkënd përveç Allahut.”*<sup>424</sup>; *“Le të thotë besmelen ai që (ther) kurban.”*<sup>425</sup>; *“Thika vendoset duke thënë “Bismil-lah, Allahu ekber” në fytin e kurbanit.”*<sup>426</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] bëri këtë dua: *“Bëj që të për-mendem për të mirë te breznitë e ardhshme...”*, (Esh-Shuara: 84) pasi e kishte mbushur zemrën me dije dhe besim, gjuhën me argument dhe vërtetim, trupin me zjarr, familjen më parë ia mbështeti Allahut me urdhrin e Tij në shkretëtirë, djalin për flijim, pasurinë për të varfrit...etj.

## BËHET PREJ FAMILJEVE TË ZGJEDHURA FAMILJA E IBRAHIMIT

Thotë Allahu i Madhërishëm në Kur’anin Famëlartë: *“Allahu i zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi të gjithë njerëzit (e kohës së tyre).”* (Ali Imran: 33)

Allahu, Krijuesi i gjithësisë, zgjedh disa njerëz në mesin e njerëzve të tjerë për t’i ngarkuar me detyrën profetike. Këtë

<sup>424</sup> Muslim, *Edâhî*, 8 (1978); Nesâî, *Dahâjâ*, 34; *Musned*, I, 108, 118, 152, 217.

<sup>425</sup> Buhâri, *Edâhî*, 1; Muslim, *Edâhî*, 1; Tirmidhi, *Edâhî*, 1.

<sup>426</sup> Ebû Dâvud, *Dahâjâ*, 4 (2795).

e shikojmë edhe në Kur'anin Famëlartë, në të cilin Allahu i Madhërishëm thotë: ***“Allahu zgjedh të dërguar nga engjëjt dhe njerëzit; me të vërtetë, Allahu dëgjon dhe sheh gjithçka.”*** (El-Haxh: 75)

Veçoritë dalluese të familjes së Ibrahimit [alejhislam]:

a) Allahu i Madhërishëm e shpëtoi Ibrahimin [alejhislam] nga zjarri i Nemrudit.

b) Allahu i Madhërishëm e quajti Ibrahimin Halilullah (Miku i Allahut).

c) Allahu i Madhërishëm e bëri Ibrahimin [alejhislam] babain e profetëve.

ç) Allahu i Madhërishëm e bëri Ibrahimin [alejhislam] imam për njerëzit.

d) Allahu i Madhërishëm e sprovoi me disa sprova të mëdha familjen e Ibrahimit [alejhislam], duke filluar me sprovën e madhe të braktisjes së Haxheres me Ismailin e vogël në shkretëtirën e Mekës, si dhe sakrificicën e pashëmbullit të Ibrahimit [alejhislam] me Ismailin.

Kjo familje që u bë monument i devotshmërisë dhe nënshtrimit, u shpërblye nga Allahu i Madhërishëm duke u përmendur në Kur'anin Famëlartë si dhe u shpërblye duke e përmendur këtë familje çdo ditë në çdo namaz (në lutjet Sal-lil ve Barik) pas familjes së Muhamedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].<sup>427</sup>

- “O Zoti im! Mëshiroje Muhamedin dhe familjen e tij, siç mëshirove Ibrahimin dhe familjen e tij. Pa dyshim, Ti je i Lavdëruar e i Famshëm.

<sup>427</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.199

“O Zoti im! Bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit se me të vërtetë Ti je i Lavdëruar dhe i Famshëm.”<sup>428</sup>

Kur përmendim emrin e Ibrahimit [alejhis-selam] menjëherë nënkuptojmë nënshtrimin dhe adhurimin e pashoq të tij ndaj Allahut të Madhërishëm. Ai i mësoi njerëzisë lirinë e vërtetë, respektin dhe dashurinë. I mësoi, gjithashtu, se dashuria nuk e djeg të dashuruarin.

I mësoi njerëzisë dedikimin e kurbanit. Me anë të vendimit dhe vendosmërisë për ta sjellë në vend flijimin e djalit të vetëm që e priti me dëshirë gjatë gjithë jetës së tij, tregoi se më të Madhit i duhet ofruar kurbanit më i madh në botën e njeriut. Sigurisht që kjo ishte një sprovë për Ibrahimin [alejhis-selam], të cilën e kaloi me sukses. Për këtë arsye edhe në Kur’anin Famëlartë thuhet:

***“Paqja qoftë mbi Ibrahimin!”*** (Es-Saffat: 109)

## NATYRA, THELBI I KURBANIT NË BIBËL

Ngjarja mes Ibrahimit [alejhis-selam] dhe birit të tij në Bibël tregohet në këtë mënyrë:

*“Mbas këtyre gjërave Perëndia e vuri në provë Abrahamin dhe i tha: “Abraham!” Ai u përgjigj: “Ja ku jam.”*

*Dhe Perëndia tha: “Merr tani birin tënd, birin tënd të vetëm, atë që ti do, Isakun, shko në vendin e Moriahve dhe sakrifikoje në një nga malet që do të të tregoj.”*

*Kështu Abrahami u ngrit herët në mëngjes, i vuri samarin gomarit, mori me vete dy shërbyes dhe të birin Isak*

<sup>428</sup> Buhâri, *Enbijâ*, 10; Muslim, *Salat*, 65; Ebu Davud, *Salat*, 183 (978); *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/249.

*dhe çau dru për sakrificën; pastaj u nis drejt vendit ku i kishte thënë Perëndia të shkonte.*

*Ditën e tretë Abrahami ngriti sytë dhe pa së largu vendin.*

*Atëherë Abrahami u tha shërbyesve të tij: “Rrini këtu bashkë me gomarin; unë dhe djali do të shkojmë deri atje dhe do të adhurojmë; pastaj do të kthehemi pranë jush.”*

*Kështu Abrahami mori drutë e sakrificës dhe i ngarkoi mbi Isakun, birin e tij; pastaj mori në dorë të vet zjarrin dhe u nisën rrugës që të dy.*

*Dhe Isaku i foli atit të tij Abraham dhe i tha: “Ati im!” Abrahami iu përgjigj: “Ja ku jam, biri im.” Dhe Isaku tha: “Ja zjarri dhe druri, po ku është qengji për sakrificën?”*

*Abrahami u përgjigj: “Djali im, Perëndia do ta sigurojë vetë qengjin për sakrificën.” Dhe vazhduan rrugën të dy bashkë.*

*Kështu arritën në vendin që Perëndia i kishte treguar dhe atje Abrahami ndërtoi altarin dhe sistemoi drutë; pastaj e lidhi Isakun, birin e tij, dhe e vendosi mbi altar sipër druve.*

*Pastaj Abrahami shtriu dorën dhe mori thikën për të vrrarë të birin.*

*Por Engjëlli i Zotit thirri nga qielli dhe i tha: “Abraham, Abraham!” Ai u përgjigj: “Ja ku jam.”*

*Engjëlli i tha: “Mos e zgjat dorën kundër djalit dhe mos i bëj asnjë të keqe. Tani e di mirë që ti i trembesh Perëndisë, se nuk më ke refuzuar birin tënd, të vetmin bir që ke.”*

*Atëherë Abrahami ngriti sytë dhe shikoi; dhe ja, prapa tij një dash i zënë për brirësh në një kaçube. Kështu Abrahami shkoi, mori dashin e tij dhe e ofroi si sakrificë në vend të të birit.*

*Dhe Abrahami e quajti këtë vend Jehovah Jireh. Prandaj edhe sot e kësaj dite thuhet: “Do të furnizohet mali i Zotit.”*

*Engjëlli i Zotit e thirri për të dytën herë Abrahamin nga qielli dhe i tha:*

*“Unë betohem për veten time, thotë Zoti, se ti e bërë këtë dhe nuk kurseve tët bir, të vetmin bir që ke, unë me siguri do të të bekoj fort dhe do të shumoj pasardhësit e tu si yjet e qiellit dhe si rëra që ndodhet në brigjet e detit dhe trashëgimtarët e tu do të zotërojnë portat e armiqve të tij.*

*Dhe tërë kombet e tokës do të bekohen te pasardhësit e tu, sepse ti iu binde zërit tim.”*

*Pastaj Abrahami u kthye te shërbëtorët e tij, ata u ngritën dhe shkuan bashkë në Beer-Sheba. Dhe Abrahami zuri vend në Beer-Sheba.”<sup>429</sup>*

Nëse do të bëjmë një krahasim të shkurtër mes dy besimeve ose Biblës dhe Kur’anit (bashkë me hadithet), siç e shohim në vargjet e para në Bibël, ka një tregim pak a shumë të ndryshëm nga ai i Islamit. Disa prej tyre mund t’i përmendim në këtë mënyrë:

1. Djali që do të bëhej kurban ishte Is’haku [alejhis-selam] dhe jo Ismaili [alejhis-selam], ndërsa në Islam është treguar nga fillimi që ishte Ismaili [alejhis-selam].<sup>430</sup>

2. Një ndryshim tjetër është dialogu i Ibrahimit [alejhis-selam] me dy shërbëtorët e tij, ndërsa në Islam është shejtani ai që mundohet ta pengojë dhe që i jep vesvese.

3. Ibrahimit [alejhis-selam] në Bibël si fillim i drejtohet birit të tij duke i thënë se kurbanin do e sigurojë Vetë Zoti, ndërsa në Islam Ibrahimit [alejhis-selam] i tregon birit të tij,

<sup>429</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla 22: 1-19.*

<sup>430</sup> *Târih Boyunca Tevhid Mücâdelesi, Mevdudi, v.2, f.46-47.*

Ismailit [alejhis-selam], deri në fillim se kurban i që do të flijohej ishte ai vetë.

4. Ibrahim i [alejhis-selam] këtu tregohet se e lidh dhe tenton ta presë birin e tij pa i treguar dhe është melek i ai që e ndaloj duke i thënë se, tashmë, doli në pah besimi dhe nënshtrimi yt, ndërsa në Islam Ismaili [alejhis-selam] ishte i njoftuar rreth ngjarjes dhe shtrihet vetë dhe i tregon edhe udhëzime babait të tij për ta flijuar atë duke i dhënë disa këshilla që të mos druhet për të sjellë në vend urdhrin e Allahut të Madhërishëm.

5. Një nga dallimet dhe ndryshimet që gjenden tek kjo ngjarje mes dy besimeve është edhe dashi, kurban. Në Bibël tregohet se Ibrahim i [alejhis-selam] ktheu kokën pas dhe pa një dash që ishte ngatërruar në shkurnajë, e mori atë dhe e bëri kurban. Ndërsa në Islam tregohet se dashi zbriti nga qielli bashkë me melekun dhe iu dha direkt për kurban në vend të Ismailit [alejhis-selam].

## CILI DO TË FLIJOHEJ, ISMAILI APO IS'HAKU?

Siç e pamë më lart, kjo ngjarje në Bibël është treguar ndryshe duke përmendur Is'hakun dhe jo Ismailin. Le ta paraqesim edhe një herë këtë: “Mbas këtyre gjërave Perëndia e vuri në provë Abrahamin dhe i tha: “Abraham!” Ai u përgjigj: “Ja ku jam.”

Dhe Perëndia tha: “Merr tani birin tënd, birin tënd të vetëm, atë që ti do, Isakun, shko në vendin e Moriahve dhe sakrifikoje në një nga malet që do të të tregoj.”<sup>431</sup>

<sup>431</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla 22: 1-2.*

Siç e shohim edhe në versetin e mësipërm, këtu tregohet se ai që do të flijohej për kurban ishte Is’haku, si dhe këtu tregohet se Is’haku ishte djali i vetëm i Ibrahimit [alejhisselam].<sup>432</sup>

Këtu mund të themi se bijtë e Israelit mund ta kenë ndryshuar emrin e Ismailit me emrin e Is’hakut, sepse ata vijnë nga Is’haku. Një mendim të tillë e përkrahin edhe disa versete të tjera të Biblës, të cilat bien në kundërshtim me thënien që dhamë më sipër.

*“Por Saraj, gruaja e Abrahamit, nuk i kishte dhënë asnjë fëmijë. Ajo kishte një shërbyese egjiptase që quhej Agar.*

*Kështu Saraj i tha Abrahamit: “Ja, Zoti më ka ndaluar të kem fëmijë; oh, futu te shërbyesja ime, ndofta mund të kem fëmijë prej saj.” Dhe Abrahami dëgjoi zërin e Sarajt.*

*Kështu, pra, Saraj, gruaja e Abrahamit, mbasi ky i fundit kishte banuar dhjetë vjet në vendin e Kanaanëve, mori shërbyesën e saj, Agarin, egjiptasën, dhe ia dha për grua burrit të saj, Abrahamit.”<sup>433</sup>*

*“Engjëlli i Zotit i tha akoma: “Ja, ti je me barrë dhe do të lindësh një djalë dhe do ta quash Ismael, sepse Zoti mori parasysh hidhërimin tënd.”<sup>434</sup>*

*“Abrahami ishte tetëdhjetë e gjashtë vjeç kur Agari lindi Ismaelin për Abrahamin.”<sup>435</sup>*

*Pastaj Perëndia i tha Abrahamit: “Përsa i përket Sarajt, gruas sate, mos e quaj më Saraj, por emri i saj do të jetë Sara.*

<sup>432</sup> M.E.B. *Islâm Ansiklopedisi*, v.5, f.1110.

<sup>433</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 16: 1-3.

<sup>434</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 16: 11.

<sup>435</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 16: 16.



*Dhe unë do ta bekoj dhe do të bëj që ajo të të japë edhe një bir; po, unë do ta bekoj dhe prej saj do të lindin kombe; mbretër popujsh do të dalin prej saj.”*

*Atëherë Abrahami u shtri me fytyrën ndaj tokës dhe qeshi; dhe tha në zemër të tij: “A do të lindë, vallë, një fëmijë nga një njeri njëqindvjeçar? Dhe do të lindë Sara që është nëntëdhjetë vjeç?”*

*Pastaj Abrahami i tha Perëndisë: “Vaj medet që Ismaeli të mund të jetojë para teje!”*

*Por Perëndia iu përgjigj: “Jo, por Sara, gruaja jote, do të lindë një bir, dhe ti do ta quash Isak; dhe unë do të caktoj besëlidhjen time me të, një besëlidhje të përjetshme me pasardhësit e tij.*

*Sa për Ismaelin, unë ta kam plotësuar dëshirën. Ja, unë do ta bekoj, do ta bëj të frytshëm dhe do ta shumoj fort. Ai do të bëhet babai i dymbëdhjetë princërve dhe unë do të bëj prej tij një komb të madh.*

*Por besëlidhjen time do ta përfundoj me Isakun që Sara do të lindë në këtë kohë, vitin e ardhshëm.”*

*Kur mbaroi së foluri me të, Perëndia e la Abrahamin duke u ngritur lart.*

*Atëherë Abrahami mori Ismaelin, djalin e tij, të gjithë ata që kishin lindur në shtëpinë e tij dhe tërë ata që kishte blerë me paratë e veta, tërë meshkujt e shtëpisë së Abrahamit dhe, po atë ditë, por Abrahami ishte nëntëdhjetë e nëntë vjeç kur u rrethpre në mishin e prepucit të tij.*

*Dhe Ismaeli, biri i tij, ishte trembëdhjetë vjeç kur u rrethpre në mishin e prepucit të tij.<sup>436</sup>*

<sup>436</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla 17: 15-25.*

*Dhe Abrahami i dha Isakut gjithçka zotëronte.*<sup>437</sup>

Pak më sipër pamë që ka një kundërshtim mes njohurive – informacioneve të Biblës rreth kurbanit të Ibrahimit, sepse Ismaili [alejhis-selam] derisa mbushi katërmbëdhjetë vjeç ishte djali i vetëm i Ibrahimit. Siç e shohim në kapitullin *Zanafilla 22: 1-2* në të thuhet: “Merr tani birin tënd, birin tënd të vetëm...” dhe i vetmi biri i tij në atë kohë, siç e shohim edhe në vendet e tjera të kapitullit Zanafilla, ishte Ismaili dhe jo Is’haku.

Por, nëse Allahu i Madhërishëm ka kërkuar nga Ibrahim [alejhis-selam] për të flijuar djalin e tij, Is’hakun, atëherë thënia “*djalin tënd të vetëm...*” do të jetë gabim.<sup>438</sup>

Përgëzimi i Ibrahimit [alejhis-selam] me lindjen e Is’hakut në Kur’anin Famëlartë thuhet: “*...dhe i dhanë lajmin e mirë për një djalë të dijshëm.*” (Edh-Dharijat: 28) Djale të dijshëm e shikojmë edhe në suren Hixhr: “*Ata thanë: “Mos u frikëso, se ne po të sjellim një lajm të mirë! Ti do të kesh një djalë të dijshëm!”* (El-Hixhr: 53) Ndërsa në suren Saffat thuhet djalë i mbarë: “*Dhe Ne i dhamë lajmin e gëzuar për një djalë të mbarë!”* (Es-Saffat: 101)

Gjithashtu, shohim se Kur’ani Famëlartë kur i ka treguar bijtë e Ibrahimit [alejhis-selam] i ka treguar edhe me ditëlindjet/radhën e tyre. Këtë mund ta shohim shumë qartë edhe në falënderimin që bëri Ibrahim [alejhis-selam], që tregohet në suren Ibrahim: “*Qoftë lavdëruar Allahu, i Cili në pleqëri më dhuroi Ismailin dhe Is’hakun! Vërtet, Zoti im i dëgjon lutjet!”* (Ibrahim: 39)

<sup>437</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla 25: 5.*

<sup>438</sup> *Tefhimu’l-Kur’ân, Mevdudi, v.5, f.31.*

Në Kur'anin Famëlartë ne shikojmë përgëzimin e lindjes së Is'hakut si dhe Jakubit pas tij në suren Hûd: ***“Gruaja e tij, që rrinte aty, qeshi kur Ne i dhamë lajmin e mirë për Is'hakun e pas Is'hakut - për Jakubin.”***(Hûd: 71)

Ajeti i mësipërm i Kur'anit është një argument tjetër tepër i rëndësishëm ku tregon se nuk ishte Is'haku ai që do të flijohet, sepse do të ishte e pakuptimtë nëse Ibrahim [alejhis-selam] do të shikonte në ëndërr se Allahu i Madhërishëm do t'i japë një pasardhës, të cilin ai do e bëj kurban për hir të Tij, kur njëkohësisht Ibrahim [alejhis-selam] pa se pasardhësi Is'hak do të ketë një pasardhës me emrin Jakub.<sup>439</sup>

Kjo ngjarje në Ungjillin e Barnabës tregohet ndryshe: ***“(O) Abraham! E gjithë bota e di sesa e do ti Zotin; por e si do ta dijë bota dashurinë tënde për Zotin? Patjetër duhet të veprosht diçka për dashurinë e Zotit.”***

Abrahami u përgjigj: ***“Shiko, robi i Zotit është gati të veprojë çfarë të urdhërojë Zoti.”***

Më pas Zoti e thirri Abrahamin dhe i tha: ***“Djalin tënd, djalin e parë (që ka lindur), Ismaelin, merre dhe çoje në mal dhe bëje kurban.”***

Nëse Ismaeli ishte shtatë vjeç kur lindi Is'haku e si mund të jetë Is'haku djali i parë?<sup>440</sup>

***“O robi i Zotit Isa! Përkujto fjalën time që i dhash Ibrahimit një dash për të bërë kurban kur nuk e preu thika djalin e vogël, Ismailin, që deshë ta bëjë kurban për të sjellë në vend fjalën e Zotit. Edhe ti kështu do të veprosht.”***<sup>441</sup>

<sup>439</sup> *Târih-i Taberi*, 1/183; *Tefhimu 'l-Kur'ân*, 5/32.

<sup>440</sup> *Ungjilli Barnabas*, 44. Pjesa, f.121.

<sup>441</sup> *Ungjilli Barnabas*, 13.Pjesa, f.68.

Ka transmetuar Imam Ahmed bin Hanbeli [rahimehullahu alejhi] se ka transmetuar Safije [radijallahu anha], vajza e Shejbe: “Më ka thënë nëna: “Resulullahu [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] e dërgoi Othmanin [radijallahu anhu] në Kabe dhe unë e pyeta: “O Othman! Përse të thirri Resulullahu [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]?”

Më tha se i kishte thënë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “*Kur hyra në Qabe, pashë brirët e dashit (të kurbanit të Ibrahimit). Kam harruar të të them ty për fshehjen e tyre, sepse në Qabe nuk duhet të gjendet asnjë gjë që i tërheq vërejtjen/mendjen atyre që falin namaz.*”<sup>442</sup>

Ka thënë Sufjani [rahimehullahu alejhi]: “Qëndronin brirët e dashit varur në Qabe deri kur ra zjarri. Ata u dogjën bashkë kur u dogj Qabja nga mizori Haxhxhaxh gjatë përpjekjeve të Abdullah bin Zubejrit [radijallahu anhu].”<sup>443</sup>

Ismaili [alejhis-selam] ishte i pari që shkoi në Qabe me nënën e tij, Haxheren. Ai jetonte aty, kështu edhe ky është një argument tepër i fortë në lidhje me bërjen kurban të tij.<sup>444</sup>

Meka është Moriah që përmendet në Zanafilla 22: 1-2 në Dhiatën e Vjetër të Biblës. Këtë e gjejmë në disa mënyra shkrimi të ngjashme si Morijja, Moriah dhe Môrijah. Sipas një komentimi, Moriah ka kuptimin “mund të shikohet nga larg”, “vend i lartë”. Vendi Moriah në Targumin Onkelos është përkthyer “vendi i ibadetit, adhurimit”. Sipas të dhënave të dijetarëve të Talmudit, vendi Moriah është vendi i Arabisë.<sup>445</sup>

---

<sup>442</sup> *Musned*, v.4, f. 68; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/228.

<sup>443</sup> *Ibnu'l-Ethir*, 1/104; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/228.

<sup>444</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1 f.228.

<sup>445</sup> *T.D.V. Islâm Ansiklopedisi* v.23 f.80.

Transmetimi i Muhamed bin Ka’b Kurazi [rahimehullahu alejhi] i jep vendimin përfundimtar kësaj çështjeje, duke thënë: “Një herë, në një mexhlis në të cilin gjendeshim bashkë me prijësin Omer bin Abdulaziz [rahimehullahu alejhi], filloi dilema se cili ka qenë kurhani, Ismaili apo Is’haku.

Në mbledhje gjendej edhe një person që më parë kishte qenë jehudi dhe më pas ishte bërë musliman.

Omer bin Abdulazizi [rahimehullahu alejhi] e pyeti atë person: “Me cilin djalë është urdhëruar Ibrahim [alejhisselam] për të bërë kurban?”

Personi tha: “O Prijësi i besimtarëve! Beto hem në Allahun se Ismaili ishte kurhani. Këtë të vërtetë edhe hebrenjtë e dinë shumë mirë.”<sup>446</sup>

Ka thënë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në një hadith: “*Unë jam biri i dy kurbanëve.*” Në këtë shprehje i pari është Ismaili [alejhisselam] dhe i dyti është babai i tij, Abdullah Ibn Abdulmut-talibi.<sup>447</sup>

Flijimin e Ismailit [alejhisselam] e trajtuam, ndërsa flijimin e babait të Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], Abdullah ibn Abdulmut-talibit, mund ta rikujtojmë shkurtimisht në këtë mënyrë:

Gjyshi i Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], Abdulmut-talibi, pa në ëndërr pusin e zemzemit të mbytur prej një kohe të gjatë.<sup>448</sup>

Abdulmut-talibi, pavarësisht se u mundua shumë për ta hapur pusin e zemzemit me djalin e tij, përsëri nuk mundi

---

<sup>446</sup> *Târih Boyunca Tevhid Mücâdelesi*, Mevdudi, v.2, f.51.

<sup>447</sup> *Târih-i Taberi*, 1/181; *Şeytanın Tuzakları*, Ibni Kajim el-Xhevzi, 1/369.

<sup>448</sup> *Sireti Ibni Hisham*, v.1, f.155.

t'ia arrijë qëllimit.<sup>449</sup> Abdulmut-talibi i hapi duart dhe iu lut Allahut të Madhërishëm, duke thënë: “O Zoti im! Nëse do më dhurosh dhjetë djem<sup>450</sup> dhe nëse e hap ujin zemzem me ta, njërin nga dhjetë djemtë do ta bëj kurban për Ty.”<sup>451</sup>

Krijuesi i gjithësisë, Allahu i Madhërishëm, ia pranoi lutjen dhe i dhuroi dhjetë djem Abdulmut-talibit.<sup>452</sup>

Më pas Abdulmut-talibi e hapi pusin e zemzemit. Filloi t'i gostisë haxhilerët me ujin e tij. Një natë në ëndërr iu tha: “O Abdulmut-talib! Sille në vend fjalën e dhënë!”<sup>453</sup>

Abdulmut-talibi u zgjua i frikësuar. Në mëngjes bëri kurban një dash me qëllim që të mund ta lajë këtë premtim. Por përsëri të nesërmen iu tha në ëndërr: “Kurbanin bëje të madh!”

Abdulmut-talibi më pas bëri kurban bagëti dhe deve, por për secilën herë iu tha: “Kurbanin bëje akoma më të madh!” Herën e fundit iu rikujtua hapur dhe qartë: “Bëj kurban një djalë që ke premtuar më parë.”<sup>454</sup>

Abdulmut-talibi u zgjua i frikësuar dhe, pasi i thirri të gjithë djemtë e tij, u tregoi gjithçka kishte ndodhur dhe ata ranë dakord të bëhet kurban ai që do t'i binte shorti.

Filloi hedhja e shortit. Shorti i ra Abdullahut, djalit më të vogël dhe të cilin Abdulmut-talibi e donte më shumë. Ky është babai i Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].<sup>455</sup>

<sup>449</sup> *Doğuştan Günümüze Büyük İslâm Târihi*, v.1, f.189.

<sup>450</sup> *El-Kâmil Fi't-Târih, Ibnu'l-Ethir*, v.1, f.102.

<sup>451</sup> *Ibnu'l-Ethir*, 1/102; *Târih-i Taberi*, 1/181, 460.

<sup>452</sup> *Doğuştan Günümüze Büyük İslâm Târihi* v.1, f.189.

<sup>453</sup> Nedhr: Është një zotim të cilin e bën besimtari nga dëshira e tij. Zotuesi, është në gjendje të caktojë kohën, vendin dhe llojin e zotimit. (*Ahkâmi'l-Kur'ân*, Imam Kurtûbî, v.14, f.536-37).

<sup>454</sup> *Hz. İbrahim*, Mahmud Sami RAMAZANOĞLU, f.173.

<sup>455</sup> *Sireti Ibni Hisham*, 1/206; *Târih-i Taberi*, 1/181.

Abdulmut-talibi e mori thikën dhe Abdullahun dhe e çoi tek vendi i therjes së kurbanëve.<sup>456</sup>

Kur e dëgjuan zotërinjtë e Mekës këtë vendim të Abdulmut-talibit, shkuan menjëherë dhe e ndaluan<sup>457</sup> atë nga ky vendim, duke i thënë: “Nëse ti do e therësh djalin tënd kemi frikë se kjo vepër do na mbetet adet në kohët e ardhshme.”<sup>458</sup>

Më pas kërkuan që të gjejnë një dijetar për të gjetur një rrugëzgjdhje tjetër.<sup>459</sup>

Dijetari i udhëzoi në këtë mënyrë: “Gjaku i një personi në atë kohë ishte dhjetë deve. Vendosi dy shkopinj, njëri prej tyre të jetë i Abdullahut e tjetri të jetë i deveve. Kështu që sa herë që i bie Abdullahut përsëriteni përsëri dhe për çdoherë shtoni nga dhjetë deve derisa t’i bjerë shorti shkopit të deveve.”<sup>460</sup>

Filloi hedhja e shortit, por ai vazhdimisht i binte Abdullahut dhe kështu numri i deveve filloi të shtohet. Kur u mbush numri njëqind i deveve, atëherë shorti i ra deveve.

Abdulmut-talibi e falënderoi Zotin ngaqë e nxori nga kjo vështirësi e madhe shpirtërore dhe menjëherë theri për kurban njëqind deve. Kështu që edhe Abdullahu shpëtoi pa u bërë kurban.”<sup>461</sup>

Për këtë arsye Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] tha: “*Unë jam djali i dy kurbanëve.*” I pari stërgjyshi, Ismaili [alejhis-selam], dhe i dyti Abdullahu, babai i tij.<sup>462</sup>

<sup>456</sup> *Hz. Muhamed'in Hayati*, Martin LINGS, f.24; *Târih-i Taberi*, 1/181.

<sup>457</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.181.

<sup>458</sup> *Sireti Ibni Hisham*, v.1, f.207.

<sup>459</sup> *Doğuştan Günümüze İslâm Târîhi*, 1/189; *Peygamberler Târîhi*, Ahmed BEHÇET, f.420.

<sup>460</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.181-182.

<sup>461</sup> *Sireti Ibni Hisham*, 1/25; *Ibnu'l-Ethir*, 1/102; *Târih-i Taberi*, 1/182.

<sup>462</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.181.

Nga ajo kohë e më pas pagimi i gjakut nga dhjetë u bërë njëqind deve.<sup>463</sup>

## **IBRAHIMI [alejhis-selam] SHPËRBLEHET ME DHËNIEN E IS'HAKUT [alejhis-selam]**

Ibrahimi [alejhis-selam] është halilullah (miku i Allahut të Madhërishëm). Në zemrën e Ibrahimit [alejhis-selam] nuk gjendej dashuri tjetër pos dashurisë së Allahut të Madhërishëm dhe një ditë iu drejtua Krijuesit të gjithësisë, Allahut të Madhërishëm, me një lutje të sinqertë për të pasur një djalë. Lutja e Ibrahimit [alejhis-selam] u pranua dhe Allahu i Madhërishëm i dhuroi Ismailin [alejhis-selam]. Allahu i Madhërishëm e sprovoi Ibrahimin [alejhis-selam] me flijimin e djalit që e donte shumë, por përsëri u pa shumë qartë që Ibrahimi [alejhis-selam], pavarësisht se e donte shumë djalin e tij të vetëm, përsëri në zemrën e tij nuk mbante dashuri tjetër më të madhe sesa dashuria e Allahut të Madhërishëm dhe, për këtë arsye kur u urdhërua për flijimin e tij, menjëherë tentoi ta sjellë në vendin e duhur urdhrin e Allahut të Madhërishëm.<sup>464</sup>

***“Paqja qoftë mbi Ibrahimin!” Ja, kështu, Ne i shpërblejmë punëmirët. Ai ka qenë vërtet një nga robërit Tanë besimtarë.”*** (Es-Saffat: 109-111)

Pasi Allahu i Madhërishëm e pa edhe një herë nënshtrimin dhe dashurinë e Ibrahimit ndaj Tij, këtë herë e përgëzoi edhe me një djalë tjetër që do të quhej Is'hak dhe pas tij do të vinte edhe një djalë tjetër me emrin Jakub.<sup>465</sup>

<sup>463</sup> Fetavaji Hindijje, 12/527; Târih-i Taberi, 1/182.

<sup>464</sup> Şeytanın Tuzakları, İbni Kajim el-Xhevzi, v.1, f.369.

<sup>465</sup> Târih-i Taberi, Muhamed Xherih-et-Taberi, v.1, s183.



Kur njeriu e kalon sprovën me sukses, shpërblimi i saj është akoma më i madh sesa vështirësia e saj. Sara, gruaja e Ibrahimit [alejhis-selam], ishte prej besimtareve të para që e besuan profetësinë e Ibrahimit [alejhis-selam]. Kur ishin të rinj dëshironin të kishin të paktën një pasardhës, por, pasi u sprovuan dhe nuk lindi fëmijë, Sara, tashmë, e kishte prerë shpresën, sepse ishte e moshuar.

Allahu i Madhërishëm dëshiroi që melekët që po shkonin tek Lûti [alejhis-selam] më parë të shkonin tek Ibrahimimi [alejhis-selam] dhe ta përgëzonin atë për një pasardhës me Saran.<sup>466</sup>

***“Të dërguarit Tanë, i sollën Ibrahimit lajmin e mirë dhe i thanë: “Paqe mbi ty!” Ai u përgjigj: “Paqja qoftë mbi ju!” Dhe me të shpejtë u solli atyre një viç të pjekur.”*** (Hûd: 69)

***“A e ke dëgjuar historinë e mysafirëve të nderuar të Ibrahimit? Ata hynë tek ai e i thanë: “Paqe!” - dhe ai u tha: “Paqe, o njerëz të panjohur!” E pa u vënë re, ai shkoi te njerëzit e shtëpisë dhe solli një viç të majmë. Pastaj ua afroi atyre e u tha: “A nuk po hani?”*** (Edh-Dharijat: 24-27)

***“Ata shkuan tek ai dhe i thanë “Paqe!”, por ai tha: “Në të vërtetë, Ne kemi frikë nga ju.”*** (El-Hixhr: 52)

Ibrahimimi [alejhis-selam] ishte tepër mikpritës dhe miqtë i gostiste gjithmonë në mënyrën më të mirë (për këtë arsye atij i është thënë edhe Ebû Dafjan – babai i mikpritësve).<sup>467</sup> Kjo ishte nga zakonet e palëkundshme të tij.<sup>468</sup> Rreth mikpritjes dhe dialogun mes Ibrahimit [alejhis-selam] dhe melekëve mund t'i përmendim në këtë mënyrë:

<sup>466</sup> *Târih-i Taberi*, 1/183; *Tefhimu 'l-Kur 'ân*, Mevdudi, 5/32.

<sup>467</sup> *Târih-i Ibn Asakir*, 2/157 - *Tefsirli Peygamberler Tarihi*, Ubeydullah Bayram TEKÎN, f.68.

<sup>468</sup> Muvatta, *Sifatu'n Nebijj*, 4; *Târih-i Taberi*, 1/172.

Në suren Dharijat:

*“A e ke dëgjuar historinë e mysafirëve të nderuar të Ibrahimit? Ata hynë tek ai e i thanë: “Paqe!” - dhe ai u tha: “Paqe, o njerëz të panjohur!”*

*E pa u vënë re, ai shkoi te njerëzit e shtëpisë dhe solli një viç të majmë. Pastaj ua afroi atyre e u tha: “A nuk po hani?” Dhe ndjeu frikë prej tyre, por ata i thanë: “Mos u frikësol!” dhe i dhanë lajmin e mirë për një djalë të dijshëm.*

*Atëherë erdhi gruaja e tij, që, duke thërritur dhe rrahur fytyrën, tha: “Vallë, a mundem (të lind) unë, plaka shterpë?”*

*Ata thanë: “Kështu ka qenë vullneti i Zotit tënd. Ai ësh-të vërtet i Urtë dhe i Gjithëdijshëm.” (Edh-Dharijat: 24-30)*

Në suren Hûd:

*“Të dërguarit Tanë, i sollën Ibrahimit lajmin e mirë dhe i thanë: “Paqe mbi ty!” Ai u përgjigj: “Paqja qoftë mbi ju!” Dhe me të shpejtë u solli atyre një viç të pjekur.*

*Kur pa se ata nuk po i zgjasnin duart tek mishi, nuk i pëlqeu dhe ndjeu frikë prej tyre. (Engjëjt) thanë: “Mos u frikëso, Ne jemi dërguar te populli i Lutit”. Gruaja e tij, që rrinte aty, qeshi kur Ne i dhamë lajmin e mirë për Is’hakun (Is’hak në hebraisht do të thotë: “qesh me gëzim”)<sup>469</sup> e pas Is’hakut - për Jakubin. (Kur melekët i përcollën përgëzimin e Allahut të Madhërishtëm Ibrahimit [alejhisselam] gruaja e tij, Sara, ishte në këmbë dhe buzëqeshi).<sup>470</sup> Ajo tha: “Ah! E mjera unë! A mos vallë, kështu plakë do të lind unë, (më pas kur lindi Is’haku populli u habit se si ka mundësi të bëjnë fëmijë këta dy të*

<sup>469</sup> T.D.V Islâm Ansiklopedisi, v.21, f. 268.

<sup>470</sup> El-Xhamiu ’li-Ahkâmi ’l Kur’ân, 9/104; Târih-i Taberi, 1/172.

moshuar burri ishte rreth njëqind dhe gruaja rreth nëntëdhjetë vjeç)<sup>471</sup> ***ndërkohë që edhe burri im është plak! Me të vërtetë, kjo është diçka e jashtëzakonshme!***

(Të flasësh me melekët, të marrësh përgëzim prej tyre, si dhe dëgjimi i thënies, mendimit dhe fjalëve të tua prej tyre.... këto janë ngjarje që kanë ndodhur si për burrat, po ashtu, edhe për gratë. Shikojmë se, siç është përgëzuar babai i profetit, po ashtu, është përgëzuar edhe nëna e profetit).<sup>472</sup>

***Ata (engjëjt), thanë: “A mos vallë, po çuditësh me urdhrin e Allahut? Mëshira e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë mbi ju – familjen e të Dërguarit. Me të vërtetë, Ai është i Falënderuar dhe i Lavdëruar!”***

***Pasi i kaloi frika Ibrahimit dhe i erdhi lajmi i gëzuar, ai polemizoi me të dërguarit Tanë për popullin e Lutit. Vërtet, Ibrahimit ishte i butë, i dhembshur e vazhdimisht i kthyer (tek Allahu). “O Ibrahim, shmangu prej kësaj! Me të vërtetë, erdhi urdhri nga Zoti yt dhe ata do t’i gjejë dënimi i pashmangshëm.” Kur i erdhën të dërguarit Tanë Lutit, ai u hidhe-rua, ndjeu një shtrëngim në shpirtin e tij dhe tha: “Kjo është ditë e rëndë!” (Hûd: 69-77)***

Në suren Hixhr:

***“Ata shkuan tek ai dhe i thanë “Paqe!”, por ai tha: “Në të vërtetë, ne kemi frikë nga ju.”***

***Ata thanë: “Mos u frikëso, se ne po të sjellim një lajm të mirë! Ti do të kesh një djalë të dijshëm!” Ibrahimit tha: “Po ma sillni këtë lajm të mirë, edhe pse më ka goditur pleqëria?! Mbi ç’bazë po ma sillni këtë lajm?” (Ibrahimi [alejhisselam])***

<sup>471</sup> *Târih-i Jakubi*, 1/26; *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, 1/194; *M.E.B. İslâm Ansiklopedisi*, 5/1074.

<sup>472</sup> *Celâl ve Cemal Aynasında Kadın*, Cevâdi AMULÎ, f.135.

me këtë shprehje nuk kishte për qëllim Istib'ad – “kundërsh-tim”. Por, përkundrazi, ai këtu ka pasur për qëllim “Isti'xhab” mënyra, shprehja e habisë, papritshmërisë dhe kjo ndodh tek njeriu përballë një ngjarjeje të re dhe mahnitëse.)<sup>473</sup>

*Ata u përgjigjën: “Ne ta japim lajmin e mirë me vërtetësi, prandaj mos u bëj shpresëhumbur!” Ibrahim i tha: “E kush mund ta humbë shpresën nga mëshira e Zotit të vet, përveç atyre që janë të humbur”?! (Ibrahimi [ale]his-selam] më parë kishte bërë një lutje që të kishte edhe pasardhës me gruan Sara).<sup>474</sup>*

*Ai i pyeti: “Cili është qëllimi juaj, o të dërguar?”*

(Ata) *thanë: “Ne jemi dërguar te një popull keqbërës (për ta shkatërruar të gjithin), përveç familjes së Lutit. Ne do t'i shpëtojmë të gjithë ata, përveç gruas së tij; për atë Ne kemi caktuar si dënim që të mbetet pas me të tjerët.” (El-Hixhr: 52-60)*

Në suren Saffat:

*“E pa dyshim, ata të dy janë nga robërit Tanë besimtarë.” (Es-Saffat: 112)*

Në suren Ankebut:

*“Dhe, pasi të dërguarit Tanë i sollën lajmin e mirë Ibrahimit, i thanë: “Ne do t'i zhdukim banorët e këtij vendbanimi, sepse banorët e tij janë vërtet keqbërës.”*

*Ai (Ibrahimi) tha: “Por atje banon edhe Luti!” Ata thanë: “Ne e dimë më mirë kush është atje. Ne do ta shpëtojmë atë dhe familjen e tij, përveç gruas së tij; ajo do të qëndrojë me ata që do të mbesin (për t'u dënuar).” (El-Ankebut: 31-32)*

Në suren Rûm:

<sup>473</sup> *Celâl ve Cemâl Aynasında Kadın*, Cevadi AMULÎ, f.133.

<sup>474</sup> *El-Xhamiu 'li-Ahkâmi 'l Kur'ân*, Imam Kurtûbî, v.9, f.107.

***“Andaj, shikoji gjurmët e mëshirës së Allahut, si e gjallëron tokën pas shkretimit të saj. Vërtet, Ai do t’i ringjallë edhe të vdekurit, se Ai është i Fuqishëm për çdo gjë.”*** (Er-Rûm: 50)

Fahreddin er-Rrazi ka thënë: “Me thënien: ***“...dhe i dhanë lajmin e mirë për një djalë të dijshtëm.”*** tek ajetet që dhamë më lart nënkuptojmë se përgëzimi ishte për një djalë, i cili edhe ai do të jetë profet.”<sup>475</sup>

Në suren Ibrahim:

***“O Zoti ynë, Ti e di vërtet çfarë fshehim e çfarë shfaqim haptazi. Allahut nuk i fshihet asgjë, as në Tokë, as në qiell. Qoftë lavdëruar Allahu, i cili në pleqëri më dhuroi Ismailin dhe Is’hakun! Vërtet, Zoti im i dëgjon lutjet!”*** (Ibrahim: 38)

Is’haku [alejhis-selam] ishte i gjatë, me sy të zinj, me fytyrë të bukur, fliste mirë, flokët dhe mjekrën e kishte të bardhë.<sup>476</sup> Is’haku [alejhis-selam] i përngjante shumë babait të tij, Ibrahimit [alejhis-selam].<sup>477</sup>

Në lidhje me këtë le të shohim shkurtimisht se çfarë përmban Bibla:

“Por Abrahami dhe Sara ishin pleq, në moshë të kaluar, dhe Sara nuk kishte më të përmuajshmet e grave. Prandaj Sara qeshi me veten e saj, duke thënë: “Plakë si jam, a do të kem unë gëzime të tilla, meqenëse vetë zoti im është plak?”<sup>478</sup>

“Dhe Sara u ngjiz dhe lindi një djalë me Abrahamin në pleqërinë e tij, në kohën e caktuar që Perëndia i kishte thënë. Dhe Abrahami ia vuri emrin Isak birit që i kishte lindur dhe që Sara kishte pjellë. Pastaj Abrahami e rrethpreu birin e tij Isak

<sup>475</sup> *Tefsir-i Kebir*, Fahrudin er-Razi, v.14, f.115.

<sup>476</sup> *Peygamberler Târihi*, Muhamed Asım KÖKSAL, v.1, f.240.

<sup>477</sup> Hâkim-i Mustedrek, 11/557; *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, 1/240.

<sup>478</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla* 18:11-12.

kur ishte tetë ditësh, ashtu siç e kishte urdhëruar Perëndia. Por Abrahami ishte njëqind vjeç, kur i lindi biri i tij Isaku. Dhe Sara tha: “Perëndia më ka dhënë çka duhet për të qeshur, kushdo që do ta dëgjojë ka për të qeshur bashkë me mua.” Dhe tha, gjithashtu: “Kush mund t’i thoshte Abrahamit që Sara do të mëndte fëmijë? Sepse unë i linda një djalë në pleqërinë e tij.”<sup>479</sup>

## RINIA E ISMAILIT [alejhis-selam]

Kur erdhën dhe u vendosën në Meke, xhurhumët jetonin me ushqim gjuetie. Për këtë arsye dilnin jashtë Haremit të Mekes për të gjuajtur.<sup>480</sup>

Ismaili [alejhis-selam] kur u rrit dhe erdhi në moshën e adoleshencës mësoi nga xhurhumët gjuetinë me shigjetë dhe hark.<sup>481</sup> Këtë e shikojmë edhe në Zanafilla në Dhiatën e Vjetër të Biblës, ku thuhet: “...ai u rrit, banoi në shkretëtirë dhe u bë shenjëtar harku”<sup>482</sup> Ai mësoi shumë mirë harkun arab dhe kishte një nishan tepër të saktë.<sup>483</sup>

Njëherë kur po bënë garë në hedhje shigjete një grup nga fisi eslem, Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] u tha atyre: “*O Bijtë e Ismailit! Hidhni shigjetë, stërgjyshi juaj ishte një usta/specialist në hedhjen e shigjetës.*”<sup>484</sup>

Ismaili [alejhis-selam] ishte një gjuetar tepër i mirë me shigjetë harku. Gjuante jashtë Haremit të Mekes. I pëlqente

<sup>479</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla 21:2-7.*

<sup>480</sup> *Ahbaru Meke, Ezraki, f.57.*

<sup>481</sup> *Peygamberler Târihi, M. Asım KÖKSAL, v.1, f.194.*

<sup>482</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla 21: 20.*

<sup>483</sup> *Peygamberler Târihi, M. Asım KÖKSAL, v.1, f.194.*

<sup>484</sup> *Buhâri, Xhihad, 78; Enbiâ, 12; Menakib, 4..*

shumë të gjuante, të hipte në kalë dhe në veçanti të zbuste kuajt e egër.<sup>485</sup> Ismaili kishte metodat e tij që i zbuste ata. Përpara tij nuk i hipte/nuk mund t'i hipte askush kuajve të egër. Ismaili [alejhis-selam] është i pari që i ka hipur kalit të egër.<sup>486</sup>

Ka thënë Resulullahu [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në një hadith: *“Mbani kuaj! Merrini dhe lini trashëgimi kuajt, sepse kjo është trashëgimia nga babai juaj Ismaili.”*<sup>487</sup>

*“Është lidhur nyje mirësie në ballët e kuajve deri në Kiamet.”*<sup>488</sup>

*“Kuajt janë tre llojesh: një lloj i tyrë është ngarkesë për pronarin; një lloj është mbulesë për pronarin; dhe një lloj është shpërblim për pronarin. Kali që është ngarkesë për pronarin është kali që e ushqen për t'u krenuar dhe për armiqësi kundër muslimanëve. Ky lloj kali është ngarkesë për të.*

*Ndërsa kali që është mbulesë është kali që e ushqen për në rrugë të Allahut të Madhërishëm; gjithashtu nuk harron se është haku i Allahut të Madhërishëm në qafën dhe në shpinën e tij. Ky kalë është një mbulesë për të.*

*Ndërsa kali që është shpërblim për pronarin është kali që ushqehet në bahçe ose në livadh për në rrugën e Allahut të Madhërishëm dhe muslimanët. Një kalë i tillë për çdo gjë që ha në bahçe apo në livadh i dhuron aq sevape/shpërblim pronarit të tij. Edhe për plehun e tij ai fiton sevape/mirësi.*

*I dhurohen sevape/mirësi pronarit të kalit edhe për gjurmët dhe papastërtinë e tij nëse kali e këput litarin dhe bën një apo dy turne. Gjithashtu, Allahu i shkruan sevape*

<sup>485</sup> *El Bidaje ve'n-Nihaje*, Ibn Kethir, v.1, f.283.

<sup>486</sup> *El Bidaje ve'n-Nihaje*, 1/283; *Peygamberler Târihi*, 1/194.

<sup>487</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f.283.

<sup>488</sup> Muslim, *Zekât*, 6 (987/26); Tirmidhi, *Xhihad*, 19; Nesâi, *Hajl*, 4; Ibn Mâxhe, *Tixharet*, 69 (2305).

*pronarit të kalit sa gëlltitjet dhe masa e ujit që të ketë pirë kali kur kalon pranë lumit edhe nëse pronari nuk ka kaluar me qëllim që t'i japë ujë kalit.*<sup>489</sup>

Ismaili e kishte shumë pasion të gjuante me shigjetë, me hark apo hedhjen-kërcimin gjatë gjuetisë.<sup>490</sup>

Ismaili [alejhis-selam] ishte aq i aftë dhe i mprehtë si në zgjuarsi, po ashtu, edhe në gjueti. Për këtë arsye xhurhumët i dhuruan Ismailit shtatë dhen dhe kjo ishte pasuria e parë e Ismailit. Pas dhuratës së dhenëve Ismaili [alejhis-selam] filloi edhe punën e çobanit.<sup>491</sup>

Ismaili [alejhis-selam] i kulloste bagëtitë përreth Haremit. **“...dhe shikoni pamje të bukura, kur i ktheni nga kullota dhe, kur i nxirrni në kullotë.”** (En-Nahl: 6) Ndërsa nëna jonë, Haxherja, i milte qumështin në mëngjes dhe në mbrëmje, si dhe me leshin e tyre mundohej të siguronte jetesën.<sup>492</sup>

**“Kafshët Ai i ka krijuar për ju. Njëpërmjet tyre ju siguron rroba të ngrohta dhe dobi të tjera. Prej tyre ju ushqeheni.”** (En-Nahl: 5)

Në të njëjtën kohë, Ismaili përfitoi respektin dhe dashurinë e njerëzve, duke u mësuar arabishten me gramatikë të xhurhumëve.<sup>493</sup>

Sipas transmetimit, thuhet se arabishten më parë e kanë folur xhurhumët dhe vëllezërit Katuran.<sup>494</sup>

<sup>489</sup> Muslim, *Zekât*, 6 (987/26).

<sup>490</sup> *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, v.1, f.194.

<sup>491</sup> *Şamil, İslâm Ansiklopedisi*, 4/148-149; *El Mizan*, 1/409.

<sup>492</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.128.

<sup>493</sup> Ibn Sa'd, *Tabakat*, 1/51; Ibnu'l Esir, 1/98; *El Bidaje ve'n-Nihaje*, 1/282.

<sup>494</sup> *Texhrid-i Sarih Terxhemesi* ve Şerhi, v.9, f.123.



Ismaili [alejhis-selam] ishte trembëdhjetë vjeç kur e mësoi arabishten. Në të njëjtën kohë ishte edhe i vetmi në Hixhaz që e fliste atë rrjedhshëm dhe pastër.<sup>495</sup>

Ka thënë Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: *“Ismaili është (i pari) që ka folur arabishten fasih. Atëherë (Ismaili) ishte një djalë katërmëdhjetë vjeç.”*<sup>496</sup>

E kanë pyetur sahabët Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “O i Dërguari i Allahut! Si u bëre ti më i miri ynë të flasësh fasih dhe me shprehje më të mirë?”

Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] është përgjigjur: *“Kur ishte gati në prishje arabishtja, më erdhi Xhebraili [alejhis-selam] dhe ma mësoi gjuhën tepër të pastër si e ka folur babai im, Ismaili [alejhis-selam].”*<sup>497</sup>

## HAXHERJA I THA LEB-BEJK (I PËRGJIGJEM) THIRRJES SË KRIJUESIT TË SAJ

Nëna jonë, Haxherja, tashmë, kishte ardhur në moshën nëntëdhjetë vjeçe dhe si të gjithë shpirtrat e tjerë **“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen...”** (Ali Imran: 185) iu përgjigj thirrjes “Leb-bejk” nga kjo botë e shkurtër për në botën e përhershme<sup>498</sup> kur njëkohësisht ishte në përgatitjen e martesës së Ismailit.<sup>499</sup>

---

<sup>495</sup> *Ibnu'l-Ethir*, 1/98; *El Bidaje ve'n-Nihaje*, 1/283.

<sup>496</sup> *El-Bidaje ve'n-Nihaje*, Ibn Kethir, v.1, f.283.

<sup>497</sup> *Kenzu'l-Umal*, Alijju'l Muttaki, v.11, f.490..

<sup>498</sup> *Peygamberler Târihi*, A.Lûtfi KAZANCI, 1/245; *Peygamberler Târihi*, M.Asim KÖKSAL, 1/195.

<sup>499</sup> *Allah'a Davette Peygamberlerin Metodu*, Muhamed Surur bin Naif Zeyne'l-Abidin, f.306

Ismaili [alejhis-selam] ishte rreth njëzet vjeç kur ndërroi jetë nëna e tij. Ismaili [alejhis-selam] e varrosi atë në Qabe.<sup>500</sup> Vendi në të cilën u varros Haxherja quhej Hixhr, ky vend në të njëjtën kohë ishte edhe vendi në të cilin Ibrahim [alejhis-selam] e la Haxheren me Ismailin e vogël.<sup>501</sup>

Vendi në të cilën u varros nëna jonë, Haxherja, në kohën tonë gjendet në pjesën veriore të Qabes në të cilën gjendet Altinolluk. Është vendi në formën e gjysmë hënës dhe është i thurur me mur/Hatim.<sup>502</sup> Ky vend që ka emrin Hixhr renditet brenda Qabes.<sup>503</sup> Transmeton Aisheja [radijallahu anha] se e ka pyetur Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “A është Hatimi prej Qabes?” dhe ai tha: “*Po, është prej Qabes.*”<sup>504</sup>

Resullullahu [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në kohën pasi i kishte ardhur profetësia, pavarësisht se dëshiroi t'i zgjerojë muret veriore të Qabes nga ana Hixhr, hoqi dorë nga ky mendim duke menduar se mos shkaktonte ndonjë kaos për muslimanët e rinj. Në lidhje me këtë Aisheja [radijallahu anha] tregon:

*“O Aishe! Sikur populli të mos ishte i sapo dalë nga shirku (sikur ta kishin përvetësuar Islamin (besimin) plotësisht në zemrat e tyre), do ta shembja Qaben dhe do e ndërtoja në një vend afër dhe i vendosja dy dyer, njërën në anën lindore dhe tjetrën në anën perëndimore. Gjithashtu, i shtoja*

<sup>500</sup> *Ibnu'l-Ethir*, 1/101, 105, 125; *Peygamberler Târîhi*, Prof. Dr. Ismâil YİĞİT, f.290.

<sup>501</sup> *Misrîh Hacer*, Abdulhamid Xhûde es-Sehhar, f.177.

<sup>502</sup> *Texhrid-i Sarih Muhtasar Buhâri Sherhi*, v.6, f.17; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/284; *Ibni Sa'd-Tabakat*, v.1, f.52; *Mukaddime*, Ibn Haldun, 2/474..

<sup>503</sup> *Texhrid-i Sarih Muhtasar Buhâri Sherhi*, 6/17; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/284; *Ibni Sa'd-Tabakat*, 1/52.

<sup>504</sup> *Buhârî, Haxh*, 42.

*gjashtë arshin/kut në anën Hixhr, sepse kurejshit e kanë zvogëluar Qaben kur e kanë ndërtuar (gjatë rregullimit).*<sup>505</sup>

Muslimanët që shkojnë për të bërë Umre apo Haxhin vijnë nga ana Ruknu Jemani për të filluar tavafin dhe me fytyrë nga Haxheru’l-Esvedi dhe thonë: “Bismil-lah, Allahu Ekber (Me emrin e Allahut, Allahu është më i Madhi).” Dhe kështu e vazhdojnë tavafin në anën e majtë. Gjatë tavafit duhet kaluar nga ana e jashtme e Hixhri Ismail (Hatim), sepse është e ndaluar kalimi në të.

Krijuesi i gjithësisë, Allahu i Madhërishëm, e ka shpërblyer kështu në vendin më të mirë një grua që u sprovua me shumë sprova të rënda dhe të ndryshme, e cila i kaloi me suksese me besimin e saj të palëkundshëm. Pavarësisht se ngjyra e saj ishte e zezë, brendia e zemrës, shpirtit të saj ishte e ndriçuar me nurin e besimit të pastër dhe të palëkundshëm në Allahun e Madhërishëm. Kështu që ajo u bë monument i besimit të pastër dhe nënshtrimit të Allahut të Madhërishëm dhe do të jetë shembull për të gjithë besimtarët e besimtare të që janë në vështirësi apo në rehati deri në Ditën e Kiametit.

## HAXHERJA ËSHTË AJO QË...

Haxherja është një gur themeltar i gruas në Islam me qëndrimin e saj që ka ndjekur në mbrojtje të besimit. Allahu i Madhërishëm i mundësoi asaj të jetë grua e një profeti dhe nëna e një profeti. Si dhe e ka shpërblyer duke e vendosur në Mekë.

Pavarësisht se ajo ishte një shërbëtoe e zezë përsëri Allahu i Madhërishëm e ka zgjedhur në mesin e panumërt të krijesave, në mesin e mijërave grave dhe e bëri atë prej grave

---

<sup>505</sup> *Kutubi Sitte*, v.13, f.169-170.

të nderuara. Në të njëjtën kohë, ne këtu shohim se takvaja – devotshmëria ndaj Allahut të Madhërishëm është më e lartë se çdo ngjyrë, racë etj.

Ajo u sprovua me largimin nga shtëpia dhe largimin me kilometra të tëra larg njerëzve dhe Ibrahimit [alejhis-selam]. U braktis në shkretëtirë të pabanuar, por në realitet një sprovë e tillë për ata që e kalojnë me sukses nuk do të ishte një dënim, por do të ishte një shpërblim aq i madh sa që do të përmendet dhe do të jetë shembull për të gjithë deri në Ditën e Kiametit.

Allahu i Madhërishëm i dhuroi asaj ujin më të pastër dhe më të mirë të botës, ujin e zemzemit. Gjithashtu, ajo nderohet, përkujtohet me mall dhe merr mësim, kurajo, guxim etj., nga historia e saj çdo besimtar dhe besimtare që shkon në Umre apo në Haxh. Në çdo Umre apo Haxh kujtohet Haxherja, biri i saj, Ismaili [alejhis-selam], dhe Ibrahim [alejhis-selam]. Në këtë mënyrë mund të shohim shumë qartë se sa i kënaqur ishte Allahu i Madhërishëm prej tyre dhe ata prej Allahut të Madhërishëm.

Haxherja e fitoi lirinë dhe sigurinë e saj me anë të besimit. Kjo ishte Haxherja gruaja e profetit Ibrahim [alejhis-selam] dhe nëna e profetit Ismail [alejhis-selam], e cila e bëri thirrjen islame për në rrugën e drejtë të Allahut të Madhërishëm gjatë gjithë jetës së saj. Allahu i Madhërishëm edhe profetin e fundit, Muhamedin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e ka sjellë nga biri i Haxheres, Ismaili [alejhis-selam].

Çdo muslimane duhet të mundohet të jetë një Haxhere, me qëllim që kur të lindi nevoja të ketë nëna si Haxherja për të ndriçuar rrugën. Të dijë shumë mirë se çfarë është nënshtrimi i plotë përpara Allahut të Madhërishëm, me qëllim që kurrë të mos i humbi shpresat dhe besimin edhe kur

është e dobët dhe e vetmuar. Do të shoh se një qëndrim i tillë do ta shpërthejë ujin më të mirë të botës në mesin e shkretëtirës, kështu që në këtë mënyrë do ta largojnë etjen edhe brezat e tjerë dhe vlera e saj e vërtetë duhet të jetë në shpirtin dhe mendjen ku jeton besimi i pastër dhe i vërtetë dhe jo në tokë, në vendin e lindjes, racës, ngjyrës apo pamjes fizike.

### MARTESA E ISMAILIT [alejhis-selam] DHE PASARDHËSIT E TIJ

Ismaili [alejhis-selam] ishte një djalosh me një trup të mirë, me flokë të bardhë, me një fytyrë të bukur dhe të shndritshme, me kokë normale, sy të mëdhenj, me hundë të madhe, me qafë të gjerë, me supe të gjerë, me duar dhe këmbë të mëdha dhe i fortë.<sup>506</sup>

Fisi i xhurhumëve thanë: “Uji i zemzemit shpërtheu për arsye të Ismailit dhe nënës së tij. Nëse largohet nga këtu Ismaili, mund të thahet burimi dhe të mbesim pa ujë. Për ta mbajtur Ismailin në Meke duhet t’i gjejmë një vajzë të mirë dhe ta martojmë.”<sup>507</sup>

Menjëherë i hynë kësaj pune dhe shkuan tek fisi amerikana dhe atje gjetën vajzën e prijësit të fisit. Vajza ishte Xhedda, vajza e Sa’dit<sup>508</sup> ose Umare, vajza e Said bin Usame bin Ekil el-Amaliki.<sup>509</sup>

<sup>506</sup> *Peygamberler Târihi*, Asım KÖKSAL, v.1, f.233.

<sup>507</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.166.

<sup>508</sup> *El Bidaje ve’n-Nihaje*, Ibn Kethir, v.1, f.283.

<sup>509</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.47; *El Bidaje ve’n-Nihaje*, 1/283.

Ismaili [alejhis-selam] nuk kishte asnjë fëmijë nga kjo grua.<sup>510</sup> Umare ishte grua e ashpër, e paedukuar dhe me vese të këqija.<sup>511</sup>

Njëherë kur Ibrahimimi [alejhis-selam] erdhi për të vizituar gruan dhe birin e dashur në Meke, Ismaili [alejhis-selam] në atë kohë kishte dalë përreth kufijve të Haremit për gjueti për të plotësuar nevojat e shtëpisë (ushqimit).<sup>512</sup>

Ibrahimimi [alejhis-selam] e pyeti gruan e Ismailit [alejhis-selam], Umaren, se ku është burri? Ajo tha: “Ka dalë për të kërkuar riskun tonë.”

Ibrahimimi [alejhis-selam] e pyeti: “Si e keni gjendjen e jetesës?”

Gruaja e Ismailit tha: “Ne jemi në një gjendje të keqe, të mjeruar, kemi vështirësi të mëdha.”

Ibrahimimi [alejhis-selam] u shqetësua kur pa sjelljet dhe mënyrën se si sillej grua e Ismailit me mysafirët, e pakënaqur, e paedukatë dhe e ashpër, dhe kur iku Ibrahimimi [alejhis-selam] tha: “Kur të vijë zotëria juaj, jepi selamin tim dhe thuaj “duhet ndërruar pragu i derës”.

Kur erdhi Ismaili [alejhis-selam] në shtëpi ndjeu disa gjëra dhe pyeti: “A ka ardhur kush sot tek ne?”

Gruaja me një përgjigje nënçmuese tha: “Po, erdhi një burrë i moshuar dhe pyeti për ty dhe unë i tregova që nuk je në shtëpi. Pyeti rreth jetesës sonë dhe unë i tregova që jemi në vështirësi, pamjaftueshmëri.”

Ismaili [alejhis-selam] i tha: “A të tha ndonjë këshillë ty?”

<sup>510</sup> *Tabakat*, Ibn Sa’d, v.1, f.51-52.

<sup>511</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.167.

<sup>512</sup> Buhâri, *Ehâdithu ’l-Enbijâ*, 9 (1414); *El Bidaje ve’n-Nihaje*, 1/222; *Ibnu ’l-Ethir*, 1/98; *Târih-i Taberi*, 1/167.

Ajo tha: “Po, më tha të përcjell selamin e tij dhe më këshilloi që të them ty për të ndryshuar pragun e derës.”<sup>513</sup>

Pragu i derës ishte një shprehje figurative. Gruaja dhe pragu janë sigurimi i hyrjes në shtëpi. Ka përdorur këtë fjalë nga ngjashmëria e tyre.<sup>514</sup>

Ismaili [alejhis-selam] tha: “Ai që ka ardhur është babai im. Këshilla e tij është urdhri për divorcin tim nga ty,<sup>515</sup> urdhëro, shko tek familja jote.”<sup>516</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] kur erdhi herën tjetër për ta vizituar Ismailin në Meke, pa se arabët xhurhumë e flisnin arabishten fasih (të pastër dhe të qartë) dhe bukur. Si dhe kur pa se edhe biri i tij, Ismaili [alejhis-selam], kishte mësuar prej

<sup>513</sup> Buhâri, *Ehâdithu 'l-Enbijâ*, 9 (1414); *Ibnu 'l-Ethir*, 1/98; *El Bidaje ve'n-Nihaje*, 1/283; *Târih-i Taberi*, 1/167.

<sup>514</sup> *Kur'ân-i Kerim 'de Hz. İbrahim*, Ö. Ahmed Ömer, f.76.

<sup>515</sup> Tregon Ibn Omeri [radijallahu anhu]: “Isha i martuar me një grua. Babai nuk e donte atë grua dhe më urdhëroi të divorcohem prej saj, por unë nuk iu binda urdhrit të tij. Kur i tregova gjendjen Resulullahut [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] më tha: “*O Abdullah bin Omer! Divorcohu nga gruaja...*” Ebu Davud, Edeb, 129; Tirmidhi, *Talak*, 13; Ibn Mâxhe, *Talak*, 36 (2088).

Pavarësisht se Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në një hadith ka thënë: “*Nëse do të vinte ndonjë profet tjetër pas meje, ai do të ishte Omeri.*” (Tirmidhiu, *Menakib*, 68) Përsëri Abdullah Ibn Omeri [radijallahu anhu] u divorcua nga gruaja pas urdhrit të Profetit.

Në të dy shembujt shohim se djemtë janë ndarë nga gratë e tyre sipas dëshirës, pëlqimit të baballarëve të tyre. Por, pa dyshim, duhet të kemi kujdes dhe kursesi nuk duhet të harrojmë një realitet rreth këtyre dy ngjarjeve.

Rasti i parë i Ismailit [alejhis-selam]: Mospëlqimi i Ibrahimit [alejhis-selam] ishte një mospëlqim si baba, por, në të njëjtën kohë, edhe mospëlqimi i një profeti.

Rasti i dytë i Abdullah bin Omerit: Mospëlqimi i Omerit [radijallahu anhu] ishte një mospëlqim vetëm si baba, sepse ajo nuk ishte e pëlqyer dhe e duhur për birin e tij. Për këtë arsye edhe biri i tij ishte i mendimit me të drejtë që nuk mund të ndahet gruaja nëse nuk e pëlqen babai, por kur e pyeti Profetin [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe ai e këshilloi po njëjloj, urdhëroi për divorcim, atëherë bëri divorcin prej saj. Sepse Abdullah bin Omeri [radijallahu anhu] e dinte shumë mirë që: “*O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur.*” (En-Nisâ: 59)

<sup>516</sup> Buhâri, *Ehâdithu 'l-Enbijâ*, 9 (1414); *Târih-i Taberi*, 1/167; *Tibyan Tefsiri*, 1/89.

tyre fesahatin (përsosmëria e gjuhës) dhe belagatin (retorinë), atëherë e këshilloi të martohet me një vajzë prej tyre.

Ismaili [alejhiss-selam] e dëgjoji këshillën e babait, i pëlqeu vajza e Mudad bin Amr el-Xhurhumi dhe u martua me të.<sup>517</sup>

Vajza e kishte emrin Ra'le<sup>518</sup> ose Sej-jide dhe kishte gjuhë të ëmbël, fytyrë të buzëqeshur, me edukatë dhe e mirësjellshme.<sup>519</sup>

Pas një kohe Ibrahimimi [alejhiss-selam] erdhi përsëri për vizitë. Por përsëri Ismailin [alejhiss-selam] nuk e gjeti në shtëpi. E pyeti gruan e Ismailit për të dhe ajo u përgjigj: “Ka dalë për të kërkuar riskun tonë.”

Ibrahimimi [alejhiss-selam] e pyeti: “Si jeni?” dhe “si e keni gjendjen e jetesës?”

Ajo u përgjigj: “Ne jemi në mirësi dhe në bollëk” dhe më pas e falënderoi Allahun.

Ibrahimimi [alejhiss-selam] e pyeti: “Cili është ushqimi juaj?”

Ajo tha: “Mishi – gjuetia.”

Ibrahimimi [alejhiss-selam] e pyeti: “Çfarë pini?”

Ajo u përgjigj: “Ujë.”

Ibrahimimi [alejhiss-selam], duke i hapur duart, iu lut Allahut të Madhërishëm: “O Zoti im! Bëji të bereqetshëm-pjellorë mishin dhe ujin e tyre.”

Kur erdhi Ismaili [alejhiss-selam] në darkë në shtëpi e pyeti gruan: “A ka ardhur njeri sot në shtëpinë tonë?”

<sup>517</sup> *Ibnu'l-Ethir*, 1/117; *El Bidaje ve'n-Nihaje*, 1/283 *Târih-i Taberi*, 1/161.

<sup>518</sup> *Sireti Ibni Hisham*, v.1, f.39.

<sup>519</sup> *Târih-i Taberi*, 1/167; *El Bidaje ve'n-Nihaje*, 1/283.



Gruaja tha: “Po, erdhi një i moshuar me pamje të bukur.” dhe e lavdëroi me fjalë të mira atë. Më pas vazhdoi fjalën e saj, duke thënë: “Më pyeti për ty dhe unë i tregova gjendjen, më pas më pyeti për jetesën tonë dhe unë i tregova që jemi mirë.”

Ismaili [alejhis-selam] e pyeti: “A të këshilloi ndonjë gjë ty?”

Ajo tha: “Po, më këshilloi të përcjell selamin dhe i thuaj t’i dali për zot pragut të derës.”

Ismaili [alejhis-selam] tha: “Ai është babai im dhe pragu i derës je ti. Më ka urdhëruar mua që të dal ty për të zot.”<sup>520</sup>

Ndërsa në Zanafillë të Dhiatës së Vjetër të Biblës kjo tregohet në këtë mënyrë: “Sa për Ismaelin, unë ta kam plotësuar dëshirën. Ja, unë do ta bekoj, do ta bëj të frytshëm dhe do ta shumoj fort. Ai do të bëhet babai i dymbëdhjetë princërve dhe unë do të bëj prej tij një komb të madh.”<sup>521</sup>

Allahu i Madhërishëm i dhuroi Ismailit [alejhis-selam] me këtë grua dymbëdhjetë fëmijë.<sup>522</sup> Më i madhi e kishte emrin Nabit. Një tjetër e kishte Kajzer. Ndërsa të tjerët i kishin: Ezbul, Mebsha, Mishme, Mashi, Dima, Azer, Tajma, Jatur, Nebish dhe Kejzuma.<sup>523</sup>

Pasardhësit, fëmijët e Ismailit [alejhis-selam], në Bibël janë treguar në këtë mënyrë: “*Tani këta janë pasardhësit e Ismaelit, bir i Abrahamit, që egjiptasja Agar, shërbëtorja e Sarës, i kishte lindur Abrahamit. Këta janë emrat e bijve të*

<sup>520</sup> Buhâri, *Ehâdîthu 'l-Enbijâ*, 9 (1414); *Ibnu 'l-Ethir*, 1/98; *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, 1/283; *Târih-i Taberi*, 1/167.

<sup>521</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla* 17: 20.

<sup>522</sup> *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, 1/283; *Ibnu 'l-Ethir*, 1/117; *Târih-i Taberi*, 204.

<sup>523</sup> *Sireti Ibni Hisham*, 1/39; *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, 1/283.

*Ismaelit, sipas emrit të brezave të tyre: Nebajothi, i parëlin-duri i Ismaelit; pastaj Kedari, Abdeeli, Mibsami, Mishma, Dumahu, Masa, Hadari, Tema, Jeturi, Nafishi dhe Kedemahu. Këta janë bijtë e Ismaelit dhe emrat e tyre, sipas fshatrave dhe fushimeve të tyre. Ata qenë dymbëdhjetë princërit e kombeve të tyre përkatës. Por këto janë vitet e jetës së Ismaelit, gjithsej njëqind e tridhjetë e shtatë vjet; pastaj ai dha frymë dhe vdiq, dhe u bashkua me popullin e tij.”<sup>524</sup>*

---

<sup>524</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla 25: 12-17.*

**PJESA E SHTATË**  
**NDËRTIMI I QABES DHE ADHURIMI I**  
**HAXHIT**



## UDHËTIMI NË RRUGË TË ALLAHUT PËR HIR TË NDËRTIMIT TË SHTËPISË SË ALLAHUT

Një ditë prej ditësh Xhebrail Emini erdhi tek Halilullah Ibrahim dhe i tha: “O Ibrahim! Të urdhëron Zoti të ndërtosh një shtëpi!...”<sup>525</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] pa humbur kohë, menjëherë filloi udhëtimin për të çuar në vendin e duhur urdhrin e ndërtimit të “Bejtullahut”.<sup>526</sup>

Rruga mes Shamit dhe Mekës si gjithmonë ishte një rrugë e vështirë dhe e largët. Shkretëtira nuk dinte të mbaronte, por ai, kur u nda nga Babilonia gjithmonë me ndjenjat dhe dashurinë e madhe, thoshte: **“Ai tha: “Unë po shkoj te Zoti im. Ai do të më udhëzojë.”** (Es-Saffat: 99) Ai vazhdimisht falënderonte dhe lavdëronte Krijuesin e gjithësisë përgjatë rrugës në shkretëtirë dhe lugina. Zemra dhe shpirti i tij kur shkoj dhe kur u kthye nga ky udhëtim gjithmonë ishte bashkë me dashurinë e Allahut.

Ishte i lumtur dhe i kënaqur, sepse nga hapi në hap po i afrohej vendit që do të punonte për ndërtesën e të Dashurit, Allahut të Madhërishëm. Do të ndërtonte me duart e tij Bejtullahun nga e cila do të shpërthente mëshira, falja, paqja, nuri (drita) dhe udhëzimi i Allahut të Madhërishëm për njerëzinë.

Sa herë që mendonte ndërtimin e saj bashkë me djalin e tij, Ismailin [alejhis-selam], aq më shumë i shtohej dashuria

---

<sup>525</sup> *Târih-i Taberi*, 1/187; *Mukaddime*, Ibn Haldun, 2/474.

<sup>526</sup> *Ibnu 'l-Ethir*, 1/100; *Târih-i Taberi*, 1/188.

dhe dëshira për ta realizuar sa më parë, sepse kjo do të ishte një burim mëshire, nuri dhe një burim faljeje.

Kur arriti në Meke Ibrahimimi [alejhis-selam] e gjeti Ismailin [alejhis-selam] pranë një peme të madhe tek zemzemi duke rregulluar shigjetën e tij.<sup>527</sup>

Ismaili [alejhis-selam] kur pa babanë e tij shkoi menjëherë për ta takuar.<sup>528</sup> Si të gjithë prindërit dhe fëmijët për prindërit e tyre, u përqaftuan dhe përshëndetën duke u puthur.<sup>529</sup>

Ibrahimimi [alejhis-selam] i tha birit të tij: “O Ismail! Më ka urdhëruar Allahu një punë të madhe.”

Ismaili [alejhis-selam] tha: “Baba i dashur! Sille në vendin e duhur çfarë të ketë urdhëruar Krijuesi.”<sup>530</sup>

Ibrahimimi [alejhis-selam] tha: “Ti do të më ndihmosh në këtë punë.”

Ismaili [alejhis-selam] tha: “Baba i dashur! Unë të ndihmoj ty në çdo punë.”<sup>531</sup>

Ibrahimimi [alejhis-selam] tha: “Më ka urdhëruar Allahu i Madhërishëm të bëj një bejt (shtëpi) këtu” duke treguar një kodrinë pak të lartë.<sup>532</sup>

<sup>527</sup> Buhâri, *Ehâdîthu 'l-Enbijâ*, 9 (1414); *Ahbaru Meke*, Ezraki, f. 49; *Târih-i Taberi*, 1/188.

<sup>528</sup> *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, 1/224; *Ibnu 'l-Ethir*, 1/100.

<sup>529</sup> Buhâri, *Ehâdîthu 'l-Enbijâ*, 9 (1414); *Târih-i Taberi*, 1/188; *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, 1/224.

<sup>530</sup> *Tibyan Tefsiri*, 1/89; *Ibnu'l Esir*, 1/100; *Târih-i Taberi*, 1/188; *Ahbaru Meke*, Ezraki, f. 49.

<sup>531</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f. 49.

<sup>532</sup> Buhâri, *Ehâdîthu 'l-Enbijâ*, 9 (1414); *Kutubi Sitte*, 14/4992; *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, 1/224; *Târih-i Taberi*, 1/188.

Transmeton Ali bin Ebî Talib [radijallahu anhu]: “Kur i ka treguar në shpallje – vahj Allahu i Madhërishëm Ibrahimit [alejhis-selam] cilësinë e krijimit të qiejve, i ka thënë: “Bejtullahu që është në tokë, është i njëjtë në rrafshin me Bejt-i Ma’mur në qiell dhe me bejzat e tjerë në shtatë katet e qiejve. Është në atë nivel saqë nëse do të bie Bejt-i Ma’mur në tokë do të binte sipër Qabes.”<sup>533</sup>

Kanë thënë disa dijetarë nga selefët: “Në çdo kat të qiellit gjendet nga një vend bejt për adhurimin e krijesave të qiejve. Bejzat e qiejve janë sikur bejti – Qabeja që është në tokë.”<sup>534</sup>

Ka thënë i Dërguari i Allahut [sal-lallahu alejhi ve sellem]: “(Në Miraxh) *më është treguar Bejt-i Ma’mur. Në ditë atë e vizitojnë dhe në të bëjnë tavaf shtatëdhjetë mijë melekë.*”<sup>535</sup>

Allahu i Madhërishëm e urdhëroi Ibrahimin [alejhis-selam] të ndërtojë një bejt – shtëpi për faljen, lutjen e njerëzve sikur bejzat e melekëve në qiej. Kështu që atij iu tregua vendi që është vendosur për ndërtimin e saj nga koha që janë krijuar qiejt dhe toka.<sup>536</sup>

Xhebraili [alejhis-selam] ishte ai që i tregoi Ibrahimit [alejhis-selam] vendin e Bejtullahut.<sup>537</sup>

Ibrahimi dhe Ismaili [alejhimës-selam] filluan gërmimet e themelit për ndërtimin e Qabes. Gjatë hapjes së themeleve hasën me gurë aq të mëdhenj saqë ngritjen e njërit prej

<sup>533</sup> *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/237; *Mukaddime*, Ibn Haldun, 2/475.

<sup>534</sup> *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1, f. 237.

<sup>535</sup> Buhâri, *Bedü’l-Hak*, 6; Muslim, *İman*, 259, 264.

<sup>536</sup> *İslâm Târihi El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/237; *Târih-i Taberi*, 1/188.

<sup>537</sup> *Ibnu’l-Ethir*, 1/100; *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/237; *Târih-i Taberi*, 1/188.

tyre ndoshta mund ta bënin vetëm tridhjetë burra, kështu që filluan ta ndërtojnë Qaben përmbi ata gurë.<sup>538</sup>

Ibrahimi dhe Ismaili [alejhimës-selam] filluan ta ndërtojnë murin në një gjerësi prej 1.5 m.<sup>539</sup>

Gjatë punimeve të tyre nën temperaturat përvëluese të diellit, Allahu i Madhërishëm i dërgoi një re për t'i bërë hije dhe një fllad ere freskuese, me qëllim që t'i lehtësohen punimet e tyre.<sup>540</sup>

Ismaili [alejhis-selam] i sillte gurët dhe Ibrahimi [alejhis-selam] me to ndërtonte murin.<sup>541</sup>

***“Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt.”*** (Ali Imran: 96)

Transmeton Ebû Dherri [radijallahu anhu]: “E pyeta Resulullahun [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] se cili është mesxhidi i parë i ndërtuar në tokë?”

U përgjigj: *“Mesxhidi-Harami.”*<sup>542</sup>

Ibrahimi dhe Ismaili [alejhimus-selam] e ndërtuan bashkë Qaben! Njëri u shpëtua nga zjarri i Nemrudit, ndërsa tjetri nga therja, bërja kurban! Që të dy ishin të përkushtuar ndaj adhurimit të Allahut të Madhërishëm dhe përgjegjës për popullin... Janë ndërtuesit e shtëpisë së teuhidit (thirrjes në besimin, rrugën e Allahut), “shtëpisë së parë”, e vendit të adhurimit. Në të njëjtën kohë ky Harem është edhe simboli i dëlirësisë.

<sup>538</sup> Ahburu Meke, Ezraki, 1/60, 62-64; *Târih-i Taberi*, 1/188.

<sup>539</sup> *Mukaddime*, Ibn Haldun, 2/474; *T.D.V. İslâm Ansiklopedisi*, 24/15.

<sup>540</sup> *El-Kâmil Fi't-Târih*, Ibnu'l-Ethir, v.1, f.100.

<sup>541</sup> *Hadislerle Kur'ân-ı Kerim Tefsiri*, 2/555; *M.E.B. İslâm Ansiklopedisi*, 5/1110.

<sup>542</sup> Buhâri, *Enbijâ*, 10, 40; *Mesaxhid*, 1, 3; Muslim, *Mesaxhid*, 5 (520).



## BEJT-I ATËK/ SHTËPIA E LIRISË NDËRTIMI I THEMELEVE TË QABES

Në arabisht “Bejti Atik” ka kuptimin “shtëpi”. “Atik” e ka origjinën nga “Atk”. “Atk” do të thotë t’i japësh lirinë skllavit. Ndërsa “Atik” do të thotë të qenurit i lirë dhe i pavarur.<sup>543</sup> “Bejti Atik” do të thotë “shtëpi e lirë, e pavarur, paan-gazhim, shtëpia e lirisë...”<sup>544</sup>

*“Kur Ibrahim i dhe Ismaili ngritën themelet e Qabes, u lutën: “O Zoti ynë! Pranoje prej nesh (këtë vepër)! Me të vërtetë, Ti je Ai që dëgjon dhe di gjithçka!*

*O Zoti ynë! Na bëj të përrulur ndaj Teje! Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përrulur ndaj Teje! Tregona ritet e Haxhit dhe pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti!”* (El-Bekare: 127-128)

Atë ditë po i luteshin Allahut të Madhërishëm dy muslimanët më të devotshëm të botës. Ata po ndërtonin shtëpinë më të vlefshme të botës dhe kërkonin nga Krijuesi që t’ua pranonte këtë mundim, punë të mirë të tyre. Gjithashtu, kërkuan që të kenë edhe pasardhës të mirë, të cilët do t’i përrulen Allahut të Madhërishëm. Për këtë arsye u lutën, duke thënë:

*“...Bëj që edhe pasardhësit tanë të jenë të përrulur ndaj Teje! Tregona ritet e Haxhit dhe pranoje pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i pendimit, Mëshirëploti!*

*O Zoti ynë! Dërgo tek ata një të dërguar nga gjiri i tyre, që t’u lexojë shpalljet e Tua, t’ua mësojë Librin dhe Urtësinë*

<sup>543</sup> Haxh, Ali SHERIATI, f.50.

<sup>544</sup> Hz. Ibrahim 'le Buluşmak, Ali SHERIATI, f.125.

(rregullat e fesë) *e t'i pastrojë* (nga gjynahet)! *Vërtet, Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti!*<sup>545</sup>(El-Bekare: 128-129)

Profeti ynë, Muhamedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], e prezanton veten e tij në këtë mënyrë: “Unë jam lutja e gjyshit tim, Ibrahimit [alejhis-selam], sihariqi i Isait, birit të Merjemes, dhe ëndrra e nënës sime, Amines...”<sup>546</sup>

Kur muri i Qabes u lartësua, Ibrahimimi [alejhis-selam], tashmë, nuk kishte fuqi t'i ngrinte gurët e tjerë.<sup>547</sup> Ismaili [alejhis-selam] filloi t'i japë gurët nga poshtë, por, pasi filloi të vështirësohej edhe kjo,<sup>548</sup> atëherë Ismaili [alejhis-selam] pruri gurin “Makam-i Ibrahim” që vizitohet sot. Pastaj Ibrahimimi [alejhis-selam] filloi ta përdorë atë për skelë dhe kështu vazhdoi ndërtimin e murit.<sup>549</sup>

Sipas transmetimit, këtë gur Ibrahimimi [alejhis-selam] e ka ngritur dhe ulur sipas nevojës që kishte gjatë ndërtimit të murit.<sup>550</sup>

Guri “Makami Ibrahim” është një gur i lehtë, me një ngjyrë të përzier të verdhë dhe të kuqe, me një ngjyrë të përafërt me të bardhë, është 20 cm i trashë, me parametra 38-36 cm.<sup>551</sup>

Sipas një transmetimi nga Aliu [radijallahu anhu], Ibrahimimi [alejhis-selam] e ndërtonte aq shpejt Bejtullahun saqë për çdo ditë rritej sa gjatësia e një burrit.<sup>552</sup> E lartësuan

<sup>545</sup> Sûre Bekare: 128-129.

<sup>546</sup> *Musned*, 4/128; *Târih-i Taberi*, 1/189.

<sup>547</sup> *Ibnu 'l-Ethir*, 1/101; *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.51

<sup>548</sup> *Kutubi Sitte*, v.14, H. No: 4992.

<sup>549</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/238; *Târih-i Taberi*, 1/188; *Kutubi Sitte*, 14/4992.

<sup>550</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.51.

<sup>551</sup> *Hicaz Albümü*, Necati ÖZTÜRK, f.28.

<sup>552</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.51.

murin e Qabes nëntë zira<sup>553</sup> (1 zira është në një përmasë 24 gishta dhe 46.2 cm e gjatë).<sup>554</sup>

## VENDOSJA E HAXHER'UL-ESVEDIT NË KËNDIN E QABES

Ibrahimi [alejhis-selam] i tha Ismailit: “Më sill të vendos një gur që nuk i ngjan gurëve të tjerë<sup>555</sup> me qëllim që të jetë shenjë e fillimit të tavafit.”<sup>556</sup>

Ismaili [alejhis-selam] doli përreth për të kërkuar gurin dhe pas një kohë erdhi me një gur në dorë, por Ibrahimit nuk i pëlqeu ai gur.<sup>557</sup> Ismaili [alejhis-selam] iku përsëri për të gjetur një gur më të mirë se sa ai.

Pasi u vonua ardhja e Ismailit [alejhis-selam], Ibrahimi [alejhis-selam] doli për të kërkuar gurin duke parë majtas e djathtas. Atëherë mali më i afërt me Qaben ishte mali Ebu Kubejs. Kur doli Ibrahimi [alejhis-selam] atje dëgjoji një zë: “Tek unë gjendet një amanet i fshehur për ty.”<sup>558</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam], pasi dëgjoji zërin, u drejtua drejt malit Ebu Kubejs. Sipas transmetimit, ishte Xhebraili [alejhis-selam] ai që ia tregoi Ibrahimit [alejhis-selam] vendin e gurit Haxher'ul-Esved. Allahu i Madhërishëm më parë ia ka lënë amanet këtë gur malit Ebu Kubejs gjatë tufanit të Nûhut [alejhis-selam] dhe i ka dhënë urdhrin: “Kur të

<sup>553</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.51.

<sup>554</sup> *T.D.V. Islâm Ansiklopedisi*, 4/411

<sup>555</sup> *Peygamberler Târihi*, Muhamed Asım KÖKSAL, v.1, f.240.

<sup>556</sup> *El-Kâmil Fi't-Târih, Ibnu'l-Ethir* v.1 f.100.

<sup>557</sup> *Peygamberler Târihi*, Muhamed Asım KÖKSAL, v.1, f.202.

<sup>558</sup> *El-Kâmil Fi't-Târih, Ibnu'l-Ethir*, v.1, f.100.

shohësh mikun tim duke ndërtuar shtëpinë time, nxirre këtë gur dhe dhuroja atij.”<sup>559</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] e nxori gurin dhe shkoi e vendosi në këndin në të cilin fillon tavafi, ku ndodhet edhe sot.<sup>560</sup>

Ismaili [alejhis-selam] erdhi pas një kohe pa e gjetur gurin, por, kur e pa Haxherul Esvedin në këndin e fillimit të tavafit, e pyeti babain e tij: “Baba i dashur! Ku e gjete këtë gurë?”

Ibrahimi [alejhis-selam] u përgjigj: “Ma tregoi Allahu i Madhërishëm me anë të Xhebrailit në majën e malit Ebu Kubejs.”<sup>561</sup>

Haxherul Esvedi në një përmasë tridhjetë centimetra,<sup>562</sup> oval, në pamjen e një veze dhe me ngjyrë të përzier të zezë dhe të kuqe, është një gur lloj silikati i shkëlqyer me vija të verdha.<sup>563</sup>

Ka thënë Resulullahu [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: “*Haxher’ul Esvedi ka zbritur nga Xheneti. Ai ishte më i bardhë se qumështi, por e kanë nxirë gabimet e bijve të Ademit (njerëzve).*”<sup>564</sup>

“*Haxher’ul-Esved dhe Makami Ibrahim janë dy gurë nga gurët e Xhenetit. Sikur Allahu të mos i kishte hequr dritën atyre, do të ndriçonin vazhdimisht në mesin e lindjes dhe perëndimit.*”<sup>565</sup>

<sup>559</sup> Ahbaru Meke, Ezraki, f.53.

<sup>560</sup> El Mizan Fi Tefsir’il Kur’ân, M. Hüseyin TABATABAÏ, v.1, f.409.

<sup>561</sup> Ahbaru Meke, Ezraki, f.53.

<sup>562</sup> Hicaz Albümü, Necati ÖZTÜRK, f.26.

<sup>563</sup> İslâm Târihi, Hayati ÜLKÜ, f.46.

<sup>564</sup> Buhâri, Haxh, 50; Tirmidhi, Haxh, 49 (877); Nesâi, Haxh, 145

<sup>565</sup> Tirmidhi, Haxh, 49 (878).

Haxher'ul Esvedi është një kamerë shumë dimensionale që është vendosur në Kabe. Kjo kamerë nuk incizon vetëm sjelljet dhe pamjet e jashtme të njerëzve, por edhe gjendjen e brendshme të trurit dhe të zemrave të tyre. Kur të vijë Dita e Gjykimit dhe sikur do të shprehen dhe tregojnë çdo gjë duke u ardhur goja çdo gjëje edhe Haxher'ul Esved do të jetë dëshmitarë.

Ka thënë Resulullahu [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]: *“Haxher'ul Esvedi në Ditën e Kiametit do të vijë me një gjuhë të rrjedhshme dhe do të dëshmojnë për ata që e kanë përshëndetur atë duke iu përmbajtur besimit monoteist, Teuhidit (besimit të pastër islam).”*<sup>566</sup>

Profeti [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në Haxhin Veda e ka puthur këtë gur, i cili është pjesa e vetme që ka ngelur nga origjinaliteti i ndërtesës.<sup>567</sup> Sigurisht një respekt i tillë nuk

<sup>566</sup> Tirmidhi, *Haxh*, 113 (961)..

<sup>567</sup> Muret e Qâbes ishin shembur dhe prishur vende-vende prej përmbytjeve të ujërave, si dhe prej klimës së ftohtë dhe të nxehtit të madh. Për këtë arsye, u bë e nevojshme ndërtimi i saj përsëri. (*Islâm Târihi*, Mahmud ŞAKÎR, v.1, f.195).

Për të ndërtuar Qâben përsëri, së pari, u ble lënda e drurit të një anije të prishur të një tregtarit rrum me emër Bakum, në portin e Xhiddes.

Mekasit e ndërtuan Qâben në një lartësi prej 18 zira'. Brenda vendosën tetë shtylla. Vendosën edhe shkallë nga brenda për të dalë në çatinë e saj. I bënë, gjithashtu, edhe çatinë. (Hz. Muhamed ve *Evrensel Mesaj*, Prof. Dr. İbrahim SARIÇAM, f.72).

Ndërsa derën e Qâbes e bënë të lartë sa gjatësia e një burri, me qëllim që të merrnin brenda atë që donin dhe të mos merrnin atë që nuk dëshironin. (*Ahbaru Meke*, Ezrakî, f.159; *El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, 2/470).

Lëndët që përdorën për rindërtimin e Qâbes nuk mjaftuan për ta ndërtuar të njëjtë si Ibrahimî [alejhis-selam], për këtë arsye pjesa që shikon Rukni Iraki bashkë me Rukni Shami ngelën jashtë vetëm të rrethuara me një mur të vogël. (*El-Bidâje ve 'n-Nihâje*, Ibn Kethir, v.1 f.240).

është gjë tjetër vetëm se një respekt për Ibrahimin dhe Ismailin [alejhimus-selam]. Puthja e atij guri që është vënë me duart e profetit Ibrahim [alejhis-selam] nga ana figurative është sikur puth dorën e Ibrahimit [alejhis-selam].

Edhe sot e kësaj dite, muslimanët e puthin dhe e prekin Haxher'ul Esvedin për të bërë sunetin e Profetit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].

Për fat të keq, orientalistët hebre dhe të krishterë puthjen dhe shenjën e respektit ndaj Haxher'ul Esvedit mundohen të nxjerrin shenjë idhujtarie sikur ekziston tek besimet e tyre. Edhe në kohët e idhujtarisë në Arabi nuk ka pasur një veprim, një adhurim apo ndonjë gjë tjetër të ngjashme rreth Haxher'ul Esvedit.<sup>568</sup>

Në lidhje me këtë në Bibël shohim këto njohuri:

“Guri, që ndërtuesit kishin hedhur, u bë guri i qoshes.”<sup>569</sup>

“Jezusi u tha atyre: “A nuk keni lexuar kurrë në Shkrimet: “Guri, që ndërtuesit e nxorën të papërdorshëm, u bë guri i qoshes. Kjo është vepër e Zotit dhe është e mrekullueshme në sytë tanë?”

Prandaj, unë po ju them se juve do t’ju hiqet mbretëria e Perëndisë dhe do t’i jepet një kombi që do ta bëjë të japë fryt.”<sup>570</sup>

---

Përmasat e Qâbes në ditët e sotme janë: gjërësia nga ana e jashtme 10.7 x 12, lartësia është 15 m, muri nga toka deri në çati është 1.25 m i gjerë. Qâbja përbëhet prej 1614 gurëve të prerë me madhësi të ndryshme. (*Hicaz Albümü*, Necati ÖZTÜRK, f.23).

<sup>568</sup> *Hac Risalesi*, Mustafa İSLAMOĞLU, f.130-31.

<sup>569</sup> *Dhiata e Vjetër*; Psalmet, 118: 22

<sup>570</sup> *Ungjilli*; Mateu 21: 42-43

Haxher'ul Esved nuk puthet dhe nderohet me qëllim idhulli, por në shenjë respekti nga historia që ai përmban.<sup>571</sup>

Thënia e Omerit [radijallahu anhu] është tepër domethënëse kur e ka puthur këtë gur: “E di që ti je një gur që as nuk të jep as dëm dhe as dobi. Vallahi, nuk do të puthja ty, nëse nuk do të shikoja të Dërguarin e Allahut të Madhërishëm duke të puthur.”<sup>572</sup>

## RËNDËSIA/FILOZOPIA E NDËRTIMIT TË QABES

Qabe është një emër që rrjedh nga Ka’b. Ka’b do të thotë të qenurit i lartë dhe çelje (hap syth). Edhe Qabja çeli në mesin e shkretëtirës së Mekës. Është quajtur Kabe<sup>573</sup> nga forma e ndërtimit të saj, Mika’b, Murabba dhe katërkëndëshe.<sup>574</sup>

Qabja është katërkëndëshe që është e barabartë dhe nuk mban ndonjë anë më shumë sesa të tjerat. Pra, është në formë kubi, një kub katërkëndësh.<sup>575</sup>

***“Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi, pra, ngado që të ktheheni është Fytyra (ana) e Allahut. Vërtet, Allahu është Gjithëpërfshirës dhe i Gjithëdijshëm.”*** (El-Bekare: 115)

Qoshet e Qabes: pjesa juglindore është Rukni- Haxheri Esved, pjesa jugperëndimore Rukni Jemani, pjesa verilindore

<sup>571</sup> *Tanrı Buyruğu*, Ömer Rıza DOĞRUL, f.46; *Hac Risalesi*, Mustafa İSLAMOĞLU, f.131.

<sup>572</sup> Buhâri, *Haxh*, 57, 60; Muslim, *Haxh*, 249, 250.

<sup>573</sup> *Meydan Larousse*, v.10, f.319; *İslâm Târihi*, H. İbrahim HASAN, v.1, f.66.

<sup>574</sup> *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, v.1, f.208

<sup>575</sup> *Haxh*, Ali SHERIATI, f.50.

është Rukni Iraki dhe pjesa veriperëndimore është Rukni Shami.

Përmasat e Qabes që ndërtoi Ibrahim [alejhis-selam] janë këto: gjatësia mes Haxher'ul Esved deri tek Hatimi pranë Rukni Shami është 32 arshin/kut (1 kut është një përmasë 24 gishta dhe 46.2 cm e gjatë<sup>576</sup>). Ana e pasme, Rukni Garbi me Rukni Jemani, janë 31 kut, ndërsa Rukni Shami dhe Rukni Garbi është 22 kut. Si dhe Haxherul Esved me Rukni Jemani është 20 kut e gjerë.<sup>577</sup>

Nëse do të bëhet pyetja se përse është kaq e thjeshtë, pa rregullime dhe zbukurime? Atëherë, mund të themi se Allahu i Madhërishëm nuk ka formë, ngjyrë... Ai është larg çdo lloj modeli dhe mënyre që mund ta përfytyrojnë njerëzit.<sup>578</sup>

Ishte tepër e thjeshtë kjo shtëpi që u ndërtua nga Ibrahim [alejhis-selam]. Ishte aq e thjeshtë që nuk kishte as çati, as penxhere, as shtresë dhe as derë.<sup>579</sup>

Kishte dy vende dyersh, njëren nga ana lindore dhe tjetra nga ana perëndimore. Në kohët e më pasme sunduesi i Jemenit, Tubba, i vuri Qabes dyer që hapen dhe mbyllen me qëllim që të mos hynin kafshë brenda.<sup>580</sup>

Kjo ndërtesë që simbolizon teuhidin ka një ndërtim tepër të thjeshtë. Është një ndërtesë e shenjtë, e vogël dhe është aq origjinale saqë nuk krahasohet me asnjë ndërtesë tjetër në botë. Kjo ndërtesë e shenjtë që u ndërtua për herë të parë me dashuri, nënshtrim ndaj Allahut, besim, vullnet

<sup>576</sup> T.D.V. *İslâm Ansiklopedisi*, 4/411.

<sup>577</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.52.

<sup>578</sup> *Haxh*, Ali SHERIATI, f.50.

<sup>579</sup> *Asr-ı Saadet*, Mevlana ŞİBLİ, v.1, f.116.

<sup>580</sup> *Kâbe Târîhi*, Ahmet GÜRKAN, f.14.



etj. nga Ibrahimî [alejhîs-selam] është ruajtur gjithmonë edhe në shekujt e ardhshëm nga çdo rrezik.

## OBLIGIMI I HAXHIT PËR NJERËZIT

Qabja është pasqyrimi në tokë i Bejtul Ma'murit, të cilit në qiell i bëjnë tavaf melaiket.<sup>581</sup> Këtë vend të shenjtë, për herë të parë, e ka përdorur për vend adhurimi Ademi [alejhîs-selam].<sup>582</sup>

Këtë mund ta shohim shumë qartë edhe tek ajeti i Kur'anit, i cili thotë: ***“Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt.”*** (Ali Imran: 96)

Ka thënë Aliu [radijallahu anhu]: “Ka pasur edhe shtëpi të tjera përpara Qabes. Por kjo shtëpi është shtëpia e parë që është ndërtuar për t'u falur njerëzit.”<sup>583</sup>

***“Në të ka shenja të qarta (që janë): vendi i Ibrahimit (mekami Ibrahim); (fakti që) kush hyn në të është i sigurt; dhe vizita (për haxh) e kësaj Faltoreje (e cila është detyrë) për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd.”*** (Ali Imran: 97)

Në lidhje me këtë në Bibël shohim: “Lavdia e këtij tempulli të fundit do të jetë më e madhe nga ajo e të mëparshmit.” Thotë Zoti i ushtrive: “Dhe në këtë vend unë do të sjell paqen...”<sup>584</sup>

<sup>581</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/237; *Târih-i Taberi*, 1/187.

<sup>582</sup> *Hac Risalesi*, Mustafa İSLAMOĞLU, f.73.

<sup>583</sup> *Kur'ân-ı Kerim'de Hz. İbrahim*, Ö.Ahmed Ömer f.81.

<sup>584</sup> *Dhiata e Vjetër*; Hagai 2:9.

Nëse do e marrim “tempullin” “Bejt-i Makdis”, nuk përputhet me paqen që vjen po në të njëjtin vend të Biblës, sepse, siç e dimë, Bejti Makdis është shkatërruar e rrënuar shumë herë nga luftërat duke filluar me asirianët, më pas babilonasit, persët dhe, për herë të fundit, nga romakët. Kështu që Bejti Makdisi, për fat të keq, nuk ka qenë i qetë dhe në paqe, siç e shohim në gjendjen e Qabes në Mekë.

“Allahu e ka bërë këtë vend të respektueshëm deri kur ka krijuar qiejt dhe tokën. Ky vend është i nderuar deri në Ditën e Kiametit me nderimin e Allahut të Madhërishëm.”<sup>585</sup>

**“Në të ka shenja të qarta (që janë): vendi i Ibrahimit (mekami Ibrahim); (fakti që) *kush hyn në të është i sigurt; dhe vizita (për haxh) e kësaj Faltoreje (e cila është detyrë) për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd.*”** (Ali Imran: 97)

Pasi mbaroi ndërtimi i saj nga Ibrahim [alejhis-selam], Allahu i Madhërishëm e urdhëroi Ibrahimin që të ftojë njerëzit për ta vizituar Qaben.<sup>586</sup>

**“Thirri njerëzit për haxhillëk: ata do të vijnë në këmbë dhe me deve prej të gjitha viseve të largëta, që të dëshmojnë dobitë e tyre dhe të përmendin Emrin e Allahut në ditët e caktuara mbi kafshët (për kurban), të cilat ua ka dhuruar Ai. Hani nga ato (mishin) dhe ushqeni nevojtarin e varfër!**

**Pastaj, haxhinjtë le të pastrojnë trupin e tyre, le t’i kryejnë zotimet e tyre dhe le t’i vijnë rrotull Shtëpisë së lashtë.”** (El-Haxh: 27-29)

<sup>585</sup> Buhâri, Xhizje, 4, (69); Muslim, Haxh, 383; *El-Bidâje ve’n-Nihâje*, 1/237.

<sup>586</sup> *El-Kâmil Fi’t-Târih, Ibnu’l-Ethir*, v.1, f.101.

Ibrahimi [alejhis-selam] i tha Krijuesit të gjithësisë: “O Krijuesi im! Unë jam i moshuar, si do e dëgjojnë njerëzit zërin tim.”

Allahu i Madhërishëm i tha: “Mjafton që ti t’i thërrasësh. Unë e bëj të mundur dëgjimin e zërit tënd tek njerëzit.”<sup>587</sup>

Pas kësaj, Ibrahimi [alejhis-selam] doli në malin Ebu Kubejs dhe, duke vendosur gishtërinjtë në veshë, thirri me zë të lartë:<sup>588</sup> “O Njerëz! Allahu i Madhërishëm ua ka bërë farz vizitën e kësaj shtëpie të vjetër për t’u mbrojtur nga dënimi i zjarrit dhe për t’ju shpërblyer me Xhenet.”<sup>589</sup> O robërit e Allahut! Bindjuni Allahut! O robërit e Allahut! Përgjigjuni thirrjes së Krijuesit tuaj.”<sup>590</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] i përsëriti këto fjalë duke u kthyer nga ana lindore, perëndimore, jugore si dhe veriore.<sup>591</sup>

Këtë zë e ka dëgjuar çdo krijesë në tokë dhe në qiej, çdo burrë dhe grua, madje dhe fetusi në barkun e nënave.<sup>592</sup>

Ata që e njihnin dhe e besonin Allahun, iu përgjigjën kësaj thirrjeje. Obligimi i Haxhit është një obligim që ka filluar atë ditë dhe do të vazhdojë deri në Ditën e Kiametit. Ata që iu përgjigjën kësaj thirrjeje thanë: “Lebbejk, Allahume lebbejk, lebbejke la sherîke leke lebbejk, ine’l-hamde ve’n-ni’mete leke ve’l-mulk, la sherîke lek.”, që ka kuptimin: “Unë i përgjigjem thirrjes Tënde, o Allah! Unë i përgjigjem thirrjes

<sup>587</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.55; *Ibnu ’l-Ethir*, 1/101; *Târih-i Taberi*, 1/192.

<sup>588</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.55..

<sup>589</sup> *Ahkâm ’il-Kur’ân*, Imam Kurtûbî, v.12, f. 63.

<sup>590</sup> *Ibnu ’l-Ethir*, 1/101; *Tibyan Tefsiri*, 3/197.

<sup>591</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.55.

<sup>592</sup> *Kutubi Sitte Şerhi*, Prof. Dr. İbrahim CANAN, v.14, f. 230.

Tënde dhe u bindem urdhrave të Tu! Unë i përgjigjem thirrjes Tënde. Ti nuk ke asnjë shok a ortak. Unë i përgjigjem thirrjes Tënde. Gjithë lavdërimet, falënderimet dhe mirësitë janë vërtet vetëm për Ty! I gjithë sundimi është vetëm i Yti dhe Ti nuk ke asnjë shok a ortak.”<sup>593</sup> Në këtë mënyrë iu përgjigjen thirrjes besimtarët.<sup>594</sup>

## HIDHEN THEMELET E HAXHIT TË IBRAHIMIT

Transmeton Aliu [radijallahu anhu]: “Babë e bir (pasi mbaroi ndërtimi i Qabes) bënë lutje: “O Zoti ynë! Na trego sesi të bëjmë Haxhin.” Pas kësaj, Allahu i Madhërishëm e ngarkoi Xhebrailin [alejhis-selam] me këtë detyrë.”<sup>595</sup>

Xhebrail Emini i tregoi kufijtë e Haremit të Mekës, ka vendosur disa gurë shenjë kufiri dhe më pas i ka treguar se çfarë duhet bërë në Tavaf, Sa’j, Arafat, Mina dhe Muzdelife, ka therur kurban, shkurtimisht i ka treguar çdo gjë që është në lidhje me Haxhin, duke i vepruar më parë vetë.<sup>596</sup>

Ka thënë Resulullahu [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] në një hadith: “*Xhebraili [alejhis-selam] ia ka treguar dhe mësuar Ibrahimit [alejhis-selam] çdo gjë që duhet bërë në Haxh.*”<sup>597</sup>

<sup>593</sup> Buhâri, *Haxh*, 26; Ebu Davud, *Haxh*, 27 (1812); Muvatta, *Haxh*, 28.

<sup>594</sup> *Tibyan Tefsiri*, 3/197; *Ibnu ’l-Ethir*, 1/101; *Târih-i Taberi*, 1/193.

<sup>595</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.191.

<sup>596</sup> *Târih-i Taberi*, 1/190; *Ibnu ’l-Ethir*, 1/101.

<sup>597</sup> *El-Kâmil Fi’t-Târih*, *Ibnu ’l-Ethir*, v.1, f.101..

Haxhilerët e parë që iu përgjigjën (e bënë) thirrjes së Haxhit ishin Ibrahim [alejhisselam], Ismaili [alejhisselam] si dhe xhurhumët.<sup>598</sup>

***“Kush është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet sinqerisht Allahut, duke qenë bamirës dhe zbatues i fesë së pastër të Ibrahimit, të cilin Allahu e ka marrë për mik të ngushtë?!”***(En-Nisa: 125)

Ibahimi [alejhisselam] i tha lebbejk (i përgjigjem) thirrjes së Allahut të Madhërishëm në Mina dhe u bë imami i namazeve të drekës, ikindisë, akshamit, të darkës si dhe e kaloi natën atje duke falënderuar dhe kaluan në Arafat pasi e falën namazin e sabahut me xhemat në Mina.<sup>599</sup>

Ibrahim [alejhisselam] në Arafat, në vendin që gjendet sot xhamia Ibrahim, fali me xhemat “xhemi takdim”, namazin e drekës dhe të ikindisë.<sup>600</sup>

Më pas kaluan me haxhilerët në Xhebeli Rahme. Më rënien e diellit kaluan në Muzdelife. Edhe aty falën namazin e akshamit dhe të jacisë, “xhemi Te’hir”, dhe e kaluan natën aty. Në mëngjes falën namazin e sabahut dhe më pas kaluan në Mesh’ari’l Haram të Muzdelifes dhe në fund erdhi me njerëzit në Mina.<sup>601</sup>

Në Mina, pasi i tregoi njerëzve xhemret (Xhemre Ûla/Xhemra e Parë, Xhemre Vusta/Xhemra e mesme dhe Xhemre Akabe/Xhemre e Madhe), filluan të godasin shejta-

<sup>598</sup> *Tabakat’ul Kubra*, Ibn. Sa’d, v.1, f.48.

<sup>599</sup> *El-Kâmil Fi’t-Târih, Ibnu’l-Ethir*, v.1, f.101.

<sup>600</sup> *Peygamberler Târihi*, M. Asım KÖKSAL, v.1, f.206.

<sup>601</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, v.1, f.68-69.

nin me gurë. Më pas u tregoi haxhilerëve vendin e kurbanëve. Qethën flokët pas therjeve të kurbanëve dhe dolën nga ihrami.<sup>602</sup>

Thotë Allahu i Madhërishëm në Kur'anin Famëlartë:

***“Kujtoni kur Ne e bëmë Qabenë vendgrumbullimi dhe sigurie për njerëzit, duke thënë “Bëjeni vendin e Ibrahimit si vendfaljeje!” Ne i urdhëruam Ibrahimin dhe Ismailin: “Past-rojeni Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që e vizitojnë, që rrijnë aty për adhurim dhe që falen duke u përkulur dhe përrulur.”*** (El-Bekare: 125)

Më parë detyrimet e Haxhit bëheshin brenda Qabes, por, pasi u shtua numri i haxhilerëve, filloi të mos i përballojë kjo ndërtesë e vogël, kështu që arabët e zgjeruan territorin e saj dhe i vunë emrin Haram. Këtu filluan të falen namazet kur u bënë farz (obligim) me ardhjen e profetit të fundit, Muhamedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Për këtë arsye, edhe këtij vendi iu tha “Mesxhidil Haram”. Ky vend nuk ishte i rrethuar me ndonjë mur deri në kohën e halifes Omer [radijallahu anhu]. Omeri [radijallahu anhu] kur ishte halife bleu disa shtëpi që ishin rreth Mesxhidi Haramit dhe e pastroi, rregulloi si dhe e rrethoi me mur.”<sup>603</sup>

Aliu [radijallahu anhu] i shpjegon në këtë mënyrë urtësitë e zgjedhjes së Mekës për adhurimin e Haxhit: “Allahu i Madhërishëm këtë shtëpi që dëshiron rrotullimin e njerëzve përreth saj e ka vendosur në një vend të thatë e të nxehtë. Nëse dëshironte mund të urdhëronte ndërtimin e saj në një vend me gjelbërim, lule të shumta si dhe me pemë frutore nga të gjitha llojet. Por, atëherë, sprova nuk do të

<sup>602</sup> *El-Kâmil Fi't-Târih, Ibnu'l-Ethir, v.1, f.101.*

<sup>603</sup> *Doğuştan Günümüze Büyük İslâm Târihi, v.1, f. 129.*

ishte kaq e vështirë dhe e madhe. Atëherë njerëzit në vend që të shkonin për adhurim do të shkonin për shëtitje. Allahu i Madhërishëm i sprovon njerëzit me sprovë të vështira, me qëllim që të dali në pah se cili prej tyre është i sinqertë dhe do të veprojë dhe cili prej tyre nuk është i sinqertë. Nuk duhet harruar se edhe shpërblimet janë sipas vështirësive të sprovave. Njerëzit sprovohen për të përfutur sa më shumë nga mëshira e Allahut të Madhërishëm.”<sup>604</sup>

## LARGIMI I IBRAHIMIT [alejhis-selam] NGA MEKA

Ibrahimi [alejhis-selam] pasi solli në vendin e duhur obligimin e Haxhit u drejtua drejt Shamit, duke kaluar nga mali Hira për të shkuar tek Sara. Përgjatë rrugës pa se nga ana e Mekës livadhet, kodrinat dhe përrrenjtë ishin vende të thata, ndërsa nga ana e Shamit pa se kishte gjelbërim me ujë etj.

Kur e pa edhe një herë këtë dallim, Ibrahimi [alejhis-selam] tha me vete: “Si do të jetojë Ismaili [alejhis-selam] në këtë vend të thatë bashkë me familjen e tij?”<sup>605</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] iu lut Allahut të Madhërishëm për këtë vend dhe, në lidhje me këtë, le të shohim disa ajete nga Kur’ani Famëlartë:

Në suren El-Bekare:

***“Kujtoni kur Ne e bëmë Qabenë vendgrumbullimi dhe sigurie për njerëzit, duke thënë “Bëjeni vendin e Ibrahimit si vendfaljeje!” Ne i urdhëruam Ibrahimin dhe Ismailin: “Past-rojeni Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që e vizitojnë, që***

<sup>604</sup> Kur’ân’da *Însaniyet Mektebi*, Âyetullah Murtaza Mutahhari, f. 41-42.

<sup>605</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherih-et-Taberi, v.1, f.190.

*rrijnë aty për adhurim dhe që falen duke u përkulur dhe përlulur.”*

*“Kur Ibrahim i lut: “Zoti im, bëje këtë vend qytet të sigurt dhe furnizoji me prodhime banorët e tij, ata që besojnë në Allahun dhe në jetën tjetër!” - Allahu tha: “Atë që nuk beson, për pak kohë do ta bëj që të kënaqet e pastaj do ta hedh në dënimin e zjarrit.” Eh, sa vendbanim i keq që është ai!”*(El-Bekare: 125-126)

Në suren Tîn:

*“Për fikun dhe ullirin, për malin e Sinait. Dhe për këtë Qytet të sigurt (Mekën).”*(Et-Tîn: 3)

Në suren Kurejsh:

*“Shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri për të mbrojtur fisin Kurejsh, për t’i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë. Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes), i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike.”*(El-Kurejsh: 1-4)

Ka thënë Allahu i Madhërishëm në një hadith kudsî: “Kur Unë i kam dhënë një robî Tim shëndet dhe pasuri të bollshme dhe nëse nuk më vjen Mua (tek Shtëpia ime) një herë në pesë vite, vërtet ai është i privuar.”<sup>606</sup> Edhe në këtë hadith kudsî shikohet shumë qartë rëndësia e vizitës së Qabes.

*“... Ne i urdhëruam Ibrahimin dhe Ismailin: “Pastrojeni Shtëpinë Time (Qabenë) për ata që e vizitojnë, që rrijnë aty për adhurim dhe që falen duke u përkulur dhe përlulur.”*(El-Bekare: 125)

Ibrahimi [alejhîs-selam] iku në Sham dhe më vonë kur erdhi koha e Haxhit, këtë herë ai erdhi nga Bejti Makdis në

<sup>606</sup> Shejh Albani e ka bërë sahih këtë hadith.



Bejtul Atik duke bërë Haxhin bashkë me nënën tonë, Sara, dhe me të birin, Is'hakun [alejhis-selam], dhe u kthyen përsëri në Palestinë pasi mbaruan Haxhin.<sup>607</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam], gjatë viteve që i kishin mbetur nga jeta e tij, shkonte në Meke për të vizituar Ismailin [alejhis-selam] dhe, pasi bënte Haxhin, kthehej përsëri në Sham.<sup>608</sup>

### KALIMI NË BOTËN TJETËR/VDEKJA E SARËS DHE IBRAHIMIT [alejhis-selam]

Nëna jonë, Sara, ndërroi jetë në Habrun kur ishte në moshën njëqind e tridhjetë vjeçe.<sup>609</sup>

Habra ose Hebron gjendet mes Vadi'l-Kurra dhe Shamit, është nga vendet e Bejtu'l-Makdisit (Kudsit), është quajtur edhe Halil'ur-Raman.<sup>610</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] e varrosi atë në krahinën Kenan të Palestinës<sup>611</sup> në shpellën Makpelahut.<sup>612</sup> E bleu atë vend 400 gr. argjend dhe kështu e varrosi në të Sarën.<sup>613</sup>

Ismaili [alejhis-selam] erdhi nga Meka në Hebron për të ngushëlluar babain e tij, Ibrahimin, dhe vëllain e tij, Is'hakun [alejhimus-selam], për nënën Sara.<sup>614</sup>

<sup>607</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.74.

<sup>608</sup> *Ahbaru Meke*, Ezraki, f.74.

<sup>609</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/252; *Ibnu'l-Ethir*, 1/123.

<sup>610</sup> *T.D.V İslâm Ansiklopedisi*, 21/268; *Peygamberler Târîhi*, M. Asım KÖKSAL, 1/221.

<sup>611</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f. 194.

<sup>612</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla*, 25: 9.

<sup>613</sup> *Misrîh Hâxher*, Abdulhamid Xhûde es-Sahhar, f.155.

<sup>614</sup> *Misrîh Hâxher*, Abdulhamid Xhûde es-Sahhar, f.165.

Sara ishte ajo që u zbukurua me besimin e vërtetë të Allahut të Madhërishëm, duke kundërshtuar idhujtarinë dhe të gjithë vështirësitë e Nemrudit. Nuk ishte thjesht vetëm gruaja e Ibrahimit [alejhis-selam], por ajo ishte, gjithashtu, edhe ndihmëse e tij në thirrjen e teuhidit të Allahut të Madhërishëm. Tregoi një shembull dhe guxim të madh, duke e martuar vetë Ibrahimin [alejhis-selam] me shërbëtoren e saj, Haxheren, kur ajo vetë nuk lindi fëmijë. Qëndroi gjithmonë pranë Ibrahimit [alejhis-selam] në çdo vështirësi që hasi gjatë gjithë jetës. Luajti një rol të rëndësishëm në thirrjen e grave në Islam. Nga fundi i jetës së saj, Allahu i tregoi një mrekulli duke lindur Is'hakun [alejhis-selam] prej të cilit erdhën pasardhësit e Bijve të Israilit.

Sara është një gur kriter i rëndësishëm në qëndrimin e patundshëm të saj në revolucionin e gruas. Allahu i Madhërishëm i mundësoi dhe e nderoi të jetë gruaja e një profeti dhe nëna e një profeti.

Ibrahimi [alejhis-selam], pas vdekjes së Sarës, u martua me një grua nga krahina Kenan me emrin Katura/Keturah binti Yaktur.<sup>615</sup>

Ibrahimi [alejhis-selam] bëri gjashtë fëmijë me këtë grua. Emrat e tyre ishin: Buad, Merran, Medjan, Kejsan, Ustuva dhe Shuah.<sup>616</sup>

Emrat e tyre në Bibël kalojnë në këtë mënyrë: “Pastaj Abrahami mori një grua tjetër, që quhej Keturah. Kjo i lindi Zimranin, Jokshanin, Medanin, Madianin, Ishbakun dhe Shuahin.”<sup>617</sup>

---

<sup>615</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 25: 1; *Târih-i Taberi*, 1/194.

<sup>616</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.194.

<sup>617</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 25: 1-2.

Ibrahimi [alejhis-selam] erdhi për të banuar në qytezën Hebron/Halil'ur-Rahman të Palestinës<sup>618</sup> kur ishte njëqind e shtatëdhjetë e tre<sup>619</sup> ose njëqind e shtatëdhjetë e pesë<sup>620</sup> vjeç.

Ismaili [alejhis-selam], kur i shkoi lajmi i gjendjes së përkeqësuar të Ibrahimit [alejhis-selam], mori kalin më të mirë dhe shkoi nga Meka në Hebron. Aty takoi babanë e tij dhe përpara vdekjes ia bënë hallall njëri-tjetrit hakun nëse kishin.<sup>621</sup>

Kjo ishte hera e tretë që Ismaili [alejhis-selam] vinte në Hebron. Hera e dytë ka qenë në martesën e vëllait, Is'hakut [alejhis-selam].<sup>622</sup>

Bibla në lidhje me këtë thotë: “Këto janë vitet e jetës së Abrahamit: ai jetoi gjithsej njëqind e shtatëdhjetë e pesë vjet. Pastaj Abrahami dha frymën e fundit dhe vdiq në pleqëri të mbarë, i shtyrë në moshë dhe i ngopur me ditë dhe u bashkua me popullin e tij. Dhe bijtë e tij, Isaku dhe Ismaeli, e varrosën në shpellën e Makpelahut në arën e Efronit, biri i Zoarit, Hiteut, që ndodhet përballë Mamres.”<sup>623</sup>

Në Kur'anin Famëlartë shikojmë disa këshilla rreth fesë (Islamit) që jetoi Ibrahimi dhe në lidhje me pasardhësit dhe duanë e tij:

<sup>618</sup> *Peygamberler Târihi*, Prof. Dr. Ismâil YİĞİT, f.237; *Kur'an-ı Kerim Meâl ve Tefsiri*, Ömer Nasuhi Bilmen, 1/116-117.

<sup>619</sup> *Kur'ân-ı Kerim'de Hz. İbrahim*, Ömer Ahmed Ömer, f.108.

<sup>620</sup> *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/174; *Ibnu'l-Ethir*, 1/124 - *Tefsirli Peygamberler Tarihi*, Ubeydullah Bayram TEKİN, f. 85.

<sup>621</sup> *Peygamberler Târihi*, Prof. Dr. Ismâil YİĞİT, f.237; *Kur'an-ı Kerim Meâl ve Tefsiri*, Ömer Nasuhi Bilmen, 1/116-117.

<sup>622</sup> *Mısrılı Hâxher*, Abdulhamid Xhûde es-Sahhar, f.165.

<sup>623</sup> *Dhiata e Vjetër - Zanafilla 25:7 - 9; Târih-i Taberi*, 1/202; *M.E.B. İslâm Ansiklopedisi*, 5/879

*“Fesë së Ibrahimit i shmanget vetëm ai që e nënçonon vetveten. Ne e zgjodhëm atë në këtë botë, kurse në botën tjetër ai do të jetë ndër të mirët. Kur Zoti i tij i tha: “Përulu!” - ai u përgjigj: “Ju përula Zotit të gjithësisë!”*

*Ibrahimi ua dha këtë porosi fëmijëve të tij; po ashtu edhe Jakubi: “O bijtë e mi! Pa dyshim, Allahu ka zgjedhur për ju fenë e vërtetë, prandaj mos vdisni ndryshe veçse duke qenë muslimanë të nënshtruar ndaj Atij!”(El-Bekare: 130-132)*

*“(Kujtoje) kur Ibrahimi tha: “O Zoti im, bëje të sigurt këtë qytet dhe më ruaj mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve!*

*O Zoti im, ata kanë shmangur shumë njerëz (nga rruga e drejtë). Ai që më pason mua, është i fesë sime; ndërsa për atë që më kundërshton mua, Ti, me të vërtetë, je Falës dhe Mëshirëplotë.”(Ibrahim: 35-36)*

*“O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet!” (Ibrahim: 40)*

## NDEROHET ISMAILI [alejhis-selam] ME PROFETËSI

Ibrahimi [alejhis-selam] bashkë me birit e tij, Ismailin [alejhis-selam], e pastruan Shtëpinë e Allahut dhe e mbanin të pastër vetëm për adhurim ndaj Allahut të Madhërishëm. Më pas këtë detyrë ia dorëzoi Ismailit [alejhis-selam] dhe i tha: “O Ismail! Le të jetë ky vend i yti dhe i pasardhësve të tu deri në Ditën e Kiametit.”<sup>624</sup>

<sup>624</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.199..

Ismaili [alejhîs-selam] e vazhdoi shërbimin dhe punët e Haxhit pas babait të tij.<sup>625</sup>

Allahu i Madhërishëm e nderoi me profetësi sinqertitetin dhe nënshtrimin e plotë të Ismailit [alejhîs-selam] ndaj Allahut. Këtë mund ta shohim edhe në ajetet e mëposhtme:

*“Po ashtu, udhëzuam edhe Ismailin, Eljesain, Junusin dhe Lutin secilin prej tyre e ngritëm mbi të gjithë njerëzit. Ne zgjodhëm dhe udhëzuam në rrugë të drejtë edhe disa nga paraardhësit, pasardhësit dhe vëllezërit e tyre.*

*Ky është udhëzimi i Allahut, të cilin Ai ia jep kujt të dojë nga robërit e Vet. Por, nëse ata adhurojnë zota të tjerë, do t’u humbë çdo gjë nga ajo që kanë bërë.*

*Këta janë ata që u kemi dhënë Librin, Urtësinë dhe Profecinë. E, nëse ata (banorët e Mekës) i mohojnë këto, Ne do t’ia besojmë një popull tjetër që nuk do t’i mohojë.”* (El-En’am: 86-89)<sup>626</sup>

*“Trego në Libër për Ismailin! Vërtet, ai ishte i sinqertë në premtimet e veta, (Është i pari që i ka nxjerrë mëkatarët-zullumqarët nga Meka)<sup>627</sup> ishte i dërguar dhe profet. Trego në Libër për Ismailin! Vërtet, ai ishte i sinqertë në premtimet e veta, ishte i dërguar dhe profet.*

*Ai e urdhëronte popullin e vet që të falte namazin e të jepte zeqatin dhe ishte i mirëpritur te Zoti i vet. Trego në Libër për Idrizin! Ai ishte njeri i së vërtetës dhe profet.”* (Merjem: 54-56)

Allahu i Madhërishëm e dërgoi profet Ismailin [alejhîs-selam] për Mekën dhe vendet përreth Mekës, në të cilët

<sup>625</sup> Mukaddime, Ibn Haldun, v.2, f.475.

<sup>626</sup> Târih-i Taberi, 1/161.

<sup>627</sup> Târihi Jakubî, 1/221 - Peygamberler Târihi, M. Asım KÖKSAL, 1/234

banonin xhurhumët, amalika dhe fiset e Jemenit, Ma'rib dhe Hadramevt. Ai i ftoi ata pesëdhjetë vjet në Islam. Disa prej tyre e besuan dhe disa prej tyre nuk e besuan. Por mund të themi se besimtarët ishin një numër i vogël.<sup>628</sup>

Allahu i drejtohet profetit të fundit, Muhamedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], duke i treguar rreth profetëve dhe besimtarëve të kohëve më parë në këtë mënyrë:

“(Kujto) *Ismailin, Idrizin dhe Dhulkiflin! Të gjithë këta kanë qenë të durueshëm.*”(El-Enbija: 85)

“*Kujtoje edhe Ismailin, Eljesain dhe Dhulkiflin. Të gjithë ata kanë qenë nga besimtarët e zgjedhur e të mirë.*”(Sad: 48)

“*Mirëpo të thelluarit në dituri prej tyre (hebrenjve) dhe besimtarët besojnë në atë që të është shpallur ty (o Muhamed) dhe në atë që është shpallur para teje. Posaçërisht atyre që falin namazin, atyre që ndajnë zeqatin dhe atyre që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Kiametit, me siguri do t'u japim shpërblim të madh.*”(En-Nisa: 163)

Ismaili [alejhis-selam] ndërroi jetë në moshën njëqind e tridhjetë e shtatë vjeç, dyzet vjet pas babait të tij<sup>629</sup> dhe u varros pranë varrit ku ishte varrosur nëna e tij, Haxherja.<sup>630</sup>

Paqja dhe mëshira e Allahut të Madhërishëm qoftë mbi të dhe mbi të gjithë profetët e dërguar.

<sup>628</sup> *Târih-i Taberi*, 1/204; *Tha'lebi*, f.100; *Ibnu'l-Ethir*, 1/125.

<sup>629</sup> *Târih-i Taberi*, 1/162; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/193; *Kenzu'l-Umâl*, 11/490; *Ibni Sa'd*, *Tabakat*, 1/52

<sup>630</sup> *Sireti Ibni Hisham*, 1/6; *Ibni Sa'd*, *Tabakat*, 1/52; *Ahbaru Meke*, *Ezraki*, f.86; *Ibnu'l-Ethir*, 1/125; *Târih-i Taberi*, 1/162; *El-Bidâje ve'n-Nihâje*, 1/193; *Mukaddime*, *Ibn Haldun*, 2/474.

## NDERIMI ME PROFETËSI I IS'HAKUT [alejhis-selam]

Is'haku [alejhis-selam] e dëgjoji këshillën e babait Ibrahim [alejhis-selam] dhe, kur ishte rreth moshës dyzetvjeçare, nuk mori vajzë nga kaneanët, por u martua me Refeka binti Betvil dhe ajo lindi dy djem, Ajsin dhe Jakubin.<sup>631</sup>

Is'haku [alejhis-selam] e martoi Ajsin me Besime binti Ismail, sipas këshillës që i dha vëllai i madh, Ismaili [alejhis-selam], përpara se të ndërronte jetë.<sup>632</sup>

Is'haku [alejhis-selam], pasi ndërroi jetë babai i tij, Ibrahim [alejhis-selam], filloi thirrjen për në teuhid në Sham/Palestinë dhe përreth kaneanëve kur, njëkohësisht, Ismaili [alejhis-selam] predikonte në Hixhaz.<sup>633</sup>

Këtë mund ta shohim edhe në ajetin e Kur'anit:

***“Ne i dhamë atij lajmin e mirë për (lindjen e) Is'hakut, profet prej njerëzve të mirë. Dhe Ne e bekuam atë dhe Is'hakun, por midis pasardhësve të tyre, përveç punëmirëve, ka edhe të atillë që e kanë ngarkuar dukshëm veten me gjynahe.”*** (Es-Saffat: 112-113)

***“Ne i dhuruam atij Is'hakun dhe Jakubin. Që të dy këta i udhëzuam në rrugë të drejtë, ashtu siç patëm udhëzuar më parë Nuhun. Ndër pasardhësit e tij Ne udhëzuam Daudin, Sulejmanin, Ejubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë punëmirët.”*** (El-En'am: 84)

<sup>631</sup> *Dhiata e Vjetër* - Zanafilla 24:1-67 ; Hakim-i *Mustedrek*, 11/557; *Târih-i Taberi*, 1/205; *Ibnu'l-Ethir*, 1/126.

<sup>632</sup> *Tarih-i Taberi*, 1/205; *Ibnu'l-Ethir*, El-Kâmil Fi't-Tarih, 1/125; *Peygamberler Târihi*, Prof. Dr. Ismâil YİĞİT, f.291.

<sup>633</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.205

Is'haku [alejhis-selam] ndërroi jetë në krahinën Kenan në moshën njëqind e gjashtëdhjetë<sup>634</sup> ose njëqind e tetëdhjetë vjeç, u varros në vendin ku u varros nëna dhe babai i tij në shpellën Makpelah.<sup>635</sup>

Paqja dhe mëshira e Allahut të Madhërishëm qoftë mbi familjen e Ibrahimit [alejhis-selam], e cila ishte një familje ndriçuese në rrugën e teuhidit, një familje e palëkundur dhe shembullore në rrugën e Allahut të Madhërishëm.

---

<sup>634</sup> *Târih-i Taberi*, Muhamed Xherir et-Taberi, v.1, f.206.

<sup>635</sup> *Ibnu'l-Ethir*, 1/127; *Târih-i Taberi*, 1/206.



## PËRFUNDIM

Profetët gjatë gjithë historisë kanë predikuar në njësimin dhe adhurimin e Allahut të Vetëm. Ata më parë Islamit e kanë përjetuar në vetvete dhe më pas kanë ftuar njerëzit e tjerë, duke filluar më parë nga më të afërmit e tyre. Qenien shembull të Ibrahimit [alejhis-selam] dhe familjes së tij e shikojmë edhe në Kur'anin Famëlartë, në të cilin Allahu thotë: ***“Shembull i mrekullueshëm për ju është Ibrahim dhe ata që kanë qenë me të...”*** (El-Mumtehine: 4)

Allahu i Madhërishëm e nderoi Sarën dhe Haxheren me nderin e të qenit gra të një profeti si dhe nëna të profetëve. Pavarësisht se ato ishin gra të profetit prej profetëve më të mëdhenj, përsëri edhe ato u sprovuan me sprovat më të rënda gjatë jetës së tyre. Sara u sprovua me disa sprova të mëdha gjatë jetës, siç mund të përmendim shterpësinë (nuk lindte fëmijë) e saj. Tentimin e faraonit për ta marrë shërbëtore kur shkoi në Egjipt si dhe sprova të tjera, por Allahu i Madhërishëm e ndihmoi dhe e bëri të suksesshme në jetë përballë sprovave, sepse, kur të tjerët e hodhën në zjarr Ibrahimit [alejhis-selam], Sara ishte ajo që iu përgjigj thirrjes së tij në atë ditë tepër të vështirë. Kështu që si pasojë e këtij besimi të pastër dhe tevekul-lit të plotë që zotëroi gjatë gjithë jetës, pavarësisht moshës tepër të moshuar përsëri Allahu i Madhërishëm urdhëroi që ajo të lindë, të bëhet nënë dhe një nënë profeti, gjithashtu Allahu i Madhërishëm e ndihmoi duke ia ngrirë (paralizuar) dorën faraonit sa herë që tentoi të zgjasë dorën drejt saj.

Të njëjtin shembull e shohim edhe tek Haxherja, e cila u sprovua me sprovë tepër të vështira. U sprovua duke u lënë e vetme me djalin e vogël, Ismailin [alejhisselam], në shkretëtirën përvëluese të Mekës së pabanuar, pa ujë dhe pa ushqim. Gjithashtu, u sprovua me tentimin e bërjes kurban të birit të vetëm të saj, por Haxherja, përballë çdo sprove, tregoi një shembull tepër të madh me durimin, tevekul-lin dhe besimin që mbante në zemër për Allahun. Prandaj, edhe Allahu i Madhërishëm e ndihmoi atë duke ia forcuar durimin, duke ia shtuar besimin në shpresën e Allahut dhe më pas Allahu i Madhërishëm urdhëroi shpërthimin e ujit më të mirë të botës në mesin e shkretëtirës përvëluese të Mekës, i cili do të vazhdojë deri në Kiamet dhe ky ujë iu dha si shpërblim i besimit, nënshtrimit dhe tevekul-lit të plotë në Allahun e Madhërishëm të Haxheres.

A mund të vlejnjë më shumë kënaqësitë dhe bukuritë e përkohshme sesa lumturitë dhe bukuritë e përhershme. Për fat të keq në ditët e sotme besimtarët e besimtare të sulmohen padrejtësisht nga katër anët e botës, por askush nga besimtarët e besimtare nuk duhet të harrojë se ata që e mbajnë të gjallë në mendje dhe në zemër shembullin e Ibrahimit [alejhisselam] dhe familjen e tij (Sarën, Haxheren, Ismailin...) me ndihmën e Allahut të Madhërishëm asnjë zjarr kurrrë nuk mund ta djegë besimtarin e besimtare pavarësisht mundimeve, qëllimeve, dëshirave dhe kurtheve të armiqve.

Nga cilësitë e besimtarit përballë urdhrave dhe ndalimeve të Allahut të Madhërishëm është pëlqimi dhe nënshtrimi i plotë me fjalën: “*...Ne dëgjojmë dhe bindemi...*” (El-Bekare: 285) dhe për ata besimtarë/e të tillë Allahu i Madhërishëm në Kur’an thotë: “*Dhe do t’i japë risk prej nga nuk e*

***pret. Allahu i mjafton kujt do që mbështetet tek Ai.***” (Et-Talak: 3)

Gjithashtu, nuk duhet harruar se ata besimtarë e besimtare që i mbështeten caktimit të Allahut plotësisht si Haxherja, edhe nëse do të sprovohen me skamje pasurie të thellë dhe janë në mesin e shkretëtirës përvëluese, herët apo vonë do t’u vijë uji freskues dhe ndihma e Allahut të Madhërishëm.

Pa dyshim, shembulli i familjes së Ibrahimit [alejhisselam] është një shembull i gjallë dhe mësimdhënës, udhëzues dhe ndriçues për ne në këtë kohë tepër të vështirë ku në të cilën triumfon padrejtësia përballë drejtësisë, gënjeshtër dhe ryshfeti përballë sinqeritetit si dhe triumfi i shumë gjërave të lidhura me materialen përballë shumë vlerave të vërteta.

Allahu, Krijuesi i botëve, na ka lajmëruar në Kur’anin Famëlartë në suren El-Bekare, duke thënë: ***“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave!”*** (El-Bekare: 155)

Mund të nënkuptohet shumë qartë që sprovat me fatkeqësi etj. janë tepër të vështira. Ata që e shikojnë këtë botë (sprovat e saj etj.) me syrin e atyre që e hodhën Ibrahim Halilullah në zjarr, do të vëreni se ata nuk shikojnë, mendojnë dhe besojnë gjë tjetër pos pritjes së djegies prej zjarrit të madh. Por ne si besimtarë nuk duhet të harrojmë si dhe duhet të jemi të zgjuar duke ditur se, pavarësisht deshirës së madhe të armiqve për ta djegur në zjarrin më të madh, përsëri ishte urdhri i Allahut të Madhërishëm, i Cili e urdhëroi zjarrin të bëhet i freskët dhe lulishte, siç e shohim edhe në ajetin e Kur’anit: ***“Ne thamë: “O zjarr, bëhu i ftohtë dhe***


***shpëtim për Ibrahimin! Ata deshën ta lëndonin, por Ne i bëmë të dështonin.***”(El-Enbija: 69)

Pa dyshim, sprovat e njerëzve të lartë janë akoma më të vështira, por edhe ata/ato janë në dinjitetin e vërtetë që kjo botë është e shkurtër dhe e përkohshme për këtë arsye sytë, zemrat dhe mendja e tyre nuk janë të dhëna pas saj. Kur i godet ndonjë fatkeqësi besimtarët, ata menjëherë durojnë, duke besuar se sprovat janë burime pastruese si dhe shkak lartësimi shpirtëror akoma më lart për ta. Sepse këtë e shikojmë edhe në vazhdimin e ajetit të sures El-Bekare, në të cilin tregohet shumë qartë përfundimi i duruesve: “... ***Prandaj, përgëzoji të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: “Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!” Ata do të shpërblehen me bekim dhe mëshirë nga Zoti i tyre; ata janë në rrugën e drejtë!***”(El-Bekare: 155-157)

***“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit.***”(El-Bekare:153)

## MODELET NDRIÇESE – HAXHERJA DHE SARA

Familja e Ibrahimit (a.s) dhe pasardhësit (Profetet) që rrjedhin nga familja e tij.



## BIBLIOGRAFIA

*Adayış Risalesi*, Mustafa İSLAMOĞLU, Bot. Denge Yay. 1992 İstanbul.

*Ahbaru'n-Nisa*, Ibnu'l XHEVZI, Bot. Şule Yay. 2000 İstanbul.

*Allah'a Davette Peygamberlerin Metodu*, Muhamed Surur bin Naif Zejne'l-ABIDIN, Bot. Guraba Yay. 1994 İstanbul.

*Alternatif Tıp ve Şifa Sofrası*, Mustafa ÖZER, Bot. Bürde Yay. 2001 İstanbul.

*Ana Britanica*, Bot. Milliyet Yay. 1990 İstanbul.

*Ayetler Işığında Halil'ür-Rahman İbrahim ([alejhisselam].) ve Urfa Tarihçesi*, Sabri YAZAR, Bot. Zafer Matbaası - 1989 İstanbul.

*Aziz Kur'an*, Prof. Dr. Muhamed HAMIDULLAH, Bot. Beyan Yay. 2000 İstanbul.

*Barnabas İncili (Ungilli Barnabas)*, Bot. Kültür Basın Yayın Birliği, İstanbul (nuk ka datë botimi).

*Başlangıçtan Günümüze İslam Tarihi*, Hayati ÜLKÜ, Bot. Çile & Türdav Yay. 1977 İstanbul.

*Büyük İslam Tarihi Asr-ı Saadet*, Mevlana ŞİBLİ, Bot. Eser Neşriyat, 1977 İstanbul.

*Büyük İslam İlmihali*, Ömer Nasuhi BİLMEN, Bot. Yay. 1985 İstanbul.

*Celal ve Cemal Aynasında Kadın*, Cevadi Amûlî, Bot. İnsan Yay. 1996 İstanbul.

*Çağımızda Kadın Sorunu*, Mustafa YAĞMUR, Bot. Beyan Yay. 1988 İstanbul.

*Çocuk ve Ruh Sağlığı*, Prof. Dr. Atalay YÖRÜKOĞLU, Bot. Özgür Yay. 1998 İstanbul.

*Delilleriyle Aile İlmihali*, Prof. Dr. Hamdi DÖNDÜREN, Bot. Altınoluk Dergisi Yay. İstanbul.

*Doğuştan Günümüze Büyük İslam Tarihi*, Heyet, Bot. Çağ Yay. 1992 İstanbul.

*Doğu ve Batı Arasında İslam*, Ali İzzet BEGOVIÇ, Bot. Nehir Yay. 1992 İstanbul.

*Edebu'l-Mufred (Müslüman Ferdin Edeb ve Ahlakı)*, Imam BUHARİ, Bot. Konevi Yay. 2007 Konja.

*El-Xhamiu'li-Ahkami'l-Kur'an*, Imam KURTÛBÎ, Bot. Buruç Yay. 1999 İstanbul.

*El-Kamil Fi't-Tarih*, Ibnu'l-ETHIR, Bot. Bahar Yay. 1985 İstanbul.

*El-Mevarid (Arapça-Türçe Lügat)*, Mevlüt SARI, Bot. Bahar Yay. 1982 İstanbul.

*El-Milel ve'n-Nihal (Dinler Tarihi)*, Muhamed bin Abdulkerim esh-SHEHRISTANI, Bot. Yeni Akademi Yay. 2006 İstanbul.

*El-Mizan Fi Tefsir'il Kur'an*, Muhamed Husejin TABATABAI, Bot. Kevser Yay. 1998 İstanbul.

*Emanet ve Ehliyet*, Yusuf KERİMOĞLU, Bot. Akit Gazetesinin Hediyesidir, 1998 İstanbul.

*Fahreddin er-Razî ve Nübüvvet Anlayışı*, Mehmet KELEŞ, (Teza e Masterit – e pa botuar), 2008 Konja.

*Fetevaji Hindijje*, Bot. Akçağ Yay. 1987 Ankara.

*Fıkhi Açıdan Kur'an Kıssaları*, Abdullah ACAR, Bot. e kopi Ofset, 2010 Konya.

*Fi Dhilal-il Kur'an*, Prof. Dr. Sejjid KUTUB, Bot. Hikmet Yay. 1986 İstanbul.

*Furkan Tefsiri*, Mahmut HIXHAZÎ, Bot. İlim Yay. Tarihsiz İstanbul.

*Hadislerle İslam Terğib ve Terhib*, Hafiz el-MUNDHIRI, Bot. Hikmet Yay. 1986 İstanbul.

*Hadislerle Kur'an-ı Kerim Tefsiri*, Ibn KETHIR, Bot. Çağrı Yay. 1991 İstanbul.

*Haxh*, DR. Ali SHERIATI, Bot. Bir Yay. 1988 İstanbul.

*Hac Risalesi*, Musafa İSLAMOĞLU, Bot. Denge Yay. 1998 İstanbul.

*Hak Dini Kur'an Dili*, Elmalı'lı Muhamed Hamdi Yazır, Bot. Azim Yay. 1994 İstanbul.

*Hatemu'l-Enbija*, Ali Himet BERKİ - Osman KESKİOĞLU, Bot. Diyanet İşleri Başkanlığı Yay. 1968, Ankara.

*Hayatu's-Sahabe*, Muhamed Jusuf KANDEHLEVI, Bot. Divan Yay. 1991 İstanbul.

*Hazreti İbrahim Aleyhisselam*, Mahmud Sami RAMAZANOĞLU, Bot. Erkam Yay. 1980 İstanbul.

*Hz. İbrahim ve Hz. Lût*, Harun YAHYA, Bot. Araştırma Yay. 2003 İstanbul.

*Hz. Adem'den Bugüne İslam Tarihi*, M. ŞAKİR, Bot. Kahraman Yay. 1995 İstanbul.

*Hz. İbrahim'le Buluşmak*, Dr. Ali SHERIATI, Bot. Fecr Yay. 2005 Ankara.

*Hz. Muhamed'in Hayatı*, Martin LINGS, Bot. İz Yay. 1994 İstanbul.

*Hz. Muhamed ve Evrensel Mesajı*, Prof. Dr. İbrahim SARIÇAM, Bot. Diyanet İşleri Başkanlığı Yay. (Botimi i 5) 2007 Ankara.



*Hicaz Albümü Fotoğraflarla Kutsal Topraklar*, Necati ÖZTÜRK, Bot. Diyanet İşleri Başkanlığı Yay. (Botimi i 2), 2006 Ankara.

*İbadet İlmihali*, Adem KARATAŞ, Bot. Serhat Kitabevi. (Botimi i 3) 2009 Konja.

*İslam Tarihi*, Siret-i Ibn-i HISHAM, Bot. Kahraman Yay. 1985 İstanbul.

*İslam Tarihi El-Bidaje Ve'n-Nihaje*, Ibn KETHIR, Bot. Çağrı Yay. 1994 İstanbul.

*İslam Tarihi*, Prof. Dr. Hasan İbrahim HASAN, Bot. Kayıhan Yay.1987 İstanbul.

*İslam Fıkhı Ansiklopedisi*, Prof. Dr. Vehbe ZUHAYLI, Bot. Risale Yay. 1994 İstanbul.

*İbrahimi Okuyuş*, Ahmet BAYDAR, Bot. Beyan Yay. 1998 İstanbul.

*İman ve İnkâr Aynasında İki Kadın*, Muhamed Ali KUTUB, Bot. İlke Yay. 1999 İstanbul.

*İslam Öncesi Meke Dönemi*, Prof. Dr. İhsan Süreyya SIRMA, Bot. Beyan Yay. 1991 İstanbul.

*İslam Ansiklopedisi*, Bot. Türkiye Diyanet Vakfı Yay. 2000 Ankara.

*İslam Ansiklopedisi*, Bot. Şamil Yay. 2000 İstanbul.

*İslam Ansiklopedisi*, Bot. Milli Eğitim Basımevi, 1993 İstanbul.

*Kadın Oradaydı Vahiy Sürecinde Kadın Rollerini Sara ve Hacer*, Yıldız RAMAZANOĞLU, Bot. Elest Yay. 2004 İstanbul.

*Kabe ve Meke Tarihi*, Eb'ul Velid M. El-EZRAKI, Bot. Çağrı Yay. 1980 İstanbul.

*Kaynaklarıyla Ahkam Hadisleri*, Celal YILDIRIM, Bot. Uysal Kitabevi 1992 Konya.

*Kelam*, Şerafeddin GÖLCÜK- Süleyman TOPRAK, Bot. Tekin Dağıtım 2001 Konya.

*Kisasi Enbija ve Tevarihî Hulefa*, Ahmet Cevdet Paşa, Bot. Bedir Yay. 1976 İstanbul.

*Kitab-ı Mukaddes ve Kur'an-ı Kerim'de Hz. İbrahim (alehis-selam.)*, Musa YILMAZ, (Artikull i pa botuar), 1997 ERZURUM.

*Kitab-ı Mukaddes*, Bot. Kitabı Mukaddes Şirketi, 1997 İstanbul.

*Kur'an Mesajı Meal-Tefsir*, Muhamed ESED, Bot. İşaret Yay. 1996 İstanbul.

*Kur'an Yolu Türkçe Meal ve Tefsir*, (Heyet), Bot. Diyanet İşleri Başkanlığı Yay. 2003 Ankara.

*Kur'an-ı Kerim'e Göre Peygamberler ve Teuhid Mücadelesi*, Prof. Dr. İsmail Lütfi ÇAKAN - N. Mehmed SOLMAZ, Bot. Altınoluk Dergisi Yay. 1994 İstanbul.

*Kur'an'da Peygamberler ve Peygamberimiz*, Abdulfettah TABBARA, Bot. Milli Gazete'nin Hediyesidir. 1998 İstanbul.

*Kur'an'da Asr-ı Saadette ve Günümüzde Öncü Müslüman Kadınlar*, Adem KARATAŞ, Bot. Sena Yay. 1991 Konya.

*Kur'an'a Göre Hz. Musa Firavun ve Yahudiler*, Dr. Necati KARA, Bot. Seha Neşriyat 1991 İstanbul.

*Kur'an'da Peygamber Kıssaları*, Prof. Dr. Sejjid KUTUB, Bot. Sağlam Yay. 1992 İstanbul.

*Kurani i Madhërishëm*, Përktheu nga gjuha arabe: Prof. Hasan I. Nahi, Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2006.

*Kutubi Sitte Muhtasari*, Prof. Dr. Ibrahim CANAN, Bot. Akçağ Yay. 1992 İstanbul.

*Kutsal Kitap (Tevrat, Zebur, İncil)*, Bot. Yeni Yaşam yay. 2009 İstanbul.

*Mekeye Giden Yol*, Muhamed ESED, Bot. İnsan Yay. 1988 İstanbul.

*Metalib ul-Alije*, Ibn Haxher el-ASKALANÎ, Bot. Ocak Yay. 2006 İstanbul.

*Meydan Larousse*, Bot. Sabah Gazetesi Yay. 1992 İstanbul.

*Mısırlı Hacer*, Abdulhamid Xhûde es-SAHHAR, Bot. İnkılab Basım Yayım 2011 İstanbul.

*Mukaddime*, Ibn Haldun, Bot. Yeni Şafak Gazetesi Hediyesidir 2004 İstanbul.

*Muvatta*, (Përkth. Nga Arabishtja në Turqisht: Abdullah PARLIYAN), Bot. Konya Kitapçılık 2008 Konja.

*Nimet-i Islam El-Haxh*, Mehmed Zihni SALAH, Bot. Bilici Kitabevi 1979 İstanbul.

*Peygamberler Tarihi*, Ahmed BEHCET, Bot. Uysal Yay. 1995 Konya.

*Peygamberler Tarihi*, M. Asım KÖKSAL, Bot. Türkiye Diyanet Vakfı Yay. 1995 Ankara.

*Peygamberler Tarihi*, Prof. Dr. İsmail YİĞİT, Bot. Kayıhan Yay. 2005 İstanbul.

*Peygamberler Tarihi*, Mehmet DİKMEN - Bünyamin ATEŞ, Bot. Yeni Asya Yay. 1981 İstanbul.

*Peygamberler Tarihi*, M. Faruk GÜRTUNCA, Bot. Sağlam Kitabevi 1978 İstanbul.

*Peygamberler Tarihi*, Doç. Dr. A. Lütfi KAZANCI, Bot. Zaman Yay. 1997 İstanbul.

*Peygamberler Tarihi*, Osman KESKİOĞLU, Bot. Serhat Kitabevi 2009 Konya.

*Rahmete Yolculuk*, Mehmed ALAGAŞ, Bot. İnsan Dergisi Yay. 1999 İzmir.

*Rasûlüllah'ın Anesi ve Hanımları*, Prof. Dr. Aishe A. Bintu'sh-SHATI, Bot. Uysal Yay. 1992, Konya.

*Reddu'l-Muhtar Ale'd-Durri'l-Muhtar*, Ibni ABIDIN, Bot. Şamil Yay. 1982 İstanbul

*Safvetu't-Tefasir*, Muhamed Ali es-SABUNÎ, Bot. Ensar Neşriyat 1990 İstanbul.

*Sahih-i Buhari Muhtasarı Tecrid-i Sarih Tercemesi*, Bot. Diyanet İşleri Başkanlığı Yay. 1980 Ankara.

*Sahih-i Buhari Muhtasarı Tecrid-i Sarih Tercemesi*, Abdullah Fevzi KOCAER, Bot. Hüner Yay. 2003 Konya.

*Sahih-i Muslim*, Ahmed DAVUDOĞLU, Bot. Sönmez Neşriyat 1977 İstanbul.

*Sunen-i Tirmidhi*, (Përkth. Nga Arabishtja në Turqisht: Abdullah PARLIYAN), Bot. Konya Kitapçılık 2004 Konya.

*Sistem İçinde Kadın*, Cihan AKTAŞ, Bot. Beyan Yay. 1991 İstanbul.

*Şeytanın Tuzakları*, Ibn Kajjim el-XHEVZİJE, Bot. Uysal Kitabevi 1993 Konya.

*Şeytanın Hileleri (Telbis'ü İblis) Şeytan İnsanları Nasıl Aldatır*, Ibnu'l-Xhevzi Ebu'l-Ferexh Abdurrahman bin Ali, Bot. Kahraman Yay. 2002 Ankara.

*Tarih-i Taberi Tercemesi*, Muhamed bin Xherir Et-Taberi, Bot. Can Kitabevi 1973 Konya.

*Tarih Boyunca Teuhid Mücadelesi ve Hz. Peygamber*, Mevdudi, Bot. Pınar Yay. 1983 İstanbul.

*Tefsir-i Kebir Mefatihü'l-Gajb*, Fahrudin Er- Razi, Bot. Akçağ Yay. 1989 İstanbul.

*Tefhimu'l-Kur'an*, Mevdudi, Bot. İnsan Yay. 1996 İstanbul.

*Tibyan Tefsiri*, Ayıntabi Mehmet Efendi, Bot. Akpınar Yay. 1987 İstanbul.

*Yeni Rehber Ansiklopedisi*, Bot. Türkiye Gazetesi Yay. 1993 İstanbul.

<http://www.shqiptarortodoks.com/tekste/biblike/diodati-i-ri.html> Datë: 29.07.2013 / 18:20

## AUTORI

Lindi në vitin 1984 në Ndroq të Tiranës. Shkollën 8-vjeçare e mbaroi në vendlindje. Në vitin 1998 filloi Medresen H. Mustafa Varoshi në Durrës. Në vitin 2002 mbaroi medresenë dhe shkoi në Stamboll të Turqisë për studimet e larta. Më parë mësoi gjuhën turke në Universitetin e Stambollit dhe më pas filloi fakultetin teologjik në Universitetin Selçuk të Konjës. Në vitin 2009 mbaroi fakultetin teologjik dhe në të njëjtin vit filloi masterin në të njëjtin universitet në Institutin e Shkencave Sociale në degën “Filozofi dhe Shkencat Fetare – Historia e Feve”. Në vitin 2011 mbaroi masterin dhe në të njëjtin vit filloi studimet e doktoraturës në Institutin e Shkencave Sociale në degën “Filozofi dhe Shkencat Fetare” në Universitetin Sakarja të qytetit Sakarja.

### **Shkrimet dhe përkthimet e botuara:**

#### **Revistë:**

*Lexo! Por Çfarë?* Përkthim, Etika 4 / Takim te Kur’ani.

*Historia e djaloshit trim që dëshironte të bënte një tatuazh*, Etika 26 / Mes Frikës dhe Shpresës.

*Të jesh e suksesshme nuk do të thotë të jesh e lumtur!*  
Familja 9 (shtator 2010)/ Prindërit tanë janë amanet!

*Gratë pishtare në jetën tonë!* Familja 7-8 (Korrik-Gusht 2011) / Ramazani muaji i dobive të shumta!

*Arnavutluk’ta misionerlik faaliyetleri*, Sefine Dergisi / Ekonomi ve Ahlak (Mart 2011)

*Şehir ve Medeniyet*, Sefine Dergisi / Şehir ve Medeniyet (Ekim 2011).

*Hayra erişmenin yolu: İNFAK*, Sefine Dergisi / Dünyamızda Yoksulluk (Aralık 2012).

**Libër:**

Pishtarja e Ndershmërisë MERJEMJA sipas Biblës dhe Kur'anit Famëlartë. Përkthyes & Redaktues, Shtëpia Botuese, Progresi, 2011.





## Përmbajtja:

HYRJE .....	9
-------------	---

### PJESA E PARË

PËRPPJEKJET NË TEUHID, “PËR NJËSIMIN E ZOTIT”, TË IBRAHIMIT [alejhis-selam] .....	15
LINDJA E IBRAHIMIT [alejhis-selam] .....	17
KUPTIMI DHE RËNDËSIA E EMRIT IBRAHIM .....	18
BËRJA SYNET E IBRAHIMIT [alejhis-selam] SIPAS BIBLËS.....	19
STRUKTURA E SHOQËRISË NË KOHËN E IBRAHIMIT [alejhis-selam] .....	22
PËRPPJEKJET E IBRAHIMIT [alejhis-selam] NË TEUHID, “NË THIRRJEN E NJËSIMIT TË ZOTIT” .....	23
IBRAHIMI [alejhis-selam] E FILLON THIRRJEN NGA BABAI I TIJ .....	25
IBRAHIMI REFUZON ADHURIMIN E TRUPAVE QIELLORE .....	29
THIRRJA E IBRAHIMIT [alejhis-selam] DËGJOHET NGA NJË MASË E MADHE E POPULLIT .....	31
IBRAHIMI [alejhis-selam] FTON NEMRUDIN NË NJËSIMIN E ZOTIT TË VËRTETË.....	34
IBRAHIMI [alejhis-selam] I THEU TË GJITHË IDHUJT .....	37
SPROVOHET IBRAHIMI [alejhis-selam] ME HEDHJEN NË ZJARR.....	44

### PJESA E DYTË

HIXHRETI /EMIGRIMI I IBRAHIMIT DHE MARTESA ME SARAN.....	53
IBRAHIMI EMIGRON NË HARRAN BASHKË ME BESIMTARËT .....	55
MARTESA E IBRAHIMIT [alejhis-selam] ME SARAN .....	59
DËRGIMI I PROFETIT LUT [alejhis-selam] TEK POPULLI SODOM .....	62
SARA NË PALLATIN MBRETËROR TË MBRETIT MIZOR.....	66
ANALIZË E NJË TRANSMETIMI .....	70

## **PJESA E TRETË**

MARTESA E IBRAHIMIT [alejhis-selam] ME HAXHEREN .....	81
KUSH ËSHTË HAXHERJA? .....	83
MREKULLIA QË IU DHA FAMILJES SË IBRAHIMIT .....	85
MARTESA E IBRAHIMIT [alejhis-selam] ME HAXHEREN .....	88
MOSMARRËVESHJET MES SARËS DHE HAXHERES .....	95
XHELOZIA DHE GRUAJA .....	96
PLANI I ALLAHUT NË KRIJIMIN E FAMILJES SË IBRAHIMIT .....	99

## **PJESA E KATËRT**

EMIGRIMI I HAXHERES .....	103
NDARJA QË ERDHI PAS URDHURIT HYJNOR .....	105
EMIGRIMI I HAXHERES .....	108
MEKEJA, VENDI I URDHËRUAR .....	111
PËRBËRJA GJEOGRAFIKE E MEKËS .....	112
NË MEKË HIDHEN THEMELET E FESË MONOTEISTE .....	114
KTHIMI I IBRAHIMIT [alejhis-selam] .....	118
HAXHERJA ËSHTË NJË MONUMENT I NËNSHTRIMIT DHE MBËSHTETJES NË ALLAH .....	120
HAXHERJA ËSHTË MONUMENTI I BESIMIT PËRBALLË INTRIGAVE (MASHTRIMEVE) TË SHEJTANIT .....	123
SPROVAT JANË PËR TË NGRITUR GJENDJEN SHPIRTËRORE TË NJERIUT .....	126

## **PJESA E PESTË**

PËRPJEKJA DHE SHPËRBLIMI .....	131
LODHJA DHE TEVEKULI (MBËSHTETJA NË ALLAH) .....	133
SHPËRBLIMI I HAXHERES ME UJIN ZEMZEM .....	136
SHKRETËTIRA DHE ZEMZEMI .....	142
PAVDEKSHMËRIA E HAXHERES GJATË RITEVE TË HAXHIT ....	145
HAXHERJA PËRZGJIDHET PËR MËSIMIN/PËRGATITJEN E ISMAILIT .....	147
VENDOSJA E XHURHUMËVE PËRRETH UJIT ZEMZEM .....	148

## **PJESA E GJASHTË**

ALLAHU KËRKON PREJ IBRAHIMIT [alejhis-selam] TË FLIJOJË/ BËJË KURBAN BIRIN E TIJ, ISMAILIN [alejhis-selam] .....	155
HISTORIA E ADHURIMIT TË KURBANIT .....	157
IBRAHIMI [alejhis-selam] ZOTOHET SE DO TA BËJË KURBAN NËSE DO T’I LINDË NJË DJALË .....	161
Ç’ËSHTË ËNDRRA? .....	164
ËNDRRA E IBRAHIMIT [alejhis-selam].....	167
SHFAQJA DHE VESVESET E SHEJTANIT.....	169
HAXHERJA PËRBALLË NJË SPROVE TË MADHE .....	173
SHEJTANI DORËZOHET PËRBALLË BESIMIT TË ISMAILIT .....	176
BESIMI DHE QËNDRUESHMËRIA E NËNSHTRIMIT TË ISMAILIT [alejhis-selam] NDAJ KRIJUESIT TË GJITHËSISË .....	178
GJITHË NATYRA DHE KRIJESAT PO SHIKONIN TENTIMIN PËR FLIJIMIN E ISMAILIT [alejhis-selam].....	183
SHPËRBLIMI I MONUMENTEVE TË NËNSHTRIMIT TË IBRAHIMIT DHE ISMAILIT.....	187
BËHET PREJ FAMILJEVE TË ZGJEDHURA FAMILJA E IBRAHIMIT .....	190
NATYRA, THELBI I KURBANIT NË BIBËL.....	192
CILI DO TË FLIJOHEJ, ISMAILI APO IS’HAKU? .....	195
IBRAHIMI [alejhis-selam] SHPËRBLEHET ME DHËNIEN E IS’HAKUT [alejhis-selam] .....	204
RINIA E ISMAILIT [alejhis-selam].....	210
HAXHERJA I THA LEB-BEJK (I PËRGJIGJEM) THIRRJES SË KRIJUESIT TË SAJ .....	213
HAXHERJA ËSHTË AJO QË.....	215
MARTESA E ISMAILIT [alejhis-selam] DHE PASARDHËSIT E TIJ.....	217

## **PJESA E SHTATË**

NDËRTIMI I QABES DHE ADHURIMI I HAXHIT.....	223
UDHËTIMI NË RRUGË TË ALLAHUT .....	225
PËR HIR TË NDËRTIMIT TË SHTËPISË SË ALLAHUT .....	225
BEJT-I ATÎK/ SHTËPIA E LIRISË .....	229
NDËRTIMI I THEMELEVE TË QABES.....	229

VENDOSJA E HAXHER'UL-ESVEDIT NË KËNDIN E QABES .....	231
RËNDËSIA/FILOZOFIA E NDËRTIMIT TË QABES.....	235
OBLIGIMI I HAXHIT PËR NJERËZIT .....	237
HIDHEN THEMELET E HAXHIT TË IBRAHIMIT.....	240
LARGIMI I IBRAHIMIT [alejhis-selam] NGA MEKA .....	243
KALIMI NË BOTËN TJETËR/VDEKJA E SARËS DHE IBRAHIMIT [alejhis-selam] .....	245
NDEROHET ISMAILI [alejhis-selam] ME PROFETËSI.....	248
NDERIMI ME PROFETËSI I IS'HAKUT [alejhis-selam].....	251
PËRFUNDIM .....	253
BIBLIOGRAFIA .....	258



Në çdo periudhë të historisë, popujt janë zhytur në batakun e injorancës dhe imoralitetit, madje, me vetëdije, janë larguar nga vlerat e larta jetësore. Allahu i Madhërishëm, nëpërmjet disa njerëzve të zgjedhur, i ka shpëtuar ata popuj dhe ua ka treguar rrugën e vazhdimit të jetës së ndershme, ose ndarjes ndershmërisht prej saj. Profetë e njerëz të besueshëm, dijetarë dhe njerëz të mirë. Ishin pikërisht këta, që Allahu i Madhërishëm zgjodhi si pishtarë pararojë, për të ndriçuar popujt nga netët që po errësoheshin.

ISBN 978-608-216-111-2



9 786082 161112

